



# Raporti Vjetor 2023

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>SHËNIMI I AVOKATIT TË POPULLIT .....</b>	<b>7</b>
<b>KREU I.....</b>	<b>8</b>
<b>KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL .....</b>	<b>8</b>
<b>KREU II .....</b>	<b>10</b>
<b>ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT TË RSH-SË PËR VITIN 2022 NGA INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT.....</b>	<b>10</b>
2.1 Të intensifikojë reagimin institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues .....	10
2.2 Të zgjerojë shtrirjen gjeografike të sesioneve informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave me qëllim rritjen e numrit të ankesave/kërkesave që vijnë drejtpërdrejt nga fëmijët. ....	11
2.3 Të sigurojë mekanizma të brendshëm për zhvillimin e inspektimeve/monitorimeve të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, që të mos operojë vetëm në bazë projektesh, si dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.....	12
2.4 T'i kushtojë vëmendje të veçantë hartimit të rekomandimeve ndaj strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit si rrjedhojë e konstatimeve të vazhdueshme të mosrespektimit të të drejtave themelore të shtetasve. ....	13
2.5 Të zbatohet plani i masave për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave dhe lirive, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë. Të zhvillohen takime të metejshme për të siguruar gjithëpërfshirje, si dhe të publikohet plani i masave në faqen e internetit dhe t'i dërgohet Kuvendit për dijeni. ....	14
2.6 T'i propozojë Kuvendit zhvillimin e seancave të posaçme degjimore me institucione publike për të adresuar problematika konkrete. ....	16
2.7 Të hartojë masa për të forcuar bashkëpunimin me organet dhe administratën e pushtetit vendor dhe të zhvillojë një mekanizëm për të rritur përgjegjshmërinë e pushtetit vendor.....	17
2.8 Të hartojë masa për të forcuar bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.....	18
2.9 Të hartojë rekomandime në përgjigje të nevojës së identifikuar nga progres-raporti i Bashkimit Evropian për të forcuar të drejtat e qytetarëve për administrim të mirë .....	19
2.10 Të zhvillojë aktivitete të përbashkëta me Grupin Parlamentar “Miq të Fëmijëve” për të informuar, edukuar dhe rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet e të miturve. ....	21
<b>KREU III.....</b>	<b>22</b>
<b>VLERËSIM I SITUATËS SË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA ADMINISTRATA PUBLIKE .....</b>	<b>22</b>
3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2023	22

3.1.1.	Veprimtaria e Seksionit për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor .....	22
3.1.2.	Veprimtaria e Seksionit Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar .....	25
3.1.3.	Veprimtaria e Seksionit të Përgjithshëm .....	28
3.1.4.	Veprimtaria e Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.....	30
3.1.5.	Veprimtaria e Seksionit të Fëmijëve .....	33
3.2	Të drejtat e personave të privuar nga liria .....	36
3.3	Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit .....	41
3.3.1.	E drejta e shtetasve për të lëvizur lirisht.....	42
3.3.2.	E drejta e paprekshmërisë së banesës dhe respektimi me korrektesë i rregullave të parashikuara në aktet normative.....	43
3.3.3.	Shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit, respektimi i kriterëve ligjore dhe i të drejtave të tyre. ....	44
3.3.4.	Garantimi i të drejtës së mbrojtjes me avokat i personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar dhe i të drejtave të tjera .....	46
3.3.5.	Aplikimi i masave administrative ndaj drejtuesve të mjeteve motorrike kundërvajtës nëpërmjet zbatimit me korrektesë të dispozitave të Kodit Rrugor.....	47
3.3.6.	Të drejtat kushtetuese e ligjore të të punësuarve në organet e policisë.....	50
3.4	Parandalimi i dhunës dhe torturës.....	52
3.4.1.	Gjetjet e konstatuara nga inspektimet në institucionet penitenciare.....	52
3.4.2.	Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë 55	
3.4.3.	Disa nga rekomandimet kryesore të dërguara nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vitin 2023 .....	58
3.4.4.	Niveli i respektimit të të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike .....	65
3.4.5.	Niveli i respektimit të të drejtave në Qendrat e mbyllura për të Huajt, Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit si dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut.....	67
3.4.6.	Niveli i respektimit të të drejtave në Shtëpitë e të Moshuarve Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Shkodër .....	68
3.5	Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria .....	69
3.6	E drejta për një proces të rregullt ligjor në sistemin gjyqësor .....	73
3.7	Ndihma juridike falas.....	77
3.8	Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist .....	79
3.9	Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative .....	81
3.10	Respektimi i të drejtës së pronës.....	84
3.11	Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative .....	94

3.12	Mbrojtja e konsumatorit.....	97
3.13	Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor .....	98
3.14	Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës .....	101
3.14.1.	Rekomandimet dhe përfshirja në procesin legjislativ, përgjithësues e strategjik në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve.....	106
3.14.2.	Rekomandime Legjislative .....	107
3.15	Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor .....	110
3.15.1.	Rekomandimin adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në lidhje me mungesën e personelit shëndetësor .....	111
3.15.2.	Rekomandim, adresuar MSHMS lidhur me problematikën e mjekëve të shërbimit të Mjekësisë Interne dhe Hipertensionit Arterial (HTA), në lidhje me vështirësitë që “mjekët intern” po hasin në integrimin e tyre në strukturat spitalore dhe për mospërfshirjen në listën e barnave të rimbursueshëm të barnave për diagnozat që ata trajtojnë .....	111
3.15.3.	Rekomandim adresuar Spitalit Universitar të Traumës.....	112
3.16	Respektimi i të drejtës për arsimim .....	113
3.17	Respektimi i të drejtës për kujdes social.....	115
3.17.1.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës .....	118
3.17.2.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Divjakë:.....	118
3.17.3.	Rekomandimi drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier .....	119
3.17.4.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës .....	119
3.17.5.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Shkodër .....	119
3.17.6.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Këlcyrë.....	119
3.17.7.	Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës .....	120
3.17.8.	Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.....	120
3.18	Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.....	121
3.19	Barazia gjinore .....	126
3.20	Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBTIQ.....	131
3.21	Të drejtat e minoriteteve (pakicave) kombëtare .....	133
3.22	Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore.....	136
3.23	E drejta për një mjedis të shëndetshëm.....	138
3.23.1.	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Bernës, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. ....	139
3.23.2.	Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e ndotjes së mjedisit që shkaktohet nga vendgrumbullimi i mbetjeve në Lagjen 24 Maji Vlorë.....	140
3.23.4.	Rekomandim për pastrimin dhe eliminimin e mbetjeve të shkaktuara nga aktivitetet e paligjshme, në lagjen Tepe, të qytetit të Shkodrës .....	140

3.23.4. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e mjedisit nga djegiet në zonën e Fushë Mamurrasit, drejtuar Bashkisë Kurbin .....	141
3.23.5. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet në zonën e Parkut Kombëtar Theth, drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.....	141
3.23.6. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e jetesës së qetë e të pacenuar nga zhurmat të znj. S.T. ....	142
3.23.7. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin adekuat me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno –sanitare për banorët e fshatit Domen, zona e Postribës:...	143
<b>KREU IV</b> .....	144
<b>ANGAZHIME TË TJERA INSTITUCIONALE</b> .....	144
4.1 Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe shoqërisë civile .....	144
4.1.1. Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.....	144
4.1.2. Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e shoqërisë civile .....	148
4.1.3. Opinioni “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me Marrëveshjen për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit .....	151
4.1.4. Opinioni “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” .....	154
4.1.5. Opinioni “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me çështjen kushtetuese me objekt: “Kontrolli i kushtetueshmërisë së nenit 377 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” .....	156
4.1.6. Monitorimi i aksesueshmërisë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuara në Qendrat e Votimit.....	160
4.1.7. Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj .....	162
4.1.8. Konferenca vjetore .....	166
<b>KREU V</b> .....	168
<b>BASHKËPUNIMI</b> .....	168
5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Aokatit të Popullit .....	168
5.1.1. Niveli i zbatimit të rekomandimeve .....	169
5.1.2. Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt rekomandimeve të pranuar nga institucionet .....	170
5.1.3. Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integritimit European.....	170
5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	171
5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve .....	177

5.4	Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues .....	179
5.4.1.	Rëndësia e komunikimit publik të Avokatit të Popullit .....	179
5.4.2.	Media Sociale .....	179
5.4.3.	Prezenca dhe reagimet publike mbi ngjarjet e aktualitetit në median tradicionale .....	181
5.4.4.	Aktivitetet publike zyrtare .....	182
<b>KREU VI</b>	.....	<b>183</b>
<b>SHËRBIMET MBËSHTETËSE</b>	.....	<b>183</b>
6.1	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative.....	183
6.2	Vështtrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet .....	188
<b>KREU VII</b>	.....	<b>193</b>
<b>AVOKATI I POPULLIT NË SHIFRA 2023</b>	.....	<b>193</b>

## SHËNIM I AVOKATIT TË POPULLIT

Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit është një instrument mjaft i rëndësishëm. Ai evidenton gjetjet dhe vlerëson situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Viti 2023 shënoi dy jubile të rëndësishme për të drejtat e njeriut, në Shqipëri dhe në nivel global. 75-vjetori i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe 25-vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë ishin dy ngjarje simbolike, që na sjellin në vëmendje nevojën për të forcuar përpjekjet për mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave themelore të njeriut. Ndaj dhe ky raport vjetor duhet të lexohet nën dritën e realizimit në praktikë të qëllimit të këtyre dy instrumenteve të rëndësishme. Ai mëton të adresojë dhe forcojë vlerat e lirisë, barazisë dhe drejtësisë dhe për të përkujtuar se mbrojtja e të drejtave të njeriut është një përgjegjësi e përbashkët që duhet të ketë vëmendjen maksimale në çdo nivel shoqëror dhe shtetëror.

Raporti Vjetor 2023 ofron një analizë të detajuar të sfidave, progresit dhe nevojave në fushën e të drejtave të njeriut në vend. Si një udhërrëfyes për të gjithë aktorët, duke përfshirë institucionet vendase e ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe qytetarët, ky raport ofron një bazë të rëndësishme për të zhvilluar një perspektivë të qartë, se si duhet dhe mund të garantohet respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Avokati i Popullit kërkon dhe e vë theksin tek kuptimi dhe zbatimi përmbajtësor i të drejtave të njeriut. Ndaj, ky raport përmbledh arritjet, stanjacionin, por edhe regresin në fusha të caktuara, duke bërë një analizë gjithëpërfshirëse të sfidave dhe përparimeve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Një larmi çështjesh dhe aspekte të rëndësishme të të drejtave të njeriut, adresohen hollësisht, që nga liria e shprehjes dhe e informimit, drejtësia sociale, mbrojtja e minoriteteve dhe barazia gjinore. Nëpërmjet kësaj analize është identifikuar nevoja për hapa konkrete, për të adresuar sfidat ekzistuese dhe për të përshpejtuar përparimin në fushën e të drejtave të njeriut.

Për të ardhur në një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët, është e rëndësishme që të vazhdojnë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat themelore të njeriut, duke u bazuar në analizën dhe rekomandimet e prezantuara në këtë raport.

Ndërsa ecim përpara, është e rëndësishme të angazhohemi në forma të reja dhe të ndërmarrim hapa konkrete, për të garantuar respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët tanë. Kjo kërkon një bashkëpunim të ngushtë dhe të ndërsjellë mes qeverisë, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar.

Të drejtat e njeriut janë një pjesë jetike e qytetarisë së çdo individi dhe përmirësimi i tyre është një detyrë e përbashkët për të gjithë. Një përkushtim i vazhdueshëm ndaj respektimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave është rruga e vetme drejt një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Në këtë rrugë, të drejtat e njeriut do të vazhdojnë të jenë themelet mbi të cilat ndërtohet përparimi dhe zhvillimi i ardhshëm i vendit. Vetëm duke i vendosur të drejtat e njeriut në zemër të çdo politike shtetërore, do të arrijmë progresin dhe do të realizojmë qëllimin e shpalosur në Preambulën e Kushtetutës!

*Erinda Ballanca*

## KREU I

### KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut janë struktura parësore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut në një shoqëri të caktuar. Ato janë një pjesë jetike e sistemit të mbrojtjes së këtyre të drejtave dhe vepronë në mënyrë të pavarur jo vetëm kundër keqadministrimit (historikisht funksioni kryesor) por edhe kundër shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sigurimi i pavarësisë së IKDNJ-ve, para së gjithash ndaj qeverive, është një parakusht për rolin e tyre në promovimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Referenca të shumta për pavarësinë e IKDNJ-ve, janë përfshirë në Parimet e Parisit. Pavarësia njihet gjithashtu si një parim thelbësor për funksionimin e institucioneve të ombudspersonit dhe nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës<sup>1</sup>, ndërkohë që Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian mbi Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së<sup>2</sup>, nënvizionin se *“institucionet e pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut, organet e barazisë dhe mekanizmat e tjerë të të drejtave të njeriut [ ...] luajnë një rol vendimtar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore dhe në sigurimin e pajtueshmërisë me Kartën.”*

Institucioni i Avokatit të Popullit luan një rol të rëndësishëm në sigurimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut, duke vepruar si mekanizëm promovues, monitorues, këshillues, ndërmjetësues mes qytetarëve dhe autoriteteve shtetërore, përmes rekomandimeve të dhëna në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe propozimin e masave për të garantuar respektimin e tyre.

Institucione të të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit s’janë gjë tjetër pos pasqyrë e shëmbëlltyrës së një shteti. Efektiviteti i Avokatit të Popullit si institucion që operon përmes pushtetit të butë është një tregues jo vetëm i efektivitetit të institucionit në vetvete, por edhe i kontekstit ku operon.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i përkushtuar për të siguruar që të gjithë individët të njohin dhe të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore. Në një kohë kur garantimi i të drejtave të njeriut mbetet ende një sfidë globale, roli i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut është më i rëndësishëm se kurrë. Institucioni i Avokatit të Popullit operon nëpërmjet një game të gjerë mekanizmesh, duke përfshirë edhe lobimin për ndërgjegjësimin e publikut në të gjitha sferat e shoqërisë për të adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut, duke filluar nga punët administrative e deri te sfidat më komplekse sociale.

Në Shqipëri, aktorët kryesorë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut kanë përjetuar zhvillime të rëndësishme në vitet e fundit. Ata janë bërë më të vëmendshëm, më aktivë në reagimin ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke u përfshirë në fushën e migrimit, të drejtave të mjedisit, inteligjencës artificiale, lirisë së shprehjes, dhe shumë tema të tjera që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Në disa raste, këta aktorë janë bërë zërat kryesorë për të denoncuar shkeljet dhe për të kërkuar llogari nga autoritetet përgjegjëse. Përveç kësaj, ata kanë luajtur një rol kritik në ndërgjegjësimin e publikut dhe në ndryshimin e kulturës së respektimit të të drejtave të njeriut në shoqërinë shqiptare.

Në një periudhë kur shqetësimet për lirinë dhe drejtësinë po rriten, Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut janë në krye të përpjekjeve për të siguruar që të gjithë individët të kenë qasje të barabartë në

<sup>1</sup> Parimet e Venecias.

<sup>2</sup> Miratuar në shtator 2019.



drejtësi dhe të respektohen. Ata përfaqësojnë një pikë ku qytetarët mund të kërkojnë mbrojtje dhe mbështetje në rast se ndihen të diskriminuar ose u janë shkelur të drejtat themelore të tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit luan një rol të jashtëzakonshëm në promovimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe të lirë për të gjithë duke qenë kështu një zë i rëndësishëm për të përfaqësuar interesat e popullsisë dhe për të siguruar që drejtësia dhe respektimi i të drejtave të njeriut të jenë themelet e një shoqërie të qëndrueshme dhe të orientuar drejt progresit. Sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut janë dy dimensione të pandashme të një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme. Në një shoqëri demokratike, sundimi i ligjit është themel i funksionimit të shtetit dhe mbrojtjes së të drejtave të individit. Nën sundimin e ligjit, të gjithë duhet të trajtohen me barazi para tij dhe të kenë qasje në drejtësi pa diskriminim. Përpjekjet për të garantuar respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut duhet të vazhdojnë në mënyrë të pandërprerë për të siguruar një shoqëri më të drejtë, më të barabartë dhe më të lirë për të gjithë qytetarët e Shqipërisë.

Është e rëndësishme që institucionet publike të vazhdojnë pa u lodhur përpjekjen për t'u bërë edhe më të hapura, më demokratike, më shërbyese, e mbi të gjitha më empatike ndaj qytetarëve, duke përbrendësuar vetëdijen se ato në thelb janë institucione të qytetarëve dhe burojnë prej vullnetit të tyre për të ndërtuar një shtet me institucione. Ky është një proces i gjatë rritjeje, një proces vetë-emancipues dhe vetë-edukues dhe institucione si Avokati i Popullit mund të ndihmojnë apo lehtësojnë këtë proces, mirëpo do të duhet që vetë institucionet ta kenë vullnetin për ta kryer atë.

Avokati i Popullit ka vazhduar të përforcojë bashkëpunimin e tij edhe në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë platformat e gjëra të anëtarësimit si GANHRI, ENNHRI, AOM, AOMF, IOI etj. Përmes këtij bashkëpunimi, Avokati i Popullit ka adresuar dhe shkëmbyer kontribute, praktika të mira dhe diskutuar sfidat e përbashkëta me kolegët ombudsmanë në nivel evropian. Bashkëpunimi i vazhdueshëm ka siguruar një platformë për ndarjen e njohurive dhe përvojave të suksesshme, duke përmirësuar kështu efikasitetin dhe kapacitetin e Avokatit të Popullit për t'u shërbyer qytetarëve dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre në një kontekst më të gjerë ndërkombëtar.

Një pjesë thelbësore e strategjisë së Avokatit të Popullit për të përmbushur detyrat dhe qëllimet e tij në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut është edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Avokati i Popullit njih rëndësinë e partneritetit të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, duke u bazuar në rolin e tyre të rëndësishëm në zbulimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe në ngritjen e çështjeve të rëndësishme për qytetarët. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, Avokati i Popullit siguron një platformë të hapur për dialog, ndërveprim dhe bashkëpunim në zbatimin e politikave dhe masave që kanë për qëllim të garantojnë respektimin dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut në shoqërinë shqiptare.

Në përfundim, Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, siç është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri, janë shembuj të fuqishëm të angazhimit dhe përkushtimit për vlerat e lirisë, drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Roli i tyre është i padiskutueshëm në kërkim të një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë për të gjithë qytetarët.

## KREU II

### ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT TË RSH-SË PËR VITIN 2022 NGA INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 22.6.2023, rezolutën përkatëse ku, ndërmjet të tjerash, i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masash, që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore.

Në zbatim të kësaj rezolute, institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar edhe në mandatin e tij si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke i konsideruar rekomandimet e adresuara nga Kuvendi në përputhje me këtë mandat e me vizionin e tij ka ndërmarrë masa dhe veprime përkatëse të cilat janë të trajtuara në mënyrë koncize më poshtë.

Gjithsesi, duhet të theksohet se në këtë periudhë që korrespondon me zbatimin e kësaj rezolute (muaji korrik e në vazhdim), institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, u investua drejtpërdrejtë edhe në procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile. Për shkak të rëndësisë që ka ky proces në kuadër të reformës në drejtësi, i është kushtuar një vëmendje prioritare në aspektin profesional dhe atë të burimeve njerëzore, pa anashkaluar detyrimet dhe angazhimet e tjera institucionale. Kjo veprimtari ka përbërë një sfidë jo të vogël për institucionin gjatë vitit raportues.

---

#### ***2.1 Të intensifikojë reagimin institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues***

---

Siç kemi informuar edhe më parë, niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Është kjo arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara, të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore. Edhe *Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë* për vitin 2023, ndër të tjera, cilëson se është e nevojshme të përmirësohet ndjeshëm zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit për të siguruar zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut. Është kjo arsyeja që institucioni i Avokatit të Popullit propozoi përfshirjen në Udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës të masave konkrete për ngritjen e mekanizmave që rrisin zbatueshmërinë e rekomandimeve të tij nga institucionet publike, propozim i cili u pranua. Në këtë propozim përfshiheshin, ndër të tjera, vendosja e pikave të kontaktit në institucionet e administratës shtetërore me qëllim koordinimin e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit si

dhe përmirësimin e mekanizmit ndërinstitucional për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Avokati i Popullit ka dërguar zyrtarisht rekomandimet e pazbatuara nga institucionet e administrates shtetërore së bashku me institucionet përgjegjëse, duke kërkuar mbështetjen e kësaj strukture në përmirësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij.

Ndërkohë, në faqen zyrtare të institucionit, vazhdon të jetë e hapur një rubrikë e cila përditësohet vazhdimisht në lidhje me rekomandimet e pazbatuara, institucionet përgjegjëse si dhe institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje në lidhje me rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit, çka mundëson një aksesueshmëri dhe vizibilitet nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale<sup>3</sup>.

Avokati i Popullit ka dërguar edhe një sërë rekomandimesh për marrje masash administrative për disa nga punonjësit e administratës për mungesë bashkëpunimi dhe ka adresuar çështjet në disa raste në nivel hierarkik.

---

## ***2.2 Të zgjerohet shtrirjen gjeografike të sesioneve informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave me qëllim rritjen e numrit të ankesave/kërkesave që vijnë drejtpërdrejt nga fëmijët.***

---

Gjatë periudhës janar–nëntor 2023, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të drejtat themelore të fëmijëve, si dhe punën e veprimtarinë e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave, janë organizuar tipologji të ndryshme të veprimtarive promovuese, të tilla si:

- shpërndarja e materialeve promovuese (fletëpalosje, praktikat më të mira të punës së AP-së, raste suksesi, raporte të veçanta, etj);
- ditë të hapura;
- takime informuese me nxënësit, me prani fizike;
- takime online me nxënësit;
- pjesëmarrje dhe mbështetje në aktivitetet e zhvilluara dhe të organizuara nga vetë nxënësit e shkollave 9-vjeçare e të mesme.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 42 (dyzet e dy) veprimtari me një shtrirje të gjerë gjeografike nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim<sup>4</sup> të cilat kanë sjellë një qasje të re në adresimin e

---

<sup>3</sup> Për më shumë mund ti referoheni linkut:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Regjistri%20i%20insitucioneve%20qe%20nuk%20kane%20kthyer%20pergjigje%20si%20dhe%20nuk%20kane%20zbatuar%20rekomandimet%20e%20AP.pdf>.

<sup>4</sup> Sarandë, Vlorë, Shkodër, Malësi e Madhe, Durrës, Korçë, Berat etj.

ankesë/kërkesave nga vetë fëmijët dhe përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në veçanti, Avokati i Popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) ka hartuar në bashkëpunim me UNICEF-in një broshurë informuese të dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, e cila pasqyron rastet e suksesit të trajtuara nga Avokati i Popullit me qëllim për t'i dhënë më shumë zë këtyre fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Kjo broshurë është publikuar në faqen zyrtare si dhe në platformën Facebook<sup>5</sup>.

---

### ***2.3 Të sigurojë mekanizma të brendshëm për zhvillimin e inspektimeve/monitorimeve të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, që të mos operojë vetëm në bazë projektesh, si dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.***

---

Gjatë gjithë kësaj periudhe, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në perputhje me Planin e Inspektimeve të miratuar nga Avokati i Popullit ka kryer inspektime/monitorime në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime sociale rezidenciale për fëmijët në nevojë.

Objekt i këtyre inspektimeve kanë qenë:

- kontrolli i performancës në institucionet që ofrojnë shërbime sociale rezidenciale për fëmijët në nevojë nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin këto institucione;
- vlerësimi i cilësisë së punës të personelit të këtyre institucioneve;
- vlerësimi i mjedisve dhe kushteve të institucioneve;
- vlerësimi social, psikologjik, shëndetësor i përfituesve të shërbimeve sociale rezidenciale për fëmijët në nevojë;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi;
- verifikimi i mjaftueshmërisë së buxhetit të akorduar për garantimin e të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të realizimit të 16 inspektimeve/monitorimeve, por jo vetëm, janë adresuar 29 rekomandime dhe 133 nënrekomandime, të cilat u janë dërguar 69 organeve të administratës publike me qëllim përmirësimin e trajtimit të fëmijëve në këto institucione, për të garantuar mbrojtjen dhe të drejtat e tyre, bazuar në interesin e tyre më të lartë.

Ndërkohë, duhet të theksohet se Seksioni ka kapacitete profesionale të vlefshme për kryerjen e këtyre inspektimeve por ka nevojë për shtesë në burimet njerëzore, çka shpresojmë të garantohet nga Kuvendi në vitin e ardhshëm.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Për më shumë mund t'i referoheni linkut: <https://smpdf.org/botime/>.

<sup>6</sup> Aktualisht, Seksioni përbëhet nga 4 (katër) punonjës, 1 (një) Komisioner dhe 3 (tre) ndihmëskomisionerë.

---

**2.4 T'i kushtojë vëmendje të veçantë hartimit të rekomandimeve ndaj strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit si rrjedhojë e konstatimeve të vazhdueshme të mosrespektimit të të drejtave themelore të shtetasve.**

---

Avokati i Popullit në ushtrim të mandatit të tij ka kryer disa verifikime në vend të ankesave të shtetasve si dhe ka filluar me iniciativë disa rasteve ndaj strukturave dhe punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit për shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve.

Ndër problematikat e ndjekura mund të evidentojmë:

- ankesat për shkelje të procedurave në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë;
- për shoqërimi të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor;
- për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre;
- për pengim të lëvizjes së lirë për të dalë lirisht jashtë shtetit;
- për mos dhënie të informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga shtetasit;
- për vendosje të masave administrative në mungesë nga punonjësit e Policisë Rrugore dhe mos njoftimin e tyre;
- për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë;
- për cënim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me marrëdhëniet e punës, etj.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave nga institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2023 janë kryer 43 (dyzet e tre) verifikime në vend në organet e Policisë së Shtetit.<sup>7</sup>

Në rastet kur ankesat e shtetasve dhe rastet e filluara me iniciativë kanë rezultuar të bazuara në ligj, janë bërë rekomandime strukturave të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, sikurse mund të përmendim:

- rekomandim dërguar Ministrisë së Brendshme për ushtrimin e kompetencave të tij ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në cilësinë e organit epror, për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me shtetasin B. L. dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë;
- rekomandim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për shfuqizimin e Urdhrit nr. 1657, datë 12.07.2022, për përjashtimin nga Policia e Shtetit të ish punonjësit të policisë P.B. dhe rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit;

---

<sup>7</sup> Sikurse mund të përmendim Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë si dhe Komisarariatet e Policisë nr. 1, 2, 3, 4, 7, Tiranë, Komisariatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, Komisariatin e Policisë Kavajë, Komisariatin e Policisë Durrës, Komisariatin e Policisë Shijak, Komisariatin e Policisë Shkodër dhe Komisariatin e Policisë Pogradec.

- rekomandim drejtuar Ministrit të Brendshëm për ushtrimin e kompetencave të tij ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në cilësinë e organit epror, për shfuqizimin e Urdhrit nr. 1657, datë 12.07.2022, për përjashtimin nga Policia e Shtetit të një ish punonjësi të policisë dhe rikthimin e tij në detyrë;
- rekomandim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 199 i Kodit Rrugor lidhur me njoftimin e kundërvajtësve të shkeljeve administrative dhe marrjen e masave organizative për shpejtimin e procedurave të pagimit të gjobave dhe marrjen e masave të nevojshme për ngritjen sa më shpejtë të sistemit të adresave të qytetarëve;
- rekomandim drejtuar Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë dhe Organit Administrativ Shtetëtor pranë DVP Tiranë për revokimin e gjobave administrative të vendosura ndaj shtetases I.H., pronare e mjetit me targë AB 415 DD dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 199 i Kodit Rrugor lidhur me njoftimin e kundërvajtësve të shkeljeve administrative të konstatuara në mungesë;
- rekomandim drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe për analizimin e shkeljeve ligjore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore A.N. gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me shtetasin e arrestuar V.F;
- rekomandim drejtuar Komisarariatit të Policisë Himarë, Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës efektivë të strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë për mos zbatimin e detyrimeve ligjore për dokumentimin e veprimit të shoqërimit të shtetases V. B. dhe 9 shtetasve të tjerë në datën 13.05.2023, etj.

Gjithashtu, Avokati i Popullit nëpërmjet *Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)*, ka inspektuar ambientet e Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj.

Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet, që u janë dërguar organeve eprorë të Policisë së Shtetit. I gjithë aktiviteti i MKPT-së ka rezultuar me adresimin e 94 rekomandimeve dhe 284 nënrekomandimeve si dhe me një korrespondencë zyrtare të dëndur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.<sup>8</sup>

---

**2.5** *Të zbatohet plani i masave për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave dhe lirive, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë. Të zhvillohen takime të metejshme për të siguruar gjithëpërfshirje, si dhe të publikohet plani i masave në faqen e internetit dhe t'i dërgohet Kuvendit për dijeni.*

---

Në ushtrim të mandatit të tij kushtetues për promovimin, mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, Avokati i Popullit ka përcaktuar një plan masash me qëllim

<sup>8</sup> Për më shumë referojuni Kreut 3, pikës 3.4 “Parandalimi i dhunës dhe torturës.”

informimin dhe ndërgjegjësimin për mekanizmat mbrojtës të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë<sup>9</sup>.

Me qëllim përmirësimin e njohurive të qytetarëve për të drejtat e tyre themelore, rritjes së mundësive të qasjes së qytetarëve tek institucioni i Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave pranë vendbanimeve të tyre, mbajtjen e sesioneve ndërgjegjësuese për rolin e institucionit të Avokatit të Popullit, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të njeriut, specifikisht për grupet në nevojë,<sup>10</sup> janë organizuar dhe zhvilluar veprimtari "Ditë e Hapur" në Bashkinë Sarandë, Pukë, Burrel, Peshkopi, Tepelenë.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe konsolidimit të punës me organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përpos takimeve me qytetarë dhe marrjen e ankesave, në qytetet e sipërcituara janë organizuar tryeza dhe takime me shoqatat që operojnë në mbrojtje të grupeve në nevojë.

Gjithashtu në këto qytete, janë organizuar takime dhe me përfaqësues të institucioneve shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, ku janë diskutuar problematikat e paraqitura nga qytetarët si dhe njohja me kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit. Në takimet e zhvilluara të gjithë pjesëmarrësve (qytetarë, organizata të shoqërisë civile, punonjës të administratës shtetërore), u janë shpërndarë broshura dhe materiale të tjera informuese për punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Gjithashtu, në zbatim të planit të masave, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe respektimin e zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore, rezidenciale dhe ditore, janë kryer inspektime në:

- Qendrën Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Durrës;
- Strehën LGBT, Tiranë;
- Qendrën Ditore Polivalente, Sarandë;
- Qendrën Ditore për të Moshuarit, Durrës;
- Qendrën e trajtimit të rasteve të dhunës në familje, Gjirokastrë;
- Qendrën Ditore Polivalente Kamëz.

Pas inspektimeve të kryera, për garantimin e të drejtave të përfituesve, për një shërbim sa më cilësor në zbatim të standardeve të shërbimeve sociale në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore, janë hartuar rekomandimet përkatëse drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryetarëve të Bashkive, Shërbimit Social Shtetëror, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Gjithashtu, përfaqësues të Seksionit të Përgjithshëm, kryesuar nga Komisionerja e këtij seksioni, zhvilluan më datë 04.12.2023, një takim me Zv/Rektorin e Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan dhe trupën pedagogjike të këtij universiteti. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja në mënyrë më të thelluar me problematikat me të cilat ballafaqohet sot arsimit i lartë, si dhe forcimi i bashkëpunimit lidhur me

---

<sup>9</sup> Ky plan masash është publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit dhe gjendet në linkun: [https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Plani%20i%20masave%20p%C3%ABr%20Rezoluten%20e%20Kuvendit\[30\]\[5811\]\[5727\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Plani%20i%20masave%20p%C3%ABr%20Rezoluten%20e%20Kuvendit[30][5811][5727].pdf).

<sup>10</sup> Persona me aftësi të kufizuar, të moshuar, gra, komuniteti rom dhe egjiptian etj.

adresimin e këtyre problematikave pranë organeve përkatëse, më konkretisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Më tej, në auditorin e njërit prej fakulteteve, u zhvillua një forum diskutimi me studentë dhe pedagogë, duke iu përcjellë një informacion të zgjeruar mbi rolin dhe funksionet e institucionit të Avokatit të Popullit, trajtimi nga ana e këtij institucioni i ankesave të depozituara nga qytetarët, si dhe mënyrat se si qytetarët mund të aksesojnë këtë institucion, si një instrument për vënien në vend të të drejtave dhe lirive të shkelura.

Në vijim të rolit proaktiv, për informimin mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe mënyrat e qasjes së qytetarëve në këtë institucion në rast nevojë, në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit,<sup>11</sup> është zhvilluar një tryezë e rumbullakët në të cilën morën pjesë përfaqësues të Shoqatës "Rromano Kham", si dhe një përfaqësi prej rreth 15 anëtarësh të komunitetit rom dhe egjiptian. Pjesëmarrësit u njohën me punën e kryer në këtë institucion në dobi të mbrojtjes së të drejtave të grupeve vulnerabël si dhe ndanë shqetësimet e tyre të cilat po ndiqen në vijimësi nga strukturat përkatëse të institucionit të Avokatit të Popullit.

Për përmirësimin e njohurive të qytetarëve mbi punën dhe misionin e Avokatit të Popullit, është realizuar një video me një përmbledhje të aktiviteteve më të rëndësishme vjetore të Seksionit të Përgjithshëm. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për adresimin e problematikave, janë pasqyruar në mediat sociale, në Facebook, në adresën: *Avokati i Popullit-Seksioni i Përgjithshëm*.

Në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2023, me qëllim evidentimin e problematikave potenciale ekzistuese dhe marrjen e masave të nevojshme, përkatëse për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit nëpërmjet Seksionit të Përgjithshëm si dhe përfaqësuesve të Zyrave Rajonale në qytetet Shkodër, Kukës, Pogradec, Dropull i Poshtëm, Sarandë, Berat, Vlorë, ka monitoruar aksesueshmërinë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit në disa qytete të Shqipërisë<sup>12</sup>.

Gjithashtu, në kuadër të informimit dhe promovimit, vlen të theksohet një prani mediatike e shtuar e Avokatit të Popullit e cila është trajtuar në mënyrë më të detajuar në Kreun 5, pika 5.4 "*Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues.*"

---

## 2.6 *T'i propozojë Kuvendit zhvillimin e seancave të posaçme degjimore me institucione publike për të adresuar problematika konkrete.*

---

Institucionet e pavarura janë krijuar, ndër arsytet e tjera, për të ndihmuar në funksionin mbikëqyrës të Kuvendit pasi ato kontrollojnë punën e ekzekutivit dhe të administratës publike përmes një stafi të

---

<sup>11</sup> Në muajin qershor 2023.

<sup>12</sup> Për më shumë referojuni linkut më poshtë: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/aftesi-kufizuara/informacion-mbi-monitorimi-i-qendrave-t-votimit-pr-aksesin-e-personave-me-aftsi-t-kufizuar-zgjedhje-vendore-2023-951/>.



specializuar që ka një mandat të qartë për një fushë të caktuar. Duke vepruar kështu, institucionet e pavarura kontribuojnë dhe forcojnë funksionin e mbikëqyrjes së Kuvendit dhe së bashku me këtë të fundit veprojnë si vëzhgues të qeverisë dhe institucioneve të tjera publike. Në këtë kuptim, në respekt të nenit 27 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Avokati i Popullit e vlerëson shumë të rëndësishme hapësirën që ai ka për të paraqitur raporte të veçanta për çështje të ndryshme brenda funksioneve të tij, veçanërisht nëse ato përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve.

Në zbatim të kësaj të drejte, duhet të theksojmë se vetëm gjatë vitit 2021-2022, Avokati i Popullit ka dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë 10 (dhjetë) raporte<sup>13</sup> të veçanta si më poshtë:

- raport monitorimi mbi shkeljen e të drejtave të fëmijëve gjatë Covid-19;
- raporti “Instrumenti i vlerësimit të ndikimit të të drejtave të femijeve”;
- raporti “Standarti i minimumit jetik në Shqipëri”;
- raporti “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, për periudhën janar 2020-shtator 2021 në Shqipëri”;
- raporti “Mbrojtja e fëmijës nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual”;
- raporti “Vlerësimi i impaktit të të drejtave të femijeve (CRIA);
- raporti “Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e femijeve”;
- raporti “Dhuna ndaj grave në politike”;
- raporti “Vlerësimi mbi qasjen dhe përdorimit familjar të transfertave familjare”;
- raporti “Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim, për fëmijët”;

raporte të cilat në dijeninë tonë nuk janë diskutuar në seancë plenare apo në Komisionet përkatëse parlamentare, e për rrjedhojë, Avokati i Popullit nuk ka pasur mundësinë e adresimit të drejtpërdrejtë të problematikave apo shqetësimeve që këto raporte ngrejnë në fusha të caktuara si dhe për të diskutuar me institucionet publike të cilat kanë detyrimin për t’i adresuar ato.

Avokati i Popullit mbetet i vendosur në qasjen drejt identifikimit të problematikave të ndryshme në fushën e respektimit të të drejtave të qytetarëve dhe adresimit të tyre pranë Kuvendit të Shqipërisë përmes përdorimit dhe të seancave dëgjimore me institucione publike si një instrument efektiv për të adresuar problematika konkrete.

---

## **2.7 Të hartojë masa për të forcuar bashkepunimin me organet dhe administratën e pushtetit vendor dhe të zhvillojë një mekanizëm për të rritur përgjegjshmërinë e pushtetit vendor.**

---

Zhvillimet e ndodhura në situatën social ekonomike përgjatë kësaj periudhë kohore në Shqipëri, ka gjetur një pasqyrim edhe në një qasje më kritike të institucionit të Avokatit të Popullit përkundrejt veprimtarisë së qeverisjes lokale, me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për parandalimin e pabarazisë. Veprimet e organeve të pushtetit vendor janë dhe duhet të jenë thelbësore për të ruajtur hapësirën qytetare dhe lirinë e shprehjes, për të siguruar qasjen në shërbimet themelore dhe për të përmirësuar planifikimin urban dhe synuar në arritjen e objektivave sociale të shtetit. Ky rol i qeverisjes

---

<sup>13</sup> Këto raporte gjenden në limkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>.



të pavarura nga ankuesit, bën që ata jo vetëm të mos marrin shërbimin e kërkuar, por në shumë raste ndodh që të mos marrin fare përgjigje. Një situatë e tillë ka sjellë që shtetasit të mos gëzojnë nga prona e tyre të drejtat që ua garanton legjislacioni në fuqi.

Mungesa e reagimit institucional ndaj kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë një tjetër problematikë, e cila jo vetëm ka cenuar parimet e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional por edhe ka sjellë pengesa serioze në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve, lirive dhe interesave të tyre të ligjshme. E vërteta është se shkelja apo mosrepektimi i të drejtave të pronësisë ka sjellë një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës shtetërore me padi civile për dëm jashtëkontrator që mund t'u jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e këtyre të drejtave. Me qëllim përmirësimit dhe adresimit të kësaj situatë, nisur edhe nga rekomandimi i Kuvendit të Shqipërisë, Avokati i Popullit ka përcaktuar një tërësi veprimesh me qëllim forcimin e bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës sa më poshtë vijon:

- takime të drejtëpërdrejta me titullarin e Institucionit;
- vendosja e pikave të kontaktit ndërmjet institucioneve respektive me qëllim bashkëpunimin dhe rritjen e efikasitetit të punës;
- rakordime periodike për problematikat e lindura gjatë procesit të punës dhe kryerja e takimeve periodike nëpërmjet pikave të kontaktit;
- pjesëmarrja e institucionit në mbledhjet analitike që zhvillohen nga ana e e DVASHK-së qoftë në rang drejtorie qendrore, apo qoftë edhe të DVASHK-ve Vendore.

Më datë 13 dhjetor 2023, Avokati i Popullit i ka dërguar një rekomandim Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në lidhje me moszbatimin e një rekomandimi si dhe për disa çështje të tjera që lidhen me procedurat e legalizimit, në të cilën është kërkuar edhe një takim me drejtoreshën e këtij institucioni. Deri më sot nuk ka ardhur ende asnjë përgjigje zyrtare nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të jetë maksimalisht i angazhuar për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë qytetarët sa i përket të drejtave të pronësisë si dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit institucional me strukturat përgjegjëse. Por nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme forcimi i mëtejshëm i rolit mbikqyrës të Kuvendit të Shqipërisë për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve që Avokati i Popullit u ka drejtuar ekzekutivit dhe institucioneve të tjera publike<sup>15</sup>.

---

## **2.9 Të hartojë rekomandime në përgjigje të nevojës së identifikuar nga progres-raporti i Bashkimit Evropian për të forcuar të drejtat e qytetarëve për administrim të mirë**

---

Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet kryesore të Avokatit të Popullit është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë. Ky nocion përmban administrim të mirë të pronës

---

<sup>15</sup> Avokati i Popullit shpreh besimin se mekanizmi i ri i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve do ta përmirësojë punën në këtë drejtim, ndonëse i përket si veprimtari vitit 2024.

publike, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve. Krijimi i një kulture të drejtave të njeriut në Shqipëri, kërkon bashkëpunim të ngushtë me organet e administratës publike, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike e median, si dhe rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të tij.

Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të tregojë standardin e funksionimit për Administratën Publike, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është që të jetë në shërbim të qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre. Fakti që vendimet e administratës publike janë sfidues, për nga natyra, kushtëzon një vështirësi tjetër për relativizimin e mëtejshëm të efikasitetit tonë në mirëqeverisje. Në këto kushte, jo vetëm institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri, por çdo zyrë Ombudsmani në botë, jo rrallë herë ndeshet me rezistencë nga ana e organeve të administratës publike.

Gjithashtu, funksioni i Avokatit të Popullit është të shqyrtojë çështjet që lindin si pasojë e keqadministrimit në administratën publike që nënkupton veprimet apo mosveprimet e zyrtarëve në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi. Duke goditur këtë dukuri, Avokati i Popullit promovon mirëqeverisjen dhe ndershmërinë në administratën publike. Për shkak të rëndësisë që ka e drejta e qytetarëve për administrim të mirë, edhe raporti i progresit të Komisionit Evropian, për vitin 2023, thekson rëndësinë që ka kjo e drejtë, duke përmendur ndër të tjera se *“E drejta e qytetarëve për administrim të mirë duhet të forcohet më tej. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Ombudspersonit vazhdon të lëvizë në intervalin 50-60%.....Parlamenti duhet të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe të adresojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike”*.

Për periudhën *janar-shtator 2023*, Avokati i Popullit ka adresuar gjithsej 107 rekomandime organeve publike në nivel qendror dhe vendor, që prekin fusha të ndryshme të së drejtës në funksion të respektimit dhe adresimit të të drejtave të qytetarëve të identifikuar dhe nga raportet e progresit të Komisionit Evropian.

Opinionet dhe rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit synojnë të pasqyrojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Eksperienca ka treguar se zgjidhja e një rasti individual në fakt, shpesh evidenton një problem sistematik në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, duke nxitur përgjegjësinë e organeve të administratës publike. Për të gjithë sa më sipër, forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë si dhe përmirësimi i mekanizmit ndërinstitutional për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, konsiderohet shumë i rëndësishëm në forcimin e të drejtës së qytetarëve për administrim të mirë.

---

**2.10** *Të zhvillojë aktivitete të përbashkëta me Grupin Parlamentar “Miqtë e Fëmijëve” për të informuar, edukuar dhe rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet e të miturve.*

---

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës, më datë 20 Nëntor 2023, institucioni i Avokatit të Popullit, zhvilloi në ambientet e tij veprimtarinë promovuese me titull “Së bashku me fëmijët, për të mbrojtur të drejtat e tyre”, ku u ftuan të marrin pjesë dhe ishte prezent edhe një nga zëvendëskryetarët (znj. Erisa Xhixho) e Grupit Parlamentar “Miqtë e Fëmijëve”.

Kjo veprimtari u dha mundësi fëmijëve të shkollës “Ardian Klosi” të shfaqnin në një ekspozitë punimet e tyre, me qëllim që të shprehinin lirisht opinionet e tyre për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet artit. Avokati i Popullit do të vazhdojë të ketë në vëmendje Grupin Parlamentar “Miqtë e Fëmijëve” dhe bashkëpunimin me të në aktivitete të tjera të rëndësishme që ka planifikuar të zhvillojë.

## KREU III

### VLERËSIM I SITUATËS SË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA ADMINISTRATA PUBLIKE

#### 3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2023

##### 3.1.1. Veprimtaria e Seksionit për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor<sup>16</sup>

Në fokus të veprimtarisë së Seksionit për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor kanë qenë disa çështje të trajtuara në vijimësi që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve ligjzbatuese.

Gjatë vitit 2023, nga 279 raste (ankesa dhe raste me iniciativë) për të cilat është përfunduar hetimi administrativ, në 35 raste janë konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut. Për këto raste rekomandimet u janë dërguar 54 organeve ligjzbatuese të administratës publike dhe për dijeni 7 organeve të tjera, me një total prej 98 pikash nënrekomandime për t'u zbatuar nga ana e tyre<sup>17</sup>.

Të drejtat e personave të privuar nga liria, kanë qenë në vëmendjen e punës për shkak të veçimit të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Disa nga shqetësimet apo ankesat e adresuara prej tyre në institucionin e Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me: trajtimin e tyre shëndetësor; mosekzekutimin e vendimit për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, në një institucion të posaçëm mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar; trajtimin ushqimor të të burgosurve; procedurat e transferimit të sendeve personale; të drejtën për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë gjatë qëndrimit në IEVP; të drejtën për t'u informuar etj.

Gjithashtu, në fokusin e punës ka qenë edhe hetimi administrativ i ankesave të punonjësve të administratës së IEVP-ve. Ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat e privuar nga liria, përballen me jo pak vështirësi dhe japin çdo ditë kontribut për menaxhimin e sistemit penitenciar.

<sup>16</sup> Në veprimtarinë e këtij Seksioni përfshihen fusha që kanë të bëjnë me:

- Të drejtat e personave të privuar nga liria;
- Respektimin e të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit;
- Respektimin e të drejtave të njeriut nga Prokuroria;
- Të drejtën për një proces të rregullt ligjor në sistemin gjyqësor;
- Ndihmën juridike falas;
- Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist.

<sup>17</sup> Gjithashtu, nga ndihmëskomisionerët e këtij Seksioni, në kuadër të masave organizative institucionale, janë ndjekur edhe disa ankesa të kaluara nga Seksioni për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, për të cilat janë përgatitur 4 rekomandime, të cilat u janë drejtuar 7 organeve ligjzbatuese të administratës publike, me një total prej 10 pikash nënrekomandime për t'u zbatuar nga ana e tyre.

Vlerësohet se një pjesë e mirë e problematikave të adresuara nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit për rastet e trajtuara janë marrë në konsideratë duke shënuar një rritje të bashkëpunimit me strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe ato të burgjeve.

Objekti i ankesave dhe i rasteve me iniciativë të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit ndaj *strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme* ka qenë i gjerë. Ndër to, janë evidentuar raste për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kontrole të paligjshme banese; për mos pasqyrimin në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të orës faktike të personave të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale; për keqtrajtime fizike ose psikologjike gjatë shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për mos njoftimin nga policia të familjarëve të të shoqëruarve apo moslejimin e tyre të komunikojnë vetë me ta me telefonat e tyre; për sjellje pa etikë të punonjësve të policisë gjatë komunikimit; për kushte të papërshtatshme të ambienteve të shoqërimit; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për mos sigurimin e mbrojtjes ligjore gjatë shoqërimit apo kryerjes së veprimeve procedurale; për vendosje të masave administrative të kundërligjshme nga punonjësit e Policisë Rrugore ose për mos njoftimin e këtyre masave konform dispozitave të Kodit Rrugor; për shkelje së të drejtës së informimit; për largim të padrejtë nga Policia e Shtetit; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri, si refuzimin e pajisjes së tyre me leje qëndrimi, zvarritje të procedurave për fitimin e shtetësisë shqiptare, etj.

Nuk duhet të lihen jashtë vëmendjes pasojat që vijnë nga shkeljet e të drejtave kushtetuese e ligjore të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të policisë. Këto qëndrime cenojnë imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit si dhe besimin publik të këtij institucioni të administratës publike.

Gjatë vitit 2023, sa i përket *funksionimit të sistemit gjyqësor*, Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje të gjitha zhvillimet lidhur me vënien në zbatim të hartës së re gjyqësore. Si nga ankesat e administruara në institucion, po ashtu edhe nga rastet e shqyrtuara me iniciativë, është konstatuar tejzgjatje të afateve të gjykimeve, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, etj. Po ashtu, janë evidentuar problematika thelbësore sa i përket vonesave në arsyetimin e vendimeve gjyqësore qofshin civile ose penale, duke sjellë vonesa në njoftimin e palëve dhe ushtrimin e të drejtës së ankimit ose të rekursit në Gjykatën e Lartë.

Aktualisht sistemi i drejtësisë përballet me: vakanca të theksuara të numrit të gjyqtarëve, stok të lartë dosjesh të krijuar veçanërisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dy gjykatat e apelit (të juridiksionit të përgjithshëm dhe ajo administrative), mungesa e godinave të reja (pallatit të drejtësisë) dhe një infrastrukturë dhe kushte pune tepër sfiduese në godinat ekzistuese.

Avokati i Popullit ka ngritur në mënyrë të përsëritur shqetësimin për sa i përket aksesit në drejtësi të qytetarëve me vënien në zbatim të hartës gjyqësore, duke theksuar problematikat e pritshme me të cilat do të përballëshin. Në këtë linjë, janë adresuar një sërë rekomandimesh për të sjellë në vëmendje të institucioneve kompetente se është koha për të vepruar, për të marrë masat e nevojshme, për të dhënë


drejtësi pa vonesë, sipas standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

Gjithashtu, objekt i veprimtarisë të Seksionit të Veçantë ka qenë dhe verifikimi i problematikave të qytetarëve dhe ankesave të tyre ndaj *strukturave të prokurorisë*, si: zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale; mungesë ose vonesë në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë, kryesisht kallëzuesit e veprës penale, sidomos në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal; mosinformim për kallëzimin e bërë; vonesë për njoftimet e palëve në procesin penal; problematika në zbatimin e dispozitave procedurale që parashikojnë dhe rregullojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e më konkretisht mosnjohja me aktet dhe provat (dosjen) mbi bazën e të cilave ngrihen akuzat penale, etj.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar *ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre*. Në mënyrë të përsëritur në rekomandimet e dërguara është evidentuar se përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin e shtetit për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohë optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme. Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar shpeshherë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësimit të detyrimit të shoqërisë shqiptare për finalizimin e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit dhe trashëgimtarët e tyre.







### 3.1.2. Veprimtaria e Seksionit Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar<sup>18</sup>

Gjatë vitit 2023, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka kryer 96 vizita inspektuese<sup>19</sup>, të cilat janë shoqëruar me 92 rekomandime dhe 284 nënrekomandime dërguar autoriteteve përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e gjendjes së të drejtave të personave të privuar nga liria.

Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, rezultojnë të jenë shumica të pranuar, që tregon se janë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Vlen të theksohet se bashkëpunimi dhe dialogu konstruktiv edhe gjatë kësaj periudhe, po vazhdon me të gjitha autoritetet përgjegjëse për institucionet ku privohet liria. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave, si dhe marrja e përgjigjeve për ato rekomandime që janë ende pa përgjigje.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vitin 2023 ka trajtuar edhe 46 ankesa dhe raste me iniciativë (32 ankesa dhe 14 raste me iniciativë), nga të cilat 23 ankesa lidhen me sistemin e burgjeve (mungesë mjekimi dhe medikamentesh, mungesë kushtesh jetese, mbipopullimi në burgje etj.) dhe 9 ankesa lidhen me policinë (mosdhënia e ndihmës mjekësore, shoqërim i padrejtë, etj.). Nga trajtimi i

<sup>18</sup> Në veprimtarinë e këtij Seksioni përfshihen fusha që kanë të bëjnë me: Inspektimet dhe monitorimet periodike për respektimin e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në sistemin penitenciar dhe njësitë policore; Nivelin e respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike; Nivelin e respektimit të të drejtave në Qendrat e mbyllura për të Huajt, Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit si dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut; Nivelin e respektimit të të drejtave në Shtëpitë e të Moshuarve; Monitorimin e pavarur të të drejtave të emigrantëve të huaj; Monitorimin e operacioneve për rikthimin e detyruar të shtetasve shqiptarë të cilët qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE-së.

<sup>19</sup> Në Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Njësi Policore, Qendra, Spitale Psikiatrike dhe Shtëpi të Moshuarish.

ankesave dhe rasteve me iniciativë, në 5 raste janë hartuar rekomandimet drejtuar institucioneve përkatëse. Në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka qenë pjesë e grupit të fluturimeve, për monitorimin e 2 *operacioneve* të riatdhesimit.

Nga inspektimet e kryera në disa prej IEPV-ve rezultuan kushte materiale tejet degraduese, të cilat bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të burgosurve. Po ashtu janë evidentuar probleme me amortizimin, lagështirën, furnizimin me ndërprerje të energjisë elektrike dhe ujit, sigurimin e ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit etj. *Mbipopullimi* ka pësuar një rritje përgjatë vitit 2023 në sektorët e paraburgimit dhe në disa nga IEPV-të.<sup>20</sup>

Problematik vazhdon të mbetet kujdesi shëndetësor *si*: mungesa e një institucioni të posaçëm mjekësor; mungesa e mjekëve në sistemin penitenciar; mungesa e ambienteve më vehte për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor ose Sektorët e Kujdesit të Veçantë (SKV); mungesa e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore në këto institucione; vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike etj.

Gjatë vitit 2023, janë kryer inspektime në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të shoqërimit të shtetasve, për praninë e objekteve të dyshimta në zyrat e hetimit që mund të provokojnë dhunë psikologjike tek individët, si dhe për rolin e psikologut të policisë në trajtimin e personave të mitur dhe të efektive që mund të shfaqin probleme psikologjike gjatë shërbimit. Për të gjitha rastet e shkeljeve të konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit.

Pavarësisht se ka një qasje më korrekte dhe në respektimin e të drejtave të njeriut nga punonjësit e Policisë së Shtetit, kemi patur disa ankesa si dhe raste të marra me iniciativë nëpërmjet medias ku ka pasur pretendime për raste të shkeljes së procedurës ligjore të shoqërimit, arrestimit apo ndalimit të shtetasve nga punonjësit e policisë. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe pune dhe janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.

Avokati i Popullit vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri. Për vitin 2023, nëpërmjet MKPT-së janë inspektuar institucionet e shëndetit mendor duke u kërkuar organeve qendrore dhe spitalore zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe akteve ndërkombëtare dhe konkretisht paketën e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka inspektuar dhe Shtëpitë e të Moshuarve ku konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror. Sa më sipër vështirësohet përkujdesja sipas standartit për këtë kategori përfituesish, por edhe për stafin punonjës, i cili u shërben përfituesve të kësaj kategorie etj. Lidhur me nivelin e respektimit të të drejtave të shtetasve të huaj, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ndër morri disa inspektime në qendrat e azilkërkuesve si Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë, por dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të


---


<sup>20</sup> Në IEPV Jordan Misja, IEPV Drenovë, IEPV Peqin, IEPV Fier, IEPV Tepelenë, ky fenomen vazhdon të jetë prezent.

Viktimave të Trafikut, Linzë dhe në përfundim të këtyre inspektimeve, adresoi edhe rekomandimet për institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Edhe gjatë vitit 2023, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë, Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore”, për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastër, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht). Institucioni i Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së gjatë takimeve dhe monitorimeve me përfaqësues të FRONTEX dhe të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit kanë sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve qoftë këta shqiptarë apo të huaj, si dhe respektimin rigoroz të standardeve të BE-së dhe të ligjit shqiptar.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2023 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Rrjetin e NPM-ve të Europës Juglindore, Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT), UNHCR, Këshillin e Evropës, si dhe OJF të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunime të kryera në kuadër të takimeve të përbashkëta, pjesëmarrjes në konferenca, kontakteve të drejtpërdrejta duke pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.





### 3.1.3. Veprimtaria e Seksionit të Përgjithshëm<sup>21</sup>

Seksioni i Përgjithshëm, ka intensifikuar punën për trajtimin me dinjitet të grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël apo në risk, të cilët janë më të cënueshëm dhe të pambrojtur. Fokusi për adresimin e problematikave të konstatuara ka qënë ndërhyrja nëpërmjet rekomandimeve sistemike në fushat e të drejtës për arsim, të drejtës për kujdes shëndetësor, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të drejtave të pakicave kombëtare, të drejtave të grave dhe komunitetit LGBTI, ndihmës ekonomike dhe mbrojtjes shoqërore si dhe të drejtës për një mjedis të shëndetshëm.

Gjatë vitit 2023, Seksioni i Përgjithshëm ka adresuar gjithsej 55 rekomandime me 200 nënrekomandime, drejtuar organeve të administratës publike, në 51 raste në të cilat është konstatuar nevoja për vënien në vend të të drejtave të shkelura, apo nevoja për adresimin e problematikave të konstatuara, në nivelin sistematik.

Në fushën e të drejtës për arsim, është adresuar ndër të tjera një rekomandim sistematik drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për miratimin e një pakete të re të mbështetjes për studentët në kohë krize.

Në fushën e së drejtës për kujdes shëndetësor, janë adresuar, ndër të tjera, tre rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë, me qëllim adresimin e mungesës së personelit shëndetësor në zona të vështira, të nevojës për integrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të mjekëve intern në sistemin shëndetësor të Shqipërisë, dhe të rasteve të pacientëve të pidentifikuar që marrin shërbime të kujdesit shëndetësor.

Në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për të realizuar integrimin e plotë të tyre në shoqëri, nëpërmjet rekomandimeve dhe ndërhyrjeve të tjera institucionale, është kërkuar zbatimi me rigorozitet të legjislacionit në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

<sup>21</sup> Në veprimtarinë e këtij Seksioni përfshihen fusha që kanë të bëjnë me: Të drejtën për arsim; Të drejtën për kujdes shëndetësor; Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Të drejtat e pakicave kombëtare; Të drejtat e grave dhe komunitetit LGBTI; Ndihmën ekonomike dhe mbrojtjen shoqërore; Të drejtën për një mjedis të shëndetshëm.

Në lidhje me *të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore*, vërehet që problematikat janë të ngjashme me ato të viteve të mëparshme, përfshirë mosmarrjen e përgjigjeve për kërkesat e verifikimit të viteve të punës dhe përfitimin e ulët të pensionit të pleqërisë, duke treguar vazhdimin e sfidave në zbatimin e këtij sistemi.

Lidhur me të drejtat e *pakicave kombëtare*, në fokus të vëmendjes për vitin 2023 kanë qënë të drejtat e pakicave egjiptiane dhe rome. Avokati i Popullit është angazhuar në adresimin e problematikave të identifikuar, duke vënë në pah nevojën për një qasje më proaktive dhe bashkëpunuese nga institucionet publike për integrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare. Rekomandimet janë adresuar në nivelin lokal dhe qendror për përmirësimin e kushteve të jetesës, arsimimit dhe identitetit kulturor të këtyre komuniteteve. Përtej kësaj, vijon të mbetet i nevojshëm përfundimi i procesit të hartimit të akteve nënligjore që do të garantonin respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në përputhje me ligjin në fuqi.

Sa i përket *të drejtave të grave dhe barazisë gjinore* vihet re se, megjithë masat e marra, gratë dhe vajzat përjetojnë situata dhune, pabarazie dhe diskriminimi. Problematikat e konstatuara janë adresuar vazhdimisht nëpërmjet rekomandimeve. Një iniciativë që vlen për t'u theksuar është edhe ngritja e *Observatorit për Femicidin*, për të analizuar qartë të dhënat dhe shkaqet përse ndodh femicidi, dhe të veprimeve të kryera nga institucionet, si dhe përgatitjen e raporteve periodike me gjetje dhe rekomandime adresuar institucioneve.


Sa i përket *të drejtave të komunitetit LGBTI*, evidentohet se ky komunitet vijon të përballet me sfida dhe problematika. Avokati i Popullit në vitin 2023 u fokusua në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTIQ duke organizuar trajnime për stafin, si dhe duke kryer inspektim në Qendrën STREHA për të rinjtë LGBTI+. Në këtë kuadër janë adresuar edhe rekomandime për përmirësimin e kushteve, ndërgjegjësimin dhe zbatimin e standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit për këtë komunitet. Avokati i Popullit vlerëson se objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për LGBTI+, në lidhje me identifikimin gjinor dhe njohjen e martesave, duhet të zbatohen pa vonesë.

Lidhur me përkujdesin social, vërehet se masa e *ndihmës ekonomike* vijon të mbetet e ulët në krahasim me shpenzimet mujore të domosdoshme për të mbijetuar, problematikë e cila është adresuar nëpërmjet rekomandimeve të vazhdueshme për zgjidhjen e rasteve që janë prezantuar nga qytetarët.

Lidhur me *të drejtën për mjedis të shëndetshëm*, edhe gjatë vitit 2023 është vërejtur se vijojnë problematikat mjedisore, siç janë ndotja e ajrit, ujit, dhe mjedisit nga mbetjet, si dhe ndotja akustike. Institucionet përgjegjëse kanë treguar mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit. Nëpërmjet rekomandimeve të adresuara është theksuar rëndësia e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit dhe bashkëpunimit institucional për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në Shqipëri.

Në përfundim, pavarësisht përpjekjeve të përbashkëta, problematikat në këto fusha vazhdojnë të ekzistojnë dhe të adresohen me rekomandime të vazhdueshme. Në veçanti, vlen të vihet në pah nevoja për një angazhim më të fortë dhe bashkëpunim më të ngushtë nga institucionet publike për të garantuar respektimin e të drejtave të individëve dhe komuniteteve të cenuara.

## SEKSIONI PËR GJITHSHËM 2023



### 3.1.4. Veprimtaria e Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre<sup>22</sup>

Përgjatë vitit 2023, veprimtaria e Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, është përqëndruar në monitorimin e disa prej të drejtave themelore të njeriut, të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut me Protokollin e saj Shtesë. Nga rastet e trajtuara në vitin 2023, përfshirë këtu si ankesat ashtu edhe rastet me iniciativë, për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ, janë hartuar dhe dërguar 54 rekomandime bazuar në 445 raste të trajtuara në total nga ky Seksion<sup>23</sup>.

<sup>22</sup> Në veprimtarinë e këtij Seksioni përfshihen fusha që kanë të bëjnë me: Ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe administrative; Respektimin e të drejtës së pronës dhe legalizimit të ndërtimeve pa leje; Rregullimin e marrëdhënieve të punës dhe respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative; Mbrojtjen e konsumatorit; Respektimin e të drejtave që lidhen me pushtetin vendor.

<sup>23</sup> Gjatë këtij viti raportues 72 çështje që i përkasin fushave që mbulohej nga ky Seksion janë trajtuar nga ndihmëkomisionerë të seksioneve të tjera pasi ka pasur një numër të lartë çështjesh dhe Seksioni ka qenë pa Komisioner që nga shtatori i vitit 2022.

Në fokusin e veprimtarisë së këtij seksioni, ka qenë e *drejta e pronës*, në të cilën janë përfshirë jo vetëm çështjet e pronësisë, por edhe çështje të tjera të lidhura me ekzekutimin e vendimeve të organeve të administratës; vendimeve gjyqësore të formës së prerë; procesin e rregullt ligjor; procedurat e sistemimit të banorëve të prekur nga fatkeqësitë natyrore, etj.

Çështjet e pronësisë vazhdojnë të mbeten një nga shqetësimet më madhore për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë. Pavarësisht kujdesit të veçantë që institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar, edhe gjatë vitit 2023, respektimit të të drejtës së pronësisë, nga institucione të ndryshme shtetërore është konstatuar kohëzgjatje të pajustificuara dhe në tejkallim të afateve të arsyeshme, duke lënë të pazgjidhura tashmë prej shume vitesh kërkesat e qytetarëve.

Edhe procesi i kompensimit financiar vazhdon të jetë mjaft i ngadaltë prej Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP). Referuar afatit ligjor të përfundimit të këtij procesi, pra kryerjes së pagesës për vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompesimit<sup>24</sup>, nisur nga të dhënat e ATP-së dhe ritmit me të cilin po vijon ky proces, ekziston dyshimi i arsyeshëm se ky proces nuk do të përfundojë brenda afatit ligjor.

Një numër të lartë ankesash në institucionin e Avokatit të Popullit, vazhdon të ketë ndaj Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke nisur që nga veprimet më të thjeshta, si psh, moslëshimi në kohë i kartelave për pasuritë e paluajtshme, pa përmendur vonesat në *procesin e legalizimeve*.

Respektimi i së drejtës së pronës në disa aspekte të rëndësishme është konceptuar dhe normuar që të realizohet nëpërmjet proceseve ligjore, të emërtuara si procese kalimtare nga legjislacioni në fuqi. Proceset kalimtare ligjore, si ai i ndarjes së tokës bujqësore, i kthimit (kompensimit fizik) dhe kompensimit të pronës ish pronarëve të vjetër apo procesi i legalizimit të ndërtimeve të kundërligjshme, duke mbartur në thelb njohjen dhe respektimin e të drejtës së pronës, në zbatimin e tyre praktik kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë problematikë, mungesë harmonizimi dhe përplasje praktikash ligjore, elementë që kushtëzojnë ecurinë dhe përfundimin e tyre. Nga ana tjetër, zbatimi i legjislacionit rregullator i këtyre proceseve ligjore ka krijuar mungesë stabiliteti ligjor për këtë të drejtë themelore.

Monitorimi i zbatimit të ligjit në fushën e *zhvillimit të territorit* nga organet publike të ngarkuara me kompetenca në këtë fushë, ka treguar mungesë efektiviteti në veprimtarinë e këtyre organeve publike në ushtrimin e funksioneve të veta. Kjo veprimtari administrative, publike, ndikohet në performancën e saj edhe nga paqartësia dhe mungesa e stabilitetit dhe koherencës ligjore, të legjislacionit rregullator specifik, në fuqi.

*E drejta për një proces të rregullt gjyqësor* parashikohet në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Element i këtij procesi është edhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Shteti ka një detyrim pozitiv për të organizuar një sistem për zbatimin e vendimeve i cili është efektiv si në ligj dhe në praktikë dhe siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme.

---


<sup>24</sup> Sipas ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, duhet të përfundojë brenda 10 viteve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit.

Gjatë vitit raportues, *strehimi dhe e drejta e banesës*, si një ndër çështjet më të mprehta sociale, kanë vazhduar të jenë në fokusin e punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Në kuadër të trajtimit të programeve sociale, problematikat kryesore të evidentuara lidhen me mungesën e transparencës përgjatë ndjekjes së procedurave të rregullta ligjore përsa i përket shërbimeve të cilat ofrohen nga njësitë e pushtetit vendor në kuadër të politikave sociale për kategoritë në nevojë të lidhura me kushtet e papërshtatshme të jetesës në banesa, nevojës për rikonstruksion të menjëhershëm etj.


Pjesë e veprimtarisë kanë qenë edhe rastet e lidhura me problematikat e ngritura në fushën e *infrastrukturës dhe shërbimeve publike*, duke përfshirë çështjet që lidhen me: ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore; sinjalizimi rrugor; ndriçimin e mjediseve publike; transportin publik vendor; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve; ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e banesave; trajtimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të shiut, etj.

Rregullimi i *marrëdhënieve të punës* dhe respektimi i *të drejtës për një proces të rregullt ligjor* në procedurën administrative, janë çështje që kanë vijuar të trajtohen nga Seksioni për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, si një nga problematikat kryesore të shqyrtimit të ankesave/kërkesave për largimet, lirimet, transferimet, emërimet në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil.

*Mbrojtja e konsumatorit* është një tjetër fushë e së drejtës ku është luajtur një rol proaktiv për të adresuar problematikat e paraqitura nga qytetarët, të lidhura kryesisht me furnizimin me ujë të pijshëm dhe energjinë elektrike.







### 3.1.5. Veprimtaria e Seksionit të Fëmijëve<sup>25</sup>

Këtë vit raportimi për të drejtat e fëmijëve fokusohet në çështje të ndryshme që prekin të drejtat dhe mbrojtjen e tyre, duke detajuar punën e kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit, konkretisht në trajtimin e ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë, hetimin administrativ të rasteve, inspektimet e realizuara në institucionet e përkujdesit social për fëmijët në nevojë, informimin e fëmijëve për të drejtat e tyre nëpërmjet realizimit të veprimtarive të ndryshme promovuese në institucionet e edukimit. Kjo qasje portretizon saktë edhe mënyrën e funksionimit dhe veprimit për të garantuar të drejtat e fëmijës në mjedisin digjital, shëndetësi, arsim, drejtësi, për jetesë me dinjitet, për mbrojtje etj., të para në këndvështrimin e organit monitorues në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Ky raport tregon gjithashtu se si Avokati i Popullit i përfshin fëmijët dhe dëgjon zërin e tyre. Përfshirja e fëmijëve ka përmirësuar shumë rezultatet e punës sonë dhe shpresojmë që edhe organet e tjera të administratës publike në nivel qendror dhe vendor të mund të shohin vlerën e shtuar që vjen nga pjesëmarrja e fëmijëve, veçanërisht rreth vendimeve që i prekin ata.

Gjatë vitit 2023, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pas kryerjes së inspektimeve në Shtëpitë e Fëmijëve dhe hetimeve administrative të pavarura, u ka drejtuar 70 institucioneve shtetërore të administratës publike në nivel qendror dhe vendor 29 rekomandime, me një total prej 133 nënrekomandime për t'u zbatuar nga ana e tyre si dhe ka hartuar një botim me praktikën më të mirë të punës për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Edhe këtë vit kemi një numër të konsiderueshëm të numrit të fëmijëve që ankohen drejtpërsëdrejti tek institucioni i Avokatit të Popullit<sup>26</sup>. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së veprimtarive promovuese të kryera në terren në institucionet e edukimit, ku përfitues janë të dy palët, si fëmijët ashtu dhe institucioni i Avokatit të Popullit.

<sup>25</sup> Në veprimtarinë e këtij Seksioni përfshihet fusha që ka të bëjë me mbrojtjen dhe garantimin të të drejtave të fëmijëve.

<sup>26</sup> Për vitin 2023 rezultojnë 36 ankesa të ardhura drejtpërdrejt nga fëmijët.

Pavarësisht nga përmirësimet e kryera kohët e fundit, lidhur me veprimet e ndërmarra për rritjen e masës së ndihmës ekonomike, organet e administratës publike duhet të kenë parasysh që kjo masë e ndërmarrë nuk ka arritur të ketë ndikimet e pritshme në përmirësimin apo jetesën me dinjitet të fëmijëve, familjet e të cilëve janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. Kjo pasi rritja nuk ka qenë në masën e duhur për të garantuar jetesë me dinjitet për fëmijët. Vlerësojmë se ka ardhur koha për të kryer një analizë të thelluar, bazuar në interesin më të lartë të fëmijëve, për të rritur buxhetin social dhe përmirësimin e politikave të mbrojtjes sociale, ku në qendër të jenë fëmijët, pasi edhe ulja e përqindjes së fëmijëve në raport me numrin e popullsisë nga viti në vit është një shqetësim serioz për të ardhmen e shoqërisë në vendin tonë. Gjithashtu, aplikimi i reformës së ndërmarrë nga qeveria për zbatimin e modelit bio-psiko-social për aftësinë e kufizuar është një qasje e re dhe pozitive. Megjithatë, ky model duhet të zgjerohet dhe të mbështetet më tepër financiarisht jo vetëm për identifikimin e hershëm të vështirësive zhvillimore, por edhe për të krijuar shërbime sociale gjithëpërfshirëse, të bazuara në komunitet dhe shkolla, për fëmijët me aftësi të kufizuara, si një ndër kategoritë më vulnerabël të shoqërisë.


Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të vlerësohen me modelin e ri bio-psiko-social përmes një procesi vlerësimi që realizohet nga ekipe multidisiplinare, bazuar në nevojat shëndetësore e sociale të fëmijës, si dhe me synimin për të parandaluar institucionalizimin. Ofrimi i shërbimeve sociale për ta është një element i domosdoshëm për t'u mundësuar atyre një rrugëtim jetësor dhe arsimor sa më produktiv dhe përmbushës.

Avokati i Popullit, bazuar në inspektimet e kryera në institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë, ka konstatuar se ngritja e shërbimit të kujdestarisë profesionale, zbatimi i planeve individuale për fëmijët në institucionet e përkujdesit shoqëror, transformimi i Institucioneve aktuale të Përkujdesit Shoqëror në qendra të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe fuqizimi i punonjësve në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë masa të përealizuara plotësisht brenda periudhës kohore të parashikuar në planin e veprimit të deinstitutionalizimit. Përsheptimi i deinstitutionalizimit, duke zhvendosur buxhetin nga mjediset institucionale drejt mjediseve të kujdesit alternativ, të bazuar në komunitet dhe në familje është mjaft i rëndësishëm.

Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga Rrjeti Evropian i Ombudsmenve për Fëmijë (ENOC), ku ka dhënë dhe kontributin e tij lidhur me temën “Forcimi i Institucioneve të Pavarura të Drejtave të Fëmijëve duke njohur rolin e tyre unik”<sup>27</sup>.

---

<sup>27</sup> [ENOC-2023-Statement-on-Strengthening-ICRIs-FV.pdf](#).



---

### 3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria<sup>28</sup>

---

Për vitin 2023, numri i rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), të paraqitura nga të burgosur apo familjarë të tyre, është 92.

Përsa i përket të drejtës për arsim ka nisur që në vitin 2022 një hetim administrativ, për të verifikuar ankesën e një të burgosuri, i cili ngrinte shqetësimin se nuk i ishte krijuar mundësia për të përfunduar arsimin e lartë gjatë vuajtjes së dënimit në IEVP Korçë. Në përfundim të këtij hetimi, u konstatua se rasti konkret ka marrë zgjidhje, por nuk është nxjerrë akti nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, i parashikuar në nenin 45, pika 9 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Sipas kësaj dispozite, rregullat e zhvillimit të arsimit të mesëm dhe të lartë në burgje do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 81/2020.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit ka patur interesim të vazhdueshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë, nëse ka përfunduar procesi i hartimit të aktit nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Në përgjigjen e fundit të Ministrisë së Drejtësisë, në muajin tetor 2023, institucioni është vënë në dijeni se është hartuar udhëzimi në fjalë dhe se pritet dakordësia e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Kjo e fundit nuk ka kthyer një përgjigje nëse është dakordësuar me projekt udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë, megjithëse institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar në mënyrë të përsëritur.

Një numër jo i vogël rastesh të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me *trajtimin shëndetësor të të burgosurve*. Të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor kanë qenë në vëmendje të vazhdueshme të punës së institucionit të Avokatit të Popullit, si një kategori e veçantë personash me liri të kufizuar në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.<sup>29</sup>

Shtetasi R. B., është drejtuar me një ankesë, në të cilën ka ngritur shqetësimin se nuk po zbatohet Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku është caktuar se djali i tij duhet të vazhdojë masën mjekësore “*mjekim i detyruar spitalor*”, në një institucion mjekësor të specializuar (jashtë sistemit të IEVP-ve), sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, ishte nxjerrë urdhri për ekzekutimin e vendimit penal, me arsyetimin se në kushtet e mungesës së një institucioni mjekësor të posaçëm, personat me çrregullime të shëndetit mendor, do të trajtohen në IEVP Lezhë, si një institucion tranzitor. Sipas organit të prokurorisë shtetasi në fjalë, i cili vuan nga çrregullime të shëndetit mendor, është i dyshuar për një vepër penale dhe për këtë arsye nuk mund të mjekohet në institucione mjekësore, jashtë sistemit të IEVP-ve.

---

<sup>28</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>29</sup> Legjislacioni shqiptar parashikon që kjo kategori të burgosurish, të trajtohet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, të ndodhur jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Nga ana tjetër, shërbimi ndaj tyre duhet të jepet duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor.

Qëndrimi i Avokatit të Popullit në vijimësi ka qenë se, personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata ka vendosur masën “*mjekim i detyruar*” apo “*shtrim i detyruar*”, duhet të trajtohen në një institucion të posaçëm mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar. Kjo do të ishte zgjidhja e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave në mënyrë që t’u ofrohen programe gjithëpërfshirëse të vlerësimit, trajtimit dhe rehabilitimit të tyre.

Mosvënia në zbatim e vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas përcaktimeve të tij, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, është konsideruar në kundërshtim me legjislacionin shqiptar<sup>30</sup>. Për rrjedhojë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, iu rekomandua<sup>31</sup> marrja e masave për ekzekutimin e vendimit dhe se shtetasi I. B., duhet të vijojë masën mjekësore “*mjekim i detyruar spitalor*”, në një institucion të specializuar mjekësor (jashtë sistemit të IEVP-ve).

Institucioni i Avokatit të Popullit ka administruar edhe disa ankesa për mungesë të *shumëllojshmërisë së ushqimit*<sup>32</sup> që u sigurohet të burgosurve, ankesa të cilat janë paraqitur në mënyrë individuale nga të burgosurit, nëpërmjet letrave të dërguara institucionit si edhe të dorëzuara ndihmëskomisionerëve të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, gjatë kontakteve që ata kanë patur me të burgosurit, në inspektimet e kryera në disa IEVP të vendit.

Në përfundim të hetimit administrativ të ankesës së paraqitur nga një i burgosur, rezultoi se të burgosurve nuk u është siguruar ushqim i shumëllojshëm, sipas Udhëzimit të përbashkët nr.1, datë 22.02.2022 “Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit”, të nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>33</sup>. Në lidhje me konstatimet iu adresuan Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rekomandimet përkatëse<sup>34</sup>. Avokati i Popullit ka vënë theksin në mënyrë të vazhdueshme se rishikimi i menuesë ushqimore ka qenë domosdoshmëri për shumë vite dhe se edhe udhëzimi i vitit 2022 nuk ka sjellë përmirësimin e nevojshëm e të domosdoshëm për të siguruar jetesë të denjë në sistemin penitenciar. Pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim ka vend për të përmirësuar shumëllojshmërinë në përgjithësi dhe cilësinë në disa raste, për ushqimin që iu ofrohet të burgosurve.

---

<sup>30</sup> Konkretisht me nenin 142/3 të Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; nenet 24/1, 462/1, 463/1 dhe 464 të Kodit të Procedurës Penale; nenet 8; 11/1; 23/4/5 dhe 56 të Ligjit Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale.”

<sup>31</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20ekzekutimin%20e%20vendimit%20gjyqesor%20per%20te%20burgosurit%20me%20mase%20mjekesore.pdf>

<sup>32</sup> Sipas kuadrit ligjor që rregullon *trajtimin ushqimor të të burgosurve*, në pikën 4 të nenit 36 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet se: “*Ushqimi i siguruar nga institucioni duhet të jetë i shumëllojshëm, i pasur me vlera ushqyese, të ndryshohet të paktën një herë në dy javë dhe t’u përshtatet kushteve klimaterike*”.

<sup>33</sup> Ky Udhëzim është protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 995/1 Prot., datë 07.03.2022 dhe në Ministrinë e Drejtësisë me nr. 1126 prot., datë 22.02.2022.

<sup>34</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20sigurimin%20e%20shumelloyshmerise%20ushqimore%20per%20te%20burgosurit.pdf>

Gjithashtu, në institucionin e Avokatit të Popullit janë regjistruar më herët për shqyrtim raste, kur të burgosurit kanë kryer veprime për t'u vetëdëmtuar ose për të dëmtuar të tjerët dhe punonjësit e policisë i kanë kufizuar ata me pranga në krevat dhe vendosur skafandër në kokë. Kështu, në vitin 2017 u hetuan ankesat e dy të dënuarve të IEVP Fier, të cilët pretenduan se ishin mbajtur tre ditë të kufizuar me fasheta plastike, pranga dhe skafandër në kokë në krevatin e dhomës së veçimit. Një ndër masat që u kërkuar të merrej në përfundim të hetimit nga Avokati i Popullit ishte blerja e mjeteve të veçanta të kufizimit fizik në sasi të mjaftueshme për të gjithë IEVP-të dhe blerjen e të paktën një shtrati dhe një karrige kufizuese për çdo IEVP<sup>35</sup>.

Ligji “Për Policinë e Burgjeve”<sup>36</sup> dhe “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”<sup>37</sup>, parashikojnë shtrëngimin fizik në rastet e vetëdëmtimit, por nuk përcaktojnë pajisjet e kufizimit fizik<sup>38</sup>. Megjithëse, neni 123, pika 4 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve e lejon përdorimin e prangave për të parandaluar një sjellje të dhunshme, legjislacioni i shëndetit mendor<sup>39</sup> dhe udhëzuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Mbi përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik, përdorimi i dhomës së veçimit, mjekimi i pavullnetshëm”, kërkon që të përdoren mjete të veçanta kufizimi për të zbatuar në mënyrë sa më të sigurt kufizimin fizik.

Kësaj çështje iu rikthyem në vitin 2020, të vënë në lëvizje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila në një vendim të saj është shprehur për rastin e një të burgosuri, i cili ishte kufizuar fizikisht me pranga si dhe i ishte vendosur skafandër në kokë, për të shmangur veprimet vetëdëmtuese. Kjo gjykatë ka konstatuar se nuk janë respektuar rregullat që kanë të bëjnë me kufizimin fizik të të burgosurit për sa i përket proporcionalitetit, kohëzgjatjes, kushteve të dhomës ku mbahet i kufizuar i burgosuri, kontrollit të vazhdueshëm mjekësor, ajrosjes dhe mbajtjes së të dhënave për këtë masë.

Nga institucioni i Avokatit të Popullit ka patur komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve edhe gjatë vitit 2023, për t'u informuar nëse ishin siguruar mjete të veçanta të kufizimit fizik për IEVP-të, për të burgosurit që shfaqin sjellje vetëdëmtuese.

Në përgjigjen e fundit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në muajin Janar 2024, institucioni është vënë në dijeni se janë siguruar mjetet e veçanta të kufizimit fizik të të burgosurve që shfaqin sjellje vetëdëmtuese dhe tashmë ka nisur shpërndarja e tyre në IEVP. Në vijim mbetet për t'u vlerësuar efikasiteti i përdorimit të këtyre mjeteve, mënyra e përdorimit të tyre dhe nëse numri i shpërndarë do të jetë i mjaftueshëm për të garantuar në të gjitha IEVP-të trajtimin human dhe në përputhje me aktet e sipërpërmendura.

---

<sup>35</sup> Kjo masë u kërkuar pas verifikimeve që u kryen në të gjitha IEVP-të e vendit nga ku rezultoi se asnjë prej tyre nuk kishte dhomë izolimi për të burgosur që shfaqin sjellje vetëdëmtuese dhe mjete të veçanta të kufizimit fizik, përveç IEVP Krujë që kishte vetëm një copë nga kjo e fundit.

<sup>36</sup> Ligji nr.80/2020 (nenet 9, 13 dhe 14).

<sup>37</sup> Ligji nr.81/2020 (nenet 70 dhe 71).

<sup>38</sup> Neni 14/4 i ligjit nr.80/2020 “Për Policinë e Burgjeve” përcakton se ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe i hekurave dhe çdo mjet tjetër që e vendos personin në kushtet e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo degradues.

<sup>39</sup> Ligji nr. 44/2012 dhe Urdhëri i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 586, datë 30.10.2013 “Standardet e kufizimit fizik në shërbimet e shëndetit mendorë të specializuar me shtretër”.

Të burgosurit i lejohej të mbajë veshje dhe sende të përdorimit personal gjatë vuajtjes së dënimit. Kur i burgosuri transferohet nga një I EVP në tjetrin, ai lejohej që sendet personale t'i marrë me vete. *Procedura e transferimit* të sendeve personale parashikon mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe të kthimit të këtyre sendeve, të nënshkruar nga personeli shoqërues, personeli dorëzues, personeli pritës dhe i burgosuri. Kjo nënkupton ngarkesë të kapaciteteve logjistike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke patur parasysh numrin e sendeve personale që një i burgosur grumbullon gjatë qëndrimit në I EVP dhe rrjedhimisht mund të ketë cedime në respektimin e procedurës përkatëse.

Kjo ka ndodhur me dy të burgosur të transferuar nga një I EVP në një tjetër, të cilët janë ankuar se pas transferimit, nuk u janë dorëzuar sendet e tyre personale. Pas analizimit të informacionit dhe dokumentacionit shoqërues për të dy rastet objekt të hetimit administrativ rezultoi se, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe kthimit të sendeve personale. Gjetjet iu përcollën, përmes rekomandimit të Avokatit të Popullit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve<sup>40</sup>, e cila informoi se po vlerësonte mundësinë e përcaktimit dhe saktësisë të procedurës së transferimit të të burgosurve dhe sendeve të tyre personale.

Gjithashtu, në fokusin e trajtimit të institucionit kanë qenë edhe ankesa të punonjësve të I EVP-ve, jo vetëm për faktin se edhe kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në shërbimin që ata u ofrojnë të burgosurve.

Barra kryesore për të përballuar gjendjen e shkaktuar nga përhapja e Virusit Covid-19 ra mbi personelin shëndetësor dhe mbështetës të spitaleve, duke përfshirë këtu edhe atë të I EVP-ve, pasi në Qendrën Spitalore të Burgjeve funksiononin 2 pavione për pacientë të infektuar me virusin Covid-19. Për të vlerësuar përkushtimin e kësaj pjese të administratës, u miratua VKM nr.207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë", ku është caktuar dhënia e shpërblimit financiar për personelin mjekësor dhe mbështetës të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.<sup>41</sup>

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë listën emërore të personelit shëndetësor dhe mbështetës që kanë trajtuar të burgosur të prekur nga virusi Covid-19, duke kërkuar nisjen e procedurës për marrjen e shpërblimit të përcaktuar në aktin nënligjor të sipërcituar. Por, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka pranuar kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke u shprehur se ka në kompetencë miratimin e trajtimit financiar vetëm për stafin mjekësor të institucioneve në varësi të saj. Në vijim, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar me shkresë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku ka kërkuar rishikimin e qëndrimit të saj, duke dhënë argumente sipas interpretimit që i ka bërë këtij akti. Por, edhe pas këtij komunikimi shkresor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mbajtur sërish të njëjtin qëndrim.

---

<sup>40</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20mbajtjen%20e%20procesverbalit%20te%20dorezimit%20e%20sendeve%20personale%20te%20te%20burgosurit%20qe%20transferohet.pdf>

<sup>41</sup> Ky akt nënligjor ngarkon për zbatimin e tij Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Fondi për dhënie të shpërblimit do të përballohej nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2020.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, pas regjistrimit të ankesës nga disa punonjës të personelit mjekësor, është çmuar se argumentet e dhënë nga Ministria e Drejtësisë për të shpërblyer personelin shëndetësor të I EVP-ve përkatëse, janë të qenësishme dhe në përputhje me frymën dhe interpretimin e VKM-së nr.207, datë 10.03.2020. Akti i nxjerrë për këtë qëllim, nuk bën asnjë dallim ndërmjet personelit në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo institucioneve të tjera.

Për këto arsye, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>42</sup> marrjen e masave të menjëhershme për nisjen e procedurës për dhënien e shpërblimit stafit mbështetës dhe shëndetësor të I EVP-ve, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19. *Për këtë rekomandim, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka kthyer përgjigje.*

Shqetësim i vazhdueshëm mbetet edhe organika e paplotësuar e stafit policor në I EVP, për shkak të largimeve të tyre dhe vështirësisë për të gjetur zëvendësues. Trajtimi jo i duhur financiar i tyre nuk e përmirëson situatën. Kontributi i punonjësve të Policisë së Burgjeve është i domosdoshëm për të garantuar sigurinë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Pavarësisht rritjes së pagave sipas gradave për punonjësit e Policisë së Burgjeve, nuk duhet të ketë hapa pas, pasi është evidentuar që sistemi i burgjeve po përballet me vështirësi në ruajtjen e stafit në mënyrë të qëndrueshme dhe profesionale.

Gjatë hetimit administrativ të nisur lidhur me kompensimin e shpenzimeve të transportit për disa punonjës të I EVP Lezhë, të komanduar me detyrë në I EVP “Jordan Misja”, është marrë në shqyrtim legjislacioni ku parashikohet trajtimi financiar i punonjësve të Policisë së Burgjeve në këto raste. Në pikën II/1, 2 të VKM nr. 920, datë 23.11.2020 “Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, përcaktohet se, punonjësi i Policisë së Burgjeve, kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij, në rast pamundësie të garantimit nga institucioni të transportit nga vendbanimi deri në vendin e punës, përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit<sup>43</sup>.

Nga ana tjetër, së fundmi jemi njohur me VKM-së nr. 722, datë 13.12.2023 “Për disa të drejta të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, ku parashikohet kompensim për shpenzimet e udhëtimit për këtë kategori punonjësish, kur ata emërohen ose transferohen në një detyrë tjetër. Kompensimi është caktuar në masë fikse në varësi të distancës së vendbanimit të punonjësit me vendin e punës. Por, ndërsa distanca e përcaktuar për t’u kompensuar është e njëjtë për dy kategoritë e punonjësve, shumica e kompensimit është më e konsiderueshme për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Avokati i Popullit vlerëson se ky trajtim i ndryshëm ndërmjet punonjësve të administratës shtetërore përbën trajtim të pabarabartë përpara ligjit dhe për këtë arsye i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë<sup>44</sup>. marrjen e nismës për propozimin e ndryshimit/përmirësimit të VKM-së nr. 920, datë

<sup>42</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20shperblimin%20e%20stafit%20shendetesor%20te%20I EVP%20per%20trajtimin%20e%20Covid.pdf>

<sup>43</sup> Ky kompensim është në masë në lekë për muaj, në varësi të distancës në km, të vendit të punës me vendbanimin e punonjësit. Kjo masë kompensimi është parashikuar sipas tabelës bashkëlidhur VKM-së. nr. 920, datë 23.11.2020.

<sup>44</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.



23.11.2020 “Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, ku masa e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, të jetë e barabartë me atë të përcaktuar për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.*

---

### 3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit<sup>45</sup>

---

Gjatë vitit 2023 në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 64 raste, nga të cilat 52 ankesa dhe 12 raste të filluara me iniciativë ndaj strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. Objekti i tyre ka qenë i gjerë, ndër të cilët janë evidentuar raste për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë, për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor, për arrestime apo ndalime të paligjshme, për kontrolle të paligjshme banese, për mos pasqyrimin në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të orës faktike të personave të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, për keqtrajtme fizike ose psikologjike gjatë shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë, për mos njoftimin nga policia të familjarëve të të shoqëruarve apo moslejimin e tyre të komunikojnë vetë me ta me telefonat e tyre, për sjellje pa etikë të punonjësve të policisë gjatë komunikimit, për kushte të papërshtatshme të ambienteve të shoqërimit, për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre, për mos sigurimin e mbrojtjes ligjore gjatë shoqërimit apo kryerjes së veprimeve procedurale, për vendosje të masave administrative të kundërligjshme nga punonjësit e Policisë Rrugore ose për mos njoftimin e këtyre masave konform dispozitave të Kodit Rrugor; për shkelje të të drejtës së informimit, për cënimin e të drejtës së shtetasve për t’u pranuar në Gardën e Republikës nëpërmjet bërjes së vërtetimeve subjektive të besueshmërisë, për largim të padrejtë nga Policia e Shtetit, për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri, si refuzimin e pajisjes së tyre me leje qëndrimi, zvarritje të procedurave për fitimin e shtetësisë shqiptare, etj.

Nuk duhet të lemë jashtë vëmendjes pasojat që vijnë nga shkeljet e të drejtave kushtetuese e ligjore të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të policisë që cenojnë imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit si dhe besimin publik të këtij institucioni të administratës publike. Nga ana tjetër, duhet të theksojmë faktin se rritja e besimit në publik të Policisë së Shtetit është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rritjen e performancës së këtij organi në kryerjen e misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *atë të ruajtjes së rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.*

Disa nga shkeljet e të drejtave kushtetuese e ligjore për të cilat janë bërë rekomandime gjatë vitit 2023 mund të përmenden si më poshtë vijon:

---

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20legjilsativ%20per%20ndryshimin%20e%20vkm%20per%20kompensimin%20financiar%20te%20policise%20se%20burgjeve.pdf>

<sup>45</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

### 3.3.1. E drejta e shtetasve për të lëvizur lirisht

E drejta e çdo personi për të lëvizur lirisht brenda shtetit të tij dhe për t'u larguar e kthyer nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e tij, është një nga të drejtat themelore universale të njeriut<sup>46</sup>. Në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar disa ankesa nga shtetas të ndryshëm të cilët pretendonin se pengoheshin nga Policia Kufitare dhe Migracionit për të dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo nga shtetas të huaj për të hyrë në territorin e vendit tonë. Nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se pengimi i ankuesve nga policia për të dalë jashtë vendit lidhet me mos plotësimin e kritereve përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar. Por, janë konstatuar edhe raste që punonjësit e Policisë së Shtetit u kanë cenuar shtetasve të drejtën për të lëvizur lirisht duke pretenduar se ata kanë pasur pengesa, por që kanë rezultuar jo të qenësishme.

Një rast të zgjidhjes në favor të ankuesit mund të përmendim ankesën e shtetasit A.K., lindur në Burrel, banues në Angli dhe me shtetësi angleze. Në vitin 2021 ai ishte gjobitur nga Komisarati i Policisë Kufitare Rinas, për shkak se kishte shkelur karantinimin e detyruar prej 14 ditësh, por gjobën nuk e kishte paguar<sup>47</sup>.

Sipas ankuesit, në zbatim të ligjit për kundërvajtjet administrative, ku parashikohet se, gjoba e cila nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve, parashkruhet, në datën 04.01.2023, i ishte drejtuar me kërkesë Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM) Tiranë për fshirjen e saj në sistemin TIMS. Ai pretendonte se, ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes kishte kaluar, ajo nuk i ishte dërguar dhe se gjoba nuk ishte fshirë nga sistemi. Gjithashtu, ankuesi shkruante se kishte komunikuar në telefon me punonjësit e DVKM Tiranë, por ata ishin shprehur se gjoba për shtetasit e huaj nuk parashkruhet dhe nuk hiqet nga sistemi TIMS. Në përfundim të hetimit administrativ të kësaj ankese dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar në DVKM Tiranë konstatuam se gjoba e vendosur shtetasit A.K. me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes në datën 03.01.2021 ishte e bazuar në ligj dhe e drejtë. Por, meqënëse kjo masë administrative nuk ishte ekzekutuar brenda afatit dy vjeçar, ajo ishte parashkruar dhe ankuesi nuk kishte më detyrim për pagimin e saj<sup>48</sup>. Vlen të theksohet se nga rastet individuale të hetuara nga Avokati i Popullit janë identifikuar praktika të gabuara në zbatimin e ligjit.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit i rekomanduam<sup>49</sup> DVKM Tiranë dhe Departamentit për Kufirin dhe Migracionin:

- marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e vendimit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të dhënë ndaj shtetasit A.K. me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes në datën 03.01.2021 dhe fshirjen e saj nga sistemi TIMS;
- marrjen e masave për të analizuar në mënyrë të thellë, me objektivitet dhe me profesionalizëm të shkaqeve të mos veprimit konform ligjit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të ankuesit A.K.;

<sup>46</sup> E garantuar nga neni 38 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 13 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe neni 2, i Prokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

<sup>47</sup> Gjoba ishte në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, bazuar në Aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", të ndryshuar.

<sup>48</sup> Parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

<sup>49</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20per%20Altin%20Koka.pdf>

- trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe njohjen e akteve normative që garantojnë respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve; si dhe
- përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e DVKM Tiranë dhe në shkallë vendi me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të shtetasve nga punonjësit e policisë.

*Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.*

### *3.3.2. E drejta e paprekshmërisë së banesës dhe respektimi me korrektesë i rregullave të parashikuara në aktet normative*

E drejta themelore e paprekshmërisë së banesës dhe të mjediseve që njësohen me të garantohet nga neni 37 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 i KEDNJ dhe neni 12 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Kontrolli i banesës mund të bëhet vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara në ligj<sup>50</sup>. Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 117 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësit e policisë gjyqësore janë të detyruar të zbatojnë me korrektesë procedurën përkatëse dhe të përpilojnë dokumentacionin e parashikuar në ligj për veprimin e kryer<sup>51</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me nismën e vet<sup>52</sup> rastin e bërë publik në median “Vizion Plus” TV, në datën 03.02.2023<sup>53</sup>. Ky televizion ka bërë publik rastin e kontrollit të banesës së shtetasit A.Gj. me banim në fshatin Dajç të Lezhës. Sipas bashkëshortes së tij, në orët e para të mëngjesit i kanë shkuar në banesë disa punonjës policie. Tre prej tyre pa dhënë asnjë shpjegim apo paraqitur ndonjë dokument kanë hyrë brenda dhe kanë bërë kontroll në të dy katet e banesës.

Nga shqyrtimi i këtij rasti dhe dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Shkodër rezultoi se në këtë organ është dërguar shkresa nr. 257/1 prot., datë 27.08.2022 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër e cila ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal nr. 511 (3279), datë 27.08.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër<sup>54</sup>.

Nisur nga rrezikshmëria e lartë shoqërore që paraqiste personi i shpallur në kërkim policor dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative nga specialistët për hetimin e krimit pranë DVP Shkodër, ishte bërë një plan operacional për mundësimin e gjetjes dhe kapjes së këtij personi që po i fshihej drejtësisë. Sipas informacionit të përfituar, vendndodhja e mundshme e personit të shpallur në kërkim pretendohet të ishte fshati Dajç, i Lezhës, përkatësisht në njërën prej 3 hyrjeve të një ndërtese. Në këto kushte, me ndihmën e FNSH-së është bërë rrethimi paraprak i ndërtesës, me qëllim që të pengohej dalja e mundshme e personave që ndodheshin në 3 hyrjet e saj dhe është ushtruar kontroll në ndërtesë përfshirë edhe banesën e shtetasit A.Gj.

<sup>50</sup> Kodi i Procedurës Penale në disa dispozita parashikon rastet e ushtrimit të kontrollit të banesës dhe të mjediseve të njësuar me të, organin kompetent, kohën e kontrollit, rregullat që duhen zbatuar dhe dokumentacioni që duhet mbajtur në të tilla raste. Kontrolli i banesës mund të bëhet me vendim gjyqësor ose me iniciativën e policisë gjyqësore vetëm në rastet e flagrancës.

<sup>51</sup> Në rastet e ushtrimit të kontrollit me iniciativë nga punonjësit e policisë gjyqësore, ata duhet të dërgojnë dokumentacionin e mbajtur menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli.

<sup>52</sup> Konform nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

<sup>53</sup> Vizion Plus TV - [https:// www.youtube.com/watch](https://www.youtube.com/watch)

<sup>54</sup> Ku ishte vendosur masa e sigurisë “Arrest në burg”, në mungesë, ndaj personit nën hetim A.P., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi e mbajtja pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga nenet 78 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti konstatoam se veprimet e kryera në banesat e shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N nga strukturat e DVP Shkodër për kërkimin dhe kapjen e shtetasit A.P., i cili ishte shpallur në kërkim, ishin në përputhje me aktet normative në fuqi<sup>55</sup>. Pra, policia ka qenë në rrethana të veçanta urgjence që nuk lejonin nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Por, në këtë rast veprimet e policisë, duke hyrë në banesat e shtetasve të përmendur më sipër, për kërkimin dhe kapjen e shtetasit A.P., faktikisht përbëjnë kontroll të mirëfilltë banese për gjetjen e personit në kërkim. Është mëse e qartë dhe evidente se kërkimi dhe kapja e një personi që i fshihet drejtësisë bëhet duke bërë kontrollin e mjediseve të ndryshme.

Ndërkohë, konstatoam se veprimet procedurale të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Z. M. pas kryerjes së kontrollit në banesat e shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N., nuk ishin në përputhje me pikat 2 e 4, të nenit 298 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me pikën 4, të nenit 117<sup>56</sup> të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Ndodhur në këto rrethana faktike e ligjore, nga oficeri i policisë gjyqësore Z. M. duhet të ishin mbajtur/përpiluar edhe procesverbalet e kontrollit të tre banesave të shtetasve konform pikës 4, të nenit 117 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe nenit 303<sup>57</sup> të Kodit të Procedurës Penale. Po ashtu, konstatoam se në këtë rast nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është zbatuar detyrimi ligjor për të mbajtur/hartuar procesverbalet e kontrolleve të banesave dhe dërgimin e tyre në organin e prokurorisë për të bërë vleftësimin brenda afatit ligjor prej 48 orësh nga momenti i kryerjes së këtij veprimi.

Për sa më sipër, në lidhje me gjetjet tona u adresuam rekomandimet përkatëse<sup>58</sup> Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

*Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.*

### 3.3.3. *Shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit, respektimi i kriterëve ligjore dhe i të drejtave të tyre.*

---

<sup>55</sup> Respektivisht Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 684, datë 25.11.2019 “Mbi rregullat për realizimin e kërkimit dhe kapjes së personave, si dhe gjetjes së sendeve në kërkim”, Kreu I, pikat 10, 11 e 12 dhe me pikën 2 të nenit 298 të Kodit të Procedurës Penale, të arsyeshme dhe në zbatim të misionit ligjor dhe të detyrave të Policisë së Shtetit.

<sup>56</sup> Neni 117 “Ndërhyrja në mjedise” parashikon se:

*“4. Në të gjitha rastet e hyrjes dhe të kontrollit, sipas këtij neni, punonjësi i policisë harton një procesverbal në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, ku ndër të tjera përmenden arsyet e hyrjes, kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij”.*

<sup>57</sup> “1. Policia gjyqësore dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera.

2. Policia gjyqësore mban procesverbal për:

ç) këqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet;

3. Dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore, provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit”.

<sup>58</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandime%20per%20Artan%20Gjinaj.pdf>

Shoqërimi i shtetasve në organet e policisë është një e drejtë ligjore e këtij organi për realizimin e detyrave në kuadër të përmbushjes së misionit ligjore të Policisë së Shtetit.<sup>59</sup> Meqënëse shoqërimi përbën një kufizim të lirisë së shtetasit të shoqëruar, është domosdoshmëri që kjo masë të zbatohet vetëm për rastet dhe kur përmbushen kriteret e parashikuara në dispozitat e ligjit si dhe në Procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”<sup>60</sup>. Ndërkohë strukturat e këtij organi kanë detyrimin ligjor që të krijojnë ambiente të përshtatshme e dinjitoze për qëndrimin dhe akomodimin e të shoqëruarve, të zbatojnë me korrektesë procedurat për regjistrimin e trajtimin e tyre si dhe të respektojnë të drejtat e garantuara nga aktet normative në fuqi.

Ndër vite në institucionin tonë janë administruar ankesa lidhur me këtë problematikë dhe në mjaft raste kemi konstatuar shkelje ligjore lidhur me moszbatimin e kriterëve ligjore të shoqërimit, si dhe cenim të të drejtave të të shoqëruarve gjatë kryerjes së këtij veprimi apo gjatë kohës së mbajtjes e pyetjes së tyre në ambientet e organeve vendore të Policisë së Shtetit. Ndonëse në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit është trajtuar ky shqetësim dhe është rekomanduar përmirësimi i punës, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme të këtyre strukturave.

Edhe gjatë vitit 2023 janë evidentuar shkelje ligjore të kryera nga punonjësit e policisë lidhur me shoqërimet e shtetasve. Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit. Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së kësaj shkeljeje të të drejtave të qytetarëve është edhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të policisë ndaj vartësve të tyre.

Një nga rastet për të cilin është konstatuar shkelje ligjore lidhur me shoqërimin dhe dërguar rekomandim strukturave respektive të Policisë së Shtetit<sup>61</sup>, mund të përmendim atë të regjistruar me iniciativë pas publikimit në mediat sociale në datën 14.05.2023. Shtetësja V.B. me banim në qytetin e Himarës ka bërë publik shqetësimin e saj lidhur me shoqërimin në organin e policisë në orën 02:00, të datës 13.05.2023. Sipas saj, disa punonjës policie i kanë shkuar në banesë dhe i kanë kërkuar që të shkonte me ta në polici së bashku me djalin 18 vjeç. Ajo dhe djali i saj janë shoqëruar në Komisarariat të Policisë Vlorë ku janë pyetur në lidhje me çështjen e blerjes së votave nga kandidati për Bashkinë e Himarës i koalicionit “Bashkë fitojmë”, F.B. Pasi u janë marrë deklaratimet, punonjësit e policisë i kanë lënë të lirë dhe nuk i kanë përcjellë për në banesë.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti konsatua se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Himarë në bazë të një urdhri të Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Vlorë kanë bërë shoqërimin e disa shtetasve ndër të cilët ka qenë edhe shtetësja V.B., për llogari të Strukturave të Hetimit të Krimeve në DVP Vlorë, në funksion të hetimeve proaktive regjistruar për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, me qëllim marrjen e të dhënave si person që tregon rrethana të hetimit në funksion të një procedimi penal.

<sup>59</sup> Parashikuar në nenet 109 dhe 122, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

<sup>60</sup> Miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>61</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20i%20per%20Valbona%20Bala.pdf>.

Ndërkohë konstatoam se punonjësit e DVP Vlorë të cilët kishin kryer veprime me të shoqëruarit nuk ishin treguar human dhe dinjitozë. Mbas shoqërimit në orët e natës, kryerjes së veprimeve të tjera hetimore e procedurale me të shoqëruarit, si dhe qëndrimit për rreth 10 orë në gjendje shoqërimi në organin e policisë, ata duhet të ishin dërguar në vendbanimet e tyre me mjetet e policisë, duke u kursyer kohë dhe shpenzime financiare.

Po ashtu, nga punonjësit e policisë të të gjitha strukturave të DVP Vlorë nuk ishin zbatuar detyrimet e parashikuara në aktet normative në fuqi që parashikojnë e rregullojnë shoqërimin e shtetasve në mjediset/ambientet e policisë. Nuk ishte kryer asnjë veprim administrativ për dokumentimin e veprimit të shoqërimit, si: plotësimi i formularit të raportit të shoqërimit nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Himarë, menjëherë pas shoqërimit të tyre në ambientet e DVP Vlorë; evidentimi i të dhënave të të shoqëruarve në sistemin elektronik dhe në regjistrin e evidentimit të personave të shoqëruar pas mbërritjes së të shoqëruarve në ambientet e këtij organi nga punonjësi i zyrës së informacionit të DVP ose Komisarariatit të Policisë Vlorë; përpilimi/hartimi i procesverbaleve të dokumentimit të veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dhe dhënia e kopjes së tyre të shoqëruarve nga punonjësit e policisë që kishin kryer veprime me ta, etj.<sup>62</sup>

*Ky rekomandim është pranuar nga strukturat përkatëse.*

#### *3.3.4. Garantimi i të drejtës së mbrojtjes me avokat i personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar dhe i të drejtave të tjera*

E drejta e mbrojtjes me avokat është garantuar nga nenet 28, pikat 1 dhe 31/ç të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 6, pika 3/c të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 48/1/2 e 255/1 të Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 6/2 dhe neni 11/a, c, ç, d, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në vendin tonë. Pavarësisht kësaj, në veprimtarinë e përditshme nga punonjësit e Policisë së Shtetit konstatohen raste të cenimit të kësaj të drejte themelore të shtetasve. Ndër shkaqet e këtyre shkeljeve mund të përmendim mos njohjen e akteve normative që e sanksionojnë atë, mos ushtrimi i kontrollit sa e si duhet nga eprorët e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe nga organi procedues në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të hetimit penal.

Një rast të kësaj natyre mund të përmendim ankesën e shtetasit V.F. i cili shkruante se ishte shoqëruar në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe në datën 01.09.2023, në orën 07:00. Pas rreth 12 orë pyetjeje dhe veprime hetimore nga punonjësit e këtij komisaritati është bërë arrestimi i tij për veprën penale “Vjedhje me dhunë” mbetur në tentativë. Ankuesi pretendonte se gjatë veprimeve procedurale të kryera me të i ishin shkelur disa të drejta ligjore, ndër të tjera edhe mohimi i të drejtës për të pasur prezent një avokat.

Nga hetimi administrativ i kësaj ankese dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar konstatoam se pas kallëzimit të shtetasës R.H., ankuesi ishte shoqëruar në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe e mbajtur në gjendje shoqërimi për 8 orë e 30 minuta, gjatë të cilës janë kryer disa veprimeve procedurale.

---

<sup>62</sup> Kjo procedurë parashikohet në mënyrë të qartë në nenet 6/25, 109 dhe 122/1 të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Procedurën standarde të punës: “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në vijim, ai ishte arrestuar nga oficeri i policisë gjyqësore A. N. për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, mbetur në tentative.<sup>63</sup> Sipas policisë, fillimisht shtetasi V.F. ishte pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit dhe se kjo procedurë nuk kërkon pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës.

Ky qendrim bie ndesh me nenin 109, pika 3, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe gërmës “e”, të pikës 1, të Kreut VI, të Procedurës standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”. Referuar dispozitave të këtyre akteve rezulton se punonjësit e policisë kanë detyrimin që ta njohin personin e shoqëruar me të drejtat e tij ligjore që në momentet e para të shoqërimit në mjediset e policisë. Dhe nëse i shoqëruari, pavarësisht arsyes së shoqërimit dhe cilësisë së pyetjes së tij, kërkon të komunikojë me një person të besuar, avokat apo mbrojtës ligjor, punonjësit e policisë janë të detyruar që të zbatojnë e respektojnë këtë të drejtë ligjore të tij të garantuar nga ligji.

Ndërkohë konstatoam se në procesverbalin e arrestimit të shtetasit V.F., ora e arrestimit të tij ishte shënuar ora e përpilimit të procesverbalit 17:00 dhe jo çasti (ora) i kapjes së tij në fakt (08:30) kur ai është privuar realisht nga liria<sup>64</sup>.

Gjithashtu nga ana jonë u konstata se proceverbali mbi veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, ishte plotësuar por nuk ishte nënshkruar as nga përpiluesi i tij dhe as nga personi i shoqëruar. Në vlerësimin tonë, ky fakt provon se ai nuk ishte plotësuar në kohën e duhur dhe menjëherë pas përfundimit të veprimeve procedurale. Ky qëndrim/mosveprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe me Kreun e VII-të, pika 1, gërma “a.3” të Procedurës standarde të punës, të cituar më sipër dhe mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet.

Për sa më sipër i rekomanduar<sup>65</sup> Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër marrjen e masave të nevojshme për adresimin e shkeljeve të evidentuara nga ana jonë. *Ky rekomandim është pranuar nga strukturat përkatëse.*

### *3.3.5. Aplikimi i masave administrative ndaj drejtuesve të mjeteve motorrike kundërvajtës nëpërmjet zbatimit me korrektesë të dispozitave të Kodit Rrugor*

Në veprimtarinë e përditshme në funksion të zbatimit të misionit ligjor për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, punonjësit e Policisë së Shtetit (Policisë Rrugore dhe Policisë së Rendit), vendosin gjoba ndaj drejtuesve të mjeteve të cilët kryejnë shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor. Aplikimi i gjobave administrative ka si qëllim vendosjen e rregullit dhe disiplinimin e drejtuesve të mjeteve me synim lëvizjen e lirë, të shpejtë dhe të sigurt në rrugë si për ata ashtu edhe për këmbësorët. Në disa raste, masat administrative nga punonjësit e Policisë së Shtetit vendosen në mungesë të drejtuesve të mjeteve. Kjo e

---

<sup>63</sup> Parashikuar nga nenet 139 e 22 të Kodit Penal.

<sup>64</sup> Bazuar në nenet 144, 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i orës së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Po ashtu, në bazë të nenit 258 të KPP, nga ora e arrestimit/ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

<sup>65</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandi%20per%20Visar%20Fsharri.pdf>.

drejtë është parashikuar në nenin 199<sup>66</sup> të Kodit Rrugor. Ndërkohë, në këtë dispozitë të Kodit Rrugor është parashikuar edhe detyrimi i organeve të policisë për të bërë njoftimin e shkeljes kundërvajtësit. Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi korrekt i Kodit dhe garantimi i të drejtave të qytetarëve duhet të jetë në qendër të punës së këtyre strukturave.

Në institucionin e Avokatit të Popullit për gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë administruar ankesa nga qytetarë të ndryshëm pronarë dhe përdorues të automjeteve, të cilët ngrinin shqetësimin e lidhur me vendosjen e gjobave administrative në mungesë nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Ndërkohë ankuesit kanë ngritur edhe një shqetësim tjetër që lidhet me këtë çështje. Sipas tyre, në mjaft raste, megjithëse nuk kishin dijeni për gjobat administrative të vendosura në mungesë, ndaloheshin nga punonjësit e Policisë Rrugore dhe pengoheshin për të lëvizur me automjet brenda vendit ose të dilnin lirisht me automjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa bërë më parë pagesën e detyrimeve përkatëse. Detyrimi për të likujduar pagesat e gjobave bëhej duke u tërhequr lejen e qarkullimit ose dërguar mjetin në parkime të dedikuara për Policinë e Shtetit.

Për shqyrtimin e kësaj problematike të ngritur nga ankuesit por edhe nga media, nga institucioni ynë u bënë inspektime në disa Organe Administrative Shetërore (OASH) pranë Drejtorive Vendore të Policisë dhe në disa komisariate në shkallë vendi. Objekt i këtij inspektimi ishte respektimi i procedurave ligjore lidhur me gjobat e vendosura në mungesë nga punonjësit e Policisë së Shtetit (Policisë Rrugore dhe Policisë së Rendit), plotësimi i dokumentacionit lidhur me masat administrative në fushën e qarkullimit rrugor, funksionimi i OASH-eve, respektimi i të drejtave ligjore të shtetasve kundërvajtës nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, etj.

Nga inspektimet dhe verifikimet e bëra rezultoi se numri i gjobave të vendosura në mungesë nga punonjësit e Policisë Rrugore dhe ata të Rendit Publik është i konsiderueshëm dhe më i madh se sa numri i gjobave të vendosura në prezencë të drejtuesve të mjeteve<sup>67</sup>.

Nga strukturat e policisë nuk zbatohet në mënyrë korrekte detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 199 të Kodit Rrugor dhe Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022, për njoftimin brenda 30 ditëve të shkeljeve drejtuesve të mjeteve për rastet e evidentimit dhe konstatimit të tyre në mungesë.

---

<sup>66</sup> Neni 199 “Njoftimi i shkeljeve”, parashikon se:

1. Kur nuk mund të përcaktohet menjëherë autori i shkeljes, procesverballi me të dhënat e sakta dhe të detajuara të shkeljes dhe me tregimin e motiveve që kanë bërë të pamundur përcaktimin e menjëhershëm, duhet, brenda 30 ditëve nga verifikimi i shkeljes, t’i njoftohet shkelësit përkatës.

5. Subjekti, njoftimi i të cilit nuk kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar, nuk është më i detyruar të paguajë gjobën administrative.

<sup>67</sup> Në DVP Fier në muajin Korrik 2023 nga Policia Rrugore dhe ajo e Rendit Publik janë vendosur 12,085 gjoba gjithsej, nga të cilat 4,390 gjoba ose rreth 36 % e tyre janë vendosur në mungesë.

Në DVP Durrës, në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 5,014 gjoba gjithsej, nga të cilat 2,286 gjoba ose rreth 46 % e tyre janë vendosur në mungesë.

Në Komisarlatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë gjatë muajit Gusht 2023 vetëm nga punonjësit e këtij organi janë vendosur 28,406 gjoba gjithsej, nga të cilat 20,084 gjoba ose rreth 71 % e tyre janë vendosur në mungesë të drejtuesve të mjeteve.

Në DVP Shkodër në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 4,275 gjoba gjithsej, nga të cilat 2,461 gjoba ose rreth 58 % e tyre janë vendosur në mungesë.

Në DVP Vlorë në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 6,536 gjoba gjithsej, nga të cilat 4,929 gjoba ose rreth 75 % e tyre janë vendosur në mungesë.



Praktikisht, njoftimi i kundërvajtësve për gjrobat e vendosura në mungesë bëhej formalisht me shkresë nga organi konstatues duke ia dërguar organeve të Policisë së Shtetit ku ishin banorë kundërvajtësit me qëllim për të bërë njoftimin e tyre me punonjësit e policisë të zonave përkatëse, si dhe në sistemin elektronik e-gjopa kur ai funksiononte.

Në pjesën më të madhe të njoftimeve të bëra, rreth 90 %, nuk ishin kthyer përgjigje strukturës njoftuese. Ndërsa pjesa tjetër e përgjigjeve të kthyer rreth 10 % informonin strukturën njoftuese se nuk ishin gjetur kundërvajtësit, për shkak se ata kishin ndryshuar vendbanimin, ishin larguar jashtë vendit, etj. Sipas punonjësve të policisë, kjo mënyrë njoftimi konsiderohej e mirëqënë dhe e realizuar rregullisht. Vetëm në dy raste nga DVP Shkodër dhe në një rast nga DVP Vlorë u konstatua e provua që njoftimi të ishte kryer në mënyrë korrekte duke u konfirmuar marrja dijeni nga vetë kundërvajtësi<sup>68</sup>.

Moszbatimi i mënyrës ligjore të njoftimit të kundërvajtësve justifikohet me: mungesën e infrastrukturës së nevojshme, si të regjistrimit të adresave, ndryshimin e adresave të drejtuesve të mjeteve dhe mos raportimin e këtij ndryshimi në organet përkatëse; mos parashikimi në organikën e strukturave të policisë rrugore dhe ato të rendit të punonjësve që duhet të kryejnë këtë punë, e cila është e konsiderueshme sidomos në Tiranë; mungesa e fondeve në buxhetet e tyre për shpenzimet postare, etj.

Referuar pikës 5 të nenit 199 të Kodit Rrugor rezulton se *“subjekti (drejtuesi i mjetit që ka bërë shkeljen) njoftimi i të cilit nuk kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar (30 ditëve), nuk është më i detyruar të paguajë gjobën administrative”*. Por, praktikisht këto gjopa vileshtin në kundërshtim me ligjin, me mënyrat e përshkruara më sipër, sepse në sistem subjektet rezultonin debitorë.

Për rastet e gjobave të vendosura në mungesë të drejtuesve të mjeteve, nëse njoftimi i tyre nuk bëhej brenda afatit 30 ditë, nuk bëhej “fshirja” nga sistemi. Ato vazhdonin të qëndronin aktive dhe t’u vileshtin kundërvajtësve në kundërshtim me dispozitën ligjore.

Në rastet kur pagesa e gjobave nga drejtuesit e mjeteve bëhej me para në dorë (cash) në zyrat e Postës Shqiptare, raportimi i tyre bëhej menjëherë në sistemin e-gjopa dhe pas kësaj ato “fshiheshin” nga sistemi. Ndërsa kur pagesa e gjobave bëhej edhe nëpërmjet Bankave të Nivelit të Dytë, me para në dorë (cash) apo on-line (nëpërmjet telefonit celular ose kompjuterit), heqja e gjobës nga sistemi e-gjopa bëhej pas rakordimit të bankës me sektorin e financës së organit të policisë. Vonesa e raportimit të pagesave të gjobave në sistem krijon premisa që kundërvajtësit të mos përfitojnë nga e drejta ligjore e parashikuar në nenin 203 të Kodit Rrugor, për uljen e masës së gjobës deri në masën 50% dhe për mos pagimin e kamat vonesës, kur arkëtimet bëhen brenda 15 ditëve.

Në procesverbalin e konstatimit të shkeljes si në atë manual (lidhja nr. 1) dhe atë elektronik (lidhja nr. 2) nuk ishte pasqyruar e drejta e kundërvajtësit për të bërë ankim ndaj masës administrative të vendosur nga

---

<sup>68</sup> Kodi Rrugor ka përcaktuar jo vetëm detyrimin e organit të policisë për njoftimin e kundërvajtësit në të tilla raste, por në të njëjtën kohë ka parashikuar edhe mënyrën e njoftimit, si nëpërmjet organeve të treguara në nenin 12, ose nga korrierët, me mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, apo nëpërmjet postës, sipas normave për njoftimet nëpërmjet shërbimit postar. Gjithashtu, Kodi Rrugor ka parashikuar edhe subjektin ndaj të cilit do të ngarkohen shpenzimet e verifikimit dhe të njoftimit në këto raste, i cili është kundërvajtësi.

agjenti verifikues, organin ku mund të paraqitet ankimi, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij. Kjo mangësi vjen në kundërshtim me nenin 99 të Kodit të Procedurave Administrative<sup>69</sup>.

Pajisjet në përdorim të punonjësve të policisë për evidentimin dhe provueshmërinë e shkeljeve, ishin të pa mjaftueshme në raport me numrin e punonjësve të policisë.

Për sa më sipër dhe për zgjidhjen e këtij shqetësimi të drejtuesve/përdoruesve të mjeteve, iu drejtua<sup>70</sup> Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme për marrjen e masave të menjëhershme organizative e teknike mbi zbatimin e rekomandimeve përkatëse.

*Rekomandimi është pranuar nga DPPSH, por ndërkohë nuk kemi një qëndrim nga Ministria e Brendshme sa i përket ngritjes së sistemit të adresave të qytetarëve.*

Lidhur me problematikën për mosnjohimin e gjobave të vendosura në mungesë të drejtuesve të mjeteve, në institucionin tonë janë administruar edhe disa ankesa ndaj Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, si dhe ndaj Policisë Bashkiake Tiranë. Në një rast që i përkiste shtetasës I.H. i drejtua rekomandim<sup>71</sup> Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë dhe OASH pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për: Marrjen e masave për ndryshimin e praktikës së mosnjohimit të drejtuesve të mjeteve për masat administrative të vendosura në mungesë në mënyrën dhe formën e parashikuar në Kodin Rrugor; si dhe revokimin e katër gjobave të vendosura ankueses.

*Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.*

Ndërsa në dy raste që u përkasin shtetasve E.S. dhe M.H. i bëmë rekomandime Policisë Bashkiake Tiranë, për revokimin e gjobave administrative sepse nuk ishte respektuar detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 199/i të Kodit Rrugor për njohimin e tyre, por *rekomandimet tona nuk u pranuan.*

### 3.3.6. Të drejtat kushtetuese e ligjore të të punësuarve në organet e policisë

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti ka administruar dhe shqyrtuar edhe disa ankesa që lidhen me cenimin e të drejtave në marrëdhëniet e punës të të punësuarve, konkretisht të punonjësve të Policisë së Shtetit<sup>72</sup>. Në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit, punonjësit e Policisë së Shtetit nuk kanë qenë vetëm subjekte ndaj të cilëve janë bërë ankesa, por edhe subjekte që gëzojnë të drejtën ligjore t'i drejtohen atij kur iu shkelen të drejtat dhe interesat ligjore nga organet e administratës publike duke përfshirë edhe vetë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Avokati i Popullit çmon se, përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë, dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit të garantuara nga ligji organik, Kodi i Punës dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të kësaj strukture do të sjellë motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Shtetit.

<sup>69</sup> Respektivisht pika 2, gërma “c”/iii.

<sup>70</sup> Për më shumë informacion, drejtoheni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20per%20zbatimin%20e%20nenit%20199%20te%20K.%20Rrugor.pdf>

<sup>71</sup> Për më shumë informacion, drejtoheni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20Mois%20Hoxha.pdf>.

<sup>72</sup> Garantuar nga neni 49/2 i Kushtetutës dhe ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Një nga rastet e shqyrtuara për të cilin kemi mbajtur qëndrim është ankesa e shtetasit P.B. Ankuesi shkruante se ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit me gradën “Nënkomisar” dhe ka ushtruar detyrën funksionale “Specialist pranë Sallës së Komandimit” në Komisariatit e Policisë Kavajë. Në datën 04.05.2022, rreth orës 19:10, në ambientet e dhomave të sigurisë në këtë komisariat është konstatuar vetëvarja e shtetasit të arrestuar I.M. Pas ndodhjes së kësaj ngjarjeje ankuesi ishte arrestuar në flagrancë nga Drejtoria Rajonale e AMP Durrës-Kavajë, si i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ndërkohë pas arrestimit, ndaj tij kishte filluar edhe procedura disiplinore. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me vendimin nr. 203, datë 10.05.2022, ka bërë pezullimin disiplinor të tij nga detyra. Më pas, Departamenti për Sigurinë Publike ka vendosur përjashtimin e tij nga policia. Në vijim, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është nxjerrë urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022, për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit<sup>73</sup>.

Pas përfundimit të hetimeve penale, çështja i është dërguar për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë<sup>74</sup>. Pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, ankuesi i ka bërë kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për t’u rikthyer në punë, por kërkesa e tij nuk është pranuar.

Nga hetimi administrativ i kësaj ankese konstatoam se gjatë procesit disiplinor të zhvilluar ndaj ankuesit P.B. ishin shkelur disa të drejta ligjore të parashikuara në Rregulloren e Policisë së Shtetit sikurse mund të përmendim: nuk janë respektuar të drejtat e garantuara nga neni 221 i Rregullores, si ajo e informimit me shkrim në lidhje me shkeljen e dyshuar, e të shprehurit, e mbrojtjes, e konsultimit, e njoftimit për vendimin e marrë, e ankimit, etj; nga strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale nuk është zbatuar detyrimi i parashikuar se, për punonjësën me masë sigurie, në pamundësi të njoftimit të tij, njoftimi, verifikimi dhe shqyrtimi i shkeljes bëhet me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të caktuar nga Sindikata e Policisë; nuk është respektuar neni 225/1/a i Rregullores, ku parashikohet se, hetimi disiplinor për shkelje të rëndë disiplinore pezullohet nga Drejtori i Standardeve Profesionale, në rastin kur për të njëjtën çështje pritet një vendim-njoftim nga një organ tjetër i zbatimit të ligjit, etj.

Avokati i Popullit vlerësoi se procedura e ndjekur nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për përjashtimin nga ky organ të ankuesit P.B. bie ndesh edhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Për këto arsye u vlerësua se aktet administrative të nxjerra ndaj ankuesit P.B. janë akte të paligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 109 të K.Pr.A<sup>75</sup>. Gjithashtu u vlerësua se për shkak të këtyre akteve ankuesit i janë shkaktuar pasoja të rënda profesionale, financiare dhe morale, duke i cënuar të drejtën e mbrojtjes shoqërore në punë e sanksionuar në nenin 49 të Kushtetutës. Për gjetjet tona, me

---

<sup>73</sup> Bazuar në nenit 205 të Rregullores së Policisë së Shtetit “Sjellje e rëndë diskretituese” dhe nenit 209 “Shkelja e rëndë e atributiveve/kompetencave të policisë”.

<sup>74</sup> Gjykata me vendimin nr. 220, datë 28.12.2022, ndër të tjera ka vendosur: “... Pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit Petrit Berhamaj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal...”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2023.

<sup>75</sup> Paligjshmëria e aktit administrativ

*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:*

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; .....
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo .....

shkresën nr. K2/P4-4 prot., datë 08.09.2023, i drejtuar rekomandim<sup>76</sup> Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, *i cili në vijim na informoi se ai nuk është pranuar.*

Ndodhur në këto rrethana, i rekomanduam Ministrit të Brendshëm që në cilësinë e organit epror të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të bëjë të mundur pranimin dhe zbatimin e rekomandimit tonë dhe rikthimin e shtetasit P.B. në strukturat e Policisë së Shtetit.

*Ky rekomandim nuk u pranua.*

---

### 3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës<sup>77</sup>

---

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>78</sup> (MKPT) edhe gjatë vitit 2023 ka vijuar të përmbushë detyrat e tij funksionale të përcaktuara në legjislacionin kombëtar si dhe në standardet ndërkombëtare.

Më konkretisht, MKPT ka kryer 96 inspektime periodike, kontrole me tematikë të veçantë, pjesëmarrje në 2 operacione, në rolin e monitoruesit, për rikthimin e detyruar të shtetasve shqiptarë të cilët qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE-së, vizita inspektuese në të gjitha institucionet e tjera të privimit të lirisë, si dhe trajtimi i ankesave dhe konkludimi me disa rekomandime. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me 92 rekomandime dhe 284 nënrekomandime.

Qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve ka qenë vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve dhe personave që u privohet liria, të drejta të cilat garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përveç kësaj, nga ana e MKPT-së është mbajtur në konsideratë edhe veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Administratën e Burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Për vitin 2023, MKPT-ja ka trajtuar 32 ankesa dhe 14 raste me iniciativë, nga të cilat 23 ankesa lidhen me sistemin e burgjeve (mungesë mjekimi dhe medikamentesh, mungesë kushtesh jetese, mbipopullimi në burgje etj.) dhe 9 ankesa lidhen me policinë (mosdhënia e ndihmës mjekësore, shoqërim i padrejtë, etj.). Mbas trajtimit të ankesave dhe rasteve me iniciativë, në 5 raste, Avokati i Popullit ka dalë me rekomandimet përkatëse drejtuar institucioneve.

#### 3.4.1. Gjetjet e konstatuara nga inspektimet në institucionet penitenciare

Gjetjet e konstatuara nga inspektimet në institucionet penitenciare pasqyrohen si në vijim:

---

<sup>76</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20nr.%201%20per%20Petrit%20Berhamaj.pdf>

<sup>77</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i MKPT-së në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>78</sup> Neni 81 i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe neni 30 dhe 30/1 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

## **1. Kushte infrastrukturore të papërshtatshme në ambientet e vuajtjes së dënimit**

Janë konstatuar kushte infrastrukturore të papërshtatshme janë evidentuar në mjaft prej ambienteve të vuajtjes së dënimit. Megjithëse ka disa përmirësime dhe investime, kushtet infrastrukturore të godinave kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe ndoshta vlerësim të ndryshëm të buxhetimit të zërave për përmirësime infrastrukturore. Mangësi janë evidentuar në çdo institucion, ndërkohë që në disa prej tyre, situata mund të trajtohet si trajtim degradues. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, Drejtorinë së Përgjithshme të Burgjeve për vitin 2023, mbylljen e I EVP “Ali Demi” dhe sistemimin e të paraburgosurave dhe të dënuarave në një institucion alternativ të vuajtjes së dënimit.

Avokati i Popullit vlerëson se qëndrimi i tyre në këtë institucion në kushte infrastrukturore krejtësisht të papërshtatshme për jetesën e tyre përbën trajtim jo dinjitoz e denigruar dhe për këtë arsye kërkon mbylljen sa më parë të kësaj I EVP-je dhe dërgimin e të dënuarave në një institucion alternativ. Avokati i Popullit, duke e njohur edhe gjendjen e infrastrukturës së sistemit penitenciar, sugjeron se struktura më e përshtatshme që në një kohë të shpejtë mund të plotësojë nevojat për akomodim të paraburgosurave dhe të dënuarave gra në vend është I EVP-ja e ndërtuar rishtas në qytetin e Pogradecit. Kjo I EVP ka kushtet më të mira infrastrukturore dhe është e përshtatshme për të siguruar trajtim dinjitoz të tyre në periudhë afatshkurtër.

Trajtimi i grave që vuajnë masat ndaluese në këtë sistem mbetet jodinjitoz dhe nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga Konventa Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>79</sup>. Për këtë arsye, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet ta vlerësojnë me kujdes e seriozitet maksimal rekomandimin e Avokatit të Popullit për të adresuar me prioritet kushtet në të cilat ndodhet kjo kategori vulnerabël. Nga bisedat e zhvilluara me to gjatë vizitave inspektuese ishte e qartë se bëhet fjalë, në masën më të madhe, për persona që kanë histori shumë trishtuese dhe i përkasin më së shumti, asaj kategorie që është më vulnerabël brenda komunitetit të grave në shoqërinë tonë.

## **2. Infrastruktura e amortizuar**

Infrastruktura e ndërtimit të godinave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta, vazhdojnë të paraqesin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje të energjisë elektrike dhe ujit, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. Institucionet me problematika emergjente infrastrukturore vazhdojnë të paraqiten I EVP 325 “Ali Demi” I EVP Durrës, I EVP 302 Tiranë, I EVP Rrogozhinë, I EVP Tepelenë, I EVP Burrel.

## **3. Mbipopullim në sektorët e paraburgimeve**

Konstatohet se mbipopullimi ka pësuar rritje përgjatë vitit 2023 në sektorët e paraburgimeve në disa nga I EVP si në, I EVP Jordan Misja, I EVP Drenovë, I EVP Peqin, I EVP Fier, I EVP Tepelenë. Gjatë vizitave, grupet e inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona të akomoduar në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m<sup>2</sup> për çdo të burgosur<sup>80</sup>.

## **4. Mosfunksionim i sistemeve të ngrohjes/ftohjes**

---

<sup>79</sup> Neni 3 i KEDNJ.

<sup>80</sup> Bashkëlidhur në Aneksin 1, Tabela pasqyruese në lidhje me popullimin në I EVP-të.

Sistemet qendrore të ngrohjes/ftohjes, pothuajse në të gjitha IEVP-të ku ishin të instaluar, nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.

#### **5. Mungesë e cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit**

Konstatohet se cilësia dhe mungesa e larmisë së ushqimit vijon të mbetet problem shqetësues thuajse në të gjitha IEVP-të.

#### **6. Mungesë në furnizimin me produktet bazë të higjienës**

Mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesa në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.

#### **7. Mungesë në mobilimin bazik**

Është konstatuar se veshjet personale mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.

#### **8. Mungesë të aktiviteteve social-kulturore dhe kurseve profesionale**

Gjatë inspektimeve janë konstatuar mangësi të theksuara në ofrimin e mundësisë për aktivitete social-kulturore për të burgosurit si dhe mungesa e kurseve profesionale të cilat luajnë një rol thelbësor në riintegrimin e tyre.

#### **9. Mungesë e stafeve shëndetësore, të ambienteve shëndetësore dhe kushteve infrastrukturore të përshtatshme**

- *Mungesa e një institucioni të Posaçëm Mjekësor* sipas parashikimeve të ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar, mbetet mangësia më e madhe e sistemit të institucioneve të mbyllura në vendin tonë. Kjo çështje ka qenë dhe mbetet lajtmotivi i mungesave strukturore të sistemit tonë shëndetësor/penitenciar. Aktualisht personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar” apo personat e deklaruar të papërgjegjshëm për kryerjen e një vepre penale mbahen në sistemin penitenciar, ndërkohë që nuk duhet të mbeten brenda këtij sistemi. Megjithë përmirësimin e kushteve infrastrukturore në vitin 2021 të vendit ku mbahen këta të burgosur, për shkak të mungesës së stafit mjekësor dhe mbipopullimit ekstrem gjendja në këtë institucion është pranë trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Nuk është zbatuar marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligj për këtë qëllim.
- *Mungesa e mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale* vijon të mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tonë penitenciar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2023, në IEVP-të e inspektuara në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Mungesa e mjekëve në një pjesë të madhe të IEVP-ve mbulohet nga mjekët me kohë të pjesshme, prej 4-orësh punë në ditë.

- Në disa institucione penitenciare *nuk janë krijuar Sektorët e Kujdesit të Veçantë (SKV)* në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, në disa Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)<sup>81</sup>.
- *Mungesa e një sistemi të qendrueshëm për të zhvilluar konsulta me mjekë psikiatër* në sistemin penitenciar është një problematikë e konstatuar në vazhdimësi.
- Gjatë vitit 2023 ka pasur një numër të *lartë të vdekjeve në burgje* krahasuar me vitet e kaluara. Institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur me iniciativë hetime administrative për shtetasit që kanë ndërruar jetë në institucionet e privimit të lirisë, për shkak të vetvarjes apo problemeve shëndetësore për të identifikuar nëse humbja e jetës ka ardhur si pasojë e mos dhënies së ndihmës shëndetësore në kohë. Nga trajtimi i 10 rasteve, në 2 prej tyre Avokati i Popullit ka dalë me rekomandim drejtuar institucioneve përgjegjëse ku kërkohet një vëmendje e shtuar mbi trajtimin mjekësor si dhe ndaj personave të cilët kanë indicie suicidale.
- Ka nevojë për përmirësimin e infrastrukturës *për kryerjen e vizitave mjekësore*, pasi përgjithësisht janë të pa pajisura me mjetet e nevojshme dhe materiale ndihmëse.
- Me rëndësi është *përmirësimi në lidhje me vështirësitë e hasura në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike* specifike, në disa prej IEVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, si dhe rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- *Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP-të* që vijnë si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Vëmendje duhet t'i kushtohet përmirësimit të shërbimeve dentare, pasi që përveç ekstraksioneve, shërbimet mjekësore kryhen me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.

Avokati i Popullit vlerëson punën e vijueshme të bërë në sistemin penitenciar për ta reformuar dhe shndërruar atë në një sistem modern e që të garantojë mirëqenien e personave të paraburgosur ose të dënuar, por nga ana tjetër vlerëson se problematikat e vërejtura sa më sipër nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve dhe mungesës së dënimeve alternative.

#### 3.4.2. *Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, edhe gjatë vitit 2023, ka inspektuar ambientet e Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprorë të Policisë së Shtetit.

Inspektimet e kryera në njësitë policore kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të

<sup>81</sup> Si në IEVP Burrel, IEVP Vlorë, IEVP Berat, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë, IEVP Kukës.

standardeve të përcaktuara në legjislacionin<sup>82</sup> përkatës, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme. Këto inspektime kanë qenë si të programuara ashtu edhe mbi bazë evidentimi problematike. Në total janë bërë 47 inspektime periodike që mbulojnë 93 % të të gjitha stacioneve policore në rang vendi.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

### **1. Mungesa e ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës (MKPT), nisur nga kryerja e inspektimeve periodike në ambientet e privimit të lirisë së personit (dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie), si dhe nga trajtimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, ka konstatuar në një numër të madh rastesh se, nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve<sup>83</sup>, raste për të cilat janë dërguar rekomandimet përkatëse organeve të policisë në nivel vendor dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Në raportet e dërguara në përfundim të inspektimeve dhe nga objekti i ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara ndaj këtyre strukturave, evidentohen raste për shoqërimet të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kushte të pa përshtatshme të ambienteve të shoqërimit, etj.

### **2. Mungesa e zbatimit me korrektësi, nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të rasteve dhe kriterëve ligjore të ndalimit/arrestimit të shtetasve të cilët marrin “Metadon” dhe janë përdorues të lëndëve narkotike ose shfaqin probleme shëndetësore dhe trajtimin e tyre me dinjitet në përputhje me aktet normative në fuqi**

Avokati i Popullit në vazhdimësi është njohur nga trajtimi i ankesave dhe rasteve me iniciativë se nga punonjësit e policisë në shumë raste nuk merren masat e duhura për të adresuar personat të cilët shfaqin probleme shëndetësore, për t’ju dhënë ndihmën e duhur mjekësore në spitalin më të afërt në rastet e veprimeve të çrregullta dhe të pavetëdijshme.

### **3. Shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale.**

Në Komisariatet e Policisë provat materiale të fiksuara gjatë procedimeve penale<sup>84</sup> mbahen në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të pa paketuara/ambalazuara, në shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale. Referuar parashikimeve ligjore, konstatohet

---

<sup>82</sup> Ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, “Për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, “Për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>83</sup> Të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore

<sup>84</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë: Korrik 2017, Seksioni VII, “Provat Materiale”, neni 187 “Kuptimi i provës materiale” (Ndryshuar me ligjin 9085, datë 19.6.2003). “Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes”.



lehtësisht detyra që ka vendosur legjislatori për krijimin e dhomave të depozitimit të provave materiale si një masë parandaluese për të shmangur aktet e mundshme të dhunës psikologjike/fizike që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave. Nga verifikimet e kryera nga Avokati i Popullit, është konstatuar se nuk është përmbushur ky detyrim ligjor duke evituar në shkelje të ligjit aplikimin e një mase parandaluese që do të shmangte pasojat e ndodhura të reflektuara edhe në ankesat e vazhdueshme<sup>85</sup>.

#### **4. Shkelje të procedurave ligjore të shoqërimit, arrestimit apo ndalimit të shtetasve nga punonjësit e policisë**

Pavarësisht se ka një qasje më korrekte dhe në respektim të të drejtave të njeriut, nga punonjësit e Policisë së Shtetit, kemi patur disa ankesa si dhe raste të marra me iniciativë nëpërmjet medias ku ka pasur pretendime. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe pune dhe janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës<sup>86</sup>.

#### **5. Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)**

Nga inspektimet rezulton se dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijojnë ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.

#### **6. Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor në kohë dhe ambiente të papërshtatshme për ofrimin e konsultave**

Nga inspektimet janë konstatuar probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor në kohë nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambiente të papërshtatshme për ofrimin e konsultave. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore vazhdonin të kryeshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në procedurat standarde të Policisë së Shtetit, ndërkohë që në disa drejtori mjeku mungon.

#### **7. Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi**

Ja në konstatuar probleme lidhur me instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate. Megjithatë, vlen për t'u përmendur se sjellja e punonjësve të policisë së shtetit ndaj qytetarëve është përmirësuar ndjeshëm.

#### **8. Probleme me plotësimin e dokumentacionit**

Në vazhdimësi Avokati i Popullit i ka dhënë një rëndësi të veçantë faktit se dokumentimi i shoqërimit (procesverbalet e shoqërimit, regjistrat e shoqërimit etj.) dhe arrestimit të shtetasve është një detyrim

<sup>85</sup> <https://www.coe.int/sq/web/cpt/albania>, fq. 3.

<sup>86</sup> Për më shumë referojuni linkut: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/jails/rekomandime-drejtuar-sistemit-t-burgjeve-dhe-paraburgimit-2023-939/>

ligjor<sup>87</sup>. Moszbatimi i kësaj kërkese nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, sikurse është konstatuar nga grupet e inspektimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

### *3.4.3. Disa nga rekomandimet kryesore të dërguara nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vitin 2023*

#### ***Rekomandimi në lidhje me I.E.V.P. Shënkoll-Lezhë***

Në datën 07.09.2023, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll Lezhë, një i burgosur i ka dhënë fund jetës duke u vetëvarur në ambientet e burgut. Sipas raportimeve viktimë ishte i burgosuri Q.H., 38 vjeç, i cili kishte kryer veprën penale “dhunë në familje” dhe ndaj tij ishte caktuar masë mjekësore “mjekim i detyruar” në institucionin mjekësor të IEVP Shënkoll, Lezhë. Gjithashtu, në media u raportua se viktimë vuante nga çrregullimi psikotik dhe merrte mjekim të detyruar<sup>88</sup>. Institucioni i Avokatit të Popullit nisi një hetim administrativ për këtë rast dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në lidhje me ngjarjen e rëndë, u konstatua se nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i burgosuri me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar” vuante nga probleme të çrregullimit psikiatrik. Lidhur me këtë problematikë u konstatua se ekipet multidisiplinare kanë dështuar në misionin e tyre për të garantuar dhe vëzhguar veprimet e këtyre pacienteve me masë mjekësore “Mjekim të detyruar” nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në këqyrjen e vendit të ngjarjes rezultoi se instalimi i dusheve në atë mënyrë ka përbërë mundësinë të realizimit të qëllimit për vetëvarjen e të burgosurit Q.H., me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Stafit i IEVP-së duhet të vlerësonin që kushtet në këtë institucione duhet të jenë të tilla që mos përmbajnë indicie për vetëdëmtim apo vetëvarje nga këta pacientë.

Mungesa në organikën e stafit mjekësor nuk garanton një shërbim shëndetësor cilësor për të burgosurit, në mënyrë që të garantojnë ruajtjen e shëndetit të personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve. Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e mjekut kardiolog, mjekut laborant dhe mjekut me kohë të pjesshëm ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit në IEVP Shënkoll Lezhë<sup>89</sup>.

Konstatohet se nuk është garantuar akomodimi i të dënuarve dhe të burgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, çka do të përbënte kusht minimal për trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitimin shëndetësor të tyre.

---

<sup>87</sup> Në pikën VIII të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, përcaktohet se: “Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht evidentohet dhe dokumentohet në sistemin elektronik, në regjistra, në formularë dhe procesverbale”.

<sup>88</sup><https://top-channel.tv/2023/09/07/vetëvaret-i-burgosuri-në-shenkoll-të-lezhës/>.

<sup>89</sup> Struktura e re organike është miratuar për 189 persona, ndërkohë në ditën e ngjarjes ishin 428 pacientë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, duke mos ju përgjigju numrit kaq të lartë të këtyre personave.

Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme plotësimin e stafit shëndetësor, psiko-social sipas ligjit dhe akteve ligjore në fuqi, si dhe ofrimin e shërbimit psiko-social nga ana punonjësve të edukimit, duke ofruar asistencën e tyre çdo ditë me frekuencë 4 orë, nëpërmjet bisedave dhe aktiviteteve me këto pacientë me masë mjekësore “mjekim të detyruar”. Kjo do të krijonte një klimë të sigurt që ushqen besim reciprok, u krijon të dy palëve në komunikim të ndiejnë përgjegjësi, u ofron më shumë liri zgjedhjeje dhe si rezultat u mëson të kenë më shumë aftësi sociale.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin dhe heqjen e të gjithë elementëve që krijojnë premisa për vetëdëmtime për këta pacientë, si konkretisht zëvendësimin e dupeve dhe elementëve të tjerë për të parandaluar raste të tilla;
- analizimin me hollësi të rastit nga strukturat kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për punonjësit e Policisë së Burgjeve, të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor në IEVP Lezhë, në objekt të këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të ofrimit cilësor të shërbimit ndaj të burgosurve me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”, për të kuptuar emocionet e tyre në sjelljet e përditshme dhe për të lënë detyra për personelin e sektorit policor që të vëzhgojnë të burgosurit gjatë veprimeve të tyre në ambientet që nuk monitorohen nga kamerat në këtë institucion;
- marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e stafit të sektorit shëndetësor për pacientët me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”, si dhe për një kujdes të veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku qëndrojnë këta pacientë, higjienës vetjake të tyre dhe mjedisit që i rrethon pasi këta persona kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, sidomos nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012, “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar;
- marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve higjiëno-sanitare, për të garantuar akomodimin këtyre personave në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe rekomandimeve të CPT për këtë qëllim.

Me shkresën nr.15357 prot, 28.12.2023 I.E.V.P Lezhë ka bërë me dije se referuar ngjarjes në institucion është bërë analizë e thelluar për të nxjerrë përgjegjësitë e secilit punonjës apo stafit civil që kanë shkelur rregullat e shërbimit në momentin e ngjarjes, ku rezulton se janë thirrur për komision disiplinor.

### ***Rekomandimi në lidhje me I.E.V.P. Jordan Misja Tiranë***

Në datë 01.04.2023, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”, Tiranë, i paraburgosuri R.T., dyshohet se ka ndërruar jetë në spital, si pasojë e një arresti kardiak. Mësohet se viktima ishte 37 vjeç dhe ishte i paraburgosur nën akuzën e veprave penale “Vjedhje” dhe “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” arrestuar me datë 27.03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe ardhur në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë më datë 31.03.2023<sup>90</sup>.

Nga hetimi administrativ i kryer në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, dhe nga administrimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se nga përmbajtja e librit të pritjes së të paraburgosurit në IEVP

<sup>90</sup> <https://dosja.al/aktualitet/i-riu-vdiq-ne-qeli-reagon-pas-6-ditesh-drejtoria-e-burgjeve-konsumont-i291227>

“Jordan Misja”, Tiranë, shtetasi R.T. ndodhej në gjendje shëndetësore të rëndë dhe me dobësi trupore. Nga ana e Komisionit të Pritjes është bërë pranimi i të paraburgosurit pa marrë parasysh rrethanat shëndetësore në të cilat ndodhej<sup>91</sup>. Gjithashtu, stafi shëndetësor duhej të sugjeronte menjëherë shtrimin e tij në Qendrën Spitalore të Burgjeve që të ofrohej shërbim shëndetësor për diagnostikim, ekzaminim, dhe/ose trajtim të përqendruar në spital, që nuk mund të ofrohej prej kujdesit shëndetësor parësor në IEVP, në përputhje me sistemin e referimit.

Nga ana e Komisionit të Pritjes dhe mjekut të vizitës apo përgjegjësit të turnit nuk është parë e nevojshme koordinimi dhe kujdesi i shtuar ndaj personit të paraburgosur që ka referuar probleme të rënda shëndetësore për trajtimin e tij në spital<sup>92</sup>. Shqetësimi i të paraburgosurit R.T. ishte i drejtë dhe si i tillë duhet të vlerësohej nga ana e stafit të IEVP-së, me qëllim që të merreshin masat për kryerjen e ekzaminimit mjekësor të tij sa më parë. Rasti i këtij të paraburgosuri duhet të shikohet dhe vlerësohet në tërësinë e rrethanave të paraqitura që lidhen me gjendjen jo të mirë shëndetësore, kufizimin e lirisë, kushteve jashtë standardeve të ambienteve ku qëndrojnë të burgosurit në këtë institucion të cilat janë të njohura, dhe më tej me detyrimin ligjor të organeve shtetërore për kujdesin shëndetësor të të dënuarve. Nga vlerësimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar të Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) dhe Spitalit Universitar të Traumës (SUT), rezulton se i paraburgosuri R. T. nuk është dërguar për në spital për dhënien e ndihmës mjekësore ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund t’i shpëtohej jeta.

Nga mbikëqyrja rezulton se i paraburgosuri R.T. ka qëndruar në një dhomë me kushte jo humane dhe degraduese, ku evidentohet lagështira tej normave të lejuara, çka nuk ka ndikuar për të siguruar jetën dhe shëndetin e të paraburgosurit. Kjo tregon se stafi i IEVP-së nuk është treguar i kujdesshëm për ta dërguar në një dhomë me kushte të pranueshme banimi, duke qenë se gjendja shëndetësore e tij ka qenë e rënduar. Gjithashtu është evidentuar mbipopullimi i vazhdueshëm në disa sektorë.

Sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- marrjen e masave për zbatimin me korrektësi e në zbatim të ligjit të procedurave lidhur me konstatimin e gjendjes shëndetësore të të paraburgosurve dhe ofrimin pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor, si dhe dërgimin e tyre në spital ku mund të marrin trajtim më të specializuar në regjimin spitalor dhe mund të shpëtohet një jetë;
- analizimin e rastit me hollësi nga strukturat kompetente të policisë, objekt i këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të Komisionit të Pritjes për pranimin e të burgosurve në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, dhe trajtimin e tyre sipas ligjit;
- përgjithësimin e rastit në strukturat e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të burgosur në trajtimin e tyre shëndetësor në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, duke vlerësuar si primar jetën dhe shëndetin e të burgosurve;

---

<sup>91</sup> Në nenin 15, pika 1 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, thuhet se: “Menjëherë pas pranimit në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ezaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut dhe psikologut, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion apo vetëvrasjeve.

<sup>92</sup> Lgji nr.81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 41, pika 14, përcakton s në “raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në Qendrën Spitalore të Burgjeve ose në institucionet e Kujdesit Shëndetësor Rajonal”.

- marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe eliminimin e lagështirës, për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe rekomandimeve të CPT për këtë qëllim;
- marrjen e masave të menjëhershme për zhvillimin e trajnimeve të nevojshme për stafet mjekësore dhe Komisionin e Pritjes dhe Pranimit për të verifikuar gjendjen e të burgosurit, si dhe diagnostikimin e tyre në kohë dhe me efektivitet;
- marrjen e masave për analizimin e shkaqeve për mos dhënie të deklaramit të saktë nga stafi i I EVP “Jordan Misja” Tiranë, për të garantuar ofrimin e shërbimit shëndetësor ndaj të paraburgosurit R.T. në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj personave përgjegjës.

Ky rekomandim është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e cila nëpërmjet shkresës nr.5262 prot, datë 28.12.2023 ka bërë me dije se nga sektori i policisë janë marrë masa që gjatë zhvillimit të Komisionit të Pritjes të ndiqen procedurat standarde që normojnë punën e Komisionit të Pritjes së shtetasve arrest me burg në cilësinë e të paraburgosurit.

#### ***Rekomandim në lidhje me mungesën e dhomave të intervistimit në komisaritet e vendit***

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka inspektuar Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë si dhe komisaritet në varësi të saj.<sup>93</sup> Inspektimet u kryen, duke u bazuar në faktin se Avokati i Popullit në vazhdimësi ka trajtuar ankesa të qytetarëve për keqtrajttime psikologjike, në disa raste edhe fizike, gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë.<sup>94</sup>

Një nga problematikat e evidentuara, e cila është trajtuar edhe më herët nga Avokati i Popullit, është mungesa e dhomave të intervistimit/marrjes në pyetje të personit në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit apo të ndaluarit, brenda mjediseve të Policisë së Shtetit. Në komisaritet e policisë në Tiranë, ka mungesë të dhomave më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar. Mungon instalimi i pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit. Gjithashtu, është konstatuar se në shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale të fiksuara gjatë procedimeve penale, në Komisaritate ato mbahen në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, të pa paketuara/ambalazhuara<sup>95</sup>. Këto ambiente, siç e shpjeguem, janë dhe ambiente ku merren në pyetje personat e sipërcituar.

<sup>93</sup> Inspektime të kryera në datat 20, 21 dhe 22 Nëntor 2023.

<sup>94</sup> Përfshirë dhe gjetjet e identifikuar në kuadër të vizitës së Delegacionit të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT) të KIE-së, të zhvilluar në datat 04-15 Maj 2023, ku ka një konstatim të vazhdueshëm se nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare.

<sup>95</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë: Korrik 2017, *Seksioni VII, “Provat Materiale”, neni 187 “Kuptimi i provës materiale” (Ndryshuar me ligjin 9085, datë 19.6.2003), “Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes”.*

Sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde;
- marrjen e masave për ushtrimin e kontrolleve në ambientet e zyrave të punës së specialistëve të krimeve dhe ndihmës specialistëve për policimin në komunitet në mënyrë që të shmanget mbajtja në të e sendeve që ekspozojnë mundësi për ushtrim dhune;
- heqjen e mos mbajtjen e sendeve e mjeteve që nuk janë pjesë e orendive/pajisjeve në inventar të tyre si “armë zjarri apo gjahu, shkopinj, leva e shufra hekuri, shkop bejsbolli, zinxhirë, doreza metalike” etj, në zyrat e ndihmës/specialistëve të policimit në komunitet;
- marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme, për krijimin (ndërtimin) sa më parë brenda sistemit të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të DVP. Tiranë dhe Komisariateve të policisë në varësi të saj, të dhomave më vehte për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit;
- marrjen e menjëhershme të masave që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si dhe dhoma për depozitimin e provave të përkohshme materiale të administruara gjatë procedimeve penale;
- marrjen e masave në vazhdimësi për sensibilizimin e punonjësve të policisë në lidhje me efektet dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike mbi personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar, papajtueshmërinë në çdo rast të ushtrimit të dhunës mbi këta persona, si dhe të organizohen trajnime me punonjësit e policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

Në përgjigje të rekomandimit, DVP Tiranë dhe komisaritet në varësi të saj bëjnë me dije pranimin e tij dhe se në vazhdimësi janë marrë masa për sensibilizimin e punonjësve të policisë në lidhje me efektet dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike mbi personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar. Në vijim do të kryhen trajnime specifike me punonjësit e policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave që shoqërohen nga organet e policisë.

#### ***Rekomandim në lidhje me rastin vdekjes së shtetasit J.R.***

Në datën 02.05.2023 është regjistruar rasti i bërë publik në media, “*I riu në koma pas arrestimit*”. Sipas lajmit, J.R., 27 vjeç, ra në gjendje kome në QSUT pasi u arrestua nga policia në Tiranë më datë 12 Prill 2023. Arrestimin e tij e kishin kryer shërbimet policore të Komisarariatit Nr.2 Tiranë. I riu ishte arrestuar për vjedhjen e një tapeti dhe një palë atleteve, por 5 ditë më vonë më 17 Prill, J.R., dërgohet në Urgjencën e QSUT-së në gjendje të rëndë. Më datë 20.05.2023, shtetasi J.R., ka ndërruar jetë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë. E ëma e të riut, ka denoncuar ngjarjen e ndodhur në emisionin Uniko në Klan Plus, duke pretenduar se policia nuk i ka dhënë informacion në lidhje me problemet shëndetësore të djalit për 5 ditë e se ajo nuk kishte dijeni. Çështja pati një mbulim të madh mediatik.

Avokati i Popullit zhvilloi një hetim të thelluar për këtë rast. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit problematikat e konstatuara për rastin konkret janë lidhen me mosdhënien e ndihmës mjekësore të duhur nga komisarati nr.2 Tiranë, gjatë kohës së qëndrimit në këtë komisarati të shtetasit J.R. Nga punonjësit e shërbimit është konstatuar axhitimi i këtij personi dhe janë konstatuar sjellje jo normale të tij<sup>96</sup>, por ndihma mjekësore nuk është dhënë në mënyrë të menjëhershme. Është konstatuar sjellje jo proaktive në kufijtë e neglizhencës nga mjeku i bllokut të sigurisë për trajtimin dhe konsultimin e rastit me mjek specialistë, për të përcaktuar llojin dhe dozën e mjekimit (Metadonit), që duhet të përdorte personi i arrestuar/ndaluar, si dhe për të përcaktuar kohën kur ka marrë metadon.

Nëpërmjet ekzaminimeve të cilat janë kryer nuk është përcaktuar koha e fundit kur ky person ka marrë dozën e fundit para arrestimit. Vetëm në përfundim të këtyre ekzaminimeve, mjeku kontakton me shoqatën “Aksion-Plus” dhe me rekomandimin e mjekut toksikolog kërkon dozën e rekomanduar për trajtimin e personit.

Në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga Avokati i Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit janë trajtuar këto shqetësime dhe është rekomanduar përmirësimi i punës por, me keqardhje konstatohet se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme. Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre nga punonjësit e Policisë së Shtetit, gjatë kohës së privimit të lirisë të personit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë;
- marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për evidentimin e rastit dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete administrative për shkeljet e konstatuara;
- marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë efektive të strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me njohjen e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi, rastet dhe kriteret e arrestim/ndalimit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të arrestuar/ndaluar, e në veçanti trajtimin e këtyre shtetasve në rastin kur ata janë përdorues të lëndëve narkotike;
- përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë.

Në përgjigje DPPSH bën me dije se ky rekomandim është pranuar dhe janë nxjerrë përgjegjësitë si dhe është dërguar për njohje dhe shqyrtim gjithë strukturave vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.<sup>97</sup>

### ***Rekomandim në lidhje me rastin e ngritur nga Gjyqtari i Hetimeve Paraprake pranë gjykatës Sarandë për shtetasin S.I.***

Institucioni i Avokatit të Popullit, me vënien në dijeni të vendimit të Gjyqtarit të Hetimeve Paraprake (GJHP) pranë gjykatës Sarandë, ka kryer regjistrimin e rastit dhe ka filluar menjëherë procedurën e hetimit administrativ, për verifikimin e faktit të ngritur nga shtetasi S.I. “Për ushtrim dhune nga

<sup>96</sup> Raporti-shërbimi i mbajtur në datë.12.04.2023 nga punonjësi i policisë të komisarariatit Nr.2 Tiranë.

<sup>97</sup> Shkresa nr. 11174/1 prot., datë.08.02.2024.

punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë”, gjatë qëndrimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, të deklaruar në seancën gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurimit personal.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë i ka dërguar Avokatit të Popullit<sup>98</sup> një informacion “Raportim i deklarimit të personit të ndaluar S.I., për ushtrim dhune në Komisariatin e Policisë Sarandë”, sipas procesverbalit të të cilit, Gjyqtari i Hetimeve Paraprake (GJHP) në çelje të seancës gjyqësore në datë 16.11.2023, për vleftësimin e masës së sigurimit personal të personit të ndaluar S.I. për veprën penale “Vjedhje” e kryer në bashkëpunim, pasi ka verifikuar prezencën e palëve në seancë gjyqësore, ka pyetur të ndaluarin në lidhje me respektimin e të drejtave ligjore gjatë kohës së ndalimit në mjediset e policisë. Në përgjigje, shtetasi i lartpërmendur ka deklaruar se “jam dhunuar në komisarariat dhe kam shenja në fytyrë”. Në lidhje me këtë fakt, Gjyqtari i Hetimeve Paraprake ka vendosur që *“do t’i drejtohem Avokatit të Popullit për të verifikuar rastin”*.

Përsa më sipër, grupi i ekspertëve që zhvilloi procedurat e hetimit administrativ të rastit, ka konstatuar disa shkelje në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit, që kanë të bëjnë me neglizhencën në ushtrimin e detyrës funksionale të punonjësve të policisë.

Konkretisht, nga këqyrja e regjistrit me të dhënat për personat e shoqëruar, të arrestuar/ndaluar që ndodhej në zyrën e informacionit dhe në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, në rubrikën “Përshkrimi i pamjes së jashtme”, ishte shënuar “Normal”, pa evidentuar në regjistër përshkrimin e pamjes së jashtme dhe shenjat e veçanta të shtetasit S.I., ndërkohë që në momentin e hyrjes në mjediset e Komisarariatit të Policisë Sarandë, shtetasi ka qenë me plagë në fytyrë. Në regjistrin për të shoqëruarit dhe të arrestuarit/ndaluarit gjendet një rubrikë “Përshkrimi i pamjes së jashtme”, në të cilën punonjësit e policisë duhet të përshkruajnë detyrimisht pamjen e jashtme dhe shenja të veçanta që mund të kenë këta persona si: “me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, tatuazhe, nishane etj.”.

Por, nga hetimi rezultoi se, punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Sarandë që kanë kryer arrestimin në flagrancë, shoqërimin dhe më tej ndalimin në dhomat e sigurisë, kanë neglizhuar përshkrimin e pamjes së jashtme të shtetasit S.I. dhe shenjat e veçanta të tij, duke i dhënë mundësinë personit të arrestuar dhe avokatit mbrojtës, për t’a përdorur faktin, si masë mbrojtje në seancën gjyqësore. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, rubrikat që përbëjnë regjistrat dhe formularët “Tip”, ku evidentohen të dhënat për personat e shoqëruar, të arrestuar/ndaluar janë qartësisht të kuptueshme dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, me qëllim që çdo shtetas kur hyn në mjediset e policisë të jetë i evidentuar në tërësinë e të dhënave personale, duke përfshirë dhe pamjen e jashtme apo dhe shenjat e veçanta të tij.

Para sistemimit/akomodimit në dhomat e sigurisë, ka disa punonjës policie të nivelit zbatues i shërbimeve të rendit publik<sup>99</sup>, që kryejnë intervistimin, verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarit/ndaluarit nëse ka shenja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtimit, sëmundje të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë mjekësore apo ankesa të tjera të kësaj natyre. Në përfundim të këtij procesi, grupi i ngritur për intervistimin dhe këqyrjen e pamjes së jashtme të arrestuarit/ndaluarit, gjithçka të konstatuar e pasqyrojnë në një procesverbal verifikimi/konstatimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë punonjësit e policisë që janë përfshirë në të dhe vendoset në dosjen e të ndaluarit/arrestuarit.

<sup>98</sup> Me nr. 61005-01017-23-23/246 Regj.Them., datë 16.11.2023.

<sup>99</sup> Ku bëjnë pjesë specialisti i shërbimit, ndihmës specialisti për informacionin dhe mjeku i policisë.



Nga këqyrja e dosjes, u konstatua se nuk ishte shënuar asnjë shenjë e veçantë në përshkrimin e pamjes së jashtme të shtetasit S.I. Sipas procedurave standarde, çdo personi të arrestuar/ndaluar që mbahet në dhomat e sigurisë i çelet fashikulli me emrin e tij në regjistër. Nga verifikimi i “Kartelës mjekësore” në fashikullin e të arrestuarit S.I., ishte shënuar se ishte përdorues i lëndëve narkotike, por mjeku nuk kishte të shënuar asnjë shenjë të veçantë të identifikuar në paraqitjen e jashtme të tij. Vizitat mjekësore ndaj të arrestuarit/ndaluarit kryhen nga mjeku apo ndihmës mjeku i komisariatit të policisë, dhe në mungesë të tyre nga mjekë të qendrave spitalore rajonale të miratuar nga shefi komisariatit të policisë<sup>100</sup>. Në çdo rast kur gjatë vizitës/kontrollit konstatohen dëmtime fizike, plagë apo gjakrrjedhje, etj mjeku/ndihmës mjeku i njësisë policore dhe specialisti i shërbimeve të rendit përveç shënimeve në kartelën mjekësore dhe librat e shërbimit, duhet të marrin masa të menjëhershme për dërgimin e tij në qendrën më të afërt spitalore për t’i dhënë ndihmën e nevojshme. Nga verifikimi i praktikës dhe dokumentacionit në këtë komisariat, nuk konstatohet të jenë evidentuar apo pasqyruar nga stafi i policisë dhe mjeku, kryerja e veprimeve të parashikuara në procedurën standarde. Sa më sipër, sugjeron që ka pasur fiktivitate në plotësimin e procesverbaleve apo regjistrave të mësipërm.

Sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- marrjen e masave të menjëhershme, për zbatimin me rigorozitet nga strukturat dhe punonjësit e policisë në nivel vendor, të kërkesave ligjore për plotësimin e saktë të rubrikave në regjistrin e të shoqëruarve, arrestuarve/ndaluarve, kryesisht në rubrikën për evidentimin e “përshkrimit të pamjes së jashtme dhe shenjave të veçanta” që konstatohen tek këta persona, që në momentin e hyrjes së tyre në mjediset e Policisë së Shtetit;
- marrjen e masave të menjëhershme, për trajnimin e stafëve dhe punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP/komisariatet e policisë, për garantimin e lirive dhe të drejtave për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, sipas parashikimeve në legjislacionin kombëtarë dhe standardet ndërkombëtare;
- marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë të DVP/komisariateve të policisë, si dhe nxjerrjen e një akti nënligjor për miratimin e skemës të vendosjes së kamerave në mjediset e komisariateve të policisë ku privohet liria e personit dhe përcaktimin e një afati të arsyeshëm ligjor për ruajtjen e pamjeve filmike.

Në përgjigje D.P.P.SH. bën me dije se *rekomandimi është pranuar* dhe në zbatim të tij është tërhequr vëmendja me shkresën nr. 567, datë 16.01.2024 lidhur me “Përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe aktet ligjore të vendit, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë e personave”<sup>101</sup>.

#### 3.4.4. Niveli i respektimit të të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike

Gjatë vitit 2023, Mekanizmi Kombëtar ka inspektuar institucionet e shëndetit mendor si Spitali Psikiatrik Vlorë, Spitali Psikiatrik Shkodër, Spitali Psikiatrik Elbasan, I EVP Lezhë, Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve (IVSHB) dhe Spitali Psikiatrik “Xhavit Gjata” Tiranë.

<sup>100</sup> Si në rastin e Komisarariatit të Policisë në Sarandë.

<sup>101</sup> Shkresa nr. 11/1 prot., datë 26.01.2024.

Nga këto inspektive, problematikat kryesore të konstatuara janë:

- mungesa e kushteve strukturore të përshtatshme për trajtimin dhe rikuperimin e të sëmurëve në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” në Vlorë, Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, Spitalin Psikiatrik “Xhavid Gjata” në Tiranë dhe Spitalin me shtretër në Shkodër;
- mungesa e aktiviteteve rikuperuese apo ambienteve të zhvillimit të aftësive okupacionale në Spitalin Psikiatrik “Xhavid Gjata” në Tiranë, Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan dhe Spitalin me shtretër në Shkodër;
- numër i pamjaftueshëm i kapaciteteve për të akomoduar personat në fazë rikuperimi, problematikë e shfaqur edhe në Shën Koll (pra, sistemi i shtëpizave ku këta persona të rrinë nën përkujdesje por në autosuficiencë të monitoruar.);
- mungesa e investimeve si një nevojë imediate për rikonstruksionin e Shërbimit të Psikiatrisë QSUT “Nënë Tereza” Tiranë, që lidhet me rekomandimet ndër vite të Avokatit të Popullit si dhe standardet e kërkuara dhe parashtruara nga CPT-ja dhe KE, për një trajtim sa me cilësor dhe human të personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor;
- konstatimi i përsëritur për mungesën e investimeve dhe rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”, në Elbasan, rekomandim i përsëritur ndër vite nga Avokati i Popullit;
- shtimin në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit vazhdon të vlerësojë se është i nevojshëm shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specializantë në Psikiatri; riformulimi i kriterëve të punësimit për funksionet klinike “kujdestar” dhe “task forcë”, me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë si dhe trajnimin e punonjësve aktualë;
- vendosjen e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike;
- mungesa e krijimit të pavijoneve të posaçme për persona abuzues me substanca narkotike, të cilët manifestojnë çrregullime të sjelljes apo/dhe psikotike;
- krijimin/rikonstruksionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”;
- pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik;
- mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete;
- kushte infrastrukturore në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në spitalet psikiatrike, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale.

Shumë nga këto gjetje dhe rekomandime janë të përsëritura dhe nuk kanë nevojë për buxhetim konstant për këtë problematikë. Për gjithë sa më sipër, Avokati i Popullit ka dërguar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri.

### 3.4.5. *Niveli i respektimit të të drejtave në Qendrat e mbyllura për të Huajt, Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit si dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut*

MKPT ka realizuar gjatë vitit 2023 inspektimet përkatëse për të vlerësuar nivelin e respektimit të këtyre të drejtave në qendrat e pritjes të emigrantëve.

#### **1. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), zhvilloi në datën 17.02.2023, një inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç (QMHK).

Nga inspektimi u konstatua se vazhdonin të ishin prezente problematikat si më poshtë:

- problematika e mungesave në staf si: përkthyesi, mjeku, juristi, stomatologu mungesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në respektimin e të drejtave të personave të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë;
- në Qendër mungonin aparatet kartfonike, të cilat janë të domosdoshme për personat e huaj, për të komunikuar me familjet;
- problematika e mungesës në Qendër të përkthyesit, si një nevojë emergjente për komunikimet të cilët duhet të jenë për gjuhën angleze ose të gjuhës së huaj dominante të të huajve që ndodhen të akomoduar në këtë Qendër. Kjo mungesë sillte në vazhdimësi, vështirësi në komunikimin dhe ndërveprimin e të akomoduarve me punonjësit e Qendrës;
- mungesa e aktiviteteteve kulturore, argëtuese e sportive;
- në të gjitha ambientet e Qendrës ishte evidente mungesa e posterave me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar;
- në Qendër nuk ofrohej shërbimi stomatologjik;
- Qendra kishte vetëm një infermier i cili u përgjigjet nevojave dhe shërbimit mjekësor;
- mungonin zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes;
- lagështira ishte prezentë pothuajse në të gjitha ambientet e Qendrës, ku në ditët me shi vendosen kova për pritjen e ujit që kullon nga tavanet e dëmtuar;
- dollapët dhe dyert në të gjitha ambientet kishin nevojë për riparime.

#### **2. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë**

Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, zhvilloi në datën 06.09.2023, një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve. Përgjatë inspektimit u konstatuan disa mangësi që u adresuan në rekomandimin e posaçëm. Ndër gjetjet vlerësojmë të përmendim:

- nevojën në rritje të kuotës ushqimore dhe mangësitë në organikë;
- problematika mbi nevojën e rritjes së kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti;
- mungesa e rishikimit të organikës së kësaj Qendre duke pasur në vëmendje trendin e lëvizjeve migratore. Vlerësimi për shtimin e organikës me mjekë, infermierë, kujdestarë nate, punëtorë mirëmbajtjeje dhe sanitare të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të qendrës.

#### **3. Qendra Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë**

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut Linzë (QKPVT) u vizitua nga MKPT më datë 8.09.2023. Nga inspektimi i kryer në këtë qendër u konstatua se nuk kanë gjetur zgjidhje problematikat e konstatuara nga inspektimet e mëparshme. Më konkretisht:

- në Qendër pozicionin i Mjekut është vakant;

- kërkohet përmirësim i praktikave për aftësimin profesional me qëllim fuqizimin e përfitueseve në qendër. Për më shumë referohuni rekomandimit të plotë që gjendet në faqen e Avokatit të Popullit<sup>102</sup>.

Avokati i Popullit vlerëson faktin që godina tre katëshe i është nënshtruar rikonstruksionit në muajin shkurt 2023 dhe pritet të përfundojë në muajin dhjetor 2023.

#### 3.4.6. *Niveli i respektimit të të drejtave në Shtëpitë e të Moshuarve Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Shkodër*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka inspektuar për vitin 2023 shtëpitë e të moshuarve në grup multidisiplinor në Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Shkodër ku janë konstatuar pamjaftueshmëri e kapaciteteve njerëzore në mjekë, psikologë, fizioterapistë dhe kujdestarë, të domosdoshëm për të ofruar shërbime sipas standardeve të kujdesit shoqëror.

Gjithashtu është konstatuar mbështetje e pamjaftueshme financiare nga institucionet qeveritare dhe si rrjedhojë nevojat për riparime thelbësore, mobilje, sendet që lidhen me kujdesin personal, si karriget me rrota dhe produktet personale, të cilat përbëjnë burim për gjenerimin e vështirësive dhe problematika konkrete në ofrimin e kujdesit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe atë infrastrukturore. Për shkak të mungesave në trajnime për stafin e këtyre qendrave dhe në mënyrë që cilësia e shërbimeve të ofruara nga këta punonjës për përfituesit e qendrave të jetë në zbatim të ligjit “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”<sup>103</sup>, kemi rekomanduar që trajnimet të përfshijnë trajtimin e të moshuarve, duke bërë të mundur vlerësimin dhe plotësimin e nevojave të tyre, për të rritur kujdesjen dhe për t’u siguruar një jetesë sa më aktive për ta dhe për të siguruar që punonjësit të jenë në gjendje të parandalojnë dhunën, në mënyrë që përfituesit e këtyre qendrave të kenë një jetë sa më të sigurt.

Avokati i Popullit kërkon një vëmendje të shtuar të institucioneve shtetërore ndaj Shtëpive për të Moshuarit, duke bërë të mundur rritjen e fondeve buxhetore dhe njëkohësisht rritjen e kapaciteteve njerëzore, investime të qenësishme për kategorinë e të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore, si dhe rritje të numrit të aktiviteteve sociale për përfituesit e këtyre qendrave dhe kushte më të mira pune për stafin që i shërben kësaj kategorie.

<sup>102</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/asylum-center/rekomandime-pr-shtpit-e-t-moshuarve-2023-978/>

<sup>103</sup> Ligji nr. 121/2016.

Gjatë vitit 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar dhe trajtuar 32 raste, të cilat objekt të tyre kanë patur pretendime të qytetarëve për shkelje të të drejtave të tyre nga organet e prokurorisë.

Organi i prokurorisë, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, duhet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm për të gjitha procedimet, brenda afateve procedurale, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim bazuar në prova dhe fakte, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikëqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit.

Në vlerësim të ankesave të qytetarëve ndaj organit të prokurorisë janë evidentuar se në disa raste organi i prokurorisë nuk njofton/informon palët për vendimin përkatës në rastet e pezullimit të hetimit, mosfillimit të procedimit apo kërkesat drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes penale.

Viti 2023 ka qenë jo pak i ngarkuar për sistemin e drejtësisë, ku përveç ngarkesës në punë për çdo magjistrat si rrjedhje e vakancave të krijuara në sistem nga procesi i rivlerësimit kalimtar, edhe implementimi i hartës së re gjyqësore solli pasojat e veta përsa i përket riorganizimit të punës në zyrat e prokurorisë. Këto vështirësi janë reflektuar në punën e organeve të prokurorisë ku qytetarët kanë paraqitur ankesa për disa aspekte përse i përket veprimeve hetimore procedurale si: *zvarritje të hetimeve, mos dhënie informacioni, ndryshime të shpeshta të prokurorit të çështjes të cilat kanë sjellë si pasojë zvarritje lidhur me çështjen, mos njoftim i vendimeve në rastet e mos fillimit të procedimit penal dhe të pushimit të procedimit penal nga ana e prokurorit etj.*

Pavarësisht ngarkesës dhe rritjes së vëllimit të punës, organi i prokurorisë ka detyrën kushtetuese për ushtrimin e ndjekjes penale, e në këto kushte është detyrim respektimi i procedurave penale, kryerja e hetimeve me profesionalizëm, në një kohë sa më të arsyeshme, vlerësimi i drejtë i materialeve të hetimit në mënyrë që të arrihet në një konkluzion të bazuar për mundësinë e regjistrimit ose jo të procedimit penal. Vlen të theksojmë se, në asnjë moment Avokati i Popullit gjatë analizimit dhe shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve të prokurorisë, nuk ka synuar të vlerësojë apo ndikojë në vendimmarrjen e prokurorëve të çështjeve, pasi nuk ka dyshim që kompetente për shqyrtimin dhe vlerësimin e bazueshmërisë ligjore së këtyre vendimeve është gjykata, por në rastet e moszbatimit të detyrimeve ligjore të prokurorëve lidhur me të drejtat e kallëzuesve dhe viktimave në procesin penal, të garantuara nga Kodi i Procedurës Penale, nuk mund të qëndrojmë indiferentë<sup>105</sup>.

Avokati i Popullit, ndër vite, ka rekomanduar respektimin e të drejtës së qytetarit për t'u informuar me vendimet përfundimtare të Prokurorisë, duke synuar garantimin e të drejtës së ankimit që duhet t'u njihet individëve ndaj vendimeve respektive në çdo fazë të hetimit si dhe respektimi i të drejtës së informimit e cila rrit aksesin e qytetarëve te drejtësia.

---

<sup>104</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>105</sup> Neni 58, 356, pika 3, dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

Avokati i Popullit vlerëson se çështje të tilla ndikojnë drejtpërdrejtë tek besimi i publikut në organin e akuzës, të perceptimi që ligji vepron njësoj për të gjithë, ndaj lind nevoja e adresimit të këtyre problematikave shqetësuese. Aksesit në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e sistemit të drejtësisë në vend e në veçanti të organit të Prokurorisë. Në mënyrë të grupuar dhe sipas rëndësisë së cenimit të të drejtave në procesin penal, ankesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:

*Së pari, konstatohen zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale.* Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë për zvarritje në hetimin e procedimeve penale zënë pjesën më të madhe të numrit të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me veprimtarinë e organit të prokurorisë. Arsyet kryesore të zvarritjes në hetimin e procedimeve penale sipas vetë përgjigjeve të prokurorive lidhen kryesisht me: numrin e reduktuar të prokurorëve në strukturat e hetimit dhe procedimit penal, për shkaqet e zbatimit rigoroz të reformës në drejtësi dhe shkarkimit të një numri të konsiderueshëm të prokurorëve; numrin e lartë të çështjeve për një prokuror; riorganizimi i zyrave të prokurorisë në kuadër të implementimit të hartës gjyqësore; kompleksitetin e çështjeve, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje, marrëdhëniet seksuale me të mitur, apo vepra të tjera të rënda penale; problemet dhe zvarritjet në kthimin e përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e drejtësisë së shteteve të huaja; mosrespektim i afateve për dorëzimin e akt-ekspertimeve të urdhëruara, si dhe komandimet e prokurorëve të çështjeve në prokurori të tjera për të mbuluar vakancat e krijuara. Pavarësisht ekzistencës së këtyre faktorëve, gjatë hetimeve tona janë konstatuar raste të zvarritjeve të pajustificuara me vite të procedimeve penale.

Në një nga rastet ankuesja H.Ç parashtron se vajza e saj ka mbetur invalide, si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm të mjekut. Sipas ankueses, ndaj mjekut është regjistruar procedimi penal nr.1039 i vitit 2014, për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”. Në datën 30.07.2018 ajo ka marrë njoftim për përfundimin e hetimeve nga prokurori i çështjes dhe më pas, prej 4 vitesh, nuk ka dijeni dhe nuk është njoftuar se çfarë ka ndodhur me këtë procedim.

Pas hetimit administrativ, Avokati i Popullit konstatoi se hetimet e kësaj çështjeje ishin zgjatur në tejkalim të afateve të përshtatshme për një proces të rregullt ligjor. Hetimet lidhur me këtë çështje janë tejzgjatur në kohë dhe pa afat, nga data 28.06.2017 e deri në vitin 2023 (gati 6 vjet). Dosja hetimore vijonte të qëndronte në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nuk ishte dërguar në gjykatë në mënyrë aspak korrekte nga kjo prokurori.

Me ndjekjen e rastit nga Avokati i Popullit u bë i mundur dërgimi në gjykatë i çështjes, por siç evidentohet hetimet për këtë çështje janë tejzgjatur me vite të tëra dhe në shkelje të afateve ligjore, konkretisht prej vitit 2014 dhe deri në vitin 2023 (gati 9 vjet). Në përfundim rezultoi e domosdoshme të mbahej një qëndrim dhe për gjetjet përkatëse i kemi drejtuar rekomandim<sup>106</sup> Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku kemi kërkuar fillimin e procedurave të verifikimit të konstatimeve të bëra nga ana jonë, për të vlerësuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit

---

<sup>106</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëbsite/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf>

disiplinor për prokurorin e çështjes pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

*Së dyti, konstatohen problematika në zbatimin e dispozitave procedurale që parashikojnë dhe rregullojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e më konkretisht: mosnjohja me aktet dhe provat (dosjen) mbi bazën e të cilave ngrihen akuzat penale e personit nën hetim apo të akuzuar; mungesa ose vonesat në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i prokurorisë, kryesisht kallëzuesit të veprës penale sidomos në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal; mosveprime procedurale nga ana e prokurorit për një kohë të gjatë; mosinformim për kallëzimin e bërë; veprimet e ndjekura për zëvendësimin e prokurorit; sekuestrim i padrejtë i automjetit/pronave, sendeve personale, etj. Vonesa për njoftimet e palëve në procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes.*

Megjithëse ankuesit, persona fizikë e juridikë, në kallëzimet e bëra kanë dhënë adresat e banimit apo të punës, adresat elektronike, si dhe numrat e telefonëve, nuk kanë marrë njoftime nga organi i prokurorisë me asnjë prej formave të komunikimit (as në rrugë postare, as në rrugë elektronike dhe as nëpërmjet telefonit). Ndërkohë nga kopjet e dokumentacionit të dërguar nga organet e prokurorisë kemi konstatuar edhe raste që njoftimi i shtetasve ndodhej në dosjen penale, por nuk kishte dokument/dëftesë komunikimi që të provojë se është bërë realisht njoftimi/komunikimi i vendimeve në fjalë. Pra, në këto raste në vlerësimin tonë njoftimi është bërë formal dhe për të plotësuar dosjen, por pa efektivitet lidhur me realizimin e të drejtave të shtetasve (kallëzuesve/viktimitave të veprave penale) të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale<sup>107</sup>.

Kjo problematikë lidhet me qytetarët kallëzues të cilët u drejtohen me kërkesë për informacion organeve të prokurorisë për veprimet procedurale që janë kryer lidhur me kallëzimet e bëra në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, apo se në cilën fazë ndodhen hetimet, por nuk u jepet përgjigje<sup>108</sup>.

Në një rast institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një ankesë ndaj Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në të cilën parashtrohej se ankuesi A.K., viktimë e veprës penale ndonëse i ishte drejtuar disa herë verbalisht dhe me shkresë organit të prokurorisë për t'u informuar lidhur me ecurinë e hetimeve si dhe për të tërhequr një kopje të akteve të fashikullit hetimor nuk i është mundur nga Prokuroria. Për këtë qëllim është zhvilluar një hetim administrativ në përfundim të të cilit është konstatuar se ka patur zvarritje të veprimeve hetimore si dhe ankuesi nuk është informuar pas kërkesës së depozituar prej tij që duhej të paraqitej fizikisht si dhe të paguante një tarifë të miratuar me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm për tërheqjen e dokumentacionit që ai interesohej. Adresimi i këtij rasti nga ana e Avokatit të Popullit vuri në lëvizje organin e prokurorisë që njoftoi ankuesin për sa ai kërkonte si dhe në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore arriti të administrojë

<sup>107</sup> Neni 9/a, neni 58, neni 326 pika 3 dhe neni 329/a pika 4.

<sup>108</sup> Kërkesa e ankuesve kur ata janë njëkohësisht kallëzues dhe viktimë e veprës penale parashikohet në nenet 58/1/e, 326 pika 3 dhe 329/a pika 4 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet e tjera kur ata janë kallëzues të një vepre penale të kryer jo ndaj tyre për të cilën kanë marrë dijëni, e drejta për të kërkuar informacion bazohet në nenin 326 pika 3 dhe nenin 329/a pika 4 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu kjo e drejtë bazohet në nenin 23, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenin 10, pika 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, respektivisht në nenet 1, 2/1/a, 3.

dhe aktin e ekspertimit mjekoligjor i cili nuk ishte kryer për më shumë se një vit nga momenti i urdhërimit.

Një shqetësim i hasur në punën tonë me organet e prokurorisë ka qenë dhe moskthimi ose vonesa në kthimin e përgjigjeve të cilat janë përcjellë pas disa kërkesave nga ana jonë dhe mosdhënia e informacionit të plotë që ne kemi kërkuar, në kuadër të hetimit administrativ për trajtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të prokurorisë. Raste më të përsëritura kemi patur me Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkodër. Theksojmë se e drejta e informimit dhe afati për marrjen e informacionit të kërkuar janë të sanksionuar si në Kushtetutë dhe në legjislacionin specifik si ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ndaj respektimi i kësaj të drejte përveçse është një detyrim ligjor për çdo institucion publik por nga ana tjetër ndikon drejtpërdrejtë në perceptimin e qytetarëve përsa i takon transparencës dhe shkallës së korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

Mosbashkëpunimi i ndërsjellë institucional dhe mungesa e informacionit sjell pengesa në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave që kushtetuta dhe ligji i ka caktuar (njohur) Avokatit të Popullit si dhe cenimin e reputacionit të tij në publik.

*Së treti, konstatohen raste të vonesave të procedimeve penale përsa i takon mosparaqitjes në kohë të akteve të ekspertimit mjeko-ligjor nga ekspertët e urdhëruar nga prokurori si dhe nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Gjatë vitit 2023 është konstatuar një numër i shtuar i ankesave të qytetarëve por dhe në rastet e nisura me iniciativë nga Avokati i Popullit, të cilat lidhen me vonesa në veprimet procedurale hetimore, në përcaktimin e veprës penale apo të autorit të veprës penale si pasojë e vonesave dhe tejkalimeve të afateve ligjore në hartimin e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor. Sjellim në vëmendje se akti i ekspertimit mjeko-ligjor i kërkuar nga organet e hetimit penal në rastet e një veprë penale me pasoja për jetën e viktimes, konsiderohet një provë e rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin e hetimeve<sup>109</sup>. Akti i ekspertimit mjeko-ligjor konsiderohet nga prokurori një provë determinante për ndërtimin e dinamikës së ngjarjes, cilësimin e veprës penale dhe përcaktimin e pasojës së veprës penale apo të masës së sigurisë për autorin e dyshuar.*

Në rastet e çështjeve penale komplekse me shumë autorë dhe viktime, veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, marrëdhëniet seksuale me të mitur, apo vepra të tjera të rënda si prodhimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, paraqitja e aktit të ekspertimit nga ekspertët e fushës të caktuar nga prokurori, përbëjnë një provë vendimtare për çështjen në hetim<sup>110</sup>.

Në disa nga rastet e ankesave të shqyrtuara nga ana jonë është konstatuar se: për më shumë se një vit nga momenti i urdhërimit të prokurorit të çështjes për paraqitjen e aktit të ekspertimit mjeko ligjor nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore nuk ishte paraqitur akti; raste të paraqitjes me vonesë të ekspertit për kryerjen e ekspertizës; mungesë të ekspertëve të fushës sidomos për ato vepra penale që lidhen me prodhimin dhe shitjen e narkotikëve (për të cilat është e nevojshme të identifikohet dhe përcaktohen dozat

---

<sup>109</sup> Bazuar në përcaktimet e nenit 178 të KPP “ Objekti i ekspertimit” si dhe në nenin 185 të tij “Akti i ekspertimit”, kuptojmë rëndësinë që ka si provë në procesin hetimor ky akt si dhe afatet e përcaktuara.

<sup>110</sup>Gjatë vitit 2023, është konstatuar një shtim i rasteve të veprave penale me një tipologjie të tillë të cilat për zbardhjen e tyre kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë të organit të prokurorisë me ekspertët e fushës së mjekësisë ligjore.



e lëndëve narkotike e psikotrope në rastin e përdorimit vetjak nga subjektet e dyshuar), si dhe përcaktimin e dhunës ndaj individit apo marrëdhënieve seksuale me dhunë.

Kordinimi i punës ndërmjet organit të Prokurorisë dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, trajnimi i vazhdueshëm i ekspertëve është shumë i rëndësishëm dhe shpeshherë determinant në procedimet penale, në dhënien e drejtësisë në kohë dhe me cilësi për qytetarin. Me qëllim për të garantuar respektimin me korrektësi, paanshmëri e profesionalizëm të rregullave dhe parimeve procedurale gjatë hetimit të procedimit penal si dhe për të mundësuar dhënien e drejtësisë në kohë dhe me cilësi për qytetarët, në një nga rastet e shqyrtuara, i rekomanduam<sup>111</sup> Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës:

- marrjen e masave konkrete dhe paraqitjen e menjëherëshme të aktit të ekspertimit mjekoligjor nga ana e grupit të ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore pranë organit të prokurorisë;
- rishikimin e organikave të strukturave vendore dhe mënyrën organizative të punës së ekspertëve nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, në mënyrë që të shmangen këto raste të përsëritura;
- marrjen e masave për zbatimin nga ana e prokurorit të detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 186 të KPP.

*Ky rekomandim është pranuar nga të dy institucionet.*

---

### 3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor në sistemin gjyqësor<sup>112</sup>

---

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit i ka kushtuar një vëmendje të shtuar zbatimit të reformës në drejtësi dhe ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Ecuria e këtyre ishte pa dyshim e lidhur me reformimin dhe ringritjen e pushtetit të tretë, atij gjyqësor, si dhe njëkohësisht me kthimin e besimit të qytetarëve te ky i fundit. Kemi vlerësuar krijimin e organeve të reja të drejtësisë dhe çmojmë se ngritja e një pushteti gjyqësor cilësor dhe funksional është një detyrim ndaj shtetasve shqiptarë, për të krijuar balancën me pushtetet e tjera dhe për të forcuar shtetin e së drejtës.

Në vijimësi, kemi ndjekur të gjitha zhvillimet lidhur me hartimin dhe miratimin e hartës së re gjyqësore si dhe vënien e saj në zbatim përgjatë vitit 2023. Si nga ankesat e administruara në institucion, po ashtu edhe nga rastet e shqyrtuara me iniciativën tonë<sup>113</sup>, kemi konstatuar tejzgjatje të gjykimeve, në veçanti në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por edhe në Shkodër, Elbasan etj, ku numri i gjyqtarëve ka qenë shumë më i ulët në raport me numrin që duhet të jetë efektivisht.

Po ashtu, janë evidentuar problematika thelbësore sa i përket vonesave në arsyetimin e vendimeve gjyqësore qofshin civile ose penale, duke sjellë vonesa në njoftimin e palëve dhe ushtrimin e të drejtës

---

<sup>111</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20%20%20Prok.%20Rr.%20Dures%20%20dhe%20Insitutit%20t%C3%AB%20Mjek%C3%ABsis%C3%AB%20Ligjore.pdf>.

<sup>112</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>113</sup> Për vitin 2023, numri i rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara është 60.

së ankimit në gjykatat më të larta ose të rekursit në Gjykatën e Lartë. Vonesat në arsyetimin e vendimeve penale, veçanërisht nga Gjykatat e Apelit (aktualisht Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm), kanë pasur një impakt të theksuar për kategorinë e shtetasve të paraburgosur. Këta të fundit, për shkak të mosnxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve gjyqësore të dënimit të tyre, kanë vijuar të qëndrojnë në institucione të paraburgimit, duke iu cenuar disa të drejta që i gëzojnë shtetasit e dënuar dhe nga ana tjetër ka ndikuar në mbipopullimin e këtyre institucioneve. Problematika e mbipopullit në burgje është sjellë në vëmendje edhe në gjetjet e Raportit të CPT-së i bërë publik në datën 12.01.2024, pas vizitave që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 04 deri në datën 15 maj 2023<sup>114</sup>. Sipas CPT-së, duhen bërë përpjekje të mëdha për të kufizuar përdorimin e masës së paraburgimit (masës së sigurimit personal arrest me burg) dhe të shkurtohet koha e kaluar nga të burgosurit në ambientet e paraburgimit, me synim për të ndaluar rritjen e vazhdueshme të popullatës së të paraburgosurve dhe për të përmbysur trendin.

Sot sistemi i drejtësisë përballet me vakanca të theksuara të numrit të gjyqtarëve, stok të lartë dosjesh të krijuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dy gjykatat e apelit, mungesat e godinave (pallatit të drejtësisë) dhe rrezikun e gjobitjes së shtetit shqiptar nga Gjykata e Strasburgut për vonesat e shkaktuara palëve, etj.

Në zbatim të VKM-së nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” në të cilin është parashikuar riorganizimi i gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme të juridiksionit të përgjithshëm, e cila filloi funksionimin në datë 1 shkurt 2023 dhe ndërprerjen e veprimtarisë për 5 gjykatat e tjera të apelit në datë 31.01.2023.

Gjithashtu, me akte normative nënligjore Këshilli i Lartë Gjyqësor përcaktoi fillimin e funksionimit të 13 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në datë 01.05.2023, si dhe të dy gjykatave administrative të shkallës së parë në datë 01.07.2023.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka organikë të miratuar prej 78 gjyqtarësh, por në fund të dhjetorit 2023 kishte vetëm 25 të tillë. Ngarkesa e tyre përbëhet jo vetëm nga çështjet që janë akumuluar nga pesë gjykatat e apelit që aktualisht janë mbyllur, por njëkohësisht edhe çështje të reja që përfundojnë në shkallë të parë dhe ankimohen nga palët në gjykatën e apelit. Nuk ka asnjë diskutim se ky fakt ndikon në dhënien e drejtësisë në kohë dhe cilësi. Avokati i Popullit konstaton se situata nuk ka përmirësim që nga nisja e reformës në drejtësi në vitin 2017.

Gjatë punës sonë, kemi konstatuar se janë zvarritur çështje tepër të ndjeshme dhe delikate sikurse:

- zgjidhjet e martesës dhe rregullimi i pasojave të tyre si, caktimi i kujdestarisë dhe i detyrimeve ushqimore për fëmijët;

---

<sup>114</sup> Për më shumë informacion, shih raportin e plotë të CPT:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-report-on-albania.-1>

- çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, njohjen e vjetërsisë në punë, njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit, etj.;
- çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e masave të sigurisë, etj.

Avokati i Popullit ka ngritur në mënyrë të përsëritur shqetësimin për sa i përket aksesit në drejtësi të qytetarëve me vënien në zbatim të hartës gjyqësore, duke theksuar problematikat e pritshme me të cilat do të përballëshim. Në këtë linjë, sipas konstatimeve tona kemi adresuar një sërë rekomandimesh për të sjellë në vëmendje të institucioneve kompetente se është koha për të vepruar, për të marrë masat e nevojshme, për të dhënë drejtësi pa vonesë, sipas standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe legjisllacionin e brendshëm.

Rekomandime për përshpejtim të proceseve për zgjidhjen e martesës<sup>115</sup> dhe pasojat e saj u janë adresuar respektivisht Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Në këto rekomandime kemi sugjeruar marrjen e masave për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve familjare, me impakt në mirëqenien e fëmijëve dhe/ose gruas.

Gjithashtu, në rekomandimet tona është theksuar rëndësia e respektimit të parimit sipas së cilit gjykata duhet të realizojë një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, për të garantuar kështu të drejtat e qytetarëve. Është detyrë e të gjitha gjykatave në shkallë vendi marrja e masave për respektimin e afateve të përcaktuara në legjisllacionin procedural sa i përket përfundimit të shqyrtimit të çështjeve dhe veçanërisht për shqyrtimin me prioritet të çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve apo kanë ndikim tek fëmijët e mitur, pavarësisht përfshirjes së tyre në procesin e vettingut apo të lëvizjes brenda sistemit gjyqësor.

Gjejmë vendin për të theksuar se në sajë të rolit proaktiv, kemi komunikuar në mënyrë të vijueshme me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për adresimin në një kohë sa më të shpejtë të disa çështjeve të shtetasve me objekt zgjidhjen e martesës dhe caktimin e kujdestarisë. Në këtë kuadër, vlerësojmë bashkëpunimin që kemi pasur me këtë gjykatë për ecurinë e proceseve gjyqësore përkatëse.

Lidhur me vonesat e vërejtura në arsyetimin e vendimeve gjyqësore janë adresuar gjithashtu disa rekomandime, nisur nga rastet e hetuara në institucion. Kështu, është konstatuar mungesa e arsyetimit të një vendimi gjyqësor prej vitit 2012 (11 vjet) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.<sup>116</sup> Gjyqtari përkatës ishte shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pikërisht për arsye që lidheshin me zvarritjet e proceseve gjyqësore ku përfshiheshin edhe arsyetimet e vendimeve gjyqësore që shkonin me vite. Kërkuesi ishte njohur vetëm me shkurtimin e vendimit dhe jo me vendimin e arsyetuar të gjykatës. Prej vitit 2012 ky vendim nuk ishte zbardhur nga gjykata, për t'i dhënë mundësinë nga ana procedurale qytetarit që të mund të ushtronte të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit. Shtetasit në fjalë i është cenuar e drejta e tij për t'u njohur me vendimin e arsyetuar, si dhe mundësia e ankimit të këtij vendimi në gjykatën e apelit prej 11 vitesh, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor.

<sup>115</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimet përkatëse.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20gjyqates%20L.M.pdf> ;  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20gjyqates%20Shkoder%20K.R.pdf>.

<sup>116</sup> Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20KLGJ-L.K.pdf>

Në vlerësim të Avokatit të Popullit, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>117</sup>). Një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cenojë të drejtën e gjykimit pa vonesa dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, ky parim garanton mbrojtjen e të gjitha palëve në procesin gjyqësor ndaj “vonesave të tepruara procedurale”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ<sup>118</sup>, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “case law”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar.

Kështu, çmujmë se gjykimi i çështjeve në kohë, arsyetimi i vendimeve, si dhe dorëzimi i tyre brenda afateve procedurale, nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatojmë se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, po ashtu edhe nga gjykata e rrethit gjyqësor (në rastin konkret ajo e Elbasanit) duhet të ishin bërë veprimet e duhura organizative për menaxhimin e problematikës së ngritur nga ankuesi dhe adresimin e saj në kohë për t’i garantuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, nisur nga ajo çfarë kemi trajtuar më lart, lind si nevojë të përcaktohen mekanizma të cilat të evidentojnë dhe kontrollojnë menaxhimin e situatave të largimit të gjyqtarëve nga detyra, për shkaqe objektive ose subjektive (shkarkime, dorëheqje etj.), në mënyrë që të merren masat e duhura për të përmbushur detyrimet e tyre, për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe dorëzimin e tyre në sekretari.

Avokati i Popullit vlerëson se reforma ka nevojë për investim substancial për të arritur qëllimin e saj dhe në mënyrë të veçantë rekomandon rritjen e kapaciteteve njerëzore për të mos hedhur çdo presion mbi gjyqtarët e mbetur në sistem. Ata janë nën një presion të vazhdueshëm prej shumë vitesh dhe situatat potenciale të mbingarkesës vetëm do të përkeqësonin një situatë jo të mirë.

Dy rekomandime të tjera për arsyetimin e vendimeve gjyqësore i janë adresuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm<sup>119</sup>, një prej të cilëve lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. 148, datë

---

<sup>117</sup> Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

<sup>118</sup> PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097.

Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992.

<sup>119</sup>Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Gjykates%20se%20Apelit.pdf>.

28.03.2022, të ish Gjykatës së Apelit Shkodër për një çështje civile dhe tjetri për arsyetimin e një vendimi gjyqësor penal.

Çështja civile është gjykuar nga ish-Gjykata e Apelit Shkodër<sup>120</sup> dhe vendimi gjyqësor është shpallur në datën 28.03.2022. Gjyqtari relator që aktualisht është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka shkelur afatin procedural të arsyetimit të vendimit, të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, pasi kishin kaluar 19 muaj dhe ankuesit nuk i ishte njoftuar kopje e vendimit të gjykatës i arsyetuar. Mosarsyetimi dhe mosdorëzimi i vendimit në sekretarinë e ish Gjykatës së Apelit Shkodër apo më pas në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka sjellë si pasojë në mënyrë të pajustificuar nga ana ligjore zvarritjen e gjykimit të çështjes në tërësi në të gjitha shkallët e gjykatave dhe konkretisht nga një gjykatë tjetër, sikurse mund të jetë ajo e nivelit më të lartë kur palët në proces bëjnë ankim, në rastet kur çështja dërgohet për rigjykim në një gjykatë më të ulët, sikurse është rasti në shqyrtim, apo zvarritjen e ekzekutimit të vendimit kur palët nuk bëjnë ankim ndaj vendimit të dhënë.

Po ashtu, është adresuar rekomandim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedurave të verifikimit të konstatimeve të bëra nga institucioni ynë, në lidhje me ankesën e shtetasit A.A për të vlerësuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për gjyqtarin e ish Gjykatës së Apelit Shkodër, T.S. Kemi çmuar se nga strukturat kompetente të cilat vlerësojnë performancën e punës së magjistratëve duhet të analizohet shkelja ligjore e kryer në këtë rast nga gjyqtari i çështjes i ish-Gjykatës së Apelit Shkodër dhe të mbahet qëndrim ligjor ndaj tij për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor.

*Rekomandimi është pranuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë i cili ka nisur verifikimin e rastit të dërguar nga ana jonë.*

Duhet theksuar se afatet e zbardhjes së vendimeve gjyqësore variojnë midis 4 dhe 6 muajsh, çka përbën përkeqësim të dukshëm të afatit 30 ditor që ka qenë mesatarja kur nisi reforma në drejtësi. Nga ana tjetër rezultojnë se gjyqtarët, në përfundim të procedurave të vetingut, në jo pak raste nuk dorëzojnë dosjet apo nuk zbardhin vendimet. Vlerësojmë se në këtë rast mund të ketë nevojë për rregullime të posaçme nëpërmjet akteve normative pasi jo vetëm shkelen të drejtat e qytetarëve por edhe cënohet imazhi i drejtësisë duke pamundësuar arritjen e qëllimit të reformave.

---

### 3.7 Ndhimja juridike falas<sup>121</sup>

---

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të trajtojë ankesë/kërkesa të paraqitura në institucion lidhur me kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur për të përfituar ndihmë juridike falas në zbatim të ligjit

---

<sup>120</sup> Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rrethve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, 6 Gjykatat e Apelit janë riorganizuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datën 01.02.2023.

<sup>121</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij<sup>122</sup>.

E drejta për akses në drejtësi është një e drejtë e cila duhet t’u garantohet nga shteti qytetarëve të tij, pasi është një e drejtë themelore. Pra, është detyrim i shtetit shqiptar të bëjë të mundur aksesin në drejtësi, duke garantuar të drejtën për të përfituar shërbim ligjor falas për individët e parashikuar në ligj, duke mbrojtur kështu të drejtat e tyre themelore kushtetuese. Ky shërbim dedikohet për qytetarët me të ardhura të pakta, personat e përjashtuar në aspekt social, kategoritë e qytetarëve dhe personave të marginalizuar, si dhe ata të cilët për çfarëdo arsye janë gjendur në pozitë të vështirë ekonomike dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje të paguajnë avokat, që të mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara nga legjislacioni kombëtar dhe standartet ndërkombëtare. E drejta për ndihmë juridike falas buron nga e drejta e barazisë të të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve në realizimin dhe të gëzuarit e lirive dhe të të drejtave.

Ankesë/kërkesat e administruara në institucion lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas janë trajtuar duke këshilluar ankuesit drejtpërdrejtë, apo nëpërmjet bashkëpunimit dhe këshillimit me qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Avokati i Popullit së bashku me zyrat e tij rajonale ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me to, në kuadër të informimit të qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet ligjore, mënyrat për ushtrimin e tyre, ofrimin e asistencës ligjore për plotësimin e formularëve dhe kërkesave për përfitimin e ndihmës juridike dytësore për shtetasit që janë paraqitur pranë tyre.

Gjatë vitit 2023, janë shtuar qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore në disa qytete të vendit, si ato me financimit nga buxheti i shtetit, po ashtu edhe ato në bashkëpunim me UNDP-në në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”.

Po ashtu, Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas) ka lidhur marrëveshje të reja bashkëpunimi me institucione të Arsimit të Lartë. Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Në bazë marrëveshjes së bashkëpunimit klinikat do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standarteve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Nisur nga fakti se numri i këshillimeve nga klinikat e ligjit mbetet i ulët krahasuar me qendrat dhe ojf-të e autorizuara, rritja në të ardhmen e kapacitetit të klinikave të ligjit, angazhimi aktiv i studentëve të fakulteteve të drejtësisë, si një degë e rëndësishme e mekanizmit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, duhet të jetë një nga objektivat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Duke analizuar të dhënat<sup>123</sup> është konstatuar se pjesa më e madhe e rasteve të trajtuara janë të natyrës administrative, pasuar nga çështjet civile dhe më pak çështjet penale. Po ashtu, buxheti i dedikuar i shtetit i ndarë për ndihmë juridike është rritur nga viti në vit. Megjithatë, duhet të rritet më tej për të funksionalizuar plotësisht klinikat ligjore. Ajo çka mbetet e rëndësishme për të përmirësuar ka të bëjë me

---

<sup>122</sup> Për vitin 2023 janë trajtuar si këshillime dhe orientime mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin subjektet ankues/kërkues, 3065 raste.

<sup>123</sup> Për më tepër, shih:

<https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/12.-Analiza-Statistikore-Dhjetor-2023..pdf>

mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave statistikore për ndihmën juridike falas<sup>124</sup>. Vlen të theksohet se zyrat juridike kanë ushtruar edhe funksione për të mundësuar aksesin e qytetarëve në e-albania, çka është jashtë qëllimit të krijimit të këtyre zyrave dhe në vlerësimin tonë jo eficiente.

---

### 3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist<sup>125</sup>

---

Gjatë vitit 2023, në institucionin e Avokatit të Popullit kanë vijuar të trajtohen ankesë/kërkesa të ndryshme lidhur me problematikat që kanë paraqitur ish të përndjekurit politikë<sup>126</sup>. Për trajtimin e tyre është koordinuar me ministrinë e linjës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Nëse Ministria e Drejtësisë ka qenë korrekte dhe në respektim të parashikimeve ligjore në përgjigjet e saj, lidhur me përmbushjen e kriterëve për përfitim të ankuesve, Ministria e Financave ka paraqitur vonesa si në kthimin e përgjigjeve, po ashtu në zgjidhjen e problematikave lidhur me pagesat e kësteve të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre.

Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave sipas parashikimeve të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, janë vërejtur procedura burokratike të njëpasnjëshme dhe të tepërta për ridepozitime të vazhdueshme të dokumentacionit të të interesuarve si fotokopje të dokumenteve të identitetit ose pasaportave dhe të vërtetimeve bankare, që në thelb nuk e ndihmojnë aspak procesin.

Kështu në përgjigjen e Ministrisë së Financave për një rast të trajtuar rezulton se dosja e ish të përndjekurit politik z.M.P, është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në datën 14.09.2022, për përfitimin e kështit të katërt dhe mbart numër pagese **75**. Sipas këtij institucioni nga verifikimi i regjistrit të protokollit dhe i dokumentacionit fizik të administruar në dosjen fizike, nuk rezulton të jenë përditësuar dokumentet e kërkuara sipas shqyrtimit juridik të publikuar (dokumente të identitetit dhe vërtetim i llogarisë bankare i përditësuar).

Ndërsa në një rast tjetër, u konstatua se pavarësisht se kishte kaluar më shumë se një vit nga publikimi i emrit në listën e faqes zyrtare të Ministrisë së Financave, ankuesja në moshë të thyer nuk ishte njoftuar nga strukturat e ministrisë, në mënyrat e parashikuara në paragrafin e parë të nenit 14 të ligjit, ku shprehimisht përcaktohet se: “*Struktura përgjegjëse për pagesën e dëmshpërblimeve të ish të dënuarve politikë në Ministrinë e Financave publikon, në mënyrë periodike, në faqen zyrtare, listat e dosjeve të gatshme për pagesë dhe bën njoftimin për të gjitha subjektet përfituese, pjesë e listës, nëpërmjet shërbimit postar, njoftimit me mjete të komunikimit elektronik (e-mail) dhe medias publike.*” Çmujmë se është domosdoshmëri ndërgjegjësimi dhe rritja e përgjegjësisë së strukturave të Ministrisë së Financave, për rishikimin e dokumentacionit të depozituar nga përfituesit dhe njoftimin në kohë reale të tyre.

---

<sup>124</sup> Për më tepër, shih në faqen 39, në linkun:

[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf)

<sup>125</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>126</sup> 8 (tetë) ankesa dhe 1(një) rast me iniciativë.

Pasi ankuesja është njoftuar nga ana jonë, ka ridepozituar në mënyrë të menjëhershme me postë dokumentet e kërkuara. Po ashtu, vlen të theksohet se duhet mbajtur parasysh se përfituesit janë në moshë të thyer dhe nuk mund të presin pagesën e kësteve në fazat e tjera, për më tepër në ato raste kur dosjet kanë qenë planifikuar. Është thelbësore që strukturat kompetente të Ministrisë së Financave të zbatojnë detyrimin e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 14 të sipërcituar. Për rastin në shqyrtim dhe për asnjë rast tjetër të trajtuar nga ana jonë<sup>127</sup> e për të cilat është ngritur shqetësim në strukturat e Ministrisë së Financave, nga ana e këtyre të fundit *nuk na është përcjellë informacion* që përfituesit të jenë njoftuar prej tyre në çdonjërin nga mënyrat e parashikuara në ligjin si më sipër. Gjykojmë se, duhet vlerësuar me ndjeshmëri situata dhe vështirësitë me të cilat përballen këta njerëz në moshë tepër të thyer. Për këtë kategori ka barriera dhe mungesë aksesit në lidhje me dixhitalizimin, e për këtë arsye duhet që të ketë mënyra njoftimi alternative dhe të verifikohet nga personat përgjegjës në strukturat shtetërore respektive komunikimi me individët në mënyrën më efektive për ta.

Pas adresimit të rekomandimeve përkatëse, lind si domosdoshmëri rritja dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Financave, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të adresuara. Referojmë gjithashtu se rekomandimi i institucionit tonë adresuar më herët Këshillit të Ministrave lidhur me marrjen e masave të nevojshme për realizimin efektiv, brenda afateve të arsyeshme, të të drejtave për shtresën e ish të dënuarve/përndjekurve politikë, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së kësaj kategorie, ende nuk ka marrë përgjigje.

Pavarësisht se kanë kaluar tashmë mbi 33 vite nga rënia e sistemit komunist, të drejtat e ish të përndjekurve nuk janë vënë në vend. Kështu, shoqëria jonë nëse nuk do të përballlet me të kaluarën dhe të dëmshpërblejë plotësisht këta njerëz për dëmet e shkaktuara gjatë asaj periudhe, nuk do të jetë e aftë të ndërtojë një të ardhme të qëndrueshme. Në vendin tonë duhet të vazhdojë trajtimi i të kaluarës me objektivitet, transparencë dhe drejtësi, për rehabilitimin, integrimin dhe dëmshpërblimin e plotë të shtresës së të përndjekurve politikë. Vetë përvoja botërore na mëson se nëse harrohen tragjeditë, e së kaluarës, janë të destinuara të rikthehen në një formë apo në një mënyrë tjetër.

Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, përcakton Ministrinë e Financave autoritetin përgjegjës për shpërndarjen e dëmshpërblimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në mënyrë proporcionale në tetë këste të barabarta, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit. Në mënyrë të përsëritur në rekomandimet tona dhe raportet vjetore kemi evidentuar se përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin e shtetit për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohë optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme. Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar shpeshherë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësisht të detyrimit të shoqërisë shqiptare për finalizimin e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit dhe trashëgimtarët e tyre. Masat për dëmshpërblimin material përbëjnë veprime të cilat shpesh nuk kuptohen në mënyrë të qartë.

---

<sup>127</sup>Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimet përkatëse.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Ministrise%20se%20Financave%20A.G.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Ministrise%20se%20Financave%20D.P.pdf>



Gjykojmë se mospërcaktimi i një afati apo date të saktë se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit dhe nga ana tjetër zvarritja ndër vite, për një periudhë të pacaktuar e rehabilitimit të tyre, është në dëm të të gjitha palëve dhe të një shoqërie demokratike. Kjo e fundit duhet të realizojë efektivisht të drejtat e qytetarëve dhe jo të mjaftohet vetëm me deklarin e tyre në akte ligjore ose nënligjore të cilat mbeten të pazbatuara në praktikë.

---

### 3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative<sup>128</sup>

---

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2023, ka trajtuar 18 ankesa, nga të cilat 8 ndaj Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror, 6 ndaj Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Privat dhe 4 ndaj organeve/institucioneve debitore, në të cilat subjektet gjyqfitues/kreditor kanë pretenduar cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara me ligj për zbatimin e tyre.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, akteve noteriale që përmbajnë detyrim në të holla si dhe akteve administrative të konsideruara tituj ekzekutiv si pjesë përbërëse e procesit të gjykimit mbart pothuaj të njëjtat problematika, sikurse pasqyruar edhe në raportet e viteve të kaluara të Avokatit të Popullit. Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave shqiptare apo Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbetet një çështje me rëndësi thelbësore për shtetin shqiptar, pasi lidhet me forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë. Tejzgjatja e ekzekutimit, “*vënia në diskutim*” e drejtësisë së dhënë nga gjykata, ndikon në radhë të parë në humbjen e besimit ndaj shtetit.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2023, me objekt detyrimin e organeve të administratës publike të paguajnë shuma në të holla, Avokati i Popullit gjykon, se shkak i mosekzekutimit të titujve ekzekutivë, i cili ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, vazhdon të jete problematika që mbart Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave.<sup>129</sup> Për përmirësimin e kësaj shtate, sic kemi raportuar edhe më parë, Avokati i Popullit i dërgoi një rekomandim Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por që *nuk u pranua* nga institucionet përkatëse. Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për adresimin e kësaj problematike.

Objektivi i moslejimit të borxheve të reja edhe pse është përcaktuar si objektivi i qeverisë,<sup>130</sup> rezulton se nuk është arritur. Organet apo institucionet debitore, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”,<sup>131</sup> apo në Udhëzimin nr.1,

---

<sup>128</sup> Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

<sup>129</sup> “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogaritë e thesarit”.

<sup>130</sup> VKM nr.50, datë 05.02.2014, “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt*”.

<sup>131</sup>Neni 62.

datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas të cilit përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryejë auditimin e të gjithë procesit, i cili ka sjellë dëmin ekonomik si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile kundër personave që kanë shkaktuar dëmin.

Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura përbën cënim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë. Cënimi i parimit për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosëkzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë në një afat të arsyeshëm në vlerësimin e Avokatit të Popullit vjen si pasojë e një sërë shkaqeve, të tilla si:

- shfaqja e mungesave të cilësive dhe njohurive profesionale nga ana e përmbaruesve gjyqësorë të veçantë gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me nxjerrjen e akteve jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo situatë në raste të caktuara, rrjedh edhe nga paqartësitë e dispozitivit të titullit ekzekutiv;
- mungesa e vullnetit prej autoritetit të administratës publike për përmbushjen e detyrimit të vendosur në dispozitivin e vendimit gjyqësor apo në ligj, kjo dhe në kushtet e pasjes së gjendjes në të holla;
- kryerja e veprimeve përmbarimore jashtë objektit të ekzekutimit apo të parashikuara në ligj si dhe keqinterpretim i dispozitivit të vendimit gjyqësor civil apo administrative;
- hezitimi i pajustificueshëm nga ana e përmbaruesve gjyqësorë për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit debitor, personave të tjerë të cilët refuzojnë ose kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose veprojnë në të kundërtën e asaj që janë të detyruar me vendim të gjykatës;
- moskryerja e veprimeve të duhura prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, që mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla që institucioni shtetëror detyrohet të paguajë sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- mosnxjerrja e aktit të përbashkët midis Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme për përcaktimin e rregullave të hollësishme, lidhur me kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësor privatë nga Policia e Shtetit;
- mosçaktimi i “minimumit jetik”, ka bërë që parashikimi i vendosur në nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile të jetë i pazbatueshëm prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Po kështu, kërkimi nga përmbaruesit gjyqësorë pranë gjykatës për çaktimin e “pagës së paprekshme”,<sup>132</sup> në rastet e vendosjes së masës së sekuestrës mbi pagën e debitorit, përbën një procedurë që vështirëson procesin e ekzekutimit të detyrimeve;
- mosrespektimi i detyrimit, sikurse parashikuar në nenin 523 të K.Pr.Civile, prej Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, apo inspektoriatet vendore, për bashkëpunim me Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor në rastet e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv me objekt “Prishje objekti/ndërtimi.” ;
- referuar kohëzgjatjes ligjore për ekzekutimin e titujve ekzekutiv në “afat të arsyeshëm” sikurse parashikuar në nenin 399/1 e vijues të K.Pr.C., konstatohet se janë mijëra dosje përmbarimore në tejkallim të “afatit të arsyeshëm.”

Çështjet e ngritura në Raportin Vjetor të vitit 2022, lidhur me veprimtarinë e autoriteteve për ekzekutimin e vendimeve të dhëna prej GjEDNj-së kundër Shtetit Shqiptar, nuk kanë gjetur rrugën e zgjidhjes. Problematikat mbeten të njëjta dhe vazhdojnë të lidhen me faktin se:

---

<sup>132</sup> Parashikuar në nenin 122 dhe 123 të Kodit të Punës.

- mungesa e theksuar e informimit të publikut dhe mediave prej Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, lidhur me ekzekutimin e vendimeve të dhëna kundër Shtetit Shqiptar nga GJEDNJ-ja<sup>133</sup>;
  - nuk konstatohet publikimi në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit apo të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i raporteve vjetore të paraqitura para Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim;
  - procedura e ekzekutimit për një numër vendimesh të dhëna prej GjEDNJ-së nuk është përfunduar në afat të arsyeshëm apo afatin e parashikuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar;
  - ndaj strukturave përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve në asnjë rast nuk konstatohet fillimi i ecurisë disiplinore me rastin e mosmarrjes së masave për zbatimin e vendimeve të dhëna prej GjEDNJ-së në vite;
  - nuk ka ndodhur kryerja me prërparësi e veprimeve për ekzekutimin e vendimeve me objekt, detyrim për pagim të hollash deri 10.000 Euro, në kushtet e ekzistencës së vendimarrjeve më të hershme për të cilat detyrimi është mbi 10.000 Euro;
  - moszhvillimi i auditimit si fazë paraprake në kuadrin e zbatimit të vendimit gjyqësor me qëllim përcaktimin e personit përgjegjës i cili ka shkaktuar dëmin objekt ekzekutimit;
  - ndaj personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit nuk konstatohet zhvillimi i procedurës së posaçme nga ana e organit/institucionit debitor për shpërblimin e dëmit nga ana e tij;
  - parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor konstatohet i shkelur edhe në rastet e zbatimit të vendimeve përfundimtare të GjEDNJ-së prej strukturave përgjegjëse, ashtu sikurse ka ndodhur rëndom në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vendase;
  - masat e përgjithshme parandaluese në lidhje me ndryshimet e legjislacionit apo praktikave për shmangien e dëmeve financiare si rezultat i shkeljes së Konventës nuk rezultojnë efektive;
  - legjislacioni për ekzekutimin e vendimeve të GjEDNJ-së në Shqipëri nuk parashikon masa/veprime për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve apo vendosje sanksionesh ndaj subjekteve pengues në procesin e ekzekutimit;
  - parashikimi i Avokaturës së Shtetit si organ kompetent për nisjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GjEDNJ-së, në kushtet kur ky organ është ngarkuar me detyrimin e:
    - përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurore të Shtetit Shqiptar pranë GjEDNJ-së;
    - koordinimit të procesit të ekzekutimit, hartimit të planeve të veprimit dhe të raporteve;
    - përfaqësimit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave;
    - monitorimit të procesit të ekzekutimit të vendimeve të GjEDNJ-së nga autoritetet kombëtare,
- është zgjidhje ligjore jo oportune, joeficiente dhe në konflikt interesi.

Për rastet e trajtuara gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit u adresoi organeve të administratës publike 2 (dy) rekomendime<sup>134</sup>, në të cilat janë parashtuar për zgjidhje 6 (gjashtë) çështje të ndryshme, pranimi dhe zbatimi i të cilave mundëson rivendosjen në vend të së drejtës të subjekteve ankuese.

<sup>133</sup> Parashikuar në nenin 19/8, pika “d” e ligjit nr.10018/2008, i ndryshuar. Gjithashtu, Këshillit i ka mbaruar mandati dhe ky është një problem që duhet të adresohet.

<sup>134</sup> Këto rekomandime gjenden në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Anton%20Vasili%20DREK.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Durim%20Grabova%20DREK.pdf>

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme, ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar në rrugë gjyqësore, pala debitore duhet të marrë pjesë aktivisht në ekzekutimin e detyrimeve.

Avokati i Popullit vlerëson thelbësore të tërheqë edhe një herë vemendjen në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare e cila në vendimmarrjet e saj ka pranuar, se: “... *parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj*”.

Më tej, theksohet se “...*ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre*”.

---

### 3.10 Respektimi i të drejtës së pronës<sup>135</sup>

---

Institucioni i Avokatit të Popullit, vazhdon t’i kushtojë një kujdes të veçantë respektimit të të drejtës së pronës, jo vetëm si një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në një shtet demokratik, por edhe për vetë kohëzgjatjen e problematikave që vazhdon të paraqesë kjo fushë. Mosrespektimi dhe mbrojtja e kësaj të drejte ka qenë në fokus të një numri të konsiderueshëm ankesash (158 ankesa/raste), të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, edhe gjatë vitit 2023, gjë që vazhdon të jetë fenomen shqetësues për shoqërinë Shqiptare.

Objekti i ankesave të administruara vazhdon të jetë i orientuar kryesisht ndaj Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), organeve të pushtetit vendor (si psh: Inspektoriatet e Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive apo IKMT-së).

Veprimtaria e Drejtorive Vendore të Agjencive Shtetërore të Kadastrës, e cila duhet të ishte në harmoni të plote me legjislacionin kombëtar dhe Ndërkombëtar<sup>136</sup>, është kundërshtuar prej individëve të ndryshëm ankues, përgjatë vitit 2023, lidhur me:

---

<sup>135</sup> Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

<sup>136</sup> Nenet 41 dhe 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të Protokollit nr.1 dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e procesve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- mosrespektimin e afateve ligjore në trajtimin e kërkesave/aplikimeve të individëve, duke vonuar në kohë, apo edhe mosdhënien fare të shërbimeve të parapaguara nga qytetarët;
- mbajtjen e tarifës së shërbimit prej Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në kushtet e adresimit të gabuar të kërimit të shërbimit apo mosdhënies së tij prej drejtorive vendore;
- kufizimin e të drejtës së kërimit të shërbimeve pranë DVASHK-ve vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet platformës e-Albania;
- mosdhënien e ndihmës aktive, mbi mënyrën e kërimit të shërbimit nga individ;
- detyrimin/kushtëzimin e individit të kryejë aplikime me tarifë zero lekë (av0), për vijimin e trajtimit të kërkesës/aplikimit, në kushtet e vonesave në dhënien e shërbimit prej DVASHK-ve;
- mospërfundimin e regjistrimit të titujve të pronësisë, kryesisht AMTP-ve për tokat bujqësore të dhëna në pronësi apo përdorim;
- mosnxjerrjen e akteve të pronësisë për pasuritë që nuk zotërojnë një titull pronësie, apo “oborret në përdorim”;
- mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve, kryer prej subjekteve ndërtues/posedues të ndërtimeve informale, që prej viteve 2005-2006 e në vijim;
- mosushtrimin e detyrimit prej DVASHK-ve kryesisht apo dhe mbi bazë kërkese, për saktësimin/korrigjimin e të dhënave kadastrale të pasurive, lidhur me sipërfaqen e pasurisë, kufijtë dhe pozicionin e saj në terren;
- mosrespektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të subjekteve që i drejtohen DVASHK-ve për marrjen e shërbimeve të ndryshme kadastrale;
- moslëshimin në mënyrë të rregullt e në përputhje me aktet nënligjore të dokumentacionit të pronësisë subjekteve pronarë.

Të tjera çështje që lidhen me mosrespektimin prej DVASHK-ve, të detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacion, vazhdojnë të mbeten:

- mosbërja publike, pa kërkesë, e informacionit bazik mbi hartën kadastrale, adresën e pronës, emrin e pronarit, vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave, gjykatave ose të dhënave mbi funksionimin e tregut të pasurive;
- pamundësia e regjistrimit në platformën e-Albania e subjekteve pronarë me shtetësi jo shqiptare;
- zvarritje e tejskajshme pa shkak e procedurës administrative prej drejtorive vendore të ASHK-së në kthimin e përgjigjes Avokatit të Popullit për kërkesat apo rekomandimet e dërguara prej tij;
- mosushtrimi i veprimtarisë prej DVASHK-ve herë pas here për shkak të rënies së sistemit elektronik në dhënien e shërbimit;
- mosofrimi në këtë situatë i shërbimeve për individët kërkuar në formë alternative<sup>137</sup>;
- mosmbajtje qëndrimi prej ASHK-së si dhe mosushtrim kompetence për vendosjen e sanksionit ndaj punonjësve të drejtorive vendore, në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 64, të ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”;
- pamundësia e komunikimit drejtëpërdrejt me nëpunësit e drejtorive vendore të DVASHK-ve;
- mospërmbushja dhe mosushtrimi i detyrave ligjore në mënyrë efikase, ekonomike, të drejtë dhe të përshtatshme, si dhe sa më shpejt të jetë e mundur;
- përmbyllja e sigurisë ligjore dhe qartësia e titujve të pronësisë nuk është arritur ende plotësisht, pavarësisht nga vazhdimi i përpjekjeve për arritjen e tyre;

<sup>137</sup> Sikurse parashikohet në nenin 10/2 të K.Pr.Administrative.

- copëzimi, fragmentarizimi ligjor, zbrazëtitë në sistemin e regjistrimit dhe zbatimi i tij në këtë fushë vazhdojnë të mbeten si problematika.

Avokati i Popullit thekson se e drejta e pronës duhet të mbrohet e garantohet jo vetëm në tekstet e ligjeve dhe akteve nënligjore, por duhet të jetë në themel të punës së institucioneve të administratës shtetërore që janë ngarkuar me garantimin e zbatimit efektiv të kësaj të drejte. Pra, zbatimi i kërkesave të shtetit të së drejtës, duke siguruar procedura ligjore që garantojnë zbatimin e paanshëm dhe uniform të ligjit, pjesëmarrjen e personave të interesuar, transparencën e proceseve vendimmarrëse dhe lufta ndaj tendencave të korrupsionit, duhet të jenë objektiva parësore të veprimtarisë së këtyre organeve të administratës shtetërore.

Mospërbushja dhe mosushtrimi i detyrave ligjore në mënyrë efikase, të drejtë, të përshtatshme si dhe në afatet ligjore, janë situata të konstatuara në veprimtarinë administrative të disa organeve publike. Konstatimi i situatave të tilla, tregon se realizimi efektiv i funksioneve publike administrative nuk ka ndodhur. Krijimi i një institucioni të vetëm, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllimin e centralizimit të të gjithë veprimtarisë së institucioneve të mëparshme<sup>138</sup>, u realizua formalisht por pa një qasje të qartë në mënyrën e zgjidhjes së problematikës, që këto institucione kishin patur kur kishin funksionuar në mënyrë të pavarur. Një adresim i tillë në formalizimin e këtij institucioni, nuk ka dhënë ende efektivitetin e pritshëm në veprimtarinë e përbushjes së detyrave ndaj subjekteve/individëve. Kjo pasi vazhdon të ketë fragmentarizim të veprimtarisë, si dhe shmangie nga funksioni më i rëndësishëm i tyre administrativ, përgjigjia në kohë dhe zgjidhja e problematikave të konstatuara në çështjet e pronave.

Kështu psh, në lidhje me regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të 26.000 vendimeve të dhëna në vite prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës, të njohjes së pronës me të drejtë kompesimi<sup>139</sup>, çështja vazhdon të mbetet e papërfunduar. Mospërfundimi i procesit të kompesimit të pronave të njohura subjekteve me të drejtë kompesimi me një nga format e parashikuara në ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, mbetet çështje mjaft e mprehtë, pasi subjektet që e kanë përfituar në pronësi<sup>140</sup>, kanë disponuar dhe disponojnë mbi pronat e ish pronarëve, në kushtet kur procesi i kompensimit ende nuk ka përfunduar.

Për sa i takon trajtimin të ankesave për Agjencinë e Trajtimit të Pronave në përputhje me ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, konstatohet se procesi i kompensimit financiar vazhdon të jetë mjaft i ngadaltë. Ky proces nuk është realizuar në të tërë elementët e tij dhe mbi të gjitha subjektet e kompensuara nuk arrijnë të marrin kompensimin financiar. Referuar parashikimit të nenit 16, pika 6 të ligjit të sipërcituar, afati i kryerjes së pagesës për të gjitha vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompesimit duhet të përfundojë brenda 10 viteve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit<sup>141</sup>. Numri i vendimeve për të cilat është kryer pagesa e kompesimit për periudhën 2018-2022 është gjithsej 398. Ky numër, sikurse konstatohet është tepër i ulët referuar numrit të përgjithshëm të vendimeve të vlerësuara, si dhe afatit ligjor prej 10 vitesh të vendosur për pagesën apo

<sup>138</sup> Ish-ZVRPP-të, ish-AITPPP-të dhe ish-ALUIZNI.

<sup>139</sup> Detyrim ky i parashikuar si në nenet 193/h dhe 196 të Kodit Civil, ashtu edhe në nenin 24 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

<sup>140</sup> Kryesisht sipas ligjit 7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar, apo edhe ligje të tjera të veçanta.

<sup>141</sup> Ndërkohë referuar të dhënave të ATP-së, numri i vendimeve në total të vlerësuara për kompesim është 18735, në një vlerë të përgjithshme prej 101.134.108.990 lekë.

kompesimin në natyrë të tyre. Vijimi i kompesimit me këtë ritëm, nuk pritet të sjellë përfundimin e procesit brenda afatit ligjor të parashikuar<sup>142</sup>.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve, të inicuar kryesisht, apo të regjistruara mbi bazë ankese të subjekteve, që lidhen me respektimin e së drejtës të pronës në procesin e shpronësimit të saj, vazhdojnë të konstatohen problematika. Kjo sepse gjatë shpronësimeve për interes publik të pronës private, konstatohet se organet e administratës shtetërore sillen në mënyrë arbitare me titullarët e së drejtës së pronës/pronarët, pasi poseduesit zhvishen nga e drejta e pronësisë dhe nuk dëmshperblehen/kompensohen paraprakisht, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe brenda afateve ligjore. Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet i qëndrimit se shteti, nëpërmjet organeve të administratës shtetërore, duhet të kujdeset për interesat pronësore të qytetarëve, në rast shpronësimi, duke pasur në konsideratë procesin e rregullt ligjor dhe nevojat social-ekonomike të tyre. Ky është rasti kur ndonëse ka pasur edhe vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)<sup>143</sup> në lidhje me praktikën e shpronësimit nuk ka pasur masa me karakter të përgjithshëm që të adresojnë shkeljet strukturore të të drejtave të njeriut në rastet e punëve publike.

Nga ankesat e depozituara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet se shpërblimi njihet vetëm për ata individë të cilët e kanë regjistruar pasurinë. Në rastin e iniciuar kryesisht prej institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me shqetësimin e banorëve të fshatit Fushë-Prezë, Bërxullë, Tiranë, për heqjen nga posedimi të pasurive të paluajtshme me rastin e zbatimit të projektit publik për ndërtimin e segmentit rrugor Thumanë-Vorë-Kashar, u konstatua se procedura e shpronësimit të subjekteve pronarë, nuk kishte nisur, ndërkohë që veprimtaria për ndërtimin e segmentit rrugor, kishte nisur kohë më parë. Në lidhje me këto raste, përsërisim se shpronësimi për interes publik i pronës private, duhet të trajtohet me kujdesin e duhur dhe të jetë në vëmendjen e institucioneve shtetërore, duke respektuar të drejtën e pronësisë sikurse garantuar nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore<sup>144</sup>.

Në vijim edhe të gjetjeve të paraqitura në raportin përfundimtar të institucionit të Avokatit të Popullit në Kuvend për vitin 2022, për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, vërehet se situata e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të bëra në vite prej subjekteve ndërtues/posedues të ndërtimeve informale, vazhdon të mbetet problematike. Vlerësojmë se zgjatja e këtyre procedurave, për më tepër pa përcaktuar një afat fundor, cënon *parimin e sigurisë juridike*. Pra besueshmëria e qytetarëve tek shteti, jo vetëm për pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe për garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, do u jepte atyre sigurinë juridike, se janë subjekte të veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore u garantojnë atyre të drejtat dhe liritë themelore.

---

<sup>142</sup> Në përputhje me ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, afati i përfundimit të procesit konsiderohet viti 2025.

<sup>143</sup> Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë.

<sup>144</sup> Institucionet shtetërore gjatë procedurave të shpronësimit duhet të kenë parasysh edhe vendimmarrjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me objekt shqyrtimin e çështjeve që lidhen me problematikat e procesit të kompensimit, pasi kjo Gjykatë ka bërë të qartë se e drejta për strehim përfshin edhe rastin e godinave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, ose që ju mungon dokumenti i pronësisë. Mosrespektimi i këtyre parimeve, ndër vite ka rënduar buxhetin e shtetit dhe për pasojë atë të taksapaguesve shqiptar.

Një problematikë tjetër e konstatuar në veprimtarinë e ASHK-së, është edhe ajo që lidhet me kuptimin dhe zgjatjen e efekteve juridike të aktit administrativ “Urdhër për vënie kufizimi”, që nxirret rast pas rasti nga titullarët përkatës të drejtorive vendore të ASHK-së, përtej përmbajtjes dhe përcaktimit ligjor konkret. Ky lloj kufizimi/ndalimi i veprimeve kadastrale mbi një pasuri të regjistruar në DVASHK, i vendosur nga ana e titullarit të autorizuar nga ligji, ka tre karakteristika kryesore:

*Së pari, kufizimi kryhet me nxjerrjen e një akti administrativ që pasi hyn në fuqi, ndalon veprimet në çdo kartelë, hartë apo zonë kadastrale, nga ana e punonjësve të ASHK-së, për pasurinë përkatëse.*

*Së dyti, kufizimi është i përkohshëm dhe si i tillë ka fuqi dhe zbatohet për një kohë taksativisht të përcaktuar nga ligji. Pas këtij afati ligjor, akti administrativ i kufizimit humbet fuqinë dhe nuk sjell më pasoja juridike.*

*Së treti, afati i vlefshmërisë së aktit administrativ të kufizimit i përcaktuar në ligj, shërben si një mjet ndihmës ligjor për organin publik kur ky i fundit gjatë zhvillimit të një procedure administrative dhe në ushtrim të diskrecionit të tij vlerëson se, masa e ndalimit të veprimeve kadastrale është e nevojshme, për mbrojtjen e interesit publik gjatë kryerjes së kësaj procedure administrative. Ky afat shërben edhe si një garanci dhe mjet ndihmës për palët drejtëpërdrejtë të interesuara në procedurën administrative, pasi u jep kohë reflektimi dhe adresimi të çështjes objekt shqyrtimi në rrugë administrative, në të gjitha instancat dhe rrugët e mundshme ligjore për zgjidhjen e saj. Në kuptim të nenit 67 të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ me të cilin vendosen kufizimet e përkohshme, sipas rastit nga Drejtori i Përgjithshëm, apo nga drejtuesi i drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përbën një vendim të ndërmjetëm të nxjerrë gjatë zhvillimit të një procedure administrative<sup>145</sup>.*

Legjislacioni në fuqi ka përcaktuar se, urdhri i ndalimit të veprimeve kadastrale, pas mbarimit të afatit ligjor 30 ditor gjatë të cilit ai ka fuqi juridike, mund të vazhdojë të ketë fuqi dhe të sjellë pasoja pas këtij afati, nëse është vendosur sigurimi i padisë nga gjykata. Pavarësisht këtij përcaktimi ligjor është vërejtur në disa raste se, justifikimi i dhënë nga drejtori të caktuara vendore të ASHK-së, për moskryerjen e veprimeve kadastrale të kërkuara, për pasuri të regjistruara tashmë, është nxjerrja e urdhërave të ndalimit të veprimeve kadastrale, megjithëse ka rezultuar se këto akte administrative nuk kanë patur më fuqi juridike dhe ndërkohë që nuk është vendosur ndonjë masë sigurimi padie nga gjykata për këto raste. Po ashtu qytetarët nuk njoftohen në lidhje me këto vendime duke shkelur rëndë parimet e procedurës

<sup>145</sup> Në këtë dispozitë përcaktohet shprehimisht se:

*“1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.*

*2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.*

*3. Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i arsyetuar, me afat të përcaktuar dhe u njoftohet palëve”.*

Në linjë logjike me dispozitën e lartpërmendur, neni 68, i Kodit të Procedurave Administrative, përcakton në vazhdim se:

*“1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme:*

*a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar;*

*b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm;*

*c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj.*

*2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak i parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi”.*



administrative. Avokati i Popullit vlerëson se kjo situatë ka nevojë urgjente për ndryshim në ligj dhe qasje.

### ***Procesi kalimtar i legalizimit të ndërtimeve pa leje***

Legjislacioni normues për procesin e legalizimit ka pësuar ndryshime të shpeshta ndër vite dhe tashmë konstatohet se, legalizimi është kthyer në një titull pronësie preferencial që ofron mundësi më të lehta të përfitimit të pronës (objekt dhe truall), se sa titujt e tjerë klasikë të përfitimit të pronës në Shqipëri, apo edhe se sa fitimi i pronësisë përmes procesit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish pronarëve, të kontratave të privatizimeve, apo të fitimit të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, procesi i legalizimit është përcaktuar si një proces kalimtar administrativo-ligjor. Organi përgjegjës shtetëror, i ngarkuar me zhvillimin e këtij procesi është Agjensia Shtetërore e Kadastrës. Ky ligj ka parashikuar shtyrjen e afatit të legalizimit, duke përfshirë tanimë në proces edhe objekte të ndërtuara pas datës 27.06.2014, në ndryshim të afatit fundor të ndërtimit të përcaktuar në ligjin nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Zgjatja e afatit kohor fundor të ndërtimeve pa leje që përfshihen në proces legalizimi, në fakt rezulton problematike në kuptim të respektimit dhe mbrojtjes të së drejtës së pronës të ish pronarëve dhe shfaqet si një element cënues i sigurisë juridike, lidhur me respektimin dhe mbrojtjen efektive të kësaj të drejte. Megjithëse, i filluar që në vitin 2004, procesi i legalizimit pas pothuaj 19 vitesh, nuk ka përfunduar dhe gjasat janë që të vazhdojë për një kohë të gjatë. Një nga shkaqet që kanë ndikuar në këtë kohëzgjatje lidhet jo vetëm me faktin e ndryshimeve të shumta në legjislacion por dhe se përmbajtja e bazës ligjore që ka trajtuar procesin e legalizimit ka qënë e mangët dhe si e tillë ka shërbyer si premisë për cënimin e procesit të rregullt ligjor, në shqyrtimin e vetëdeklarimeve për legalizim, rast pas rasti.

Në këtë kuptim, një nga shkaqet e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në përmbylljen e procesit të legalizimit rast pas rasti dhe në tërësi, është mospërfundimi i procesit administrativ të shqyrtimit të vetëdeklarimeve në afatin ligjor<sup>146</sup>. Meqënëse ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar), nuk ka patur të përcaktuar afat kohor për përfundimin e procedurës administrative të nisur me vetëdeklarimin për legalizim të kryer prej secilit individ, afati procedural ligjor i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative duhej të shërbente si afati ligjor, brenda të cilit do të duhej të përfundonte procedura administrative prej ish ALUIZNI-t, me daljen me një vendim përfundimtar për legalizimin e ndërtimit informal të vetëdeklaruar, ose përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit.

Në ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, gjenden afate të qarta lidhur me këtë proces, por barra e mbartur e aplikimeve të mëparshme, ende të patrajtuara për legalizim, vështirëson përmbylljen e këtij procesi kalimtar dhe në fakt çon në mosrespektimin e këtyre afateve procedurale. Përpos disa faktorëve të tjerë që kanë ndikuar negativisht në ecurinë e procesit të legalizimit, problematika kryesore e këtij procesi lidhet me faktin se ka munguar trajtimi dhe analizimi i shkaqeve dhe faktorëve që çojnë qytetarët,

---

<sup>146</sup> Të parashikuar, në nenin 49, të ligjit nr. 8454, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. (Shfuqizuar me ligjin nr. 44/2015)

apo edhe subjektet e tjera në ngritjen e objekteve pa leje ndërtimi apo në shkelje të lejes së ndërtimit, qofshin këto me destinacion banimi apo destinacione të tjera përdorimi.

### ***Legalizimi “versus” ndëshkimi i subjektit të ndërtimit pa leje***

Sikundër legjislatori ka normuar procese që lidhen me legalizimin e ndërtimeve pa leje, në të njëjtën kohë ka miratuar bazën ligjore për ndëshkimin e individëve, apo subjekteve të cilët ngrejne ndërtime në kundërshtim me dispozitat rregullatore ligjore në fuqi. Megjithatë, edhe në këtë këndvështrim vërehet një lloj paqartësie dhe përplasje mes akteve normuese të këtyre proceseve ligjore, të ndryshëm nga njëri - tjetri. Duke identifikuar rëndësinë që ka respektimi i legjislacionit në fushën e zhvillimit të territorit dhe rrjedhimisht edhe të mbrojtjes dhe respektimit të pronës publike dhe asaj private, si dhe të drejtave të tjera reale që rrjedhin prej saj, legjislatori ka parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, veprat penale që cënojnë regjimin juridik të tokës dhe ndërtimeve<sup>147</sup>.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje është mbështetur me bazë ligjore që në vitin 2004, ndërkohë që, legjislacioni rregullator në këtë fushë, ka pësuar ndryshime të shpeshta. Nga ana tjetër ngritja e ndërtimit pa leje, sikurse parashikohet në Kodin Penal, përbën vepër penale dhe rrezikshmëria shoqërore që ajo paraqet është paraprirë dhe që prej vitit 2008, bashkëshoqërohet nga elementët penale të shpërdorimit të tokës në kundërshtim me destinacionin e saj, si dhe të pushtimit të tokës. Megjithatë, në mënyrë alogjike, që prej vitit 2004 kemi në fuqi bazën ligjore që normon procesin e legalizimeve për ndërtimet e kryera pa leje, të kundërligjshme, i cili në zbatimin e tij rast pas rasti, jo vetëm legalizon ndërtimet pa leje dhe i kthen ato në pronë të ligjshme, private, por nga ana tjetër “*amniston*” shkelësit e ligjit që kanë ngritur këto ndërtime, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Penal<sup>148</sup>.

Pavarësisht se ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, i jep kompetenca të rëndësishme Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Njësitë Vendore, procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje ka ndërhyrë si një proces frenues në ndëshkimin e paligjshmërisë, në fushën e zhvillimit të territorit. Prosesi i legalizimit, veçanërisht me realizimin e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore tek poseduesit e ndërtimeve pa leje, ndërthuret dhe ndikon në procese të tjera të rëndësishme ligjore që lidhen me respektimin dhe mbrojtjen e së drejtës së pronës publike dhe asaj private. Të tilla procese janë ai i ndarjes së tokës bujqësore, apo edhe procesi i kthimit (kompensimit fizik) dhe kompensimit të pronës ish pronarëve të vjetër. Këto procese ligjore që kanë si kryefjalë të drejtën e pronës, të ndarë nga njëri-tjetri por paralele në trajtim kanë treguar deri më tani se nuk gjejnë harmonizim dhe shpesh krijojnë përplasje, fakt që ka ndikuar në ecurinë dhe mospërfundimin e tyre. Aktualisht konstatohet se:

- ende nuk ka përfunduar procesi i ndarjes së tokës bujqësore tek subjektet të cilit duhet të përfitonin sipas ligjit;
- ende nuk ka përfunduar procesi i kthimit (kompensimit fizik) dhe kompensimit të pronës ish pronarëve të vjetër;

<sup>147</sup> Në varësi të kohës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore në Kodin Penal, subjektet që kanë konsumuar veprën penale që cënon regjimin juridik të tokës dhe ndërtimeve, dënohen me gjobë ose me heqje lirie.

<sup>148</sup> Kësaj “përplasjeje normuese”, në dispozitat ligjore në fuqi i shtohet edhe fakti tjetër se, organet publike të ngarkuara nga ligji me kompetenca kontrolli apo monitorimi në fushën e zhvillimit të territorit, nuk kanë treguar efektivitet në ushtrimin e funksioneve të veta, shtuar këtu paqartësinë dhe mungesën e stabilitetit dhe koherencës ligjore, të legjislacionit rregullator specifik, në fuqi.

- ende nuk ka përfunduar procesi i legalizimit dhe rrjedhimisht i kalimit të parcelave ndërtimore në pronësi të poseduesve, të ndërtimeve pa leje.

Legjislacioni rregullator i këtyre proceseve ligjore, (procesi i ndarjes së tokës bujqësore, procesi i kthimit /kompensimit fizik dhe kompensimit të pronës ish pronarëve të vjetër, si dhe procesi i legalizimit) nuk ka arritur të ruajë në thelb, njëtrajtësinë e trajtimit të konceptit të së drejtës së pronës dhe mbrojtjes së pronësisë, nga njëri proces tek tjetri, duke krijuar kështu edhe mungesën e stabilitetit ligjor për këtë të drejtë themelore. Ashtu siç është theksuar edhe më parë, të gjitha problematikat që u përmendën më sipër në lidhje me DVASHK-të, sjellin në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontraktor, që mund t’u jetë shkaktuar shtetasve nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar t’u bënë me dije DVASHK-ve të ndryshme<sup>149</sup> se mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve brenda afatit ligjor dhe/ose atij të arsyeshëm, në vartësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e procedurës administrative. Kjo pasi të drejtat e shtetasve për të trajtuar çështjet e tyre brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, duke i ndihmuar ata në mënyrë aktive, apo edhe e drejta e tyre për t’u informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore (veçanërisht në rastet kur ata janë pjesëmarrës në procedura administrative), janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative<sup>150</sup>, por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>151</sup>. Fakti që shtetasit, për shkaqe të pavarura nga ata, nuk arrijnë të marrin një vendim përfundimtar në një procedurë administrative (përfshi edhe vendimin “negativ”), në një kohë që kanë respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, bën që ata të mos arrijnë të gëzojnë nga pronat që posedojnë, të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi.

### ***Veprimtaria e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit***

Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit (IMT), në njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë si objekt kryesor të veprimtarisë së tyre respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore të territorit, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Gjatë vitit 2023, janë paraqitur 16 ankesa ndaj veprimtarisë së IKMT-së dhe IMT-ve, në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kanë përfunduar shqyrtimin i 4 prej këtyre ankesave dhe pjesa tjetër është ende në shqyrtim. Objekti i ankesave lidhet me mosveprimin nga ana e këtyre organeve publike për fillimin e procedurës së konstatimit dhe sanksionimit të ndërtimeve të kundërligjshme, mosveprimi në rastet e kërkesave që lidhen me respektimin e projektit të miratuar mbi bazën e të cilit është nxjerrë leja e ndërtimit, për objekte në ndërtim e sipër, si dhe pretendime të ngritura nga ankuesit për shkeljen e procedurave ligjore gjatë procesit të ndërhyrjes, për prishjen e ndërtimeve të cilësuar si të kundërligjshme.

<sup>149</sup> Duke vënë për dajeni edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

<sup>150</sup> Nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.

<sup>151</sup> Avokati i Popullit në kuadër të marrjes së masave për ecurinë e procesit të legalizimit i ka adresuar organeve përkatëse 13 rekomandime.

Për ankesat, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me aktivitetin e IKMT-së apo IMT-ve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë konstatuar disa problematika kryesore, si më poshtë vijon:

- vërehet qëndrim nga ana e IMT-ve të njërive të vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e çështjeve të caktuara në shmangie të detyrimit për ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre;
- konstatohet mungesë transparence në veprimtarinë e këtyre organeve, e referuar shpesh nga ankuesit në ankesat e tyre, por edhe e evidentuar konkretisht gjatë veprimtarisë sonë institucionale;
- konstatohen raste të përsëritura, kur ankuesit janë gjendur para situatës së cënimit të pronës së tyre, nga ndërhyrjet e IKMT-së, apo IMT-ve në bashki, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, mbi vendimmarrjen për ndërhyrjen që do të kryhej, gjë që ka cënuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;
- vërehen shkelje ligjore që çenojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit, ndërkohë që vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë në pronësi ose posedim ndërtime me statuse të ndryshme ligjore;
- megjithëse në disa ankesa është kërkuar informacion i ndërthurur, qoftë nga ana e IMT-ve në bashki, apo qoftë edhe nga ana e IKMT-së, konstatohet se mënyra e raportimit të IMT-ve pranë IKMT-së, për çështje konkrete mbetet problematike, pasi ka vonesa dhe shpesh mungesë informacioni.

Lidhur me rekomandimet e dërguara për çështjet për të cilat ka përfunduar shqyrtimi administrativ dhe të cilat lidhen me veprimtarinë e këtyre organeve publike, sjellim në vëmendje rekomandimin drejtuar IMT-së, në Bashkinë Tiranë<sup>152</sup>, për trajtimin e ankesës së shtetasit A. H. Në përgjigjen e dërguar Avokatit të Popullit është dhënë informacioni<sup>153</sup> se gjatë kontrollit të ushtruar në terren nga inspektorët e këtij organi, nuk është konstatuar situatë ndërtimore në proces, në mënyrë që të veprimeve në bazë të legjislationit në fuqi.

Nisur nga ky qëndrim i IMT-së, në Bashkinë Tiranë, kemi analizuar legjislationin rregullator, të fushës, për të kuptuar bazueshmërinë e konkluzionit të nxjerrë nga ky organ publik në këtë rast. Ligji bazë specifik që përcakton fushën e veprimit dhe kompetencat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njërive vendore, është ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar<sup>154</sup>. I përcaktuar si një nga organet e inspektimit ndërtimor, Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit të njërive vendore, ka si përgjegjësi të tij ligjore ushtrimin e kontrollit të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet mbi bazën e proceseve verifikuese dhe vendimmarrjes sanksionuese, të parashikuara këto shprehimisht në legjislationin në fuqi. Ligji nr.9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, për Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, të njërive vendore, në pikën “d”, të nenit 5, përcakton detyrimin se, gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, ky inspektoriat ndër të tjera “vendos

<sup>152</sup> Shkresa e Avokatit të Popullit nr. K3/A34-9 prot., datë 28.12.2023.

<sup>153</sup> Shkresën e IMT-së, në Bashkinë Tiranë, nr.7875/1 Prot., datë 9.10.2023.

<sup>154</sup> Në nenin 2, të këtij ligji parashikohet se, objekti i tij është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe i përgjegjësisë të tyre.

prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm." Kjo kompetencë bëhet më e qartë nga përkufizimi i dhënë në paragrafin e fundit të këtij neni<sup>155</sup>.

Në vazhdim, në gërmën "c", të pikës 8, të nenit 12, të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, përcaktohet se: "*Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:*

c) të përfshijnë në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve"<sup>156</sup>.

Nga kompetencat që IMT-së të Bashkisë Tiranë i jepen nga ligji del e qartë se ky organ publik bazuar në njoftimin e vet ankuesit por së fundmi edhe të Policisë Bashkiake Tiranë, ka patur kompetencën e plotë të verifikimit në vend të ndërtimeve, apo punimeve të pretenduara nga shtetasi A.H, si të kundërligjshme dhe të kryera nga shtetasi G.Sh. Konkluzioni i nxjerrë nga përgjigjja e dhënë prej IMT-së, në Bashkinë Tiranë, se ky organ publik nuk ka kompetencë ligjore për të ndërhyrë në këtë çështje bazuar në legjislacionin specifik, rregullator, në fuqi dhe nga fakti se nuk janë konstatuar punime ndërtimore në proces, jo vetëm nuk qëndron por në rastin më të mirë do të gjykohej si një interpretim i gabuar i ligjit që ka çuar në mënyrë të përsëritur në mosveprimin e këtij organi publik.

Nisur nga ky qëndrim i IMT-së në Bashkinë Tiranë për këtë çështje, institucioni i Avokatit të Popullit ka sjellë në vëmendje të këtij organi publik se, jo vetëm që legjislacioni në fuqi i jep mundësinë që të verifikojë në terren ligjshmërinë e ndërtimit, apo punimeve ndërtimore tashmë të kryera, por kompetenca e dhënë ligjore shkon edhe më tej, pasi është ky organ publik që shpesh njoftohet, apo i kërkohet që të prishë ndërtime të kundërligjshme, të cilat janë përfshirë paraprakisht në procesin e legalizimit por për të

---

<sup>155</sup> Shprehimisht përcaktohet se: "*Fjala "ndërtim/punim", sipas këtij neni përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen në dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit*".

<sup>156</sup> Ndërkohë, ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, në pikën 20 dhe 21, të nenit 3, si dhe në pikën 1, të nenit 39, përcakton përkatësisht se:

"20. "Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë",

21. "Ndërtim/punim pa leje", janë ato procese dhe/ose projekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e lejes së shfuqizuar",

"1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji".

Në pikat 1-3, të nenit 51, të po këtij ligji, përcaktohet se:

"1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësive, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar".

cilat vendimmarrja nga organi kompetent publik ka qënë refuzuese, pra për moslegalizim. Në këto rrethana, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- ushtrimin nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Tiranë, të përgjegjëseve, të përcaktuara në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin specifik, rregullator, në fuqi, për trajtimin e ankesës së shtetasit A. H. ;
- marrjen e masave për mospërsëritjen e kësaj praktike në të ardhmen, në procedurat administrative që do të ndiqen për trajtimin e çështjeve të tjera, brenda juridiksionit dhe kompetencave të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Tiranë.

*Ky rekomandim nuk është pranuar.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së subjektit “Erjoni” sh.p.k. për prishjen e ndërtimeve pjesë përbërëse e Komplexit Turistik “*Prestige Holiday Resort*”, të ndodhur në Golem, Bashkia Kavajë, është konstatuar se veprimtaria e IKMT-së ka cenuar respektimin e të drejtës themelore për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Për këtë shkak, Avokati i Popullit ka rekomanduar:<sup>157</sup>

- marrjen e masave nga IKMT-ja, për nxjerrjen e përgjegjëseve dhe evidentimin e personave që kanë çuar në shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjektit “Erjoni” sh.p.k., të prekur nga shembja/prishja pa një proces të rregullt ligjor i objekteve në zonën e Golemit, Bashkia Kavajë”.

*Ky rekomandim nuk është pranuar.*

Kemi konstatuar gjithashtu se dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, apo të IMT-së në njësitë vendore, gjatë prishjes së objekteve të ndërtuara me leje, e vendos veprimtarinë e këtyre organeve në kushtet e parashikuara nga ligji nr. 8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.

---

### **3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative<sup>158</sup>**

---

Në objektin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit kanë qënë marrëdhëniet e punës, parë në optikën e largimeve të padrejta nga puna në administratën publike. Gjatë administrimit të praktikave të paraqitura nga ana e qytetarëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit, përgjatë vitit 2023, ka rezultuar se këto ankesa janë paraqitur si nga subjekte të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil ashtu edhe nga ato të cilët nuk e gëzojnë këtë status. Menaxhimi i marrëdhënieve të punës në administratën publike dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative, kanë qënë ndër fushat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të investojë me qëllim garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës, në nivel vendor dhe qendror.

---

<sup>157</sup>Ky rekomandim gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Erjoni%20shpk.pdf>.

<sup>158</sup> Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Rezulton se Avokatit të Popullit, për vitin 2023, ka trajtuar 25 raste që lidhen me marrëdhëniet e punës, raste të depozituara nga vetë punonjësit të cilët janë liruar, transferuar, pezulluar apo kanë marrë masë disiplinore. Nga kqyrja e hetimeve të thelluara administrative dhe adresimit të problematikave respektive të këtyre rasteve rezulton se shumica e tyre janë raste të përfunduara dhe të zgjidhura në favor të punonjësve ndërsa pjesa tjetër vijon ende në proces të hetimit administrativ.

Me qëllim garantimin, ndërtimin, funksionimin dhe qëndrueshmërinë e një administrate publike, respektimi i parimeve bazike si ai i shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritokracisë, transparencës, profesionalizmit dhe paanësinë politike, vlerësohet se është i rëndësishëm si për kategorinë e punonjësve marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës, ashtu dhe për kategorinë e nëpunësive marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas legjislacionit në fushën e shërbimit civil. Gjatë veprimtarisë administrative janë konstatuar përsëri se në disa raste ka patur cënim të respektimit dhe të garantimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative nga organet e administratës publike për shkak të zbatueshmërisë së pamjaftueshme si dhe të mosrespektimit të parimeve dhe procedurave përkatëse ligjore të cilat janë të detyrueshme të ndiqen në këtë kuadër.

Procesi i rregullt ligjor, i garantuar si e drejtë themelore e njeriut zbatohet edhe në procedurat administrative, ndonëse ai nuk është i parashikuar në mënyrë eksplicite në ligjin horizontal për procedurat administrative<sup>159</sup>. Ky parim si një nga parimet më të rëndësishme administrative bëhet akoma më kuptimplotë dhe domethënës, veçanërisht në rastet kur procedura administrative cënon drejtpërdrejtë interesat dhe të drejtat e ligjshme të palës së cënuar, siç është e drejta për punësim, e rrjedhimisht, për mirëqënie shoqërore dhe ekonomike. E drejta për një proces të rregullt në procedurat administrative e sanksionuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, është një parim themelor kushtetues i konfirmuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Përgjatë procesit të shqyrtimit administrativ të kryer është evidentuar fakti se procedurat administrative të ndjekura kanë qenë të paqarta dhe të paplota, duke mos krijuar garanci për respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike.

Në kuadër të planit të hetimit në rastet kur, nga ana e institucioneve të administratës publike të cilat u janë adresuar kërkesat për shpjegime si dhe përcjelljen e dokumentacionit përkatës lidhur me rastet objekt hetimi, nga kthimi i përgjigjeve përkatëse të dërguara nga institucionet, pas analizimit me kujdes të përmbajtjeve të tyre, si edhe të dokumentacionit shoqërues, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës administrative dhe, për pasojë, ka adresuar rast pas rasti problematikat respektive me qëllim mospërsëritjen e tyre në vijimësi. Konstatohet se nga ana e institucioneve përgjegjëse ka mosveprime për të konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik të institucionit. Gjithashtu, në praktikë konstatohet se edhe pse ka një kuadër të plotë ligjor që saksionon procesin e rregullt ligjor, në disa raste ky parim nuk respektohet në ndjekjen e procedurave administrative gjatë ushtrimit të procedurave disiplinore nga ana e organeve të administratës publike.

---

<sup>159</sup> Kodi i Procedurave Administrative.

Në disa raste është konstatuar cënim i elementëve thelbësorë të këtij parimi, siç janë ligjshmëria, transparenca, informimi, proporcionaliteti, drejtësia dhe paanësia, objektiviteti, përdorimi i gjuhës të njohur nga subjekti, e drejta e aksesit dhe përfaqësimit, e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, kontradiktoriteti, koha e arsyeshme, arsyetimi i vendimmarrjes, e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor etj.

Largimi nga puna duke mos respektuar procedurën ligjore, ose edhe në rastet kur ky largim bëhet pa ndonjë shkak të arsyeshëm ligjor, përbëjnë arsye që këta subjekte të kenë propabilitet të lartë për të qenë gjyqfitues në paditë e paraqitura prej tyre në Gjykatë, pranë të cilës ata kundërshtojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë jo të drejtë dhe në shkelje të ligjit si në planin procedural ashtu edhe në atë material. Në këtë kontekst, veprimet ose mosveprimet, jo konform ligjit, nga ana e institucioneve përkatëse, shoqërohen me një faturë me vlerë monetare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Ndër problematikat kryesore të evidentuara nga ankesat e depozituara apo nga rastet e ndjekura me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit janë ato të lidhura me lirim/largimin e padrejtë nga detyra; procedurat e emërimit në administratën publike; transferimin e padrejtë në një tjetër pozicion; zbatimin e institutit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil; procedurat e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike; zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë; me mosdhënien e lejes vjetore ose mospagimin e saj konform ligjit.

Evidentohet fakti se ka munguar bashkëpunimi efektiv i këtyre institucioneve me Avokatin e Popullit, i cili ka sjellë si pasojë mos pasjen e mundësisë për të kryer hetime të plota dhe të shpejta. Parimi i bashkëpunimit është një detyrim ligjor e kushtetues për të gjitha organet e administratës shtetërore/publike, përmes detyrimit që t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara. Rëndësia e këtij parimi konsiston edhe në instrumentet ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, si garanci në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publike<sup>160</sup>. Referuar problematikave të hasura, institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave funksionale, ka adresuar problematikat lidhur me këto çështje si dhe ka rekomanduar marrjen e masave disiplinore, për mosveprim në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi, për punonjësit përgjegjës të ngarkuar për kthimin e përgjigjeve kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit. Veçanërisht, çështja e largimeve nga puna do të vijojë të mbetet një nga pikat kyçe për punën e Avokatit të Popullit, me qëllim dhënien e kontributeve në përmirësimin dhe krijimin e një administrate publike funksionale në përputhje me standartet Evropiane<sup>161</sup>.

---

<sup>160</sup> Siç janë raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozimet për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës etj.

<sup>161</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson ngritjen në nivel ministror të administrimit të çështjeve që lidhen me funksionimin e administratën publike duke treguar rëndësinë që ka ajo në kuadër të procesit të integritit evropian si dhe në garantimin efektiv të këtyre të drejtave.



Mbrojtja e konsumatorit është ndër politikat më të rëndësishme të Bashkimit Evropian. Shqipëria, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, është angazhuar t'i japë konsumatorit shqiptar të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si konsumatori evropian. Në mënyrë specifike ligji nr. 9590, datë 27.07.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare", neni 76 i tij, parashikon që: *"Palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë..."*.

Acquis i mbrojtjes së konsumatorit<sup>163</sup> mbulon sigurinë e mallrave të konsumit, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve në disa sektorë specifikë. Shtetet Anëtare duhet të transpozojnë acquis në legjislacionin kombëtar dhe të krijojnë struktura të pavarura administrative dhe kapacitete zbatuese të cilat sigurojnë mbikëqyrjen efektive të tregut dhe zbatimin e *acquis*.

Fuqizimi i konsumatorëve nuk është vetëm një e drejtë, por ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të përgjithshëm që i mundëson atyre të shfrytëzojnë këto të drejta dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë krijimin e një sistemi në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike kur këto vihen në rrezik. Mbrojtja e Konsumatorit, duke qenë një çështje ndërsektoriale, prek në mënyrë të pashmangshme edhe institucionet në nivel vendor, të cilat përballen në mënyrë të vazhdueshme me problemet e qytetarëve, e për më tepër me ndryshimet e fundit të reformës territoriale dhe procesit të decentralizimit në vend, njësisive të vetëqeverisjes vendore u kanë kaluar një sërë kompetencash të reja.

Për vitin 2023, nga imstitucioni i Avokatit të Popullit janë trajtuar 39 raste lidhur me pretendimet për moszbatim korrekt të ligjit, ku si subjekte të pretenduara për shkelje kanë qenë FSHU sh.a dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a. Institucioni i Avokatit të Popullit ka analizuar me kujdes shpjegimet e dërguara nga institucionet përgjegjëse si edhe dokumentacionin e përcjellë duke vlerësuar se në disa raste ka pasur vend për përmirësim të procedurës dhe mundësimin e rivënies në vend të të drejtave të shkelura. E drejta për të pasur disa shërbime elementare, si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike, është një nevojë bazike mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Edhe në kuadër të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, çështjet që lidhen me qasjen universale dhe të barabartë në ujë të pijshëm dhe në energji janë pjesë e rëndësishme e këtyre objektivave<sup>164</sup>. Objekti i rasteve me iniciativë dhe ankesë/kërkesave lidhen kryesisht me pretendime për/mbi faturime të energjisë elektrike dhe ujit, mosveprime të operatorëve kundrejt ankesave të

<sup>162</sup> Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

<sup>163</sup> Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik.

<sup>164</sup> Objektiv 6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë. 6.1: Deri në vitin 2030, të arrihet një qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë. Objektiv 7: Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë. 7.1: Deri në vitin 2030, siguron qasje universale në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.

qytetarëve, ndërprerje të energjisë/ujit, aforfe, pamundësi ekonomike për të paguar shërbimin, cilësia e shërbimit të ofruar etj.

Mbetet e rëndësishme sigurimi i masave për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë masat për të ndihmuar dhe për të shmangur ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë, veçanërisht në zonat rurale. Në disa ankesa operatorët e furnizimit me energji dhe ujë e orientojnë qytetarin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me këste duke lidhur një aktmarrëveshje midis tyre të cilën e shohin si të vetmen mundësi lehtësuese për të shlyer detyrimet e akumuluar, por pa i analizuar dhe zgjidhur problematikat në thelb duke lënë të hapur mundësinë e përsëritjes së tyre në kohë.

Problematike vazhdon të mbetet ende mungesa e infrastrukturës së kanalizimeve. Kjo mungesë elementare bëhet edhe më e patolerueshme kur Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizime Rajonale dixhitalizojnë sistemin e regjistrave të abonentëve duke mos treguar kujdes në efektet e përlogaritjeve të formulave që mbart sistemi i ri i aplikuar. Kjo pakujdesi përkthehet në nxjerrje debitor në vlera shumë të larta të abonentëve të cilët kanë qenë të rregullt ndër vite dhe vazhdojnë të jenë. Për rrjedhojë, konsiderohet i domosdoshëm trajnimi në nivelet e duhura të personelit në aplikimin e sistemeve të reja digjitale. Gjithashtu, si Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike edhe Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizime nuk zbatojnë dispozitat ligjore për sa i përket tarifimeve preferenciale apo mos tarifimin e abonentëve të cilët i përkasin kategorive specifike, siç janë grupet vulnerabël.

E njëjta indiferencë për zbatim të së drejtës së konsumatorit vërehet edhe nga ana e kompanive private të telefonisë celulare. Kjo është evidentuar në faktin e mos respektimit të vullnetit të abonentit për mbyllje kontrate nga ana e kompanive të telefonisë celulare. Edhe pse nga ana e tyre janë kryer të gjitha hapat proceduriale për mbylljen e kontratës, përfshirë edhe ato të ankimimit në rastet kur kompania e telefonisë celulare nuk ka proceduar për mbylljen e kontratës, abonentët kanë vazhduar të tarifohen me pa të drejtë<sup>165</sup>.

---

### 3.13 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor<sup>166</sup>

---

Roli i qeverisjes vendore në zbatimin e politikave, në zbatimin e *Acquis Communautaire* dhe në axhendën e integritimit evropian është shumë i rëndësishëm. Komisioni Evropian e thekson përsëri këtë rol në Komunikimin e vitit 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së ku theksohet se: “*Roli i autoriteteve rajonale dhe vendore duhet të merret parasysh në procesin e harmonizimit me BE-në dhe në zbatimin eventual të rregullave të BE-së. Duhet gjetur një ekuilibër i përshtatshëm mes qeverisë qendrore, rajonale dhe asaj vendore që mbështet më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.*”

---

<sup>165</sup> Mandati i Avokatit të Popullit shtrihet vetëm në sektorin publik dhe ka nevojë të jetë më i gjerë pasi institucioni merr jo pak ankesa nga konsumatorë të kompanive celulare dhe bankave.

<sup>166</sup> Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Roli i qeverisjes vendore është i njohur dhe konfirmuar edhe në shumë akte të organizmave ndërkombëtare, përfshirë edhe rezolutat e miratuara nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Veprimet e organeve të qeverisjes vendore janë thelbësore për të ruajtur hapësirën qytetare për të siguruar qasjen në shërbimet themelore dhe për të përmirësuar planifikimin urban duke synuar në arritjen e objektivave sociale të shtetit. Vlen të përmendet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë.26.10.2018, “Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarëve për përfitimin e shërbimeve publike”, i cili konsiderohet një garanci për përfitimin e shërbimeve publike më cilësore dhe me sa më pak kosto. Në këtë kartë përcaktohen të drejtat e qytetarëve dhe biznesit për të përfituar shërbime nga institucionet që janë të autorizuara për dhënien e tyre, ku përfshihen edhe organet e pushtetit vendor. Sipas kartës janë përcaktuar të drejtat e qytetarëve për të përfituar shërbime nga institucionet që janë të autorizuara për dhënien e tyre<sup>167</sup>.

Avokati i Popullit vlerëson se, megjithë miratimin e saj në vitin 2018, ende mbetet i ulët niveli i njohjes së kësaj karte dhe se ka nevojë të bëhet një punë më e mirë për promovimin e këtyre të drejtave.

### ***E drejta për strehim***

Si një prej të drejtave më të rëndësishme të njeriut që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin është e drejta për strehim e cila është objekt i trajtimit nga organet e pushtetit lokal. Në këtë aspekt, autoritetet lokale duhet të garantojnë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojnë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Lidhur me këtë problematikë, gjatë vitit 2023 institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 29 ankesa/raste. Ajo që duhet evidentuar është roli proaktiv i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e kësaj të drejte, ku evidentohet se një pjesë e mirë e rasteve të trajtuara janë iniciuar nga vetë institucioni. Në këtë kontekst objekt hetimi administrativ nga ana e institucionit tonë ka qenë respektimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në programet sociale të strehimit përfshihen: programi i banesave sociale me qira; programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; programi i banesave me kosto të ulët; programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; programi për krijimin e banesave të përkohshme, etj. Në evidentimin e problematikave janë orientuar njësitë e vetëqeverisjes vendore që në rastet e familjeve dhe individë të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore. Sikurse

---

<sup>167</sup> Ndër të tjera mund të përmendim: e drejta për informim; e drejta dhe përdorimi i shërbimeve publike; e drejta për trajtim të barabartë në ofrimin e shërbimeve publike; e drejta për ndihmë aktive gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve; e drejta për zgjidhje efektive; e drejta për të proceduar kërkesën tuaj sipas radhës së aplikimit; e drejta për marrjen e shërbimeve brenda afateve të arsyeshme; e drejta për marrjen e një shërbimi në mënyrë transparente; e drejta e pasjes së alternativave në paraqitjen e kërkesës për ofrimin e shërbimeve; e drejta për të mos u penalizuar për gabimet/pasaktësitë e institucioneve të administratës shtetërore; e drejta për ankimim; e drejta për pasjen e infrastrukturës në ofrimin e shërbimeve publike; e drejta e këshillimit paraprak; e drejta për shërbim cilësor, etj.

parashtruam më sipër një pjesë e këtyre rasteve i përkasin të drejtës për strehim e lidhur kryesisht me banesat sociale, me kredi të buta, bonus qiraje si dhe problematikat e lidhura me përmirësimin e kushteve të jetesës, nevojës për rikonstrukcion të menjëhershëm, pasojave të ardhura nga dëmtimet e tërmetit, përmytjeve etj.

Në ndjekjen e hetimit administrativ të rasteve që kanë të bëjnë me të drejtën për strehim, institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në konsideratë edhe angazhimin e shtetit shqiptar për realizimin brenda vitit 2030 të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku përfshihet edhe e drejta për një strehim të përshtatshëm<sup>168</sup>. Duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të drejtë të veprimtarisë administrative nga ana e tyre, lidhur me të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve. Kemi kërkuar vazhdimisht informacion lidhur me kohëzgjatjen e procesit administrativ, transparencën e këtij procesi në tërësinë e tij dhe në, raste të caktuara e konkrete, fazën në të cilën gjendet zbatimi i akteve administrative të nxjerra për këtë qëllim. Gjithashtu, evidentojmë me shqetësim të vazhdueshëm faktin se nuk kemi patur një bashkëpunim të frytshëm nga ana e organeve kompetente në dhënien e shpjegimeve pasi edhe në rastin e kthimit të përgjigjeve ato nuk janë ezauruese në të gjitha kërkesat e parashtruara nga ana jonë ose jepen përgjigje të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kërimit tonë.

Lidhur me këto problematika kemi rekomanduar në disa raste fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përgjegjës në nivel hierarkik lidhur me mospërbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre. Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në fokusin e trajtimit të tij edhe rastet e kategorive të cilat në përbërjen e tyre familjare kanë pjesëtarë të sëmurë, invalidë të grupeve të ndryshme, fëmijë, gra shtatzëna apo të divorcuara me fëmijë, të moshuar, etj. Konstatohet se organet përgjegjëse nuk kanë treguar kujdes të shtuar ndaj grupeve në nevojë për problematikat e lartpërmenduar të cilat bëjnë pjesë në fushën e strehimit.

Ligji nr. 22/2028 “Për strehimin social”, në dispozitat e tij sanksionon parimin e strehimit të përshtatshëm duke parashikuar edhe kushtet që duhet të plotësohen për t’u konsideruar i tillë. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet si dhe kur ka hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, shërbime bazë, brenda këtyre mjediseve të banimit. Thënë kjo, duhet të merren masat e duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës, veçanërisht për subjektet e veçanta dhe në nevojë për shkak të mundësive të pakta buxhetore që ata kanë. Në këto kushte çmojmë që çdo bashki, njësi e qeverisjes vendore apo institucionet e tjera kompetente, të vlerësojnë rast pas rasti situatat social-ekonomike për të krijuar mundësinë e strehimit të përshtatshëm në përputhje me normat ligjore.

---

<sup>168</sup> Pika 11: “Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurt, elastike dhe të qëndrueshme. Pika 11.1: “Deri në vitin 2030, siguroni qasje për të gjithë në strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe shërbime themelore dhe azhurnoni vendet e varfëra”.

### ***E drejta për ofrimin e shërbimeve publike***

Në kuadër të shkeljes së të drejtave të njeriut në ofrimin e shërbimeve publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga organet e qeverisjes vendore respektim të këtyre të drejtave. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike bashkitë, ndër të tjera, janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore; sinjalizimin rrugor; trotuaret dhe sheshet publike vendore; ndriçimin e mjediseve publike; transportin publik vendor; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve; ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e banesave; trajtimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të shiut, etj.

Gjatë vitit 2023, janë trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit 80 raste/ankesa ku një nga problematikat kryesore ka qenë ajo e mungesës së parametrave e standardeve të përcaktuara të rrugëve, mirëmbajtjes së tyre, ambienteve të përbashkëta, jo vetëm në kuadër të të drejtës së individit por edhe të drejtës së këtij të fundit në raport me komunitetin ku ai banon. Nga trajtimi në tërësi i rasteve, kemi konstatuar se e drejta për ofrimin e shërbimeve publike në praktikë rezulton e kornizuar si një e drejtë e cila thuhetse vuan më tepër për t'u përmbushur sidomos në zonat rurale apo qytete të vogla në ndryshim nga ato që konsiderohen qytete të mëdha. Këto problematika të parashtruara më lart mbeten në hije për shkak të mungesës së fondeve të alokuara për rrugët, kanalizimet, mbetjet shtëpiake dhe jo vetëm.

Trajtimi i këtyre problematikave është bërë duke patur parasysh edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, konkretisht objektivi nr. 9 “Ndërtimi i infrastrukturës elastike, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit”, dhe 9.1 “Zhvillimi i një infrastrukture cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe elastike, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien njerëzore, me një fokus në qasje të përbalueshme dhe të barabartë për të gjithë”.

Institucioni i Avokatit të Popullit risjell në vëmendje rëndësinë kyçe të jetesës në ambiente normale dhe të përshtatshme si një mënyrë shprehjeje e një prej parakushteve për përmbushjen e detyrimit që shteti ka për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve publike. Për këtë, gjatë trajtimit të rasteve nëpërmjet komunikimeve zyrtare iu është kërkuar institucioneve që të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve.

---

### **3.14 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës<sup>169</sup>**

---

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit nuk do të rezultonte efektive pa një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë aktorët dhe faktorët, të cilët japin kontributin e tyre në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe garantimit të

---

<sup>169</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Mbrojtjes së Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit.

tyre, i është kushtuar vëmendje maksimale parimit të “interesit më të lartë të fëmijës, si konsideratë parësore.

Gjatë vitit 2023, Shqipëria ka raportuar në Komitetin e OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” dhe kontributi i Avokatit të Popullit ka qenë pjesë e raportimit të kryer nga shteti. Komiteti, në kontekstin e monitorimit të pavarur të të drejtave të fëmijëve i ka rekomanduar,<sup>170</sup> ndër të tjera, shtetit shqiptar që:

- të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të garantuar pavarësinë e Avokatit të Popullit, duke përfshirë financimin, mandatin dhe personelin, në përputhje të plotë me Parimet e Parisit;
- të forcojë më tej mekanizmat për marrjen, hetimin dhe adresimin e ankesave nga fëmijët, në mënyrë të ndjeshme dhe miqësore ndaj tyre, duke siguruar privatësinë dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë;
- të ndërmarrë monitorimin dhe ndjekjen e këtyre mekanizmave dhe të sigurojë dukshmërinë e mekanizmit tek fëmijët në të gjithë vendin;
- t’i jepet përparësi zbatimit sistematik dhe efektiv të rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar autoriteteve shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nga institucionet e shtetit.

Në funksion të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve, fokusi i një institucioni kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përqëndrohet në:

- dëgjimin e zërit të fëmijëve, e sidomos atyre në situatat më vulnerabël;
- ndërgjegjësimin e tyre dhe të të gjithë shoqërisë me të drejtat që ata duhet t’i gëzojnë në të gjitha dimensionet, larg dhunës e gjuhës së urrejtjes në përditshmëri, e jo vetëm në legjislacion e konventa;
- vlerësimin e ndikimit të teknologjisë digjitale në jetën e shëndetin e fëmijëve;
- ruajtjen e privatësisë së fëmijëve dhe qasjes miqësore ndaj tyre;
- buxhetimin e përshtatshëm.

### ***Trajtimi i ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë***

Angazhimi kryesor që “*Asnjë të mos mbetet pas*”, i cili përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka qenë në qendër të trajtimit të mjaft rasteve me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë 2023, në kontekstin e të drejtave të fëmijës. Në këtë aspekt, është realizuar një punë intensive, në drejtim të shqyrtimit të ankesave apo kërkesave me objekt të drejtat e fëmijës, hartimit të rekomandimeve individuale, të përgjithshme apo legjislative, realizimit të inspektimeve dhe monitorimeve në terren për të ndryshuar dhe përmirësuar veprimtarinë administrative të institucioneve të administratës publike, në funksion të zbatimit efektiv të të drejtave të fëmijëve.

---

<sup>170</sup> Në mënyrë të përmbledhur Komiteti i ka rekomanduar gjithashtu shtetit shqiptar:

- Të sigurojë që e drejta e fëmijës për t’i marrë në konsideratë interesat e tij më të mira është e integruar në mënyrë të përshtatshme dhe interpretuar dhe zbatuar në mënyrë konsistente në të gjitha procedurat dhe vendimet legjislative, administrative dhe gjyqësore, si dhe në të gjitha politikat, programet dhe projektet që janë të rëndësishme dhe kanë ndikim tek fëmijët.
- Të forcojë kapacitetin e të gjithë profesionistëve përkatës për të vlerësuar dhe përcaktuar interesat më të mira të fëmijës dhe për t’i dhënë atij parimi peshën e duhur si konsideratë parësore.
- Të krijojë procese të detyrueshme dhe të hartojë dhe zbatojë mjetet për vlerësimet *ex-ante* dhe *ex-post* të ndikimit të legjislacionit dhe politikave që kanë të bëjnë me fëmijët, për realizimin e të drejtës së fëmijës që interesi më i mirë i tij të jetë konsideratë parësore.

Avokati i Popullit në përfundimet dhe rekomandimet e tij ka synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të hasura e të identifikuara, por edhe vlerësimin se si është zbatuar parimi i interesit më të lartë të fëmijëve nga i gjithë mekanizmi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve. Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka trajtuar 72 raste me iniciativë (ex-officio) për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 36 ankesa nga vetë fëmijët dhe 42 ankesa nga të rriturit, si dhe ka adresuar 29 rekomandime tek organet e pushtetit qendror dhe vendor.

### *Inspektimi/monitorimi/hetimi administrativ*

Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka inspektuar të gjitha institucionet e përkujdesit social rezidencial që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë, duke adresuar rekomandimet përkatëse organeve të administratës publike. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Rezidencial për fëmijët në nevojë janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale, të financuara nga buxheti i shtetit. Shërbimet institucionale administrohen në nivel qendror dhe vendor, duke formuar një pjesë të rëndësishme të shërbimeve të kujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë. Në kuadër të decentralizimit, 6 (gjashtë) institucione të përkujdesit social rezidencial kanë kaluar në varësi administrative të bashkive, por financohen nga Shërbimi Social Shtetëror, pra kanë varësi të dyfishtë<sup>171</sup>.

Bazuar në inspektimet e kryera ndër vite nga institucioni i Avokatit të Popullit është konstatuar se numri i fëmijëve të institucionalizuar përgjithësisht ka rënë nga njëri vit në tjetrin. Pavarësisht këtij fakti kjo rënie është shumë e papërfillshme, pasi nuk përkon me rënien e përqindjes së fëmijëve të institucionalizuar përkundrajt numrit të lindjeve, që gjithashtu është ulur shumë vitet e fundit. Përqindja e fëmijëve të regjistruar si të pranuar në institucion për arsye të varfërisë dhe problemeve sociale të familjes (jetimë socialë) është më e lartë sesa i atyre të regjistruar si të “braktisur” (jetimë biologjikë). Përveç fëmijëve jetimë “biologjikë” apo “socialë”, shërbimi rezidencial është edhe në funksion të fëmijëve të dhunuar apo që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme, por që nuk është i mjaftueshëm për këtë lloj kategori fëmijësh pasi këta fëmijë kanë nevojë edhe për shërbime të specializuara. Në institucionet e përkujdesit shoqëror publik të inspektuara nga Avokati i Popullit, ende nuk ka filluar puna për transformimin/zhvillimin e tipologjive të reja të shërbimeve me bazë komunitare.

Pavarësisht shtyrjes të zbatimit të planit të deinstitutionalizimit, Avokati i Popullit, bazuar në inspektimet e kryera, konstaton se ngritja e shërbimit të kujdestarisë profesionale, zbatimi i planeve individuale për fëmijët në institucionet e përkujdesit shoqëror, transformimi i këtyre institucioneve aktuale në qendra të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe shtimi i punonjësve në njësitë e vetëqeverisjes janë masa të përcaktuara brenda këtij viti. Disa prej godinave të institucioneve të përkujdesit social janë të vjetra dhe rikonstruktionet e kryera me qëllim rikonceptimin për ofrimin e tipologjive të reja të shërbimeve me bazë komunitare dhe ndërhyrjet e realizuara në vazhdimësi dhe në mënyrë të pjesshme, i kanë dëmtuar më shumë mjediset e akomodimit, duke mos u përshtatur me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

---

<sup>171</sup> Varësia e dyfishtë e këtyre institucioneve sjell vështirësi në menaxhimin dhe administrimin e shërbimit nisur nga shpërndarja dhe buxheti i fondeve, përzgjedhja, emërimi dhe kërkesa e llogaridhënies të personelit, elementë që ndikojnë në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.

### ***Problematikat e konstatuara***

Gjatë trajtimit të rasteve në komunikimin administrativ me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, është synuar zgjidhja e problematikave të parashtruara, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën në respektimin e detyrimeve ligjore brenda fushës së veprimtarisë të organeve të administratës publike bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijëve<sup>172</sup>. Në praktikën tonë administrative, për monitorimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror dhe vendor, nisur nga hetimet administrative të kryera kemi konstatuar shkeljen e të drejtave të fëmijëve, lidhur me:

*Të drejtën për pjesëmarrje* - Problematika kryesore e evidentuar përfshin njohjen dhe kuptimin e pamjaftueshëm të së drejtës së fëmijës për pjesëmarrje në shoqëri, si dhe njohuritë e kufizuara të të rriturve për të komunikuar dhe punuar me fëmijët drejt realizimit të kësaj të drejte. Përfshirja e fëmijëve në vendimmarrje është e dukshme në qeverisjen qendrore (dhënia e mendimeve/sugjerimeve për dokumentet strategjike që kanë të bëjnë me ta), por ende nuk është zbatuar në një mënyrë që do të siguronte pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë në nivel vendor.

*Të drejtën për arsim* - Në vitin 2023, pjesa më e madhe e ankesave/kërkesave për shkeljen e të drejtave të fëmijëve në fushën e arsimit janë ngritur nga vetë fëmijët. Ankesat e tyre të lidhura me këtë fushë adresojnë më së shumti problematikat e mjediseve të papërshtatshme infrastrukturore dhe mungesën e pajisjeve dhe mjeteve mësimore për të mundësuar nxënie efektive (kabinetet e lëndëve shkencore dhe sportive)<sup>173</sup>. Ankesat lidhur me arsimin e detyrueshëm kanë patur si objekt çështjen e sigurimit të transportit të nxënësve, mungesën e profesionistëve të kualifikuar në disa institucione arsimore, mungesën e mësuesve ndihmës, uljen e numrit të nxënësve në një numër shumë të konsiderueshëm nga viti në vit, sidomos në zonat rurale.

*Të drejtën për kujdes shëndetësor* - Shëndeti i fëmijëve ndikohet nga shumë faktorë, të cilët janë të ndryshueshëm dhe ndonjëherë të paparashikueshëm, siç kanë treguar ngjarjet e tre viteve të fundit, ku mund të përmenden pandemia, ndikimi i ndryshimeve klimatike në shëndetin e fëmijëve, por dhe zhvillimet e shpejta të teknologjisë inovative. Gjatë vitit raportues, problemet e identifikuar nga hetimet administrative të kryera vazhdojnë të jenë të njëjta me vitet e mëparshme, si numri i pamjaftueshëm i ekspertëve të kujdesit shëndetësor, sidomos të mjekëve të specializuar në fushën e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë, aksesit të fëmijëve në shërbime, vështirësitë që lidhen me realizimin e të drejtës për kujdes shëndetësor të fëmijëve me sëmundje kronike, etj.<sup>174</sup>

Në këtë fushë janë trajtuar 20 raste (*ankesa, kërkesa, raste me iniciativë*) lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët e diagnostikuar me patologji që kërkojnë trajtim të specializuar dhe që familjarët e tyre janë në pamundësi ekonomike për përballimin e këtyre shpenzimeve. Pavarësisht përpjekjeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për plotësimin e dokumentacioneve për përfitimin e këtij shërbimi me mbulimin e shpenzimeve për kurimin e tyre nga fondi prej 25%-30% i buxhetit vjetor të FSDKSH-së, asnjë rast i trajtuar nga Avokati i Popullit nuk ka përfituar mbështetje financiare.

<sup>172</sup> Për vitin 2023, janë zgjidhur në favor 65% e rasteve të trajtuara bazuar në numrin e përgjithshëm të tyre.

<sup>173</sup> Rastet *ex-officio* të trajtuara në këtë fushë lidhen me dëmtimet e institucioneve arsimore (të cilësuara jofunksionale nga Komisioni i Verifikimit) të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019, në qarqet të cilat nuk bëjnë pjesë në skemën e programit të rindërtimit.

<sup>174</sup> Fëmijët duhet të presin shumë gjatë për kontrollet e tyre të specializuara, pasi këto shërbime ofrohen vetëm në Qendrën Universitare Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë.



*Të drejtën për një standard normal të jetesës* – Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë lidhur me kushtet e vështira social-ekonomike të familjeve që në strukturën e tyre kanë fëmijë. Kushtet e papërshtatshme të jetesës ndikojnë negativisht në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve, performancën e tyre në shkollë, përvetësimin e modeleve të sjelljes dhe shprehive të punës, si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Skema e Ndihmës Ekonomike është instrumenti kryesor për “zbutjen e varfërisë” në vend, por ajo aktualisht ka një ndikim të kufizuar në zbutjen e varfërisë tek fëmijët, pasi është e orientuar për mbështetjen e familjes dhe indirekt për fëmijën.

Referuar raportit të standardit të minimumit jetik në Shqipëri<sup>175</sup>, masa e ndihmës ekonomike mbetet në nivele shumë të ulëta në krahasim me minimumin jetik. Thënë kjo, ndikimi tek realizimi i të drejtave të fëmijëve është i ulët, ndaj Avokati i Popullit thekson nevojën për të përcaktuar termin “fëmijë i varfër”. Ky përcaktim do të ndihmojë politikëbërësit për realizimin e një analize të thelluar të shpenzimeve financiare me fokus fëmijët, në nivel qendror dhe vendor, për të bërë të mundur hartimin e politikave në garantimin e të drejtave të tyre dhe raportimin e plotë të investimeve në vend për fëmijët.

*Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara* – Avokati i Popullit ka trajtuar ankesa lidhur me aplikimin e reformës së ndërmarrë nga qeveria për zbatimin e modelit bio-psiko-social për aftësinë e kufizuar, në të cilën është evidentuar se fëmijët të cilët vuajnë nga diagnoza “Celiac” janë përjashtuar nga skema e pagesave të aftësisë së kufizuar. Zbatimi i këtij modeli kërkon dokumentimin e të gjitha vështirësive që janë evidentuar, me qëllim përmirësimin dhe adresimin e tyre. Gjatë këtij viti është kryer inspektimi në Qendrën e Zhvillimit Vlorë, në të cilën u evidentua se moshja e përfituesve të qendrës nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimet e përkujdesit social. Kjo problematikë është adresuar në vazhdimësi nga Avokati i Popullit edhe për Qendrën e Zhvillimit Shkodër. Funksionimi i këtyre qendrave nuk është në përputhje me atë çka është parashikuar në legjislacionin e shërbimeve të përkujdesit social, duke penguar realizimin e procesit të vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror, si dhe ndërmarrjen e hapave për të transformuar këto qendra zhvillimi në shërbime komunitare me bazë familjen për fëmijët me aftësi të kufizuara.

*Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin* - Për garantimin e një drejtësie miqësore për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë, Avokati i Popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) kreu hetimin administrativ *ex-officio*, bazuar në situatën e rënduar psikologjike të një të mituri në I EVP Kavajë. Në vlerësim të rrethanave të ngjarjes që kishin çuar në privimin e lirisë së të miturit, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë vlerësimin e rastit duke pasur në vëmendje interesin më të lartë të të miturit,<sup>176</sup> për të siguruar aplikimin e saj në proporcionalitet dhe për të mundësuar integrimin më të lehtë në familje dhe shoqëri. Gjatë vizitës inspektuese në I EVP Kavajë, u konstatua se disa nga rekomandimet e adresuara në vazhdimësi për këtë institucion nuk janë zbatuar në praktikë.

---

<sup>175</sup> Realizuar në vitin 2020 nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNDP, sipas të cilit minimumi që i duhet një personi për të garantuar nevojat bazë në Shqipëri është 17 875 lekë në muaj.

<sup>176</sup> Sipas përcaktimeve të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Komentit 2 të Konventës Evropiane për Ekstradim.

### 3.14.1. Rekomandimet dhe përfshirja në procesin legjislativ, përgjithësues e strategjik në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve

Për të përmirësuar përpjekjet e vazhdueshme të organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, për realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve lidhur me veprimet që duhet të ndërmarrin këto institucionet përgjegjëse, udhëhequr nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve dhe në interesin më të lartë të tyre, Avokati i Popullit ka dërguar rekomandime<sup>177</sup> për:

#### 1. Të drejtën për arsim, argëtim dhe aktivitete kulturore

- marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për realizimin e një vlerësimi të përgjithshëm të gjendjes infrastrukturore të institucioneve arsimore në vend, duke evidentuar qartë nevojat në bashkëpunim me pushtetin vendor për të inkurajuar, motivuar dhe rritur cilësinë e arsimimit të fëmijëve/nxënësve, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimit të mjeteve të domosdoshme mësimore me qëllim edukimin dhe aftësimin e tyre;
- marrjen e masave për identifikimin dhe adresimin e nevojave të nxënësve romë-egjiptianë që nuk vijnë rregullisht në mësim, apo janë në rrezik braktisjeje nga strukturat arsimore dhe referimin e tyre pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijëve;
- marrjen e masave për forcimin e sistemit që monitoron dhe vlerëson respektimin e të drejtës për t'u arsimuar, nëpërmjet identifikimit në kohë të nxënësve romë dhe egjiptianë që mund të braktisin shkollën dhe referimit të tyre tek strukturat e mbrojtjes së fëmijëve;
- forcimin e punës për rritjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me qëllim realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, për një edukim cilësor me dinjitet dhe respekt të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në përmbushje të interesit më të lartë të fëmijës;
- marrjen e masave të menjëhershme për monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të mjediseve të institucioneve arsimore me qëllim parandalimin e reklamimit dhe konsumimit të ushqimeve të pashëndetshme;
- marrjen e masave për dhënien e informacionit në shkolla lidhur me sigurinë ushqimore dhe promovimin e përzgjedhjeve të shëndetshme ushqimore.

#### 2. Të drejtën për kujdes shëndetësor

- marrjen e masave për ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar burimet e disponueshme të shtetit (FSDKSH-së) dhe burimet e tjera, duke përfshirë organizatat jofitimprurëse, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat, për krijimin e një fondi të veçantë dedikuar vetëm për fëmijët, për të bërë të mundur mbulimin e shpenzimeve të mjekimit që nuk janë brenda paketës së shërbimeve spitalore dytësore dhe ofrimin e shërbimeve spitalore terciare të skemës së detyrueshme të sigurimeve të kujdesit shëndetësor;
- marrjen e masave për ngritjen e një platforme brenda sistemit të referimit të pacientëve të dedikuar vetëm për fëmijët të diagnostikuar me patologji që kërkojnë shërbime të specializuara, të cilat nuk janë të përfshira brenda paketës së shërbimeve spitalore dytësore dhe spitalore terciare të skemës së detyrueshme të sigurimeve të kujdesit shëndetësor të FSDKSH-së. Platforma të sigurojë një

<sup>177</sup> Këto rekomandime gjenden në linkun: <https://smpdf.org/2023/03/01/rekomandime-2023/>

listë të të gjithë fëmijëve që, për aq sa është e mundur, të përfitojnë pagesa për paketat e shërbimeve të veçanta të ofruara nga shërbimet spitalore, publike dhe jopublike brenda dhe jashtë vendit nga fondi i veçantë i vënë në dispozicion çdo vit dedikuar vetëm për fëmijët;

- marrjen e masave për përfshirjen e fondit të veçantë të parashikuar në mënyrë specifike vetëm për fëmijët në Vendimin e Këshillit të Ministrave për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, i cili miratohet çdo fillim viti.

### 3.14.2. Rekomandime Legjislative

#### 1. Parandalimi i martesave të hershme

Në kushtet kur dispozita ligjore e Kodit të Familjes<sup>178</sup> vijon të mbetet e pandryshuar, Avokati i Popullit e rimorri këtë rast me iniciativë, bazuar dhe në konkluzionet përfundimtare (2023) që Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës i ka rekomanduar Shqipërisë “*që të heqë të gjitha përjashtimet që lejojnë martesën për fëmijët nën moshën 18 vjeç,*” duke i adresuar rekomandimet Ministrisë së Drejtësisë si vijon:

- marrjen e masave për shfuqizimin e nenit 7, paragrafi i dytë, të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, të ndryshuar, që u jep të drejtën gjykatave të lejojnë martesat nën moshën 18 vjeç, me qëllim parandalimin e martesave të fëmijëve dhe përcaktimin e moshës minimale për martesë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, KDF-në dhe interesin më të lartë të fëmijëve;
- marrjen e masave për rishikimin e Kodit Civil për të hequr të gjitha përjashtimet ligjore nga mosha minimale prej 18 vjeç për martesë si për vajzat, ashtu dhe për djemtë, si dhe për të harmonizuar dispozitat ligjore në këtë drejtim.

Për këtë rekomandim, Ministria e Drejtësisë informon se *do të mbahet në konsideratë në kuadër të analizave përkatëse që do të kryhen për ndërhyrjet ligjore në Kodin e Familjes dhe Kodin Civil.*

#### 2. Ushtrimi/humbja e përgjegjësisë prindërore

Nga rastet e trajtuara me iniciativë, pas realizimit të inspektimeve në institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijët, në shumicën e rasteve është evidentuar qëndrimi afatgjatë i fëmijëve (mesatarisht 4-5 vjet) në këto institucione me pasoja negative për zhvillimin normal të tyre, veçanërisht për ata nën 6 vjeç (jo lehtë të korigjueshme). Një vlerësim sipërfaqësor i interesimit të prindit dhe dështimi për të fuqizuar familjen biologjike, janë arsye që i lënë fëmijët “peng” të institucionalizimit. Duke mos u shpallur “të braktisur”, ata nuk kanë mundësinë për t’u birësuar dhe për të marrë mbështetjen dhe ngrohtësinë e një familjeje. Avokati i Popullit bazuar në termin ligjor “*përgjegjësi prindërore*”, thekson se prindërit duhet të jenë të ndërgjegjësuar për detyrimet e rëndësishme prindërore që kanë në raport me fëmijën. Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit adresoi rekomandimin Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me vlerësimin e nevojës për rishikimin e Kodit të Familjes për të parashikuar kuptimin e detajuar dhe mënyrën e zbatimit në praktikë të parimit “të interesit më të lartë të fëmijës” dhe rastet e braktisjes së fëmijës nga prindi. Për këtë rekomandim, Ministria e Drejtësisë informon se *do të mbahet në konsideratë në kuadër të analizave përkatëse që do të kryhen për ndërhyrjet ligjore në Kodin e Familjes.*

---

<sup>178</sup> Neni 7, paragrafi i dytë.

### **3. Veprimtaritë promovuese për të drejtat e fëmijëve**

Ndërgjegjësimi dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve kontribuon në mirëqenien, zhvillimin dhe ruajtjen e dinjitetit të fëmijëve. Avokati i Popullit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës nga ana e organeve publike, gjatë vendimmarrjeve të tyre. Disa nga aspektet kryesore ku është fokusuar veprimtaria promovuese e Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijëve janë:

### **4. Cenueshmëria e fëmijëve, mbrojtja nga dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi**

Fëmijët janë në thelb të cënueshëm për shkak të moshës dhe varësisë së tyre nga të rriturit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol vendimtar në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe neglizhenca, duke mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, përmendim prononcimin publik dhe trajtimin e rastit *ex-officio* lidhur me ushtrimin e dhunës ndaj një vajze të mitur nga katër bashkëmoshatare të saj, në qytetin e Vlorës.<sup>179</sup> Lidhur me trajtimin e fenomenit Avokati i Popullit ka rekomanduar vazhdimisht:

- forcimin e sigurisë në komunitet e shkolla, me qëllim rritjen e numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë;
- krijimin e shërbimeve të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe çdo formë e saj, për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur këtë fenomen negative;
- rolin proaktiv, që të gjithë aktorët institucionalë dhe joinstitucionalë duhet të luajnë në ndërgjegjësimin e shoqërisë për masat shtrënguese në rastet e dhunës ndaj fëmijëve, qoftë kjo e ushtruar nga prindërit, duke kërkuar heqjen e të drejtës prindërore në të tilla raste.

Po kështu, Avokati i Popullit ka bërë një prononcim publik dhe ka trajtuar rastin e ushtrimit të dhunës ndaj një fëmije të mitur, 3 vjeç, në mjediset e një kopshti fëmijësh, si dhe rastin e abuzimit seksual të mjekut me të miturën 14-vjeçare, duke theksuar rëndësinë që ka mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe pornografisë.

### **5. Promovimi i qasjes “Fëmija në qendër”**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka prioritet, ndër të tjera, edhe të drejtat e fëmijëve duke adoptuar një qasje me në qendër fëmijën, duke njohur dhe respektuar nevojat, kapacitetet dhe perspektivat unike të fëmijëve në proceset e tyre jetësore, politike dhe vendimmarrëse. Në kontekstin e angazhimit institucional të Avokatit të Popullit për këtë pikë përmendim realizimin e veprimtarive me karakter informues dhe promovues, në formën e tryezave/takimeve me fëmijët e dy institucioneve arsimore<sup>180</sup>. Fëmijët/nxënës diskutuan për/rreth të drejtave të tyre, duke u ndalur veçanërisht tek e drejta për pjesëmarrje dhe rëndësia e dëgjimit të zërit të tyre.

### **6. E drejta për arsim**

Institucionet e të drejtave të njeriut mbrojnë dhe monitorojnë realizimin e të drejtës së fëmijëve për arsim. Sigurimi i aksesit në arsim cilësor për të gjithë fëmijët është thelbësor për zhvillimin e tyre intelektual

---

<sup>179</sup> Gjatë trajtimit të këtij rasti institucioni i Avokatit të Popullit u kërkoi organeve kompetente të marrin masat e nevojshme, për trajtimin me profesionalizëm, në një kohë të shpejtë të çështjes, si dhe ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së duhur për të miturën, viktimë e kësaj dhune.

<sup>180</sup> Shkolla 9-vjeçare “Kosova” dhe “E Kuqe”, të qytetit të Tiranës.

dhe social, për të thyer ciklin e varfërisë dhe për të promovuar barazinë në shoqëri. Ndër të tjera, Avokati i Popullit në këtë kontekst, ka realizuar:

- publikime në media (web dhe rrjetin social facebook) dhe pjesëmarrje në takime me institucionet e administratës publike dhe organizatat e shoqërisë civile, 181 ku janë evidentuar disa nga problemet me të cilat ndeshet arsimit sot në vendin tonë, si dhe rëndësinë e nxitjes së arsimit gjithëpërfshirës;
- veprimtari promovuese, “Ditë e hapur”, me fëmijë/nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.<sup>182</sup>

## **7. Pjesëmarrja e fëmijëve**

Pjesëmarrja aktive e fëmijëve në proceset e vendimmarrjes dhe dëgjimi i zërit të tyre është mjaft i rëndësishëm. Institucioni i Avokatit të Popullit në takimet dhe aktivitetet promovuese ka mundur të përfshijë zërat, perspektivat dhe opinionet e fëmijëve në çështjet që i prekin ata. Në këtë kontekst janë realizuar:

- aktiviteti/veprimtaria promovuese me rastin e ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijës.<sup>183</sup> Aktiviteti, i cili organizua në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, u shoqërua me prezantimin e punimeve (piktura) të realizuara nga vetë fëmijët e shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Tiranë.
- organizimi i festës së 1 qershorit, ditës së fëmijës, në kopshtin nr.20 të qytetit të Tiranës. Në këtë veprimtari të organizuar morën pjesë 140 fëmijë të moshave nga 3 në 6 vjeç, prindër, komuniteti i zonës, si dhe përfaqësues të institucioneve që punojnë me fëmijët.
- veprimtari “Ditë të hapura”, me fëmijët/nxënës të gjimnazit “Ismael Qemali”, Tiranë, të shkollës 9-vjeçare “Imelda Lambertini”, Elbasan, në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, ku të rinjve iu theksua rëndësia e katalogut të të drejtave e duke u ndalur veçanërisht tek liria e shprehjes, ushtrimi i së cilës bën të mundur dëgjimin e zërit të tyre, etj.

## **8. Shëndeti, mirëqenia dhe e drejta për zhvillim**

E drejta e fëmijëve për shëndet, përfshin aksesin në kujdesin shëndetësor, ushqimin dhe një mjedis të sigurt. Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka luajtur një rol të rëndësishëm në advokimin e politikave që i japin përparësi mirëqenies fizike dhe mendore të fëmijëve duke synuar që politikat dhe praktikat institucionale të promovojnë zhvillimin e plotë të fëmijëve, përfshirë mirëqenien e tyre fizike, mendore dhe sociale. Gjatë realizimit të aktiviteteve promovuese “Ditë të Hapura” në disa institucione arsimore në vend, Avokati i Popullit ka vënë theksin në respektimin dhe detyrimin e institucioneve në përmbushjen e disa detyrimeve që përmban KDF-ja.

## **9. Mbrojtja e fëmijëve të marginalizuar dhe të pafavorizuar**

Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit është fokusuar në adresimin e nevojave të fëmijëve të marginalizuar dhe të pafavorizuar, siç janë ata me aftësi të kufizuara, fëmijët e vendosur në institucione rezidenciale apo ata që jetojnë në varfëri/varfëri ekstreme. Në këtë kontekst, përmendim organizimin e veprimtarisë “Ditë të hapura”, me fëmijët/nxënës dhe stafin e shkollës 9-vjeçare “Adem Sheme”, Sarandë. Qëllimi i kësaj veprimtarie promovuese ishte edukimi i fëmijëve për/rreth të drejtave të tyre dhe adresimi i

<sup>181</sup> P.sh, takimi i organizuar nga CRCA/ECPAT Shqipëri, mbajtur në mjediset e qendrës COD, Kryeministri.

<sup>182</sup> Fëmijët të cilët morën pjesë në këto takime/aktivitete përfaqësonin bashkëmoshatarët e tyre të qyteteve si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Dibra dhe Korça, grupin “IMPACT” të organizatës World Vision, fëmijë e të rinj pjesë e organizatës “Save the Children” Lazarat etj.

<sup>183</sup> 20 nëntor 2023.

problematikave, sidomos të fëmijëve pa kujdes prindëror 6-15 vjeç të institucionit rezidencial “Vangjel Pulla” të cilët edukohen të gjithë në institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”, Sarandë, etj.

## 10. Përgjegjësia ligjore

Institucioni i Avokatit të Popullit ka mundur të krijojë korniza ligjore dhe mekanizma për t’i nxjerrë në pah përgjegjësitë për shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Kjo ndihmon në parandalimin e shkeljeve dhe siguron drejtësi për fëmijët që kanë përjetuar shkelje të të drejtave. Angazhimi i Avokatit të Popullit në këtë drejtim është konkretizuar, siç kemi informuar edhe më pare, në publikimin e raportit të veçantë “Politikat e pensionit ushqimor, detyrimin për ushqim për fëmijët”, si dhe prononcimin mediatik për këtë çështje.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve është thelbësor për krijimin e një bote ku çdo fëmijë të trajtohet me dinjitet, respekt dhe barazi. Avokati i Popullit, gjatë vitit 2023, ka realizuar 42 aktivitete promovuese (takime, ditë të hapura dhe aktivitete online), të cilat janë trajtuar në Kreun II (Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2023 nga institucioni i Avokatit të Popullit) të këtij raporti.

---

### 3.15 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor<sup>184</sup>

---

Shëndeti është në themel të mirëqenies së individit, ndaj ai konsiderohet një indikator thelbësisht i vlefshëm për arritjen e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Sipas OBSH-së “*Shëndeti është një gjendje e mirëqenies totale fizike, mendore, sociale, dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes ose e dobësisë.*”

Shëndeti i mirë u mundëson njerëzve të punojnë dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri dhe të mbështesin veten financiarisht. Për këtë arsye sektori i shëndetësisë mund të luajë një rol kryesor në mbështetjen e sektorit social në qëllimet e tij për uljen e varfërisë dhe të përjashtimit social. Nga ana tjetër ndërhyrjet sociale përmirësojnë paralelisht treguesit shëndetësorë të popullatës dhe individëve të synuar. Qëllimi i shëndetësisë është të përmirësojë ndjeshëm shëndetin dhe mirëqenien e popullatës, të ulë pabarazitë shëndetësore, të forcojë shëndetin publik dhe të sigurojë sisteme shëndetësore me në qendër njerëzit, të cilat janë universale, të barabarta, të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë.

Avokati i Popullit vlerëson se parimi mbi të cilin duhet të mbështet funksionimi i kujdesit shëndetësor është cilësia e shërbimit dhe efënca duke garantuar sigurinë e pacientit dhe pa anësinë. Në këtë mënyrë zbatohet një tjetër standard ndërkombëtar që e ka filluesën që në Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, si dhe ka konfirmuar objektivin social kushtetues sipas të cilit shteti synon standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm për qytetarët e tij.

Referuar ankesave të regjistruara në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2023, rezultojnë 38 të tilla, nga të cilat 18 rezultojnë të jenë raste të marra me iniciative. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezultojnë se për 30 ankesa është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave të shqyrtuara me iniciativë, 15 prej tyre rezultojnë të

---

<sup>184</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës apo inisiativës tonë. Ankesat/rastet me inisiativë evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si:

- trajtimi mjekësor jo konform standardeve për disa sëmundshmëri;
- burokraci lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”(QSUT);
- mungesa e medikamenteve për fëmijët me leuçemi në QSUT;
- mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shumë qendra shëndetësore në vend për shkak të mungesës së mjekëve, amortizimit dhe mosfunksionimit të godinave të emërtuara si qendra shëndetësore;
- mungesa e personelit të mesëm infermier, si dhe mjekëve specialistë e thelluar kjo vit pas viti;
- ikjet masive të mjekëve dhe infermierëve duke dhënë rezultate negative kryesisht në spitalet rajonale.

Referuar rasteve specifike në të cilat nga institucioni i Avokatit të Popullit ankesat kanë rezultuar të bazuara, evidentojmë:

### *3.15.1. Rekomandimin adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në lidhje me mungesën e personelit shëndetësor*

Ndër vite ka pasur përpjekje për të adresuar mungesën e personelit shëndetësor në spitalet e rretheve, si dhe në zonat e largëta, nëpërmjet programeve të ndryshme të prezantuara nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, si programi për “rikthimin e trurit” 2006 – 2011, ofrimi i bonuseve mbi pagën për mjekët që pranojnë të punojnë në spitalet rajonale të qyteteve të ndryshme të vendit, etj. Por këto programe duket nuk kanë pasur rezultatet e pritshme përse fenomeni vazhdon. Avokati i Popullit është në dijeni të faktit që ky nuk është një problem vetëm i Shqipërisë por qartas gjendja në Shqipëri është më problematike krahasuar me vendet e tjera në Ballkan. Ndonëse fenomeni shqetësues i mungesës së personelit shëndetësor në rrethe dhe zonat e largëta është trajtuar edhe në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, objektivi specifik që lidhet me fuqizimin e mëtejshëm të kujdesit shëndetësor parësor, mbetet sfida thelbësore e zbatimit në praktike të kësaj strategjike<sup>185</sup>.

Në këtë kushte, Avokati i Popullit i rekomandoi MSHMS-së:

- Të vijojë angazhimin institucional dhe të nxisë e koordinojë angazhimin ndërinstitutional në zbatim të Strategjisë Kombëtare të shëndetësisë 2021-2030, për të adresuar mungesën e burimeve njerëzore dhe sfidat në shërbimet shëndetësore në zonat rurale dhe të vështira për t’u aksesuar nga qytetarët”.

### *3.15.2. Rekomandim, adresuar MSHMS lidhur me problematikën e mjekëve të shërbimit të Mjekësisë Interne dhe Hipertensionit Arterial (HTA), në lidhje me vështirësitë që “mjekët intern” po hasin*

---

<sup>185</sup> Ndonëse ndër vite ka pasur përpjekje për adresimin e kësaj problematike, është e nevojshme të vijohet puna në këtë drejtim për ofrimin e zgjidhjeve të qendrueshme dhe afatgjata, si rritja e investimeve në infrastrukturë, rishikimi i kurrikulave të trajnimit bazë dhe ndërtimi i një programi të ri kombëtar të mjekësisë lëvizëse për të mbështetur kujdesin shëndetësor në zonat rurale dhe të vështira për t’u arritur. Gjithashtu, është e rëndësishme të ndërmerren masa për të përmirësuar sistemin e pagesës dhe për të siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët në të gjithë territorin e vendit. Për të arritur këto qëllime, duhet të kemi një angazhim të përbashkët të institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe profesionistëve të shëndetësisë.

*në integrimin e tyre në strukturat spitalore dhe për mospërfshirjen në listën e barnave të rimbursueshëm të barnave për diagnozat që ata trajtojnë*

Duke parashtruar rolin e rëndësishëm që luajnë në shërbimin spitalor, ata kanë kërkuar, ndër të tjera, përcaktimin e statusit dhe pozicionimin e mjekut intern në strukturat që ofrojnë shërbime shëndetësore të specializuara. Në këtë kushte, Avokati i Popullit i rekomandoi MSHMS<sup>186</sup>:

- trajtimin në kohën më të shpejtë të mundshme të çështjeve të parashtruara për zgjidhje nga ana e mjekëve intern, nga ana e grupit të punës të konfirmuar tashmë prej jush, me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim edhe me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, dhe ofrimin e zgjidhjeve përkatëse për secilën prej tyre;
- nxjerrjen e të gjitha akteve të nevojshme nënligjore administrative, në përmbyllje të procedurës administrative që do të ndërmerret në këtë rast, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe njoftimin e këtyre mjekëve internistë, si palë drejtëpërdrejtë të interesuara.

*Për këto rekomandime vlerësojmë me shqetësim dhe keqardhje se nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

### *3.15.3. Rekomandim adresuar Spitalit Universitar<sup>187</sup> të Traumës*

Avokati i Popullit ka adresuar me rekomandim Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë, ankesën e shtetasit A. Z., me detyrë Shef i Shërbimit të Kirurgjisë Plastike Rikonstruktive (Angiokirurgjisë) dhe Këmba Diabetike, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, lidhur me dhënien e një mase disiplinore ndaj këtij shtetasi ish drejtor i këtij spitali. Ky rekomandim është trajtuar në nivel sistemik, dhe ka adresuar problemet që kemi evidentuar në procedurën objekt shqyrtimi, me qëllim për të kontribuar në përmirësimin e procedurave të mira administrative që duhet të zbatojnë institucionet e administratës publike, të cilat duhet të garantojnë standardet më të larta për një qeverisje sa më afër qytetarëve. Në këto kushte, Avokati i Popullit rekomandoi:

- marrjen e masave për të kërkuar rregulla të qarta që të përcaktojnë procedurat e dhënies së lejeve të paguara në zbatim të detyrimit kushtetues të pundhënësit për të garantuar leje vjetore të paguara për punmarrësin;
- marrjen e masave për të parashikuar në kuptim të nenit 37 të Kodit të Punës, procedura kontraktuale apo rregullative, për të garantuar të drejtën e pjesmarrësve në procedura administrative për t'u dëgjuar;
- shfuqizimin e pikës 2, të Urdhrit nr.729, dt.06.12.2022, konkretisht “vërejtje me paralajmërim” për A. Z., si një akt administrativ, pjesërisht i pavlefshëm.

*Ky rekomandim nuk u pranua nga Drejtuesja e Spitalit Universitar të Traumës.*

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se mekanizmat e përgjegjësisë janë thelbësore për të siguruar nivelin e respektimit të detyrimeve të shtetit që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës për kujdes shëndetësor. Monitorimi dhe vënia para përgjegjësisë e shtetit, arrihet nëpërmjet mekanizmave administrative, politike, gjyqësore si dhe duke përfshirë në proces një numër aktorësh siç janë, OJF-të e ndryshme, institucionet kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut si dhe vetë qytetarët të cilët po

<sup>186</sup> Rekomandimi i Avokatit të Popullit, nr. Prot.K1/J4-4, dt.22.12.2023.

<sup>187</sup> Rekomandim i Avokatit të Popullit, nr.Prot K1/A37-5, dt.02.02.2023.



ndërgjegjësohen për të drejtën e tyre për një kujdes të denjë shëndetësor. Gjthashtu, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se shteti mban përgjegjësi dhe luan një rol aktiv ndikues në faktorët e tjerë ekonomiko-social që ndikojnë në shëndetin si dhe në krijimin e infrastrukturës materiale dhe njerëzore për diagnostikimin dhe luftimin e sëmundjeve si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit.

---

### 3.16 Respektimi i të drejtës për arsimim<sup>188</sup>

---

E drejta kushtetuese për t'u arsimuar shihet si e drejte dhe detyrim, ku në njërin anë të gjithë gëzojnë mundësinë për t'u arsimuar, e në anën tjetër parashikohen disa detyrime për ta jetësuar këtë të drejtë, detyrime të cilat bien mbi shtetin, prindërit por dhe vetë fëmijët. Prindërit kanë detyrim për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollë, ndërsa mekanizmit shtetëror i lind detyrimi të sigurojë infrastrukturën e nevojshme falas për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës për arsim. Arsimiti është konsideruar gjerësisht si një instrument udhëheqës i rritjes ekonomike nëpërmjet kontributit të tij në ndërtimin e kapaciteteve të kapitalit human. Përfitimet nga arsimi nuk shihen vetëm për individin e shkolluar, por edhe për ekonominë si një e tërë. E drejta për arsim përfshihet në kategorinë e të drejtave dhe lirive ekonomike, sociale dhe kulturore. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila e ka përfshirë atë si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore.

Arsimi i lartë dhe reforma arsimore universitare ka qenë dhe mbetet një nga temat më të rëndësishme publike në vend. Megjithëse prej vitit 1990 arsimi i lartë ka pasur 3 reforma të thella, kuadri ligjor nuk e ka nxitur në masën e duhur reformimin e brendshëm të jetës universitare duke përfshirë kurrikulat, kërkimin shkencor dhe rolin e studentit brenda jetës universitare. 8 vjet pas miratimit të reformës në arsimin e lartë, universitetet publike dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, dy institucionet kryesore të ngarkuara për zbatimin e kësaj reforme, kanë shfaqur mangësi dhe problematika në përmbushjen e detyrave që u paracakton ligji. Avokati i Popullit vlerëson se problemet më të spikatura me të cilat ndeshet arsimi i lartë në Shqipëri mbeten:

- cilësia me të cilën studentët pranohen në universitet;
- mungesa e bazës materiale dhe shkencore që shkollat e mesme dhe të larta ofrojnë për këta nxënës dhe studentë;
- mungesa e bazës shkencore për pedagogët;
- mbyllja e degëve të mësuësisë si dhe largimi i të rinjve për studime jashtë vendit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2023 e në vijim, problematikat sa i përket të drejtës për arsim, të bëra prezente, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të adresuara pranë Institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe online duke konstatuar edhe për këtë vit, sërish, se arsimi i lartë dhe reforma arsimore universitare vijojnë të mbeten në mënyrë të qëndrueshme një nga temat më të rëndësishme publike në vend për shkak të problematikave që ajo paraqet.

---

<sup>188</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Referuar ankesave të regjistruara në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin raportues, rezulton të jenë regjistruar 42 të tilla<sup>189</sup>, nga të cilat 20 janë raste të marra me iniciativë. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për 35 ankesa është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave të shqyrtuara me iniciativë, rreth 16 prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës apo iniciativës tonë.

Problematikë serioze, e trashëguar edhe nga viti pararendës, dhe e evidentuar në një pjesë të konsiderueshme të ankesave individuale të depozituara pranë institucionit tonë, vijon të jetë punësimi jo mbi bazë meritokracie i arsimtarëve, vonesat në marrjen e kuotës financiare të mësuesve që punojnë larg vendbanimit të tyre, për shkak të burokracive të procedurave të tenderimit si dhe mjaft problematika që shqetësojnë stafet akademike të universiteteve në rang vendi. Gjithashtu vërehet se fenomeni i largimit të rinjve nga Shqipëria po kthehet në një trend shumë shqetësues. Largimi i rinjve është një realitet që po ndodh jo vetëm për shkak të politikave liberale të punësimit të ndjekura nga shtete të tjera, por edhe për shkak të pamundësisë të arsimimit (për degë të caktuara vendosja e kriterit të notës mesatare) si dhe të mungesës të sigurisë së punësimit të denjë në vendin e tyre. Në fokus të veçantë të punës së institucionit janë vënë edhe pretendimet e shumta në numër të studentëve të cilët për shkak të rritjes së çmimeve dhe treguesve të inflacionit u përballën me kosto të larta financiare qoftë për jetën studentore ashtu edhe për pagesat e tarifave të shkollimit.

Gjatë vitit raportues, probleme ka paraqitur procesi i akordimit të bursave të studentëve, të parashtruar në ankesat individuale të depozituara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ankesa të cilat janë adresuar për zgjidhje në administratat e Rektoratit, Universiteteve dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në kuadër të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e tij, institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar takime në Universitetin e Elbasanit dhe grupe studentësh në Tiranë për të qënë sa më pranë tyre dhe për të diskutuar me ta problematikën e ndryshme lidhur me jetën studentore dhe bërjen me dije të kompetencave dhe rolit të Avokatit të Popullit në mbështetje të drejtave të tyre. Në këto takime me studentë e staf akademik u morën ankesa të cilat u adresuan rast pas rasti për zgjidhje pranë organeve përkatëse.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni për të cilat janë gjetur të drejta ankesat, për vitin 2023 do specifikonim rastin me iniciativë të bërë publik në media me objekt: “Paketa anti-krizë, revoltohen studentët e harruar. Vuajmë çmimet marramëndëse të qirave”. Nisma zuri fill menjëherë pasi qeveria bëri publike masat për përkrahjen e disa grupeve në këtë kohë krize, por ndër të tjera, nuk përfshiu studentët që janë një grup shumë i prekur nga rritja e çmimeve, pasi qiratë dhe kostoja e jetës janë rritur shumë, dhe jo vetëm që nuk u është dhënë asistencë, por as nuk është diskutuar për lehtësim tarifash. Varfëria është shumë komplekse. Ajo është mungesë e të ardhurave, mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe i mjeteve bazë të jetesës, për të përballuar dhe kapërcyer sa

---

<sup>189</sup> Ankesat janë paraqitur si nga mësuesit, pedagogët dhe edukatorët ashtu dhe nga nxënësit dhe studentët.

më denjësisht këtë situatë, kërkon një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale për kategorinë e studentëve dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë financiare të tyre. Sa më sipër, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>190</sup>:

- marrjen e masave për miratimin e një pakete të re të mbështetjes sociale për studentët, për t'u mundësuar jetesën normale/dinjitoze, në kushtet e krizës globale dhe asaj lokale;
- marrjen e masave për vlerësimin e mundësive që kjo paketë në terma të kohështrirjes, të jetë e disponueshme deri në përmirësimin e treguesve ekonomike dhe në kapërcimin e situatës së krizës.

*Ky rekomandim u shqyrtua dhe u pranua pjesërisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.*

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër edhe të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të datës 22.06.2023, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2022”, zhvilloi veprimtarinë “Ditë e Hapur” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u parashtruan problematikat dhe sfidat me të cilat haset ky institucion në punën e tij të përditshme si dhe u referuan në mënyrë të detajuar disa propozime konkrete që lidheshin me; domosdoshmërinë e heqjes së notës mesatare për aksesin në arsimin e lartë; harmonizimin e akteve nënligjore që zbatohen nga institucionet e arsimit të lartë; unifikimin e programeve të studimit, si një parashikim ligjor i papërmbyshur ende; bashkëpunimin e institucioneve të arsimit të lartë me institucione apo agjenci në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; dokumentacionin për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit me procedurë si tejet administrative dhe jo akademike; shpenzimet për praktikantë mësimorë në terren me studentët; bursat financiare dhe përjashtimin ose reduktimin e tarifave të shkollimit në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL); krijimin e fondit të librave në bibliotekë në IAL; krijimin e infrastrukturës së laboratorëve apo qendrave kërkimore në IAL, etj..

Të gjitha këto propozime u përfshinë në rekomandimin që Avokati i Popullit i dërgoi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>191</sup> për:

- marrjen e masave për gjetjen e mekanizmave ligjore e financiare për zgjidhjen/adresimin e problematikave të evidentuara dhe parashtruara me sygjerime konkrete sa më sipër, të Universitetit A.Xhuvani, Elbasan”.

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë përgjigje deri në hartimin e këtij raporti ndonëse kanë kaluar afatet e parashikuara në ligj.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e shtetit shqiptar për rritje të pagave të mësuesve dhe pedagogëve, vlerëson se mbetet ende sfida mbështetjeja financiare për motivimin e mëtejshëm të tyre. Përmes angazhimit të efektshëm Shqipëria duhet të jetë e përgatitur të sigurojë arsim cilësor gjithëpërfshirës, i cili të mundësojë përfitime konkrete dhe efektive për nxënësit/studentët si dhe ndërtimin e kapaciteteve të kapitalit human.

---

### 3.17 Respektimi i të drejtës për kujdes social<sup>192</sup>

---

<sup>190</sup> Rekomandimi i AP, nr.prot.K1/I77-6, dt.25.07.2023.

<sup>191</sup> Rekomandimi i AP, nr. Prot.K1/G4-2, dt.27.12.2023.

<sup>192</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Qëllimi i Politikave të Përfshirjes Sociale është garantimi një sistemi transparent, të përgjegjshëm dhe të rregullt, për vlerësimin e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të varfërisë dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive, shëndetit, arsimit, strehimit dhe mungesës së nevojave bazë, si elementë bazë të të drejtave të njeriut. Politikat për mbrojtjen sociale në Shqipëri mbështeten në objektivat sociale që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka njohur si detyra të shtetit për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike apo fetare, jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore sa i përket sigurimit të ushqimit të nevojshëm, strehimit, shëndetit dhe arsimit.

Varfëria<sup>193</sup> (norma e rrezikut të varfërisë) në Shqipëri mbetet e lartë, mbi 22.0 %<sup>194</sup>. Sipas rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (EUSILC) 2021 që mat kushtet e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material në familjet shqiptare, publikuar më datë 30.12.2022 nga INSTAT<sup>195</sup>, vlerësohet se niveli i përjashtimit social në Shqipëri, pra i individëve në rrezik varfërie, ose thellësisht të privuar materialisht, ose me intensitet shumë të ulët në punësim, është rreth 43.9 % e popullsisë. Privimi i rëndë material<sup>196</sup> vlerësohet në 35,2 % në 2021. Kjo do të thotë se pothuajse 1/3 e popullsisë jeton në kushte shumë të vështira ekonomike. Duke ju referuar studimit për “Transfertat e Mbrojtjes Sociale drejt Familjeve të Varfëra”<sup>197</sup>, ku janë listuar kategoritë e shpenzimeve për familjet e varfëra, ushqimi zë pjesën më të madhe të shpenzimeve duke lënë hapësirë të pakonsiderueshme për shpenzime të tjera si komunikimi, kultura, etj.

Skema e Ndhmës Ekonomike, si një nga mjetet që ka në dorë shteti për të ndihmuar individët e varfër, është në vetvete një zinxhir procedurash që përfshin institucione qendrore dhe vendore. Përmirësimi i indikatorëve për vlerësimin e familjeve të varfëra dhe ekstremisht të varfëra është një ndër objektivat kryesorë të krijimit dhe përshtatjes së skemës së Ndhmës Ekonomike. Masa e Ndhmës Ekonomike përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM nr. 597/2019). Ajo reflekton strukturën e familjes dhe skema e saj bazohet në një vlerësim të testimit të mjeteve dhe burimeve dhe familjet mund të jenë përfituese edhe nëse kanë disa burime të ardhurash. Pjesë e asistencës sociale janë edhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, transfertat “cash” që adresojnë personat me aftësi të kufizuara dhe, në rastet e paaftësisë së plotë, kujdestarët e tyre si dhe familjet në nevojë etj.

Sfidë e reformës për Ndhmën Ekonomike, vijon të mbetet masa e ulët e saj, nxjerrja nga skema të familjeve në rrezik të varfërisë, mos mbulimi i të gjitha kategorive vulnerabël, përfituese të ndihmës ekonomike dhe mangësia e akteve nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik dhe përshtatjen e

---

<sup>193</sup> Varfëria përkufizohet si një person që jeton me më pak se 5.5 dollarë amerikanë në ditë bazuar në fuqinë blerëse të rishikuar të vitit 2011 (PPP). Në maj 2020, PPP 2011 ky vlerësim u rishikua duke rezultuar në 5,5 dollarë amerikanë në ditë. Ky rishikim pasqyron një rivlerësim të krahasimeve të kostos së jetesës midis vendeve, por nuk nënkupton një ndryshim real të varfërisë brenda vendeve (<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/33623/9781464815300.pdf>).

<sup>194</sup> <https://albania.un.org/sites/default/files/202204/UN%20Albania%20Annual%20Progress%20Report%202021.pdf>

<sup>195</sup> <https://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/income-and-living-conditions-in-albania/publication/2022/income-and-living-conditions-in-albania-2021/>

<sup>196</sup> Privimi i rëndë material përkufizohet si përqindja e popullsisë me mungesë të detyruar prej të paktën 4 nga 9 sendet e privimit material.

<sup>197</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Vler%C3%ABsim%20mbi%20qasjen%20dhe%20perdorimin%20familjar%20te%20transfertave%20te%20MS.pdf>

kësaj mase në planin kohor, si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave të qytetarëve<sup>198</sup>.

Monitorimi i masave për uljen e varfërisë, nxitjen e përfshirjes sociale dhe respektimin e të drejtës për kujdes dhe përfshirje sociale është një nga përparësitë e institucionit të Avokatit të Popullit, sepse këto masa do të ndihmojnë në çlirimin e potencialit të konsiderueshëm njerëzor të pashfrytëzuar në Shqipëri, si dhe uljen e ndikimit pengues të pabarazisë mbi rritjen ekonomike dhe integrimin shoqëror. Gjatë vitit 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar raste të paraqitura nga ankesat e qytetarëve, apo të trajtuara me iniciativë. Referuar ankesave të regjistruara gjatë këtij viti, rezulton të jenë regjistruar 35 të tilla, nga të cilat 10 janë të nisura me iniciativë.

Për trajtimin e këtyre rasteve, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer hetime administrative, të cilat janë përmbyllur me zgjidhjen e tyre në favor të qytetarëve dhe/ose sqarimin e ankuesve lidhur me shkaqet ligjore të ndërprerjes apo të mospërfitimit të ndihmës së kërkuar, shoqëruar me sugjerimet përkatëse për zgjidhjen e problematikës së trajtuar si dhe duke adresuar problematikat nëpërmjet rekomandimeve drejtuar institucioneve përgjegjëse. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për 19 ankesa është përmbyllur shqyrtimi dhe janë adresuar 8 rekomandime institucioneve përgjegjëse, ndërsa të tjerat vijnë ende të jenë në proces hetimi administrativ.

Problematikat më të spikatura të evidentuara në rastet e trajtuara gjatë këtij viti janë:

- masa e ulët e ndihmës ekonomike dhe pamundësia për të përballuar shpenzimet e jetesës;
- pamjaftueshmëria e fondeve të dedikuara për ndihmën ekonomike për të plotësuar nevojën për kujdes social ndaj grupeve vulnerabël;
- pezullimi dhe ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike, përjashtimi nga skema e ndihmës ekonomike për arsye të ndryshme, gjatë përdorimit të sistemit elektronik për pikëzimin. Regjistri elektronik kombëtar është krijuar më qëllimin për përshpejtimin e procesit dhe uljen e rasteve abuzive, por pa krijuar pengesa. Çdo sistem është i ndërtuar nga njeriu dhe duhet të përmirësohet për të realizuar qëllimin e vënies së tij në punë, që është vlerësimi i drejtë i nevojave dhe trajtimi i të gjithë aplikuesve në mënyrë të barabartë. Nga ana tjetër, misioni i organeve shtetërore është të adresojnë nevojat e qytetarëve dhe të mos kufizohen në zbatimin pa analizë të “rezultateve” të sistemeve dixhitale të bazuara në vendimmarrjen automatike sipas algoritmave të inteligjencës artificiale;
- paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike. Kjo si për shkak të nivelit të ulët arsimor e aksesit të kufizuar në informacion të personave që i përkasin grupeve vulnerabël të cilët shpesh penalizohen nga sistemi i pikëzimit, dhe nuk përfitojnë ose humbasin mbështetjen si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë, ashtu dhe nga mungesa e ndarjes së informacionit me kategoritë e interesuara, mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori nga institucionet përgjegjëse, që sjell rrjedhimisht edhe mungesë të aksesit të tyre në këto shërbime. Ndërkohë që nuk rezulton që të zbatohet për këto raste karta e të drejtave të qytetarëve që marrin shërbime publike;
- nevoja për ngritjen apo forcimin e kapaciteteve ekzistuese të njësive administrative dhe aktorëve pjesë e mekanizmit referues, për garantimin e zbatueshmërisë korrekte të kuadrit ligjor,

<sup>198</sup><https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>.

informimin në kohë dhe korrekt të kategorive në nevojë, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, me qasje proaktive për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve. Në këtë këndvështrim, njohja dhe zbatimi korrekt i ligjit është element thelbësor jo vetëm për imazhin e administratës publike, e cila duhet të përfaqësojë një trup të specializuar nëpunësish që shërbejnë në funksion të interesit më të lartë publik, por dhe për zgjidhje afatgjatë të problematikave të hasura nga qytetarët;

- buxhetet e kufizuara në nivel lokal për adresimin e përshtatshëm të politikave sociale;
- mungesa e të ardhurave si rrjedhojë e mospërfitimit të ndihmës ekonomike, në ato familje ku të ardhurat mungojnë ose janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet minimale të jetesës, sjellin rrjedhimisht edhe problematika të tjera lidhur me kostot për të përballuar një strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të qëndrueshëm, si dhe mundësitë për aksesin në shërbimet e punësimit dhe të shëndetësisë. Për më tepër, në familjet që kanë dhe fëmijë, këto pasoja prekin edhe aksesin e tyre në arsim;
- problematika e familjeve apo individëve në nevojë që banojnë në njësitë e largëta e me terren të vështirë, të cilët hasin vështirësi për të aplikuar për Ndihmë Ekonomike, por edhe në aksesin në shërbime të tjera si shëndetësore, të punësimit e arsimimit, për shkak të mungesës së transportit apo pamundësisë për të përballuar shpenzimet lidhur me të.

Avokati i Popullit vlerëson se këto gjetje janë të përsëritura dhe se ka munguar adresimi efektiv i tyre nga institucionet përgjegjëse. Referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të cilat hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit përkatës<sup>199</sup>, evidentojmë:

#### 3.17.1. Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës<sup>200</sup>

- përmarrjen e masave për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Kukës me fokus njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor të Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë, të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend si dhe rolin e Avokatit të Popullit.

#### 3.17.2. Rekomandimi drejtuar Bashkisë Divjakë:

- Për marrjen e masave për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional dhe realizimin e trajnimeve për punonjësit e Bashkisë Delvinë, për njohjen e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e pushtetit vendor dhe rolin e tyre, atë të mbrojtjes sociale, rolin e Avokatit të Popullit si dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vend.
- marrjen e masave të nevojshme bazuar në legjislacionin në fuqi, për një zgjidhje të problemit të strehimit të familjes J.<sup>201</sup>

<sup>199</sup> Gjatë vitit 2023 janë hartuar 7 rekomandime drejtuar institucioneve përgjegjëse vendore, që lidhen me fushën e të drejtës për kujdes social, dhe një rekomandim drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.

<sup>200</sup> Nr. Dok.202201256, Shkresa nr K1/K10-10 datë 06.03.2023. (*Bashkia Kukës nuk i është përgjigjur rekomandimit të Avokatit të Popullit.*)

<sup>201</sup> Nr. Dok. 202201593, Shkresa nr. K1/ I122-6 Prot., datë 08.03.2023. (*Bashkia Divjakë ka pranuar rekomandimin e Avokatit të Popullit. duke marrë masat e nevojshme*)

3.17.3. *Rekomandimi drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier*<sup>202</sup>

- për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe marrjen e masave për një vlerësim serioz të mënyrës se si do të trajtohen në vijim çështjet sensitive të pakicave kombëtare, në territorin nën juridiksionin e saj, por dhe të shtresave në nevojë që mbështeten nga shteti shqiptar me programet e mbrojtjes sociale, duke patur një qasje bashkëpunuese, përmbajtësore dhe një shkëmbim të drejtë të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin atyre.

3.17.4. *Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës*<sup>203</sup>

- për marrjen e masave të menjëhershme për hartimin e programit të strehimit për shtresat në nevojë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar strehim të qendrueshëm dhe të përshtatshëm për znj. B.S. në vlerësim të nevojave të familjes dhe parashikimeve të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe akteve nënligjore përkatëse.

3.17.5. *Rekomandimi drejtuar Bashkisë Shkodër*<sup>204</sup>

- për marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin e kushteve social-ekonomike, ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për Znj. V. S.

3.17.6. *Rekomandimi drejtuar Bashkisë Këlcyrë*<sup>205</sup>

- për marrjen e masave për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni juaj çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe një shkëmbim të drejtë e shterues të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.
- për marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit/ve të Bashkisë Këlcyrë që nuk ka/kanë përmbushur dhe nuk përmbush/përmbushin detyrimin ligjor në marrëdhënie me institucionin e Avokatit të Popullit apo me subjektin ankues.

---

<sup>202</sup>Nr. Dok. 202201267, Shkresa nr. K1/ I95-10 Prot., datë 08.03.2023. (*DRSHSSH Fier nuk ka pranuar rekomandimin e Avokatit të Popullit duke i mbetur qëndrimin të mëparshëm dhe duke minimizuar rastin me objekt disa familje rome, në çështjen e një familjeje të vetme*).

<sup>203</sup>Nr. Dok. 2023000255, Shkresa nr. K1/ D3-12 Prot., datë 25.07.2023. (*Bashkia Kukës nuk i është përgjigjur rekomandimit të Avokatit të Popullit*).

<sup>204</sup> Nr. Dok. 202300529, Shkresa nr. K1/V4-9 Prot., datë 30.11.2023. (*Bashkia Shkodër nuk i është përgjigjur rekomandimit të Avokatit të Popullit*).

<sup>205</sup> Nr. Dok. 202200629, shkresa nr. K1/H3-8 Prot., datë 06.12.2023. (*Bashkia Këlcyrë nuk i është përgjigjur rekomandimit të Avokatit të Popullit*).

### 3.17.7. Rekomandimi drejtuar Bashkisë Kukës<sup>206</sup>

- për hartimin e një planpagese periodike mbështetur në mundësitë e kufizuara financiare të familjes A., si familje në nevojë, me qëllim shlyerjen e detyrimit nga familja A., të lindur për shkak të mos përcaktimit të pjesëtarit të familjes, znj. M.A si person me aftësi të kufizuara, për periudhën mars 2021- maj 2023;
- për krijimin e një politike të konsoliduar për të adresuar problematika të ngjashme, nëpërmjet mekanizmit të planpagesave periodike;
- për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstucional si dhe marrjen e masave për një vlerësim serioz të *mënyrës sesi trajtohen nga institucioni juaj çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe një shkëmbim të drejtë e shterues të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.*

### 3.17.8. Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Shëndetsisë<sup>207</sup>

- për marrjen e masave për të koordinuar dhe vlerësuar në vazhdimësi problematikat që shfaqen nga përdorimi i sistemeve elektronike të bazuar në vendimmarrjen automatike, si dhe zbatimin e një politike me qasje dhe qëllim drejt realizimit të përmirësimit efektiv të sistemeve elektronike, duke vlerësuar mundësitë alternative të ndërhyrjes për të shmangur gabimet e sistemeve që krijojnë pabarazi dhe ndikojnë në zgjerimin artificial të pabarazisë shoqërore apo ekonomike.

Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale, por gjithsesi ndërhyrjet mbeten të kufizuara në kohë dhe masa e ndihmës ekonomike vijon të raportohet nga qytetarët në ankesat e tyre edhe përgjatë këtij viti, si vlerë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar, e pamjaftueshme të zbusë varfërinë dhe të mundësojë integrimin social të individëve dhe familjeve në nevojë. Shqipëria ende vijon të mbetet një ndër vendet që nuk e ka të përcaktuar ligjërisht minimumin jetik, llogaritja e tij shërben si një tregues për të përcaktuar kufirin real të varfërisë, për të ndarë individin e varfër nga jo i varfër. Ky tregues duhet të qëndrojë në themel të hartimit të politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë<sup>208</sup>. Një vlerë e përditësuar dhe e miratuar e minimumit jetik ndihmon për të përcaktuar sa i duhen minimalisht një qytetari për të jetuar, si dhe normën minimale të ndihmës ekonomike, pensioneve, pagesës së papunësisë, etj. Legjislacioni duhet të parashikojë format dhe mjetet se si duhet të aplikohet ky minimum, deri sa të mundësojë që çdo qytetar të përfitojë lehtësisht një garanci të tillë që të sigurojë jetesë dinjitoze me shërbimet bazike dhe të këtë të mundur pjesëmarrjen aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar<sup>209</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se varfëria nuk është vetëm mungesë e të ardhurave, por edhe mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të

<sup>206</sup> Nr. Dok. 202300675, shkresa nr. K1/SH5-7 Prot., datë 18.12.2023. (*Bashkia Kukës nuk i është përgjigjur rekomandimit të Avokatit të Popullit*).

<sup>207</sup> Nr. Dok. 202300529, shkresa nr. K1/V4-10 Prot., datë 18.12.2023 (*Ministria e Financave ka pranuar rekomandimin e Avokatit të Popullit duke parashikuar marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit të skemës së mbrojtjes sociale dhe ndërveprimin e tij me sistemet e tjera në funksion të referimit dhe ndjekjes së situatës së familjeve/individëve në nevojë*).

<sup>208</sup> Avokati i Popullit ka përgatitur raportin e veçantë “Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri”(2020).

<sup>209</sup> Raporti sugjeron ndryshimin e ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshirjen si dispozitë të veçantë të përkufizimit të minimumit jetik.



njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standartet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore.

---

### 3.18 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara<sup>210</sup>

---

Institucioni i Avokatit të Popullit prioritet të punës së tij ka gjithashtu edhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Për vetë natyrën e punës dhe kompetencave të tij, Avokatit i Popullit ka vlerësuar gjithmonë me përparësi fenomenet shqetësuese me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara, duke e orientuar një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së tij në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Referuar çështjeve të regjistruara për vitin 2023, rezulton të jenë trajtuar 78 raste<sup>211</sup>, ku është përmbyllur hetimi administrativ për 46 çështje, ndërsa 22 të tjera vijojnë të jenë në proces shqyrtimi. Nga numri total i çështjeve të shqyrtuara, rezultojnë 25 çështje të zgjidhura në favor të qytetarëve. Konstatohet se problematikat më të spikatura, të shprehura në përmbajtjen e çështjeve të shqyrtuara, konsistojnë në sa më poshtë:

#### **1. Mosratifikimi nga shteti shqiptar i Protokollit Opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”**

Kjo çështje është prezantuar edhe në Raportin Vjetor 2022 dhe ka vijuar të trajtohet edhe përgjatë vitit 2023. Komiteti Drejtues për zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ka rekomanduar për shtetin shqiptar, ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës pa vonesë të mëtejshme.<sup>212</sup> Në përmbushje të këtij detyrimi nga shteti shqiptar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informon se do të vijojë proceset dhe do të merren masat përkatëse në lidhje me ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

#### **2. Mospërfitimi në masën 200% të pagesës mujore të aftësisë së kufizuar për personat, të cilët gëzojnë Statutusin e të Verbërit kur ndjekin Shkollën e Avokatisë**

Edhe për këtë problematikë, trajtimi i së cilës është iniciuar që në vitin 2022, Avokati i Popullit ka vijuar ndërhyrjen institucionale, duke sjellë sistematikisht në vëmendje faktin se punësimi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara dhe në këtë kontekst të qënurit në punë si avokat privat, krijon të ardhura jo vetëm për personin me aftësi të kufizuara, por edhe për familjarët e tyre duke mundësuar në këtë mënyrë përmbushjen e atij që është synimi parësor, integrimi në jetën shoqërore të kësaj kategorie, me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së tyre.

---

<sup>210</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>211</sup> 57 ankesa dhe 21 raste të marra me iniciativë.

<sup>212</sup> Rezoluta e datës 25.09.2019, pika 10.

Për mundësi të barabarta, pjesëmarrje dhe përfshirje të plotë dhe efektive në shoqëri, Avokati i Popullit ka dërguar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rekomandimin:

**3. Për marrjen e nismës për një shtesë në pikën 2, Kreu III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.182, datë 26.02.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, si dhe të ndihmës personal”, i ndryshuar**

Pas insistimit institucional për marrjen në konsideratë të këtij rekomandimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përgjigjen e saj parashton se *rekomandimi do të vlerësohet gjatë rishikimit të legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar, sipas Planit Analitik të Akteve.*

**4. Vlerësimi i Aftësisë së Kufizuar nga Komisioni Bio-Psiko-Social**

Me zbatimin e skemës së re të vlerësimit Bio-Psiko-Social për personat me aftësi të kufizuara, janë adresuar ankesa, të cilat kanë patur si objekt: mosdhënie të grupit të invaliditetit; ndryshim të grupit të invaliditetit/nivelit të aftësisë së kufizuar; heqjen e statusit të invalidit paraplegjik/tetraplegjik dhe për pasojë mospërfitim të mbulimit të shpenzimeve për paketën higjieno-sanitare. Për adresimin e këtyre problematikave edhe përgjatë këtij viti, institucioni i Avokatit të Popullit u është drejtuar Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar ku ankuesit kanë vendbanimin e tyre si dhe Komisionit Mjekësor për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar pranë Shërbimit Social Shtetëror, të cilat në përgjigjet e tyre theksojnë se diagnozat mjekësore nuk janë përfshirë si kriter përfitues në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar mbi moshën 18-vjeç.

Për shqyrtimin e mëtejshëm të problematikave të prezantuara, Avokati i Popullit ka dërguar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rekomandimin:

- për marrjen në konsideratë të kërkesave të Avokatit të Popullit që disa diagnoza mjekësore, të cilat janë forma të paralizës dhe që janë hequr me zbatimin e kësaj skeme të re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të përfshihen si kriter mjekësor përfitues të Statusit të Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

*Ky rekomandim nuk është pranuar*, por Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shprehet se i ka në fokusin e saj çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka ndërmarrë reforma në këtë fushë duke adresuar çdo problematikë në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera përgjegjëse për implementimin e tyre.

**5. Mosdhënie e shpërblimit për festat e fundvitit 2022 dhe të vlerave financiare të akordura për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë dhe zbutjes së impaktit të krizës**

Për trajtimin financiar ligjor të mohuar për shtetasen A.Ç, përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar ndër vite, pas një analize të akteve nënligjore të nxjerra për dhënien e shpërblimit për festat e fundvitit 2022 dhe mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës dhe zbutjes së efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë si dhe të Vendimit të marrë nga KMCAP-i<sup>213</sup> - Epror P/T dhe Neurologji, si një akt juridik-mjekësor-administrativ, që ka fuqi ligjore ekzekutive<sup>214</sup>, i cili garanton

<sup>213</sup> Rivlerësimi i masës së pensionit të invaliditetit.

<sup>214</sup> Rregullore “Për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funkcionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, kreu III/4 Vendimmarrja.

të drejtën e saj për përfitim, si një të drejtë të fituar, Avokati i Popullit i dërgoi Drejtoreshës së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror rekomandimin:

- për dhënien e shpërblimit për festat e fundvitit 2022, shumat përkatëse nga mbështetja financiare për zbutjen e impaktit të krizës dhe zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë 3000 (tre mijë) lekë, 8000 (tetë mijë) lekë dhe 9000 (nëntë mijë) lekë;
- për dërgimin e listës së personave përfitues ose jo të grupit të invaliditetit menjëherë pas marrjes së vendimit nga Komisionet Bio-Psiko-Sociale të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar dhe të KMCAP-it Epror pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat më pas ia dërgojnë Bashkive.

Shërbimi Social Shtetëror e ka *pranuar plotësisht rekomandimin* dhe ndër të tjera informon se Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ka komunikuar me Njësinë Administrative përkatëse, ku ka kërkuar planifikimin e fondit për të kryer pagesat e mësipërme.

#### ***6. Mosmarrje përgjigje për datën e komisionimit të personave me aftësi të kufizuara nga Komisioni Mjekësor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, me qëllim përfitimin e grupit të invaliditetit***

Sjellim në vëmendje se pas ndërhyrjeve institucionale të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), edhe përgjatë këtij vitit, konstatohet një bashkëpunim i frytshëm, nëpërmjet marrjes në konsideratë të kërkesave për përsheptim të caktimit të datës së shqyrtimit të ankesave në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë SHSSH-së. Për kategorinë e personave, të cilët me vendim të Komisionit Mjekësor Epror të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar/ SHSSH-së, rezultojnë jo përfitues të grupit të invaliditetit, është përcjellë informacioni i detajuar ligjor për të drejtën e tyre për tu paraqitur përsëri për vlerësim në komision.

#### ***7. Mosrimbursim të biletave në transportin urban dhe interurban të personave me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim në qytetet Vlorë dhe Dibër***

Pavarësisht se kuadri ligjor specifik përcakton shprehimisht të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për rimbursimin e biletave të transportit urban dhe interurban,<sup>215</sup> këta të fundit vijnë të paguajnë të plotë biletën. Pas ndërhyrjes të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Bashkisë Vlorë dhe Dibër, nga ana e tyre u vlerësuan kërkesat dhe janë planifikuar fondet në Buxhetin e vitit 2024, me qëllim përjashtimin nga pagesa e këtij shërbimi të kategorive përfituese nga legjislacioni përkatës.

#### ***8. Mungesa e përshatshmërisë në infrastrukturën ndërtimore në Qendrat e Votimit***

Duke qenë se e drejta e votës së lirë, të fshehtë dhe të barabartë është një nga të drejtat themelore dhe të patjetërsueshme të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka vënë theksin te ushtrimi efektiv i kësaj të drejte nga të tëra grupet shoqërore në vend e në këtë kuadër vëmendje të shtuar ka marrë

---

<sup>215</sup> Neni 11 i ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, ka përcaktuar se: “Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban”.

Neni 11 i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar, ka përcaktuar se: “Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, bashkë me shoqëruesin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat, ndërsa udhëtimi interurban rimbursohet nga shteti në masën 50 për qind të vlerës”.

krijimi i kushteve të përshtatshme për të ushtruar këtë të drejtë për personat me aftësi të kufizuara, me akses të garantuar në qendrat e votimit<sup>216</sup>.

Është domosdoshmëri që në çdo qendër votimi duhet të ketë një standard minimal kushtesh që lehtëson aksesin gjatë gjithë procesit të votimit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, të cilat lidhen me sigurimin dhe vënien në funksionim të logjistikës së nevojshme si dhe të përcaktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit. Respektimi i këtyre kushteve duhet të vlerësohet nga ana e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmbushjen e plotë dhe të përshtatshme të tyre.

Në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2023, Avokati i Popullit u është drejtuar me rekomandim kryetarëve të bashkive në vend:

- për marrjen e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e ushtrimit lirisht të së drejtës së tyre kushtetuese, të votës, në Zgjedhjet Vendore, më datë 14 Maj 2023<sup>217</sup>.

Avokati i Popullit vë theksin se mungesa e lehtësive të përshtatshme për votimin e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, mund të konsiderohet edhe si një kufizim apo pengesë, ndaj të drejtës së tyre të votës. Gjithashtu, në kuadër të veprimtarisë së institucionit për monitorimin paraprak të përgatitjeve për procesin zgjedhor për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, Avokati i Popullit iu drejtua Komisionit Rregullator Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke i rekomanduar:

- përmirësimin, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, para zgjedhjeve të ardhshme për organet e qeverisjes vendore, të Udhëzimit nr. 1 datë 5.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ;
- shtimin e parashikimeve të detajuara në këtë udhëzim, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK në qendrat e votimit, si dhe për çështjet e parashtruara në rekomandimin të Avokatit të Popullit<sup>218</sup>;
- parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët mundësojnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Me vendimin nr. 11, datë 20.03.2023, të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së<sup>219</sup> është vendosur që në Udhëzimin ekzistues nr. 1, datë 5.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për

---

<sup>216</sup> Detyrimi për t’iu garantuar personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, rrjedh ndër të tjera specifikisht, nga Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

<sup>217</sup> Kanë kthyer përgjigje vetëm 11 Bashki (Rrogozhinë, Tiranë, Pogradec, Divjakë, Cërrik, Elbasan, Peqin, Kuçovë, Ura-vajgurore, Kurbin, Mirditë), të cilat kanë konfirmuar faktin e marrjes së masave për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke vendosur kryesisht qendrat e votimit në katet e para, si dhe duke caktuar personel ndihmës për të mundësuar ushtrimin lirisht të të drejtës së votës.

<sup>218</sup>Nr. K1/S4-2, datë 06.04.2021

<sup>219</sup> Vendim “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020 të komisionit rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.”

zgjedhjet” të bëhen disa amendime, të cilat janë adresuar edhe më herët nga institucioni i Avokatit të Popullit<sup>220</sup>. Nga vlerësimi i kujdesshëm i këtyre amendimeve vërehet se Udhëzimi është përmirësuar, duke disiplinuar rregullat minimale teknike që duhet të plotësojnë qendrat e votimit me qëllim aksesimin edhe nga personat me aftësi të kufizuara, si nga pikëpamja e vendosjes së hapësirave që mundësojnë aksesin në këto qendra, por edhe duke hequr togfjalëshin “si rregull” në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 8 të këtij Udhëzimi. Kështu, sipas udhëzimit të KQZ-së, për të gjitha qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara, Kryetari i njesisë së vetqeverisjes vendore duhet të caktojë ambientet e votimit vetëm në katet e para.

### **9. Mungesa e infrastrukturës ndërtimore në godinat e Bashkisë Dibër dhe Tepelenë**

Aksesueshmëria është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut që është liria e lëvizjes, e drejta për të marrë normalisht shërbimet publike në të gjitha fushat e jetës, e drejta e informimit dhe komunikimit që lidhet me lirinë e çdo njeriu për t’u përfshirë në mënyrë aktive në jetën publike dhe politike të vendit. Mospasja akses në infrastrukturë, sjell efekte negative në arritjen e marrjes së informacionit nga personat me aftësi të kufizuara, krijon vështirësi për këtë kategori, të cilët duhet domosdoshmërisht që të shoqërohen nga një person tjetër. Nëse nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, nuk mund të arrihet të marrja e informacionit. Prandaj, aksesueshmëria ose qasja, vlerësohet si një parakusht për realizimin e të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Për garantimin e të drejtave për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim në infrastrukturën ndërtimore, Avokati i Popullit i ka dërguar Kryetarëve të Bashkive, rekomandimin për:

- marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe në shikim në godinën e Bashkisë Tepelenë;
- miratimin e një plani masash, sipas standardeve të elementëve të përshtatshmërisë, duke përfshirë në këtë proces edhe këta personam
- përcaktimin e një afati kohor të përshtatshëm për realizimin e kësaj të drejte;
- marrjen e masave që shërbimet digjitale të jenë miqësore për personat me aftësi të kufizuara.

Në Ditën Ndërkombëtare të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit, me anë të një një mesazhi sensibilizues, iu drejtua të gjitha strukturave shtetërore që ta trajtojnë me prioritet nevojën për një jetesë të pavarur dhe me dinjitet të personave me aftësi të kufizuara dhe së bashku për të kultivuar një mjedis që krijon mundësi për të gjithë dhe heqjen e barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e barabartë

---

5 a) Shkronja “b”, e pikës 3, e nenit 5 ndryshohet si më poshtë vijon: “b) zbatimin e rregullave teknike sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara me qëllim aksesimin e tyre në qendrën e votimit duke siguruar së paku që: i. Hyrja për në qendrën e votimit të ketë kalim të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme, ii. Dyert e hyrjes për në çdo qendër votimi (hyrja kryesore dhe hyrja brenda QV-së) të lejojnë kalimin me lehtësi edhe nga personat në karriqe me rrota. Pragu i derës përpara dhe pas saj të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqet e ambienteve.”

b) Pas pikës 3, të nenit 5, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij neni, me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bashkitë dërgojnë informacionin për masat e marra, brenda 10 ditëve nga marrja e saj.”

c) Në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 8, fjalët “...si rregull...” hiqen.

në shoqëri. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se kërkohet ndërgjegjësimi i të gjithë shoqërisë për të qënë pjesëmarrës aktivë në procesin e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

---

### 3.19 Barazia gjinore<sup>221</sup>

---

Avokati i Popullit konstaton se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në mbrojtje të të drejtave të grave, kryesisht për mbrojtjen nga dhuna me të gjitha format e saj. Qeveria ka miratur Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Ngritja e strukturave të posaçme dhe përpjekjet për fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, fushatat ndërgjegjësuere në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve gjinore, janë veprime që çojnë në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna. Po kështu, Shqipëria është palë në Konventat specifike, që adresojnë të drejtat e grave sipas së cilave, ka detyrimin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve të rëndësishme duke harmonizuar legjislacionin e brendshëm me to, si dhe përbushjen e rekomandimeve të dhëna nga komitetet e ekspertëve.

Me gjithë masat e marra vihet re se gratë dhe vajzat përjetojnë situata pabarazie dhe diskriminimi, ndërsa duke iu referuar shifrave zyrtare, dhuna ndaj grave me të gjitha format e saj, nga viti në vit, ka pësuar rritje<sup>222</sup>. Përgjatë vitit 2023, problematikat e evidentuara nëpërmjet ankesave, rasteve me iniciativë, ditëve të hapura, pjesëmarrjes në tryeza të rumbullakta, dhe çështjeve të përcjella nga shoqëria civile kanë konsistuar më së shumti në dhunën ndaj grave/vajzave me të gjitha format e saj, e më specifikisht:

- dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave minorene, e raportuar më shpesh nga mediat, përbën një problem shqetësues, gjë e cila ka treguar se institucionet përgjegjëse duhet të shtojnë vëmendjen ndaj kësaj problematike;
- problematikat e ngacmimit seksual në ambientet publike dhe bullizmi nëpërmjet platformave sociale kanë pësuar një rritje të dukshme. Fyerjet, shpifjet, gjuha e urrejtjes e përdorur në disa raste kanë shkaktuar situata dhune në familje deri tentativa për vetëvrasje;
- përdorimi i gjuhës seksiste në mediat audiovizive;
- gjatë procesit gjyqësor për zgjidhjen e martesës dhe lënien e fëmijëve për rritje e edukim, është evidentuar se gratë janë përballur me procedura të zgjatura për dhënien e vendimit përfundimtar, gjë e cila ka ndikuar në situata dhune verbale midis ish bashkëshortëve dhe gjuhë urrejtjeje apo privim të takimit me fëmijët e mitur;
- vrasja ndaj grave dhe vajzave ndërkaq është një nga format më ekstreme të dhunës. Femicidi po godet rëndë shoqërinë shqiptare. Që prej vitit 2010, mbi 159 gra dhe vajza u mungojnë familjeve shqiptare. Vetëm për vitin 2023 rezultojnë 10 gra të vrara;
- problemet e shëndetit mendor me të cilën përballlet sot shoqëria, bëhen më të rënda në rastet e dhunës në familje, ku vazhdon të konstatohet vështirësi në menaxhimin e rasteve të tilla nga shërbimet sociale në bashkitë e vendit.

---

<sup>221</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>222</sup> Të dhënat e INSTAT, referuar botimit “Burra dhe gra në Shqipëri”, kanë treguar se gjatë vitit 2022, rreth 70,2% të viktimave të dhunës në familje dhe 81,8% viktimave të dhunës seksuale kanë qënë gra.

Referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me problematikat e sipërpërmenduarat evidentojmë, si më të spikaturin, çështjen e bërë publike nëpërmjet medias, OraNews TV<sup>223</sup>, e trajtuar me iniciativë nga Seksioni i Përgjithshëm, në të cilën ngrihej shqetësimi se: *“Vajzat në Qytetin Studenti ndjeheshin të pasigurta, për shkak të ngacmimeve seksuale, shpesh deri në përndjekje. Lëvizja për Universitetin ka protestuar ndaj kësaj situatë, duke kërkuar më tepër mbrojtje nga ana e policisë për vajzat që jetojnë në Qytetin Studenti, sidomos në orët e vona të natës, orë në të cilat nuk sigurohet kjo mbrojtje”*.

Pas ndërhyrjes insitucionale nga ana e Avokatit të Popullit, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, rezultoi se u ndërmorrën masat e mëposhtme nga ana e këtyre institucioneve:

- u përforcuan shërbimet e komisariatit në territorin e Qytetit Studenti, sidomos në orët e vona të natës, dhe duke komunikuar herë pas here me personelin që shërben pranë sporteve të godinave të studentëve;
- punonjësit e Postës së Policisë kanë bashkëpunuar me Drejtorinë e konvikteve në Qytetin Studenti, duke organizuar takime me studentët në konvikte. Sipas informacionit të dhënë gjatë takimeve nuk është ngritur më shqetësimi lidhur me ngacmime seksuale, përndjekje apo forma të tjera të dhunë në drejtim të tyre;
- drejtuesit e Komisarariatit Nr.1, në mënyrë të vazhdueshme japin detyra dhe porosi për punonjësit e policisë së zonës, që të ushtrojnë kontrole të vazhdueshme në hyrje, rreth godinave si dhe në ambjentet e jashtme të pushimit për studentët/studentet me qëllim parandalimin e ndonjë ngjarje kriminale;
- drejtorja e Ndriçimit Publike të Bashkisë Tiranë, ka marrë masat për vendosjen e ndriçimit publik në territorin e Qytetit Studenti, duke zgjidhur problematikën.

Ndërsa referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të cilat hetimi administrativ është përmblyllur me hartimin e rekomandimit përkatës, evidentojmë:

- rekomandimi i Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili iu drejtua të gjitha bashkive në vend për “Marrjen e masave nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për sigurimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri, në zbatim të legjislacionit shqiptar, si edhe në përputhje me dokumentat ndërkombëtare të nënshkruara e ratifikuara nga Shqipëria dhe frymën e Konventës CEDAW, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në përfaqësimin e secilës gjini në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri”. Deri në fund të vitit 2023, 48 bashki kanë pranuar rekomandimin duke treguar angazhim për respektimin e ligjit dhe marrjen e masave për përmirësimin e balancës gjinore në organet e emëruara të vetëqeverisjes vendore;
- rekomandimi i Avokatit të Popullit për “Marrjen e masave për disa ndryshime legjislative, me theks parandalimin e seksizmit në media dhe trajtimin e problemeve të gjeneruara nga ky fenomen”<sup>224</sup>, drejtuar institucioneve përgjegjës për të ndërmarrë iniciativën ligjore për ndryshimet përkatëse.
- 

<sup>223</sup> Linku: <https://www.oranews.tv/vendi/mbroni-vajzat-tek-qyteti-studenti-levizja-per-universitetin-kerkon-reagim--i1074107>.

<sup>224</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rek.%20ndryshime%20ligjore%20lidhur%20me%20seksizmin%20ne%20media.pdf>.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i situatës së dhunës ndaj grave dhe vajzave, duke marrë shkak edhe nga një vlerësim i kryer nga shoqata “Gruaja shqiptare në Audiovizual AWA”, me temë “Seksizmi në median audiovizive. Analizë e legjislacionit vendas dhe detyrimi për përafrim legjislacioni me standardet europiane”<sup>225</sup>, Avokati i Popullit konstatoi se media audiovizive, në mënyra të ndryshme, përfshirë dhe programet që transmeton, shpesh kontribuon në shkelje të të drejtave të grave dhe vajzave. Steriotipet gjinore, pabarazia, seksizmi dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave, shfaqen herë pas here nëpërmjet sjelljeve, komenteve dhe shakave seksiste, të cilat edhe pse tentohet të shfaqen si të padëmshme, në fakt janë poshtëruese dhe përuhin gratë dhe vajzat, dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime psikologjike ose socio-ekonomike, në disa raste edhe fizike e seksuale.

Pas rekomandimit të dërguar në muajin prill 2023, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku u përfshi dhe përkufizimi i seksizmit në media, ndërsa me Vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi Kodin e Transmetimit të Mediave Audiovizive, ku është shtuar një kapitull i veçantë, i cili ka parashikime lidhur me luftën kundër seksizmit dhe protretizimit të stereotipeve gjinore në përmbajtjen mediatike audiovizive, duke përfshirë kështu edhe masat rekomanduese të dhëna nga Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit konstaton se përgjatë vitit 2023, raportimi i rasteve të cenimit të grave dhe vajzave u intensifikua. Ngjarje të rënda tronditën disa herë publikun, që nga dhuna fizike, abuzimi seksual dhe përdhunimi, deri në vrasje. Avokati i Popullit nëpërmjet deklaratave zyrtare të publikuara në faqen zyrtare<sup>226</sup>, si dhe në rrjetin social Facebook u ka kërkuar dhe bërë thirrje urgjente:

- institucioneve përgjegjëse për çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, që të reagojnë sa më shpejt për krimet e ndodhura, nëpërmjet një analize të thellë ku të përfshihen të gjitha hallkat e sistemit që punojnë në mbrojtjen, garantimin dhe mbështetjen për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, që krime të tilla të rënda të mos përsëriten;
- policisë, prokurorisë dhe gjykatave të analizojnë pa vonesë rastet e ndodhura dhe të tregojnë zero tolerancë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke patur parasysh ndjeshmërinë gjinore;
- të gjitha insitucioneve në nivel qendror dhe vendor, që kanë përgjegjësi ligjore, të marrin të gjitha masat për rehabilitimin e dhunuesve, si dhe për të shtuar dhe shtrirë në të gjithë vendin shërbimet mbështetëse të specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore apo për të fuqizuar ato ekzistuese;
- sistemit arsimor të punojë me përkushtim për edukimin e brezit të ri me parimet e drejtësisë dhe barazisë gjinore, për ta bërë të papranueshme dhunën në çdo formë të saj, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit;

---

<sup>225</sup> <https://vizionalsherbim.website/albanianwomaninaudiovisual.com/wp-content/uploads/2021/11/studimi-arsyetimi-ligjor-per-propozimet-ligjore-AWA.pdf>.

<sup>226</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/avokati-i-popullit-ngre-zrin-kundr-vrasjes-s-grave-n-shqipri-903/>.  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/avokati-i-popullit-shnon-8-marsin-ditn-ndrkombtare-t-gruas-905/>



- medias të trajtojë me profesionalizëm raste të tilla, për të qënë një aleate në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- publikut të gjerë, grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të distancohen dhe dënojnë krime të tilla, të cilat janë një minim për demokracinë, të drejtën e jetës dhe të drejtat e njeriut.

Sjellim në vëmendje se vrasja e grave dhe vajzave është një nga format më ekstreme të dhunës. Femicidi po godet rëndë shoqërinë shqiptare. Konstatohet se ndër vite ka munguar një analizë e mirëfilltë sidomos për shkaqet e vrasjeve, vetëvrasjeve të grave/vajzave dhe dëmtimi i shëndetit për shkak të dhunës. Ka analiza të pjesshme të kryera nga shoqëria civile lidhur me punën e strukturave shtetërore përgjegjëse për të parandaluar krime të tilla. Për të analizuar qartë të dhënat dhe shkaqet përse ndodhemicidi dhe të veprimeve të kryera nga institucionet, si dhe përgatitjen e raporteve periodike me gjetje dhe rekomandime adresuar institucioneve, Avokati i Popullit ka kërkuar mbështetjen e UNWOMEN për ngritjen e një mekanizmi, Observatori për Femicidet, iniciativë e cila pritet të finalizohet në muajt e parë të vitit 2024.

Në kuadër të mandatit të tij ligjor si promovues i të drejtave të grave dhe vajzave, avancimit të barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë qënë pjesë e tryezave të rrumbullakta si dhe aktiviteteve të organizuara nga institucionet dhe shoqëria civile si në kuadër të ditës ndërkombëtare të grave më 8 Mars, 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, dhe përtej këtyre ditëve, duke përsëritur qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me fuqizimin e grave dhe vajzave, rritjen e buxheteve qendrore dhe vendore për të adresuar çështjet e dhunës ndaj grave, fuqizimit të strukturave sociale dhe rolit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkitë e vendit, për të garantuar mbështetjen e menjëhershme për viktimat e dhunës në familje, zbatimit të ligjit me korrektësi, etj. Avokati i Popullit i bashkohet si çdo vit Fushatës së 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, që organizohet nga 25 nëntor- 10 dhjetor, nën fushatën globale UNITE të OKB<sup>së</sup>. Fushata e vitit 2023 u zhvillua nën sloganin “Investoni për të Parandaluar Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave”. Në koordinim me aktivitetet e fushatës, cover i faqes zyrtare të AP u vesh me ngjyrën portokalli, simbol i luftës kundër dhunës ndaj grave, me mesazhin “Asnjë justifikim për dhunës ndaj grave dhe vajzave”. Nëpërmjet deklaratës zyrtare në datën 25 nëntor<sup>227</sup>, në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Avokati i Popullit i është bashkuar zërit të çdo individi, komuniteti dhe organizate në angazhimin e palëkundur për të çrrënjësuar të gjitha format e dhunës ndaj grave, jo vetëm përgjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, por dhe përtej këtyre ditëve.

Konventat për të drejtat e grave, monitorimi për zbatimin e tyre, është një tjetër drejtim i punës. Në muajin tetor në ambjentet e Avokatit të Popullit u zhvillua një takim me përfaqësues të Grupit të Ekspertëve për Monitorimin e Konventës së Stambollit GREVIO, të cilët në kuadër të raundit të II tematik të monitorimit, për periudhën 2017-2022, “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi, për gratë viktime të dhunës në familje dhe me bazë gjinore”, bashkëbiseduan dhe kërkuan informacione, opinione dhe vlerësimet e Avokatit të Popullit lidhur me situatën e të drejtave të grave dhe dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën. Rezultatet dhe rekomandimet për Qeverinë Shqiptare priten të dalin në një raport të veçantë në qershor të vitit 2024.

<sup>227</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/avokati-i-popullit-solidarizohet-me-nismn-pr-16-ditt-e-aktivizmit-kundr-dhuns-ndaj-grave-960/>.

Të dhënat statistikore dhe ndarja sipas gjinisë si dhe publikimi i tyre, janë mjaft të rëndësishme për të kuptuar më mirë trendin e avancimit të barazisë gjinore, janë baza për analiza të thelluara lidhur me ndarjen e roleve gjinore, apo shkaqeve që çojnë në diskriminim. Në kuadër të Memorandimit të Bashkëpunimit të vitit 2020<sup>228</sup>, Avokati i Popullit bashkëpunon me INSTAT, lidhur me përgatitjen e Kapitullit “Të drejtat e Njeriut”, për botimin e përvitshëm “Burra dhe gra në Shqipëri”. Sipas botimit më të fundit të lançuar nga INSTAT në korrik 2023, “Burra dhe Gra në Shqipëri 2023”<sup>229</sup>, rezulton se: “Për të gjitha llojet e ankesave që i adresohen Avokatit të Popullit, në vitin 2022, ankesa të paraqitura nga burrat për pretendim shkeljeje të së drejtave sipas llojit janë 843 ankesa (52,2%) dhe 472 ankesa janë paraqitur nga gratë (29,3%). Ankesa për shkeljeje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë, për vitin 2022 janë 229 (18,5%). Në totalin e ankesave për pretendim shkeljeje të së drejtave, shumica e tyre i përkasin të drejtave në grupin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore”.

Gjatë vitit 2023, është patur në fokus dhe inspektimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara emergjente pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, për viktimat e dhunës në familje, të cilat duhet të funksionojnë duke zbatuar jo vetëm standardet kombëtare në fuqi, por edhe duke konsideruar standardet ndërkombëtare, sidomos ato të theksuara në Konventën e Stambollit. Këto inspektime u kryen në Qendrën për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen, Durrës dhe Qendrën e Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet në Familje, Gjirokastrë. Avokati i Popullit ndërsa mirëpret të gjitha përpjekjet dhe masat e ndërmarra nga Qeveria dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për t’u përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës me shërbime të specializuara, duke alokuar edhe fonde nëpërmjet Mekanizmit të Fondit Social, vazhdon të konstatojë se këto shërbime duhet të përmirësohen thelbësisht, të shtohen në numër dhe të shtrihen në të gjithë vendin, të jenë të aksesueshme dhe të arritshme për të gjitha grupet e grave së bashku me fëmijët e tyre.

Që prej janarit 2020, Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen është ngritur në Bashkinë e Durrësit, si një model shërbimesh në kuadër të Reformës Kombëtare për Shërbimet Sociale dhe Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Shërbimi i emergjencës u ofrohet individëve, viktimat të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre si dhe atyre pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar, që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin. Analiza e informacionit të grumbulluar gjatë inspektimit të realizuar, u përmbyll me përcjelljen pranë institucioneve përkatëse<sup>230</sup> të rekomadimit për: “Marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të funksionimit të Qendrës për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen- Durrës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të shërbimeve mbështetëse të specializuara”. Ky rekomandim është pranuar nga Bashkia Durrës dhe Shërbimi Social Shtetëror me angazhimin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit.

Qendra e Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet në Familje, është ngritur në Bashkinë e Gjirokastrës, që prej janarit 2020, si një shërbim emergjent, në kuadër të Reformës Kombëtare për

<sup>228</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/Memorandume-marreveshje/memorandum-and-agreement-516/>.

<sup>229</sup> <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>.

<sup>230</sup> Bashkisë Durrës, Qarkut Durrës, Prefektit të Qarkut Durrës, Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore si dhe për dijeni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Shërbimet Sociale dhe Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, si dhe bazuar në Planin Social të Bashkisë Gjirokastër. Qëllimi i kësaj Qendre është të sigurojë strehimin e sigurt dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psiko-emocionale, ndihmës ligjore dhe referimit në shërbim mjekësor, të punësimit dhe të strehimit falas për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe atyre në risk duke zbutur sadopak efektet e krizës që shkakton dhuna.

Rezultatet e inspektimit dhe vlerësimi i informacioneve në përputhje me legjislacionin për shërbimet e përkujdesit shoqëror dhe standardet për ofrimin e shërbimeve, u përmbyllën me rekomandimin për “*Marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të funksionimit të Qendrës së Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet në Familje, Gjirokastër, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të shërbimeve mbështetëse të specializuara*”, drejtuar Bashkisë Gjirokastër, Qendrës së Trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, Shërbimit Social Shtetëror dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. *Rekomandimi është pranuar nga të gjitha institucionet dhe është në proces zbatimi.*

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke patur në vëmendje të veçantë çështjet e fuqizimit të grave dhe vajzave, të luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, është i angazhuar që të vijojë punën e tij monitoruese dhe promovuese, në mbrojtje të të drejtave të tyre, duke patur në vëmendje dhe Vërejtjet Përmbyllëse dhënë Qeverisë Shqiptare nga Komiteti “Për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave” si dhe rekomandimet që priten të jepen nga GREVIO, në kuadër të Raportit II të shtetit për zbatimin e Konventës së Stambollit. Po kështu, do të vijojë të monitorojë shërbimet e përkujdesit shoqëror, si strehëzat emergjente dhe shërbimet e specializuara për dhunën ndaj grave, me qëllim përmirësimin e standardeve të shërbimit në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

---

### 3.20 Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBTIQ<sup>231</sup>

---

Avokati i Popullit, në rolin e tij si promovues dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut, ka në vëmendje ashtu si për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, edhe të drejtat për personat LGBTIQ<sup>232</sup>. Nga monitorimi i vazhdueshëm i situatës lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, pjesëmarrja në aktivitetet ndërgjegjësuëse të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile, në kuadër të fushatës IDAHOT<sup>233</sup>, si dhe në tryezat e rumbullakta përgjatë vitit 2023, të organizuara me fokus mbrojtjen e të drejtave për personat LGBTIQ, Avokati i Popullit ka konstatuar se ende anëtarë të këtij komuniteti janë pjesë e paragjyqimeve, stigmatizimit dhe diskriminimit. Për më tepër, gjuha e urrejtjes e shprehur sidomos në mediat sociale është prezente ndaj personave LGBTIQ dhe grupeve të tjera më të disavantazuara të shoqërisë. Këto konstatime të Avokatit të Popullit kanë qenë në të njëjtën linjë edhe me konstatimet e dhëna në Raportin Progresin për Shqipërinë për vitin 2023, të Komisionit të Bashkimit Evropian.

---

<sup>231</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

<sup>232</sup> Lesbike, homoseksual, biseksual dhe transgjinnor.

<sup>233</sup> Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë.

Nëpërmjet deklaratës zyrtare në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, në 17 maj 2023, theksohet se: *“Avokati i Popullit beson se puna e përbashkët, me përgjegjshmëri dhe seriozitet nga të gjitha insitucionet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë, duhet domosdoshmërisht të çojë përpara zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit për LGBTI+, 2021-2027, ndryshimeve të duhura ligjore të propozuara në të, apo masave të tjera në fushën e punësimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe shërbimeve publike, si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë. Ligjet dhe politikat janë një aspekt. Pranimi, toleranca, mbështetja, nga shoqëria dhe familja janë po kaq të rëndësishme”*.

Gjatë vitit 2023, konstatohet se nuk ka patur ankesa, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë t’i jenë adresuar Avokatit të Popullit, nga anëtarë të komunitetit LGBTIQ. Por, sjellim në vëmendje se në takimet me qytetarët të organizuara në kuadër të Ditëve të Hapura në disa bashki të vendit, kemi synuar edhe ndërgjegjësimin lidhur me të drejtat për personat LGBTI+, për të krijuar një mjedis sa më pranues dhe larg qëndrimeve diskriminuese.

Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve konsiderohet si pjesë e rëndësishme e punës për adresimin adekuat të problematikave me të cilat ballafaqohen personat LGBTIQ. Për këtë qëllim, Avokati i Popullit ka bashkëpunuar me Aleancën LGBTI+, për organizimin e një trajnimi për stafin e institucionit, trajnim i cili u realizua në datë 17 nëntor 2023. Qëllimi i tij ishte rritja e aksesit dhe trajtimin efektiv të raportimeve në adresimin e rasteve të motivuara nga diskriminimi mbi baza të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit. Po kështu përfaqësues të Zyrrave Rajonale të Avokatit të Popullit, u trajnuan gjatë muajit prill dhe maj 2023, nga organizata OMSA, me çështjet që lidhen me punësimin dhe specifikisht me zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit LGBTI+ 2021-2027, për zvogëlimin e barrierave që i mbajnë personat LGBTI+, larg tregut të punës dhe rritja e aksesit në punë të denjë në sektorët e punësimit jo tradicional.

Sjellim në vëmendje se përgjatë vitit raportues, institucioni i Avokatit të Popullit ka konsoliduar partneritetin me organizatat e shoqërisë civile, të cilat mbrojnë të drejtat e këtij komuniteti, duke luajtur rol proaktiv në të gjitha veprimtaritë e organizuara me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë në lidhje me këto të drejta. Institucioni i Avokatit të Popullit, një nga funksionet e tij ka dhe monitorimin/inspektimin e qendrave rezidenciale publike, të cilat duhet të funksionojnë duke zbatuar standardet kombëtare në fuqi, por njëkohësisht duke konsideruar standardet dhe parimet ndërkombëtare të barazisë dhe mosdiskriminimit, respektimit dhe garantimit të vlerave, personalitetit, dinjitetit, sigurisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit, si dhe të së drejtës për t’u mbrojtur, integruar dhe për të përfituar shërbime mbështetëse të specializuara, të përshtatura me nevojat e personave LGBTI+.

Për këtë qëllim, në korrik 2023, është inspektuar Qendra STREHA, duke patur në vëmendje rëndësinë që ka kjo Qendër, si e vetmja në vend dhe rajon, që ofron shërbim multidisiplinar dhe të strehimit emergjent për të rinjtë LGBTI+, të moshës 18-29 vjeç, të cilët kanë qenë viktimat të dhunës përfshirë dhunën në familje për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore, karakteristikave seksuale të tyre, apo viktimat të dhunës në partnership.

Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve, ndërgjegjësimi i publikut dhe advokimi për të kapërcyer barrierat dhe vështirësitë që hasin në familje dhe shoqëri komuniteti LGBTI+, si dhe integrimi i këtyre

të rinjve, janë disa nga aktivitetet e kësaj qendre. Që prej vitit 2019, Qendra STREHA mbështetet pjesërisht nga buxheti i shtetit (Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale). Pas inspektimit në këtë Qendër, duke vlerësuar kushtet e jetesës, dokumentacionin si dhe intervistave të zhvilluara me përfitues dhe personelin që punon në këtë qendër, Avokati i Popullit adresoi rekomandimin “Për marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të funksionimit të Qendrës STREHA”. Masat rekomanduese sipas institucioneve kanë të bëjnë me:

- sigurimin e qëndrueshmërisë së Qendrës STREHA, nëpërmjet rritjes së fondeve buxhetore, duke patur parasysh se ky është aktualisht i vetmi shërbim rezidencial në vend për personat LGBTI+, të cilët përjetojnë dhunë, përfshirë dhunën në familje ose abuzim. Për këtë brenda vitit 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse sociale të Qarkut Tiranë, të planifikojnë rritjen e mbështetjes me fonde buxhetore për Qendrën STREHA;
- të shihet mundësia e planifikimit të shpenzimeve për blerjen e dysheqeve, dollapeve dhe karrige të reja, nga Qendra STREHA në bashkëpunim me Qarkun, me qëllim për të mundësuar jetesën normale të përfituesve;
- qarku Tiranë të bashkëpunojë me institucionet qendrore dhe vendore, për gjetjen e ambienteve të lira pronë shtetërore ose asete të tjera, për mundësimin e një ambienti të përhershëm e të përshtatshëm, për zhvillimin e aktivitetit të Qendrës STREHA;
- kryerjen e monitorimit të standardeve dhe aktivitetit të Strehës LGBTI+ nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

*Rekomandimi është pranuar dhe është shprehur angazhimi dhe gadishmëria nga ana e Shërbimi Social Shtetëror dhe Këshillit të Qarkut Tiranë për të zbatuar rekomandimet përkatëse.*

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se problemi me i shprehur në lidhje me komunitetin LGBTIQ, vijon të mbetet shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të shtetit dhe shoqërisë lidhur me të drejtat e këtij komuniteti, e për pasojë, hartimi i legjislacionit specifik mbi njohjen e identitetit gjinor të ndryshuar, ndryshimi i Kodit Penal dhe Kodit të Familjes, e ndërthurur dhe me aktivitete promovuese nga institucione në kompetencë të të cilave është kjo detyrë funksionale, është qasja e duhur për avancimin e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të këtij komuniteti.

---

### 3.21 Të drejtat e minoriteteve (pakicave) kombëtare<sup>234</sup>

---

Vëmendja institucionale e Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2023 i është kushtuar të drejtave të pakicave kombëtare, duke u fokusuar kryesisht në përmirësimin e kushteve të jetesës për anëtarët që i përkasin pakicës kombëtare Egjiptiane dhe Rome, si pakica të cilat shfaqin problematika më të shpeshta e më të mprehta, krahasuar me pakicat e tjera kombëtare në vend.

Roli proaktiv i Avokatit të Popullit është ushtruar nëpërmjet adresimit të problematikave të rrjedhura nga ankesat apo të identifikuara nga media dhe shtypi i shkruar, duke rekomanduar dhe masat eventuale. Problematikat e trajtuara, të cilat lidhen kryesisht me kushtet tepër të vështira të jetesës, mungesës së

---

<sup>234</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

shërbimeve apo aksesit në shërbime si dhe aksesit në arsim, janë trajtuar dhe do të vijojnë të trajtohen në optikën e çështjeve sistematike, për të evidentuar hapësirat për të gjetur zgjidhje afatgjata. Barazia, përfshirja dhe integrimi i pakicave kombëtare në të gjitha situatat dhe përballë të gjitha sfidave që has shoqëria, duhet të jetë në vëmendjen e veçantë të organeve të administratës publike, e cila duhet të ketë një qasje më proaktive, më bashkëpunuese dhe ndjeshmëri e profesionalizëm më të lartë për trajtimin e tyre.

Manifestimi i shprehjeve dhe akteve individuale si dhe i politikave institucionale dhe praktikave të marxhinalizimit, përjashtimit, dhunës fizike, gjuhës së urrejtjes, zhvleftësimit të kulturës dhe stilit të jetesës së Romëve, mbetet fenomen shqetësues për një shoqëri demokratike. Ky fenomen prodhon një sërë stereotipesh negative dhe imazhe të deformuara që përfaqësojnë një formë specifike të racizmit, për individët dhe komunitetet Rome por jo rrallë edhe për ato Egjiptiane. Jo vetëm kuadri strategjik si dhe ai ligjor për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, duhet të projektojnë politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, por edhe organet në nivelin e qeverisjes qendrore dhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, duhet të marrin masa për t'i përfshirë këto grupe të marginalizuara si pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

Në një pjesë të konsiderueshme të ankesave të tjera të trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit, janë identifikuar çështje të ngritura nga individë pjesëtarë të minoriteteve kombëtare, por që nuk identifikohen drejtëpërdrejtë në kuadër të të drejtave komunitare të minoriteteve kombëtare, apo edhe të të drejtave të ligjshme individuale, për shkak të qënies pjesëtar në një minoritet kombëtar. Këto ankesa vijojnë të kenë objekt të tyre ankimin për të drejtën për strehim, të drejtën për punësim, të drejtën për të përfituar nga sistemi i përkujdesjes shoqërore, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi.

Gjatë vitit 2023, është nisur hetimi administrativ me iniciativë për 5(pesë) çështje, për problematika që i përkasin komuniteteve përkatëse apo edhe individëve pjesëtarë të minoriteteve (pakicave) kombëtare, në të gjithë vendin, si dhe janë marrë në shqyrtim 6 (gjashtë) ankesa/kërkesa individuale. Problematikat dhe sfidat me të cilat vazhdojnë të përballen pakicat kombëtare janë të tipologjive të ndryshme, por në thelb mbeten të lidhura me:

- nevojën për përmirësimin thelbësor e tërësor të kushteve të jetesës;
- rritjen e përmirësimin e nivelit të arsimimit dhe aftësive;
- të drejta të tjera si identiteti etnik, gjuhësor, kulturor e fetar.

Gjatë vitit 2023 disa nga problematikat e evidentuara janë adresuar nëpërmjet rekomandimeve, si vijon:

- **Rekomandim drejtuar Njësisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës:** Për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno-sanitare të fshatit Borakë. Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.
- **Rekomandim drejtuar Bashkisë Vlorë:** Për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Egjiptian që banon në lagjen “Partizani”, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, dhe sigurimin e angazhimit institucional në këtë çështje. Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.
- **Rekomandim drejtuar Bashkisë Shkodër:** Për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Egjiptian që banon në lagjen “Liria” Shkodër, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, dhe sigurimin e angazhimit

institucional në këtë çështje. Për këtë rekomandim nuk ka pasur një përgjigje nga Bashkia Shkodër, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit.

- **Rekomandim drejtuar Bashkisë Fier:** Për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave për një vlerësim të plotë e gjithëpërfshirës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom që banon në fshatin Drizë, Fier, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Ky rekomandim është refuzuar nga Bashkia Fier e cila ka kthyer përgjigje institucionale duke u shprehur se jo vetëm nuk e pranojnë por as nuk e kuptojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit.
- **Rekomandim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:** Për vlerësimin e mundësive për ngritjen e një programi studimi të nivelit të dytë në gjuhët shqipe dhe rome, si program formimi vazhdues i programit të nivelit të parë, si dhe kryerjen e një analize dhe vlerësimi të mundësive për hapjen e programeve të studimit, fillimisht të nivelit të parë, e më pas edhe të niveleve të tjera, edhe në universitetet e tjera publike në vend. Në lidhje me këtë rekomandim, ka pasur një përgjigje nga Minsitria e Arsimit dhe Sportit, e cila ka mbajtur qëndrimin se institucionet e arsimit të lartë gëzojnë autonomi dhe liri akademike në përputhje me legjislacionin në fuqi, e rrjedhimisht janë kompetente për hartimin e strukturës dhe zhvillimit të programeve si dhe për të kërkuar hapjen e tyre, në bazë të vlerësimit paraprak të nevojave për aftësi në tregun e punës.
- **Rekomandim drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:** Për marrjen e masave për miratimin në një kohë sa më të shpejtë të protokolleve dhe procedurave të posaçme për menaxhimin e rasteve të pacientëve të paidentifikuar dhe forcimin e ndërveprimit institucional dhe ndërinstitutional për këto raste në të gjitha institucionet në Republikën e Shqipërisë. Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar pjesërisht nga Ministria së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila i është drejtuar disa strukturave shtetërore të kujdesit shëndetësor, duke përcjellë udhëzime pranë tyre për hapat që duhet të ndjekin.

Nga ana tjetër theksojmë se, ashtu sikundër e kemi evidentuar edhe në raportet e mëparshme, vijon të mbetet aktual rekomandimi i Avokatit të Popullit, për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”<sup>235</sup>. Më konkretisht, mbeten për t’u miratuar katër akte nënligjore, si më poshtë:

- projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”;
- projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”;
- projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetë-identifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji;
- projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm

---

<sup>235</sup> Drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me shkresën Nr. K1/I10-2 datë 25.02.2020.

kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e "Fondit për pakicat kombëtare".

Viti 2023 ka shënuar një angazhim të vazhdueshëm të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve kombëtare në Shqipëri, me qasje proaktive për adresimin e problematikave të identifikuara nëpërmjet hetimeve administrative dhe rekomandimeve specifike. Avokati i Popullit vendos theksin tek nevoja për angazhim institucional nga organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor, për të siguruar barazi, përfshirje dhe integrim të pakicave kombëtare në shoqërinë shqiptare, për të ndërtuar një mjedis më të barabartë dhe gjithpërfshirës për të gjitha grupet etnike.

---

### 3.22 *Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore*<sup>236</sup>

---

Sistemi i sigurimeve shoqërore përbën skemën kryesore të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Duke qenë se realizimi i kësaj të drejte është me rëndësi jetike për qytetarët, pasi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë për përballimin e jetesës së përditshme, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ajo duhet të realizohet shpejt, në mënyrë efikase dhe pa zvarritje nga institucionet përgjegjëse.

Qytetarët, të cilët i janë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit kanë parashtruar në objektin e ankesave të tyre problematika lidhur me:

- mosllogaritjen e drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë;
- masën e ulët të këtyre pensioneve;
- mosnjohjen e vjetërsisë të saktë në punë;
- mosdhënien e plotë të pensioneve të pleqërisë;
- mungesën e përgjigjeve për kërkesat për rishqyrtim të pensionit të pleqërisë;
- mosvënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes së pensionit;
- mosdhënien e së drejtës për të përfituar pension suplementar, si punonjës i nëntokës, etj.

Referuar ankesave të regjistruara për vitin 2023, rezulton të jenë trajtuar 38 të tilla, nga të cilat për 26 raste ka përfunduar hetimi administrativë dhe 12 raste janë në proces shqyrtimi. Në favor të qytetarëve janë zgjidhur 11 raste. Avokati i Popullit, në tagrin e tij ligjor si këshillues, përgjatë procesit të trajtimit të ankesave, të cilat kanë rezultuar të pabazuara, ka orientuar qytetarët duke i sqaruar ligjërisht për qasjen e zgjidhjes së problematikës, përmes ndjekjes së ankimit administrativ në Komisionet Rajonale të Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku ato kanë vendbanimin si dhe në Komisionin Qendror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Lidhur me problematikat e sipërpërmenduarat evidentojmë, sa më poshtë:

#### **1. Llogaritje jo e drejtë të pensionit të pleqërisë**

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, për të përmirësuar situatën e përfituesve, institucioni i Avokatit të Popullit i ka sugjeruar në mënyrë sitematike Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rishqyrtimin e dosjeve

---

<sup>236</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.



të pensionit dhe rillogaritje të masës së pensionit të pleqërisë, Në disa raste, ka rezultuar se pas rillogaritjeve të kryera, qytetarëve u ka ndryshuar masa e pensioneve duke përfituar edhe shtesa kreditore.

## **2. Mosnjohja e sakte e viteve të punës në llogaritjen e pensionit të pleqërisë**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka asistuar për pajisjen me dokumentacionin e vjetërsisë në punë duke iu drejtuar Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore. Në rastet e mungesës së dokumentacionit pranë Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, qytetarët janë sqaruar se kompetencat e njohjes së fakteve juridike apo të saktësisimit të dokumentave janë vetëm të Gjykatës dhe janë orientuar se nëse do të ndjekin rrugën gjyqësore, të aplikojnë për përfitimin e ndihmës juridike falas, në formën e ndihmës juridike dytësore<sup>237</sup>.

## **3. Mosllogaritja e saktë të viteve të punës**

Pas adresimit të kësaj problematike nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit pranë organeve përgjegjëse, në varësi të gjetjeve për raste konkrete, qytetarëve u është njohur rast pas rasti vjetërsia në punë duke rezultuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin efektiv të së drejtës për të përfituar nga ligji nr.29/2029 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

## **4. Mospajisja e qytetarëve me aktet e ndodhura në dosjen e tyre të pensionit**

Edhe përgjatë këtij viti, qytetarët kanë adresuar pranë institucionit të Avokatit të Popullit problematikën e mospajisjes me akte, të cilat ndodhen në dosjen e pensionit të pleqërisë, duke kërkuar ndihmën e këtij institucioni për vënien në dispozicion të tyre. Pas ndërhyrjeve institucionale, ankuesve u është bërë e mundur pajisja me dokumentat e kërkuara.

## **5. Mosdhënia e së drejtës për tërheqjen e pensionit të pleqërisë, me prokurë të dhënë pa afat**

Sa i përket kësaj problematike, sjellim ne vëmendje se sipas kuadrit ligjor në fuqi, personi i autorizuar nga pensionisti, sipas aktit noterial me prokurë pa afat për tërheqjen e pensionit të pleqërisë, duhet të paraqitet pranë Zyrës Postare për të tërhequr pensionin e të përfaqësuarit dhe bonusin e fund vitit 2023. Në ankesën drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, ankuesi G.K. parashtron se nga ana e punonjësve të postës i është refuzuar dhënia e pensionit, pasi nga ana e Postës Shqiptare është dërguar një njoftim që të gjitha prokurat e lëshuara pa afat, të deklarohen të pavlefshme.

Sipas Marrëveshjes<sup>238</sup> të lidhur ndërmjet Postës Shqiptare dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, prokurat duhet të jenë me afat 3-vjeçar vlefshmërie ose 6-mujore. Theksojmë se ky njoftim nuk disponohet në formë shkresore<sup>239</sup> nga ana e Zyrës Postare dhe as është afishuar në ambientet e saj, me qëllim njoftimi dhe njohje nga ana e pensionistëve.

Duke marrë shkas nga ky rast dhe duke vlerësuar se pensionistët, të cilët janë në kushte pamundësie shëndetësore, financiare apo dhe të atyre që jetojnë jashtë vendit për të marrë dijeni mbi modalitetet e ndryshuara, Avokati i Popullit i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore duke kërkuar marrjen e

<sup>237</sup> Dhënia e ndihmës juridike dhe ofrimi i mbrojtjes para gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

<sup>238</sup> Me nr.6096/1425, datë 11.07.2023, “Për pagesën e pensioneve dhe përfitimeve të tjera nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”

<sup>239</sup> Me nr.prot, nënshkrim dhe vulë.

masave për të afishuar njoftimin në ambientet e postës, me qëllim njoftimin e pensionistëve me këtë modalitet të ndryshuar sa i përket afatit të prokurës për tërheqje pensioni.

Në përmbyllje, theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson arritjet e deritanishme të shtetit shqiptar, përmes reformimit të sistemit publik të sigurimeve shoqërore, por vlerëson se duhet të synohet drejt objektivit të të qenit më efektiv në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore, pasi disa çështje vijojnë prej vitesh të mbeten tepër të ndjeshme në opinionin publik, kryesisht pensionet e ulëta, masa e të cilave është e pamjaftueshme për përballimin e një jetese normale.

---

### 3.23 E drejta për një mjedis të shëndetshëm<sup>240</sup>

---

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, çdokush ka të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm. Kushtetuta parashikon gjithashtu të drejtën për informim si e drejtë dhe liri themelore e njeriut. Kjo mbrojtje vjen më e plotë referuar ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, duke plotësuar kështu kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër.

Kuadri ligjor dhe institucional në fushën e mjedisit është në rishikim të vazhdueshëm. Kapitulli 27 (“Mjedis dhe klima”) është ndër kapitujt më të rëndësishëm të acquis së BE-së, ndërkohë që në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2023, theksohet se “*Shqipëria tregon një nivel përgatitjeje në këtë fushë dhe se është bërë përparim i kufizuar në përafrimin e politikave dhe legjislacionit me acquis të BE-së, në fusha të tilla si menaxhimi i ujit, kimikatet, krimi mjedisor dhe politika klimatike.....*”.

Në kuadër të të drejtës për akses në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, Avokati i Popullit thekson rëndësinë që duhet t’i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri, pasi problemet mjedisore mund të kenë implikime negative, direkte dhe indirekte për realizimin efektiv të të gjitha të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar, përgjatë vitit 2023, problematikat sa i përket të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, të bëra prezent, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të depozituara pranë institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe online.

Referuar rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ankesave por dhe ato me nicitivë, për vitin 2023, rezulton të jenë trajtuar gjithsej 18 raste, Përgjithsisht, ankesat e qytetarëve të paraqitura pranë Avokatit të Popullit pasqyrojnë të njëjta problematika si edhe vitin e kaluar të tilla si ndotja e ajrit dhe ujit, ndotja akustike, ndotja e mjedisit nga mbetjet, ndotja e mjedisit pranë lumenjve si dhe shkarkimi i mbetjeve të papërpunuara në to.

Avokati i Popullit konstaton se institucionet qendrore dhe vendore përgjegjëse për fushën e mjedisit, vazhdojnë mospërbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga e drejta për një mjedis të pastër dhe të

---

<sup>240</sup> Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

shëndetshëm. Gjithashtu, vërehet se një nga sfidat në sektorin e mjedisit vijon të mbetet dhe menaxhimin mbetjeve, si mungesa e një pjese të infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, mungesa në shkallë kombëtare e landfilleve për mbetjet e rrezikshme dhe për mbetjet inerte. Përsa i përket nivelit të ndotjes akustike vlerësohet se, dhe për vitin 2023, nisur nga ankesat e administruara nga institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur mbrojtjen dhe garantimin e jetës së qetë e të pa cënuar nga zhurmat, pavarësisht ndryshimeve të reja ligjore “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në mjedis”, të miratuar në qershor të vitit 2023.

Avokati i Popullit konstaton se parimi i zhvillimit të qëndrueshëm nuk është zbatuar në masë të mjaftueshme për shkak të faktit, se mbrojtja e mjedisit trajtohet si dytësore dhe jo aq e rëndësishme sa zhvillimi social dhe ekonomik. Institucionet përgjegjëse në përgjithësi tregojnë mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi, në ushtrimin e përgjegjësive ligjore dhe në marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problemeve në mbrojtjen e mjedisit.

Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të trajtimit të çështjeve mjedisore evidenton si tejet problematike mosreagimin apo mospërgjigjen e institucioneve ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit. Në këtë kontekst, mosdërgimi i informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për të cilat hetimi administrativ është përmbjllur me hartimin e rekomandimeve përkatëse për vitin 2023, evidentojmë:

*3.23.1. Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Bernës, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.*

Në shtator 2023, Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernës i rekomandoi Shqipërisë pezullimin e ndërtimit të Aeroportit të Vlorës derisa të kryhet një procedurë e re dhe e mjaftueshme e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM). Në këtë aspekt, Avokati i Popullit në zbatim të pikave rekomanduese të dala nga Komiteti i Përhershëm i Bernës, rekomandoi:

- marrjen e masave të nevojshme për zbatim të konventës së ratifikuar me ligjin nr.94 datë 2.3.1998, për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitatet Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës), e cila është një instrument juridik detyrues ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës ;
- marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të dala nga Komitetit i Përhershëm i Bernës në lidhje me ndërprerjen e punimeve për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, deri në plotësimin e masave konkrete të përcaktura në këtë rekomandim;
- marrjen e masave për evidentimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata punonjës të Ministrisë, të cilët nuk kanë bashkëpunuar për dërgimin e informacionit në kohën e kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit.

*Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.*

### 3.23.2. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e ndotjes së mjedisit që shkaktohet nga vendgrumbullimi i mbetjeve në Lagjen 24 Maji Vlorë

Nisur nga një situatë tepër serioze dhe emergjente për shëndetin e qytetarëve, Avokatit të Popullit rekomandoi sa më poshtë:

- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që, Bashkisë Vlorë, i jepen nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për eliminimin e ndotjes që shkaktohet nga vendgrumbullimi i mbetjeve në Lagjen 24 Maji Vlorë;
- marrjen e masave nga Bashkia Vlorë, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme për hapjen e vendeve të reja (landfield) për grumbullimin e mbetjeve brenda standarteve dhe sipas afateve të përcaktuara në kontratën e projektit në bashkëpunim me KFW (Bankën Gjermane);
- marrjen e masave për identifikimin dhe ndalimin në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, të personave/subjekteve përgjegjëse për djegien e mbeturinave në lagjen 24 Maji, të cilët shkaktojnë ndotjen e shëndetit të komunitetit dhe mjedisit përreth;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga Ministria e Turizimit dhe e Mjedisit në rritjen dhe forcimin e monitorimeve nga inspektoriatet përkatëse me synim zbatimin rigoroz të ligjit;
- marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor në ushtrimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e mbetjeve;
- marrjen e masave nga Kryetari i Bashkisë Vlorë për evidencimin dhe fillimin e ecuresë disiplinore, për ata punonjës të bashkisë të cilët nuk kanë bashkëpunuar për dërgimin e informacionit në kohën e kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit;
- marrjen e masave për vendosjen e tabelave treguese, ku të shënohet që zjarrëvënja me dashje konsiderohet vepër penale.

Në vlerësim të përgjigjeve të dhëna nga institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit me keqardhje konstaton *mungesën e reagimit nga ana e Bashkisë Vlorë*, në shkëlqje të dispozitave ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë dhe garantojnë të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar shpjegime dhe informacione nga çdo organ i administratës publike. Po ashtu vërehet se nga monitorimi i ajrit urban kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në vendgrumbullimin e mbetjeve në Lagjen 24 Maji Vlorë, ndotja e ajrit rezulton më e lartë se norma e lejuar. Nisur nga kjo situatë, Avokati i Popullit u bën sërish thirrje institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave të menjëhershme dhe konkrete për zgjidhjen e problemit, i cili vazhdon të mbetet një shqetësim serioz dhe emergjent për shëndetin e qytetarëve.

### 3.23.4. Rekomandim për pastrimin dhe eliminimin e mbetjeve të shkaktuara nga aktivitetet e paligjshme, në lagjen Tepe, të qytetit të Shkodrës<sup>241</sup>

Gjetjet e Avokatit të Popullit identifikuan mosreagimin e institucioneve përgjegjëse në drejtim të zgjidhjes së problematikës. Po ashtu vërehet se institucionet shmangin përgjegjësitë, duke dërguar vazhdimisht korrespondenca shkresore ndërmjet tyre, por në asnjë moment nuk reflektojnë planifikimin e masave apo hapave konkrete në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit rekomandoi sa më poshtë:

<sup>241</sup> Drejtuar Bashkisë Shkodër, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe për dijeni, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, për hartimin dhe zbatimin e një plani të mirëfilltë menaxhimi të integruar të mbetjeve në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër shoqëruar me aktivitete dhe buxhetet përkatëse;
- marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor në ushtrimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e mbetjeve;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga inspektoriatet përgjegjëse, në rritjen dhe forcimin e monitorimeve me synim zbatimin rigoroz të ligjit;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që, Bashkisë Shkodër, i jepen nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për pastrimin e mbetjeve që janë grumbulluar në zonën “Tepe”;
- marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse vendore për identifikimin dhe ndalimin e individëve/subjekteve që kryejnë aktivitet të paligjshëm, si hedhja e mbetjeve të patrajtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve për të shmangur ndotjen masive si edhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbajtjen pastër të ambientit.

*Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar pjesërisht nga institucionet përgjegjëse.*

#### *3.23.4. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e mjedisit nga djegiet në zonën e Fushë Mamurrasit, drejtuar Bashkisë Kurbin*

Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit rekomandoi sa më poshtë:

- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që, Bashkisë Kurbin, i jepen nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për eliminimin e ndotjes që shkatohet poshtë urës në Lumin Drojë, zona e Fushë Mamurrasit;
- marrjen e masave për identifikimin dhe ndalimin në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, të personave/subjekteve përgjegjëse për djegien e mbeturinave, të cilët shkaktojnë ndotjen e mjedisit përreth dhe dëmtimin e shëndetit të komunitetit;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për parandalimin e ushtrimit të aktiviteteve të paligjshme dhe ndotjes së mjedisit në këtë zonë;
- evidencimin e stafit dhe strukturave të Bashkisë Kurbin, të cilët nuk kanë bashkëpunuar për dërgimin e informacionit të kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe marrjen e masave disiplinore për të mos u përsëritur kjo situatë në të ardhmen.

*Rekomandimi është pranuar por zbatuar pjesërisht nga institucionet përgjegjëse.*

#### *3.23.5. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet në zonën e Parkut Kombëtar Theth, drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.*

Në këtë rekomandim, Avokati i Popullit thekson rëndësinë e angazhimit të Bashkisë Shkodër në krijimin dhe funksionimin e një Sistemi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e mbetjeve dhe bashkërendimin administrativ të strukturave të ndryshme qendrore dhe

vendore për zbatimin e legjislacionit mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të zonave të mbrojtura. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit rekomandoi sa më poshtë:

- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që Bashkisë Shkodër, i jepen nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për pastrimin e mbetjeve që janë grumbulluar në zonën e Thethit;
- marrjen e masave për ruajtjen me përparësi të zonës së mbrojtur bashkiake me të gjithë përbërësit e vet nga ndikimet e mundshme negative të veprimtarive që ushtrohen në zonën e Thethit;
- evidencimin e stafit dhe strukturave të Bashkisë Shkodër, të cilët nuk kanë bashkëpunuar për dërgimin e informacionit të kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe marrjen e masave disiplinore për të mos u përsëritur kjo situatë në të ardhmen.

*Rekomandimi është pranuar por zbatuar pjesërisht nga institucionet përgjegjëse.*

### *3.23.6. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e jetesës së qetë e të pacenuar nga zhurmat të znoj. S.T.<sup>242</sup>*

Në këtë rekomandim gjetjet e Avokatit të Popullit identifikuan mosreagimin e institucioneve përgjegjëse në drejtim të zgjidhjes së problematikës të prezantuar në ankesën e qytetares. Po ashtu, vërehet se institucionet shmangin përgjegjësitë, duke referuar jo vetëm njohje jo të mirë të tyre nga pikëpamja ligjore, por njëkohësisht mungesë të mjeteve logjistike për matjen e ndotjes. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit rekomandoi:

- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga Bashkia Elbasan si; masa administrative, pezullimin apo mbylljen e veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e ligjit “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në mjedis”<sup>243</sup>;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit dhe Ministria e Brendshme në rritjen dhe forcimin e monitorimeve nga institucionet e varësisë me synim zbatimin rigoroz të ligjit;
- marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në lidhje detyrat e lënë nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë për izolimin e pjesës së mbetur të ambientit ku punon dhe është burim për zhurma;
- marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse për garantimin e cilësisë së monitorimit, të matjeve, të zbatimit të metodikave nëpërmjet pajisjeve të certifikuara për matjen e niveleve të zhurmës;
- marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kërkesave ligjore nga subjektet fizike/juridike, të cilat ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar të saj;
- marrjen e masave për zhvillimin e trajnimeve të stafit me qëllim arritjen e objektivave dhe zbatimit të kritereve ligjore e rregullatore për një inspektim efektiv dhe të sigurt të zhurmave mjedisore.

*Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar pjesërisht nga institucionet përgjegjëse.*

<sup>242</sup> Drejtuar Bashkisë Elbasan, IKMT Elbasan, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, dhe AKM-së.

<sup>243</sup> Ligji nr. 50/2023 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, të ndryshuar.

*3.23.7. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin adekuat me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno –sanitare për banorët e fshatit Domen, zona e Postribës<sup>244</sup>.*

Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit rekomandoi:

- marrjen e masave të menjëhershme nga Ujësjetës Kanalizime sh.a Shkodër për furnizimin adekuat me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno-sanitare, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për të mos cënuar në asnjë rast shëndetin e banorëve në Fshatin Domen, zona e Postribës, Shkodër;
- marrjen e masave të menjëhershme për investime në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve me qëllim zgjidhjen përfundimtare të situatës së krijuar e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi;
- marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga Ministria e Turizimit dhe e Mjedisit në rritjen dhe forcimin e monitorimeve nga inspektoriatet përkatëse me synim zbatimin rigoroz të ligjit;
- marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor në ushtrimin e kompetencave të ngarkuara nga ligji në funksion të mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit përreth.

*Rekomandimi është pranuar pjesërisht por është i pazbatuar.*

Në analizë të fakteve të mësipërme evidentohet se Shqipëria tregon mangësi në sistemin e mbrojtjes së mjedisit, funksioni i të cilit nuk është vetëm mbrojtja e natyrës dhe mjedisit, por edhe e të drejtave të njeriut, të parashikuara nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar. Situata emergjente që ndodhet vendi ynë, sa i përket ndotjes së mjedisit, sistemit aktual të menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes joadekuate të komponentëve të ndryshëm mjedisorë, kërkojnë bashkëpunim sistematik dhe të koordinuar të të gjithë autoriteteve përgjegjëse në të gjitha nivelet për të ruajtur mjedisin për brezat e sotëm dhe ato të ardhshëm.

---

<sup>244</sup> Drejtuar Bashkisë Shkodër, Ujësjetës Kanalizimeve Sh.a Shkodër, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës.

## KREU IV

### ANGAZHIME TË TJERA INSTITUCIONALE

---

#### 4.1 Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe shoqërisë civile

---

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vijim të publikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë<sup>245</sup>, të shpalljes së vendeve vakante dhe thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqërisë civile, Avokati i Popullit nisi menjëherë punën për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme administrative për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e përcaktuara në ligjin e sipërcituar. Në vijim, me Urdhër<sup>246</sup> të Avokatit të Popullit u krijua grupi *Ad-Hoc* i punës për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor si dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe shoqërisë civile.

##### 4.1.1. Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve

Grupi *Ad-Hoc* i Punës për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, në përputhje me dispozitat ligjore, mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, brenda një afati 5 ditor nga momenti i paraqitjes. Në rastet kur u vlerësua e nevojshme të plotësohej dokumentacioni, kandidatët u njoftuan në rrugë elektronike, duke u lënë atyre në dispozicion një afat prej 5 ditësh, sikundër parashikohet nga ligji. Grupi *Ad-Hoc*, ka administruar të gjitha përgjigjet e ardhura nga kandidatët, duke evidentuar datën kur është kërkuar dokumentacioni/informacioni, si dhe datën kur është plotësuar dokumentacioni/informacioni nga kandidatët. Çdo komunikim elektronik me kandidatët, si dhe çdo dokumentacion që është paraqitur në rrugë elektronike, postare apo fizikisht nga kandidatët, është administruar nëpërmjet një procesverbali shtesë për dokumentacionin e paraqitur.

Nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të administruar rezultoi se kishin shprehur interesin gjithsej 29 kandidatë nga rradhët e avokatëve, nga të cilët:

- në 6 raste, kandidatët kishin shprehur interesin vetëm për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- në 22 raste kandidatët kishin shprehur interesin për anëtar në të dy pozicionet, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- në 1 rast kandidati e kishte shprehur interesin jashtë afatit të përcaktuar.

---

<sup>245</sup> Datë 20 korrik 2023.

<sup>246</sup> Urdhëri nr.113, datë 24.07.2023, “Për krijimin e grupit *Ad-Hoc* të punës, për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor si dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga rradhët e avokatëve”, i ndryshuar.



Me qëllim të verifikimit të plotësisë të çdo kriteri ligjor nga secili kandidat, u hartua nga një skedar individual për çdo kandidat, në të cilin pasqyrohet i gjithë dokumentacioni i paraqitur që vërteton përmbushjen e secilit kriter, ose evidentohet kërkesa e Avokatit të Popullit për dokumentacion shtesë si dhe dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të kësaj kërkesë. Të gjitha këto materiale përmbledhëse së bashku me realcionin përkatës iu vunë në dispozicion Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*. Në përputhje me nenin 23 dhe 25 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas kërkesës së Avokatit të Popullit, në kuadër të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur *Ad-Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidateve për anëtarë të Këshillit të lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, Dhoma e Avokatisë komunikoi listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore për anëtar dhe anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur *Ad-Hoc*.

Avokati i Popullit pas shqyrtimit të listës së avokatëve ftoi më të riun në moshë dhe më të vjetrin në moshë, ndër ta, që të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad-Hoc*. E njëjta procedure, dhe në bazë të të njëjtit kriter, u ndoq edhe në rastin e caktimit të dy anëtarëve zëvendësues. Në përfundim të procedurave të mësipërme, Avokati i Popullit bëri publikë emrat e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues nga rradhët e avokatëve, në Komisionin e Pavarur *Ad-Hoc*. E njëjta procedurë u ndoq edhe në rastin e plotësisë të vendit të anëtarit në Komisionin e Pavarur *Ad-Hoc* nga Akademia e Shkencave.

Më datë 24 gusht 2023 u zhvillua mbledhja e parë<sup>247</sup> e konstituimit të Komisionit, në të cilën nisi zyrtarisht puna për hartimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave të funksionimit të këtij Komisioni<sup>248</sup>. Ky komision e konsideroi shumë të rëndësishme qasjen drejt një procedure transparente dhe në respekt të plotë të kriterëve ligjore, si dhe prezencën dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë në çdo fazë të zhvillimit të këtij procesi, me cilësinë e vëzhguesit. Gjithashtu, në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut në lidhje me të gjitha fazat e zhvillimit të këtij procesi, në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit u hapën dy rubrika të veçanta të cilat në mënyrë të vazhdueshme u përditësuan me informacione dhe njoftime për shtyp në lidhje me këtë proces<sup>249</sup>.

Gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit *Ad-Hoc*, zhvilloi takime me përfaqësues të delegacionit të Bashkimit Evropian si dhe të misionit të OPDAT-it në Tiranë, me qëllim ndjekjen, monitorimin dhe mbështetjen nga afër të këtij procesi në të gjitha fazat e tij nga këto organizma, duke pasur parasysh rolin qendror të tyre në progresin e vazhdueshëm të reformës në drejtësi. Përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë kanë qënë të pranishëm në cilësinë e vëzhguesit në të gjitha mbledhjet e Komisionit *Ad-Hoc*, duke dhënë ndihmë, por pa ndërhyrje në procesin vendimmarrës.

Në kuadër të verifikimit të kushteve ligjore, vlerësimit paraprak të kriterëve profesionale dhe morale dhe renditjes së avokatëve që kandidojnë për të qënë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Avokati i Popullit në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur *Ad-Hoc*, i dërgoi zyrtarisht Prokurorisë së Përgjithshme kërkesën për verifikimin e formularëve të deklarimit të integritetit. Gjithashtu, shkresa zyrtare iu dërguan edhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit

<sup>247</sup> Gjatë gjithë procesit u zhvilluan 14 (katërmëdhjetë) mbledhje të Komisionit të Pavarur *Ad-Hoc*, përkatësisht në datat 24 gusht 2023, 7 shtator 2023, 27 shtator 2023, 2 tetor 2023, 3 tetor 2023, 12 tetor 2023, 13 tetor 2023, 3 nëntor 2023, 4 dhjetor 2023, 7 dhjetor 2023, 13 dhjetor 2023, 16 dhjetor 2023, 26 dhjetor 2023, 28 dhjetor 2023 dhe 29 Dhjetor 2023.

<sup>248</sup> Me vendimin nr.2, datë 27.09.2023, Komisioni *Ad Hoc* miratoi dhe rregulloren e funksionimit të tij.

<sup>249</sup> Këto rubrika gjenden në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article-ildp-layout/transparency>.

të Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

Duhet të theksohet se Prokuroria e Përgjithshme nuk pranoi të realizojë kontrollin e integritetit të kandidatëve gjë që krijoi realisht pengesa serioze në punën dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së Komisionit të Pavarur Ad-Hoc, jo vetëm në lidhje me përmbylljen e procesit të vlerësimit të kandidatëve nisur nga kriteret profesionale dhe morale të përcaktuara nga ligji si dhe renditjen e tyre bazuar në këto kriterë, por sidomos sa i përket vonesave që krijoheshin në proces nga një qasje e tillë. Në vlerësim të këtij institucioni ky verifikim duhet kryer nga Komisioni *Ad-Hoc*, ndonëse nenet 31 dhe 129, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, përcaktojnë qartë se verifikimi bëhet nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>250</sup>. Për rrjedhojë, Komisioni *Ad-Hoc*, për shkak të rëndësisë që kishte verifikimi në kuadër të vlerësimit të kriterëve të integritetit të kandidatëve, vlerësoi që ta realizojë vetë këtë proces (për aq sa ishte e mundur). Sigurisht që kryerja e këtij procesi kërkonte investim në kapacitete njerëzore dhe kohë, që nuk janë të parashikuara nga ana e ligjvënësit në momentin e hartimit të ligjit.

Komisioni mundësoi realizimin e procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga rradhët e avokatisë, përmes zhvillimit të një hetimi të thelluar administrativ. Kjo konsistoi në: (1) verifikimin e detajuar të plotësimit të kriterëve ligjore për secilin kandidat përmes vlerësimit të kujdesshëm dhe të ndërlidhur të dokumentacionit të administruar në dosjet e tyre, përfshirë jetëshkrimin, studimet universitare, librezat e punës, vërtetimet e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, si dhe çdo dokument tjetër që administrohej në dosje dhe që lidhej me plotësimin e këtyre kriterëve; (2) marrjen e informacioneve apo dokumentacionit shtesë nga vetë kandidatët në rastet kur, për elementë të caktuar<sup>251</sup> dokumentacioni nuk ishte i mjaftueshëm, nuk ishte i qartë, apo kishte mospërputhje; (3) marrjen e informacionit zyrtar nga institucionet publike në lidhje me integritetin, shlyerjen e rregullt të të gjitha detyrimeve tatimore, dhe masat disiplinore; si dhe (4) marrjen e informacioneve publike, të tilla si të dhënat në lidhje me aktivitetin e ushtruar nëpërmjet ekstrateve historike të publikuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, apo informacione të tjera nga burime zyrtare publike që i shërbenin procesit.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, si fazë e parë e këtij procesi, Komisioni *Ad-Hoc*, shpalli më datë 7 dhjetor 2023 emrat e kandidatëve që plotësonin kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe emrat e kandidatëve që nuk i plotësonin këto kushte. Ndërkohë, për kandidatët që plotësonin kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni i Pavarur *Ad-Hoc* vendosi të vijojë më tej me fazën e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale përmes zhvillimit të seancave dëgjimore.

Komisioni i Pavarur *Ad-Hoc* miratoi paraprakisht Metodologjinë për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin) për renditjen e kandidatëve për anëtarë

---

<sup>250</sup> Të dyja dispozitat përcaktojnë se: *Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike” nëse është e nevojshme. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve.*

<sup>251</sup> Të tilla si shlyerja e rregullt e detyrimeve tatimore, vërtetimi i vjetërsisë në punë apo profesion, ushtrimi efektiv dhe pa ndërprerje i profesionit të avokatit, moslargimi me masë disiplinore, rezultatet gjatë studimeve universitare, etj.

në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve<sup>252</sup>. Kjo Metodologji u hartua mbi bazën e Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, miratuar me Vendimin nr. 51, datë 21.06.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në datat 13 dhe 16 dhjetor u zhvilluan seancat dëgjimore dhe pas përfundimit të tyre, Komisioni i Pavarur *Ad-Hoc* nisi procesin e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin) për renditjen e kandidatëve.

Duhet të theksohet se, gjatë kësaj periudhe, pati edhe ankimime pranë Gjykatës Administrative të Apelit nga 4 (katër) kandidatë për të cilët Komisioni kishte marrë dhe komunikuar vendimin se nuk plotësonin kriteret ligjore për të qenë anëtarë të KLGJ dhe KLP, në përfundim të të cilave rezultoi se ankimet e tre kandidatëve u rrëzuan nga Gjykata si të pambështetura në ligj. Ndërkohë, për kandidatin tjetër vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit jo vetëm ka krijuar pritshmëri jo të ligjshme dhe të pabazuara tek palët ndërgjyqëse por bie ndesh edhe me kritere dhe parime të gjykimit administrativ të vendosura tashmë nga vetë kjo gjykatë, apo edhe nga gjykatat e një niveli më të lartë të gjykimit.

Në vendimmarrjen e saj, *së pari*, Gjykata Administrative e Apelit ka shkelur kufijtë e lejuar të shqyrtimit të saj në këtë gjykim, kufij të cilët janë vendosur nga neni 10, i ligjit nr. 49/2012 dhe nenet 32 e 130, të ligjit nr. 115/2016, *së dyti*, gjykata ka shqyrtuar çështjen në meritë të saj në kundërshtim me sa i lejohej dhe ka marrë atributet e organit publik dhe, *së treti*, gjykata në përpjekje të interpretojë normën në fakt ka krijuar/shtuar normë<sup>253</sup>. Kjo vendimmarrje ka shkelur në mënyrë flagrante parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi nuk ka pasqyruar saktë ndërgjyqësinë në lidhje me palët e paditura si dhe ka shkelur afatin ligjor të dërgimit të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit<sup>254</sup>. Avokati i Popullit është i mendimit se tejzgjatja e procedurave për të zbardhur vendimin e arsyetuar, ka qenë e një natyre të tillë që rrezikonte në shkallë të konsiderueshme interesat e palëve, nga kohëzgjatja e tepruar e procedurës gjyqësore, për sa kohë që procesi i shqyrtimit nga Komisioni *Ad Hoc* kishte afate konkrete kohore të përcaktuara me ligj, të cilat janë të shkurtra dhe legjislacioni nuk parashikon mekanizma për sigurimin e objektit të padisë për një rast të tillë, por edhe sepse pozicionet vakante në KLGJ dhe KLP ishin të limituara në numër. Për këto arsye Avokati i Popullit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, për kundërshtimin e vendimit nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të kandidatëve, bazuar në kriteret e parashikuara në pikat 1 deri në 5, të nenit 34 dhe pikave 1 deri në 5, të nenit 132, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Metodologjinë e vlerësimit, Komisioni i Pavarur *Ad-Hoc* ka miratuar renditjen e kandidatëve. Me përfundimin e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin) për renditjen e kandidatëve për anëtarë në Këshillin

---

<sup>252</sup> Vendimi nr.11, datë 07.12.2023 i Komisionit të Pavarur Ad-Hoc.

<sup>253</sup> Bazuar edhe në jurisprudencën dhe vendimmarrjet e mëparshme të Gjykatës së Apelit, apo edhe të Gjykatës së Lartë, në këto lloj gjykimesh, nuk mundet që Gjykata në vendimin e saj ti imponojë Komisionit *Ad Hoc* se si duhet të marrë një vendim gjatë procedurave për vlerësimin paraprak dhe renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve. Duke ndodhur kjo gjë, Gjykata ka marrë kompetencat dhe tiparet e organit publik gjë që nuk përputhet me kompetencat ligjore të Gjykatës si dhe natyrën e gjykimit në këtë rast, pasi krijon një problematikë serioze në kuadër të kuptimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykata.

<sup>254</sup> Vendimi nr. 109 (86-2023-1510), i Gjykatës Administrative të Apelit u shpall në datën 28 dhjetor 2023, ndërsa vendimi i arsyetuar ju vu në dijeni Avokatit të Popullit (nëpërmjet shërbimit postar), vetëm në datën 16 janar 2024.

e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve, Komisioni i Pavarur *Ad-Hoc* më datë 29.12.2023 e konsideroi të përfunduar angazhimin në këtë proces.

Për rrjedhojë, nëpërmjet shkresës nr.8 prot, datë 23.01.2024, nga ana e Avokatit të Popullit iu përcoll Kuvendit të Shqipërisë raporti i vlerësimit dhe i gjithë dokumentacioni i plotë i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve.

Nisur nga angazhimi dhe eksperiencia e deritanishme e Avokatit të Popullit si pjesë e procesit të verifikimit paraprak për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve dhe shoqëria civile, vlerësohet nevoja e ndërmarrjes së iniciativave ligjore për ndryshimin e dispozitave të ligjit nr.115/2016, “Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë institucionale për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, afateve kohore të realizimit të këtij procesi, cilësisë së përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe nevojës së mbështetjes financiare të institucionit të Avokatt të Popullit në realizimin e këtij procesi etj.

#### *4.1.2. Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile*

Ashtu si dhe në rastin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë, Grupi *Ad-Hoc* i Punës për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, në përputhje me dispozitat ligjore, mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, brenda një afati 5 ditor nga momenti i paraqitjes. Në rastet kur u vlerësua e nevojshme të plotësohej dokumentacioni, kandidatët u njoftuan në rrugë elektronike, duke u lënë atyre në dispozicion një afat prej 5 ditësh, sikundër parashikohet nga ligji. Grupi *Ad-Hoc*, ka administruar të gjitha përgjigjet e ardhura nga kandidatët, duke evidentuar datën kur është kërkuar dokumentacioni/informacioni, si dhe datën kur është plotësuar dokumentacioni/informacioni nga kandidatët. Çdo komunikim elektronik me kandidatët, si dhe çdo dokumentacion që është paraqitur në rrugë elektronike, postare apo fizikisht nga kandidatët, është administruar nëpërmjet një procesverbali shtesë për dokumentacionin e paraqitur.

Nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të administruar rezultoi se kanë shprehur interes gjithsej 13 kandidatë nga radhët e shoqërisë civile, nga të cilët:

- në 2 raste, kandidatët kishin shprehur interesin vetëm për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- në 1 rast, kandidatja kishte shprehur interesin vetëm për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- në 9 raste kandidatët kishin shprehur interesin për anëtar në të dy pozicionet, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- në 1 rast kandidati u tërhoq nga kandidimi.

Për qëllime të verifikimit të plotësimit të çdo kriteri ligjor nga kandidatët, është hartuar nga një skedar individual për çdo kandidat, në të cilin u pasqyrua i gjithë dokumentacioni i paraqitur, që vërteton përmbushjen e secilit kriter, ose evidentohet kërkesa për dokumentacion shtesë, si dhe dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të kësaj kërkesë. Në zbatim të pikës 9, të nenit 56 dhe pikës 9, të nenit 154, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, u zhvillua më datë

25.08.2023, në ambientet e institucionit, përmes një procesi të hapur dhe publik, shqyrtimi dhe verifikimi i përmbushjes së kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatëve që kishin shprehur interesin për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Avokati i Popullit ftoi të gjitha organizatat e shoqërisë civile si dhe aktorë të tjerë të interesuar që të ishin pjesë e këtij procesi të rëndësishëm përmes prezencës dhe kontributit të tyre në këtë fazë shqyrtimi dhe verifikimi të përmbushjes së kushteve dhe kritereve ligjore. Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve sipas pikës 10 të nenit 56, Avokati i Popullit shpalli tre herë thirrjen për shprehje interesi për anëtarë të komisionit të shoqërisë civile,<sup>255</sup> që do të kryejnë verifikimin paraprak të kandidaturave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Duhet të theksohet se pas shpalljes së dytë, me përfundimin e afatit të shprehjes së interesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile, Avokati i Popullit nisi procesin e verifikimit të plotësimit të kritereve nga organizatat që kishin shprehur interes për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile duke bërë publike emrat e organizatave të cilat plotësonin kriteret e përcaktuara ligjore. Duke qenë se një nga organizatat e shoqërisë civile njoftoi heqjen dorë nga shprehja e interesit për pjesëmarrjen në komisionin e shoqërisë civile, kjo gjë krijoi mungesën e kuorumit minimal të konkurrueshmërisë dhe përzgjedhjes së tyre, sipas dispozitave të ligjit nr.115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, duke konsideruar të nevojshme rishpalljen e thirrjes për shprehje interesi për anëtarë të komisionit të shoqërisë civile.

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të plotësimit të kritereve, organizatat e shoqërisë civile të cilat plotësonin kriteret e përcaktuara ligjore për të vazhduar në fazën tjetër të procesit ishin si më poshtë:

- Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"
- Qendra “Qëndresa Qytetare”
- Fondacioni “Kontribut për Edukim”
- Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- Qendra për Çështjet e Informimit Publik “Infoçip”
- Shoqata “Drejtësia Sociale”
- Klinika Ligjore “Wisdom”

Me datë 18 shtator 2023, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e parë e organizatave të shoqërisë civile që plotësonin kriteret ligjore për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile. Duke qenë se ishin më shumë se 5 organizata që plotësonin kriteret ligjore, u ra dakort që më datë 20 shtator 2023, të zhvillohej procedura për përzgjedhjen me votim të fshehtë.

Në këtë datë, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e dytë e organizatave të shoqërisë civile. Prezent në këtë takim ishin përfaqësuesit e organizatave të mëposhtme<sup>256</sup>:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"
- Qendra “Qëndresa Qytetare”
- Fondacioni “Kontribut për Edukim”
- Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm

<sup>255</sup> Kjo për shkak të mungesës së interesit nga organizatat e shoqërisë civile për të marrë pjesë në këtë proces.

<sup>256</sup> Ndërkohë që nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë nuk mori pjesë asnjë përfaqësues.

- Qendra për Çështjet e Informimit Publik “Infoçip”
- Shoqata “Drejtësia Sociale”
- Klinika Ligjore “Wisdom”

Në përputhje me procedurat e parashikuara nga nenet 56 dhe 154 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas përfundimit të procesit të votimit, pesë organizatat që morën më shumë vota ishin si më poshtë:

- Qendra “Qëndresa Qytetare”
- Shoqata “Drejtësia Sociale”
- Klinika Ligjore “Wisdom”
- Fondacioni “Kontribut për Edukim”
- Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm

Organizatat e mësipërme të përzgjedhura si anëtare të komisionit të shoqërisë civile zgjodhën si kryetar të këtij komisioni z. Gentian Serjani, përfaqësues i shoqatës “Drejtësia Sociale”. Mbledhja e parë e këtij Komisioni u zhvillua më datë 26 shtator 2023. Duhet të theksohet se pas përfundimit nga Avokati i Popullit të procesit të hapur dhe publik, të shqyrtimit dhe verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatëve nga rradhët e shoqërisë civile, vlerësimi i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore së bashku me dokumentacionin përkatës të kandidatëve i’u vu në dispozicion Komisionit të Shoqërisë Civile, për të vijuar më tej sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Duhet të theksohet se gjatë periudhës së vlerësimit, pati edhe ankimime pranë Gjykatës Administrative të Apelit nga 4 (katër) kandidatë për të cilët Komisioni kishte marrë dhe komunikuar vendimin se nuk plotësonin kriteret ligjore për të qenë anëtarë të KLGJ dhe KLP, në përfundim të të cilave rezultoi se ankimet e dy kandidatëve u rrëzuan nga Gjykata si të pambështetura në ligj.

Vonesat në zhvillimin e seancave gjyqësore apo në zbardhjen e vendimeve nga Gjykata çuan në zgjatjen e procesit.<sup>257</sup> Komisioni i Shoqërisë Civile sapo pati në dispozicion të gjitha vendimet e zbardhura të Gjykatës Administrative të Apelit vijoi me hapat e mëtejshëm administrativ për përfundimin e këtij procesi dhe, më datë 17 prill 2024, përcolli pranë Kuvendit të Shqipërisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara nga neni 58, pika 1, dhe neni 156, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ashtu si dhe në rastin e procesit të verifikimit paraprak për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve, edhe për këtë proces vlerësohet se është e nevojshme ndryshimi i dispozitave të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, që lidhen me saktësimin e kriterëve dhe përcaktimin e standarteve të njëjta<sup>258</sup> të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për cilësitë e kandidatëve si dhe me funksionimin e Komisionit të Shoqërisë Civile. Gjykojmë se përfshirja e Avokatit të Popullit, jo vetëm në fazën e vlerësimit paraprak të dokumentacionit, por dhe si pjesë e këtij Komisioni do të ishte një vlerë e shtuar që do të kontribonte thelbësisht jo vetëm në garantimin e zbatimit të standarteve të njëjta por edhe në realizimin e një procesi transparent dhe në respekt të plotë të kriterëve ligjore, pa cenuar frymën dhe

<sup>257</sup> Vendimi i fundit i marrë nga Gjykata Administrative e Apelit për një nga kandidatët ankimues është i datës 28 shkurt 2024.

<sup>258</sup> Siç përcaktohen në rastin e procesit të verifikimit paraprak për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.

qëllimin e ligjit. Kjo, dhe për shkak të rolit dhe eksperiencës të fituar tashmë nga Avokati i Popullit në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për përzgjedhjen e anëtarëve nga rradhët e avokatisë.

#### 4.1.3. *Opinionimi “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me Marrëveshjen për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit*

Gjate vitit 2022 një e pesta (1/5) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqiti para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë kërkesën me objekt: “Shfuqizimin e ligjit 50/2022 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit,...”, me pretendimet kryesore për “Cënimin e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare”. Me anë të shkresës nr.826/27, datë 06.02.2022, të Gjykatës Kushtetuese, institucioni i Avokatit të Popullit u njoftua se për këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin e datës 31.01.2023, kishte vendosur “*Pranimin e kërkesës për thirrjen në cilësinë e subjekteve të interesuara në këtë gjykim edhe të Presidentit të Republikës dhe të Avokatit të Popullit*”. Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin e institucionit tonë dhe në respekt të përcaktimeve të dhëna në ligjin nr.8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kjo kërkesë u konsiderua nga ana e Avokatit të Popullit, si kërkesë për dhënien e një opinionimi “*Amicus Curiae*”, të cilin institucioni ynë ja dërgoi me shkrim Gjykatës Kushtetuese në fillim të muajit mars të vitit 2023.

Këtë opinion institucioni ynë u përpoq ta trajtonte si të lidhur jo vetëm me premisat e cënimit, apo jo të një të drejte themelore të njeriut, por edhe me dhënien e një perspektive më të gjerë nga këndvështrimi i standartit më të lartë të zbatimit të së drejtës. Më konkretisht në këtë opinion institucioni ynë trajtoi: premisat për cënimin e Trashëgimisë dhe Identitetit Kombëtar. Nga ana jone u theksua se Trashëgimia kombëtare përbën një nga bazat e shtetit shqiptar, të parashikuara si në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe në disa Konventa ndërkombëtare që vendi ynë ka ratifikuar. Trashëgimia kulturore, si komponent i trashëgimisë kombëtare, duhet të trajtohet në përputhje edhe me standardet universale parashikuara nga: neni 27 pika 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, neni 15 pika 1, gërma a, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (Faro, 27 tetor 2005).

Në lidhje me standardet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kombëtare, Parku Kombëtar i Butrinti është një pasuri e trashëgimisë kulturore, e cila përbën për çdo shtetas të vendit tonë një gur themeli të rëndësishëm në krijimin e identitetit tonë kombëtar. Ky Park dhe zona rreth tij është një pasuri jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare/universale dhe për vlerat që ka, është përfshirë në listën e pasurive botërore të UNESCO-s (Konventa “Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore” ose Konventa e Parisit), si sit ligatinor me rëndësi ndërkombëtare, për habitatet e shpendëve ujorë ose Konventa Ramsar.

Duke qenë se Parku i Butrintit përfiton mbrojtje edhe nga Konventa të tjera, si ajo “Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore” (Konventa e Parisit), në opinionin dërguar Gjykatës Kushtetuese, nga ana jonë u trajtua pjesëmarrja e Ministrisë së Kulturës në Fondacionin Butrinti, në

raport me legjislacionin vendas, duke analizuar ligjin nr. 28/2018 «Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë», legjislacionin që rregullon krijimin dhe veprimtarinë e Fondacioneve (nenet 54 – 63 të Kodit Civil, ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar,<sup>259</sup>), si dhe karakteristikat e institucioneve shtetërore që krijohen me ligje të posaçme dhe kanë formën e personit juridik publik, në raport me Fondacionet që krijohen nga persona fizike ose juridikë.

Po kështu në opinionin tonë u analizua: Parimi i pavarësisë së Organizatave jofitimprurëse<sup>260</sup>, problematikat që mund të hasen në rastet e mbivendosjes së pjesëmarrjes së institucioneve publike shtetërore, si bashkëthemelues me persona juridikë privatë në të njëjtin fondacion; pamjaftueshmëria e legjislacionit për të rregulluar pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore publike në Fondacione. Kjo pasi përfshirja e dy neneve në ligjin nr. 20/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe nxjerrja e një akti nënligjor të Ministrisë të Kulturës në zbatim të tij, janë të pamjaftueshme për krijimin apo pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore publike në Fondacione. Në vlerësimin tonë dhënë në opinion, do duhej që fillimisht të hartohej i plotë legjislacioni, ku duhet të saktësohet me rregulla si pjesëmarrja e institucioneve shtetërore publike në Fondacione të këtij lloji, ashtu edhe mënyra e mbikqyrjes së Fondacioneve nga shteti (detyrim ky i parashikuar në Kodin Civil, por ende i paplotësuar si duhet)<sup>261</sup>.

Në opinion kemi trajtuar edhe mungesën e harmonizimit të pjesëmarrjes së Ministrisë së Kulturës në një Fondacion të tillë, me politikat dhe fushën e veprimit të kësaj Ministrie. Kjo pasi politikat udhëzuese që i ka përcaktuar Këshilli i Ministrave Ministrisë së Kulturës, janë: Sigurimi i mbështetjes financiare nëpërmjet Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, por jo krijimi apo pjesëmarrja në Borde për menaxhimin e pasurive me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore, siç është bashkëthemelimi dhe pjesëmarrja e Ministrisë së Kulturës në Fondacionin për menaxhimin e Butrintit.

Edhe pjesëmarrja e Ministrisë të Kulturës në anëtarësinë e bordit drejtues të Fondacionit Butrinti, pavarësisht se mund të ketë patur si qëllim garantimin e përfaqësimit më të mirë të interesave shtetërore në mbrojtjen e Parkut të Butrintit, në thelb është një element problematik, pasi në cilësinë e anëtarit, Ministri do të duhet t’i nënshtrohet një legjislacioni tjetër dhe jo atij mbi bazën e të cilit ai ushtron veprimtarinë si organ publik. Ky pozicionim i dyzuar i Ministrisë të Kulturës, mund të krijojë problematikë si në përfaqësim ashtu edhe në kuorumin e vendimmarrjes në Bord.

Në opinion analizohen edhe: Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë, e 27 tetorit 2005, Konventa Evropiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (e rishikuar), paqartësia në lidhje me kompetencat e Institutit të Arkeologjisë, si dhe referenca në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe administrimin e saj, e vlerëson me qëllimin që përveç ruajtjes së cilësisë së jetës, edhe për kujdesin për burimet historike, kulturore dhe artistike të rajonit dhe banorëve të tij, duke i njohur

---

<sup>259</sup> Neni 2, pika 3 e ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”: “*Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtme kanë këto kuptime ...3. “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e tyre zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti*».

<sup>260</sup> Neni 6 «Parimi i pavarësisë nga shteti» dhe neni 7 «Marrëdhëniet e organizatave jofitimprurëse me organet shtetërore», të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.

<sup>261</sup> Neni 59, i Kodit Civil: “*Rastet dhe mënyra e mbikqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj*”.



autoriteteve kombëtare gëzimin e një hapësire vlerësimi në përcaktimin e interesit të përgjithshëm të shoqërisë<sup>262</sup>.

Në fokusin e detyrimit që ka shteti shqiptar për mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare sipas Kushtetutës (nenet 3 dhe 59/1/g), standardeve të konventave të ratifikuara nga vendi ynë (kryesisht Konventa e Parisit), apo edhe të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në lidhje me cënimin e Trashëgimisë kombëtare natyrore, në opinion kemi vlerësuar se nën këndvështrimin juridiko-administrativ, ndërthurja e elementëve arkeologjik dhe mjedisor në zonën e Butrintit dhe rreth tij, është mjaft specifike, pasi i nënshtrohet legjislacioneve të ndryshme, që rregullojnë përkatësisht fushën mjedisore dhe atë kulturore/arkeologjike, legjislacione këto që brenda të njëjtës sipërfaqe gjeografike përcaktojnë: struktura të ndryshme administrimi, regjime të ndryshme ruajtjeje dhe mbrojtjeje, si dhe plane menaxhimi të ndryshme.

Në opinion kemi theksuar se bashkëhartimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të pasurive të përfshira në listën e UNESCO-s, nga institucionet shtetërore, është një standard i pranuar si nga Konventat ndërkombëtare të sipërcituara, ashtu edhe nga Manualet e UNESCO-s, në zbatim të këtyre Konventave dhe se moszbatimi i detyrimeve ligjore të mësipërme, si:

- moszbatimi nga Fondacioni i Planit të menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit të miratuar me VKM, por përkundrazi përpjekja për të zbatuar një plan të ndryshëm menaxhimi të hartuar nga vetë Fondacioni;
- kalimi i kompetencave për administrimin e Parkut Kombëtar të Butrintit, nga Bordi i përbërë me përfaqësues të institucioneve shtetërore, tek Fondacioni (ku përfaqësohet vetëm Ministria e Kulturës);
- mosushtrimi i kompetencave të Administratës Rajonale të Zonës së Mbrojtur, për të ushtruar kompetencat që i janë njohur me ligj brenda Zonës së Parkut Kombëtar;
- janë premisa për cënimin e drejtëpërdrejtë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, dhe si të tilla:
- janë në shkelje të neneve 3, 59 gërmat, d, dh dhe g, të Kushtetutës;
- bien ndesh me parimin e shtetit të së drejtës (parashikuar nga neni 4 i Kushtetutës);
- bien ndesh me parimet e Konventave ndërkombëtare të cituara më sipër.<sup>263</sup>

Për arritjen e një standardi, në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes sa më të mirë të identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, kemi vlerësuar dhe rekomanduar në opinion që për harmonizimin e legjislacionit të fushave të kulturës dhe mjedisit, si dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare, për territorin e Parkut të Butrintit dhe zonën rreth tij, ka nevojë për parashikime ligjore specifike (si psh. hartimi i një ligji të veçantë për Parkun e Butrintit), përpara se të kalohet në forma të reja administrimi, siç parashikon ligji nr. 50/2022.

Kemi vlerësuar gjithashtu se duhet patur mjaft kujdes, që në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje, nuk duhet kurrësesi të krijohen hapësira që mund të ndikonin negativisht në situatën mjedisore të Parkut të Butrintit, qasje kjo që kërkon rishikimin e bazës rregullatore të krijimit të marrëdhënies ndërmjet shtetit shqiptar, dhe Fondacionit të menaxhimit të Butrintit, me qëllim si ofrimin e garancive të plota për

---

262 Vendimet e GJEDNJ-së Kozacioğly kundër Turqisë, 19 Shkurt 2009, § 54 dhe Kristiana LTD kundër Lituaniës, 6 shkurt 2008, § 104, Beyeler kundër Italisë, 5 janar 2000, § 112; Ruspoli Morenes kundër Spanjës, 28 nëntor 2001, § 39 dhe vendimi Debelianovi kundër Bullgarisë, 29 qershor 2007, § 54.

263 Sipas nenit 122, pika 3 të Kushtetutës: “Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

përmbushjen e funksioneve dhe detyrimeve themelore të shtetit që rrjedhin nga Konventat e ratifikuara nga vendi ynë, si dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, për verifikimin e respektimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare mjedisore, me qëllim që të mos preket niveli i mbrojtjes mjedisore në këtë Pasuri Botërore dhe Zonë Ramsar.

Duke qenë se opinioni ynë synonte të jepte edhe standarde ndërkombëtare, nga ana jonë u bënë përpjekje për të evidentuar modele të tilla të ngjashme në vende të tjera (pra të administrimit të pasurive me vlera universale, nëpërmjet bashkëthemelimit të Fondacioneve të këtij lloji), por nuk u gjet ndonjë rast i ngjashëm. Për më tepër që nga materialet e shqyrtuara për këtë opinion, rezultoi se kalimi në këtë formë të re administrimi, e cila e nuk ishte provuar kurrë më parë, u krye pa argumentuar/provuar domosdoshmërinë e këtij modeli të ri dhe pa shfrytëzuar dhe shteruar fillimisht mundësitë aktuale që lidhen me përmbushjen e funksioneve themelore të vetë shtetit<sup>264</sup>. Duke referuar nivelin aktual ndërkombëtar të konsiderimit të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore si një e drejtë themelore e njeriut, në kuadër të respektimit të parimit të proporcionalitetit, sa i takon ndërhyrjes që shkaktohet në këtë të drejtë nga ndryshimi i formës së menaxhimit, në opinion është analizuar gjithashtu kriteri i përpjesëtimit të drejtë, midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë, në mënyrë që kufizimi mos të çënojë thelbin e të drejtës.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në jurisprudencën e saj ka theksuar se pavarësisht diskrecionit që ka ligjvënësi për të vepruar brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë, është e papranueshme në shtetin e së drejtës ndërmarrja dhe miratimi i nismave ligjvënëse të pabazuara në vlerësime ose studime paraprake (shih vendimin nr.29 datë 2.07.2021 dhe vendimin nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera.

Në konkluzion të opinionit, institucioni ynë ka rekomanduar që *nisur edhe nga statusi i lartë që gëzon Parku Kombëtar i Butrintit, legjislacioni shqiptar që mbulon fushat e ruajtjes dhe administrimit të pasurive kulturore dhe natyrore në Republikën e Shqipërisë, parë në kontekstin Kushtetues të ruajtjes sa më mirë të Trashëgimisë dhe Identitetit Kombëtar, por edhe të frymës së Konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, shfaq problematika të cilat mund të përbëjnë premisa për çënim të parimeve kushtetuese, ndaj ka kërkuar një vlerësim shumë të kujdesshëm nga ana e Gjykatës Kushtetuese.*

4.1.4. *Opinionit “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”*

Avokati i Popullit ka dhënë mendim me kërkesë të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e paraqitur nga kërkuuesi Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, me objekt *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e*

---

<sup>264</sup> Konventat ndërkombëtare në të cilat Parku i Butrintit është i përfshirë (Konventa e Parisit, Konventa Ramsar, etj.), parashikojnë ndihma në rast nevojë, mundësi këto që nuk rezultoi të kishte qenë nevoja për tu përdorur si opsione.

*Republikës së Shqipërisë të Vendimit nr.495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykateve”.*

Institucioni i Avokati i Popullit, në fazat e para të propozimit të hartës së re gjyqësore, përpara miratimit të Vendimit të sipërpërmendur, ka ndjekur me shumë vëmendje diskutimet dhe debatet publike mbi këtë propozim të mbajtura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Për arsye se kjo çështje ka pasur një ndjeshmëri të lartë, por duke mbajtur parasysh edhe ankesat e paraqitura nga qytetarët në institucion, sidomos ata që iu përkasin grupeve vulnerabël, është filluar hetimi i rastit me iniciativë. Në përfundim të hetimit administrativ është adresuar edhe rekomandim për këtë çështje *për rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, duke garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.*

Avokati i Popullit vlerësoi se zbatimi i hartës së re nuk e përmirëson aspak aksesin në drejtësi, por përkundrazi e cenon këtë parim, duke passjellë edhe rritjen e kostove për qytetarët dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Në rastin e zbatimit të reformës në drejtësi në vendin tonë prej disa vitesh tashmë, janë konstatuar vakanca të theksuara të gjyqtarëve në gjykata të niveleve të ndryshme. Njëkohësisht kjo ka passjellë zvarritje të gjykimeve të shtetasve, rrjedhimisht cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht atë që lidhet me gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Miratimi i hartës gjyqësore i cili redukton dukshëm gjykatat, mund të rezultojë një reformë që do të kufizojë edhe më shumë të drejtën e qytetarëve lidhur me respektimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjeve.

Po ashtu, rritja e distancës për të vijuar gjykimet në shkallën e parë dhe të dytë të gjykimit sipas hartës së re, do të ndikojë dukshëm në vështirësitë që do t’u paraqiten qytetarëve për të ndjekur proceset gjyqësore dhe njëkohësisht rritjen e shpenzimeve. Vakancat e gjyqtarëve reflektojnë problematikën më të madhe në funksionimin normal të gjykatave. Kjo situatë sjell pamundësi për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve, duke krijuar vonesa të konsiderueshme në dhënien e drejtësisë.

Avokati i Popullit në opinionin e dërguar Gjykatës Kushtetuese i qëndroi mendimit se harta gjyqësore e miratuar e cenon aksesin në drejtësi në interpretim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj duhet rishikuar, duke u vlerësuar në këndvështrimin e garantimit të aksesit në drejtësi të qytetarëve si në gjykatat e shkallës së parë (të juridiksionit të përgjithshëm dhe ato administrative) edhe në gjykatat e apelit.

Gjykata Kushtetuese më datë 27.12.2023, pasi mori në shqyrtim kërkesën dhe pretendimet e parashtruara nga kërkuesit, si edhe prapësimet e subjekteve të interesuara, me shumicë votash, vendosi: *“Rrëzimin e kërkesës. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të individit në gjykatë, Gjykata vlerësoi se në balancimin e interesave është respektuar interesi publik i së mirës së përgjithshme, nga njëra anë, me kufizimin e së drejtës së aksesit, nga ana tjetër”.*

Duke vënë në balancë pasojat që synon zbatimi i hartës së re gjyqësore, që lidhen me të drejtën e individit për eficiencë, efikasitet dhe cilësi në dhënien e shërbimit të drejtësisë, me pasojat në të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, Gjykata arriti në përfundimin se kjo ndërhyrje nuk cenon parimin e proporcionalitetit.

Në krahasimin e këtyre pasojave është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se individët kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën kushtetuese për akses në gjykatë pavarësisht efekteve të riorganizimit gjyqësor, të cilat, në thelb, nuk e kanë bërë të pamundur ushtrimin e kësaj të drejte.<sup>265</sup>

4.1.5. *Opinionimi “Amicus Curiae” në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me çështjen kushtetuese me objekt: “Kontrolli i kushtetueshmërisë së nenit 377 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në datën 20.09.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesat me nr. 9 (GJ) 2023 të Regjistrimit Themeltar të paraqitur nga Gjykata e Lartë dhe nr. 11 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, të paraqitur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me objekt: “Shfuqizimi i nenit 377 të Kodit Civil, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. (Ligji nr. 8577/2000)

Me anë të shkresës nr. 866/5 Prot, datë 20.09.2023, “Njoftim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë publike si dhe bashkimin e çështjeve”, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me vendimin e datës 20.09.2023 ka vendosur bashkimin e gjykimit të këtyre çështjeve në një çështje të vetme me objekt: “Shfuqizimi i nenit 377 të Kodit Civil, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” si dhe thirrjen në këtë gjykim me cilësinë e subjekteve të interesuara Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave, Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Avokatin e Popullit.

Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin e institucionit tonë dhe në respekt të përcaktimeve të dhëna në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kjo kërkesë u konsiderua nga ana e Avokatit të Popullit, si kërkesë për dhënien e një opinionimi “*Amicus Curiae*”, të cilin institucioni ynë ia dërgoi me shkrim Gjykatës Kushtetuese brenda muajit tetor të vitit 2023.

Këtë opinion institucioni ynë u përpoq ta trajtonte si të lidhur jo vetëm me premisat e cënimit, apo jo të një të drejte themelore të njeriut, por edhe me dhënien e një perspektive më të gjerë nga këndvështrimi i standartit më të lartë të zbatimit të së drejtës, në kushtet kur Institucioni i Avokatit të Popullit është një organ Kushtetues i cili mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit dhe i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje.

Avokati i Popullit është një organ që kryen një rregullim institucional të shtetit të së drejtës duke promovuar standartet e një procesi të rregullt ligjor, i shtrirë ky te të tre pushtetet: legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Avokati i Popullit si mekanizëm i shtetit të së drejtës me kompetenca fleksibël, ndihmon në ruajtjen e themeleve të këtij të fundit, pasi cenimi i një të drejte siç është “e drejta e pronës” duhet jo

---

<sup>265</sup> Për më tepër, shih vendimin nr.70 datë 27.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese:

[https://www.gjk.gov.al/include\\_php/previewdoc.php?id\\_kerkesa\\_vendimi=3975&nr\\_vendim=1.](https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3975&nr_vendim=1.)

vetëm të ndjekë një qëllim legjitim, por ky cenim duhet të jetë proporcional për të mos krijuar një disbalancë në ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut.

Lidhur me papajtueshmërinë e nenit 377 të Kodit Civil me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbështetur qëndrimin e shprehur nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë se neni 377 i Kodit Civil vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe për këtë shkak ai duhet të shfuqizohej nga Gjykata Kushtetuese. Ky nen sipas Institucionit të Avokatit të Popullit, cënon disa nga parimet më të rëndësishme kushtetuese dhe është në kundërshtim me parashikimet dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në opinionin e paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese u analizuan, ndër të tjera, disa parime juridike si më poshtë vijon:

*Cënimi i parimit të sigurisë juridike.* Sipas qëndrimit të paraqitur nga ana jonë në lidhje me cënimin e këtij parimi në vështrim të nenit 377 të Kodit Civil, siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, se shkaqet që janë vlerësuar nga jurisprudenca kushtetuese se kanë çuar në cenimin e parimit të sigurisë juridike janë të ndryshme. Ato përfshijnë nga shkeljet me karakter konceptual, dijenia për normën juridike, qartësia e normës, ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit, garancia e mosdënimit pa ligj, zgjatja e procesit gjyqësor, moscenimi i vendimit të formës së prerë dhe detyrimi për zbatimin e tyre, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme dhe realizimi i mbrojtjes efektive gjyqësore.

Ekzistenca e një norme juridike në sistemin ligjor nuk është e mjaftueshme për të konsideruar të plotësuar kërkesën për siguri juridike, kjo për faktin se norma duhet të jetë edhe e qartë. Paqartësia nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike<sup>266</sup>.

Bazuar në standardin kushtetues si më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se neni 377 i Kodit Civil i cili rregullon rrethin e subjekteve që gëzojnë të drejtën për të përfituar me testament, lexuar në sinkron edhe me nenin 406 të këtij Kodi në masën që ndërvepron me këtë dispozitë, në stadin aktual, nuk paraqitet në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, parë nën optikën e sigurisë juridike, qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ.

Neni 377 i Kodit Civil paraqitet sipas opinionit të Avokatit të Popullit si një normë plotësisht kufizuese, e paqartë dhe problematike dhe kufizimi i lirisë së testatorit në caktimin e trashëgimitarit testamentar në kuptim të nenit 377, është maksimalisht ndërhyrës dhe kushtëzues. Testatori shtetas shqiptar, sipas këtij neni gjendet në një pozitë pamundësie absolute për të disponuar me testament ndaj një personi të tretë jashtë rrethit të trashëgimtarëve të tij ligjorë, qoftë edhe për një pjesë minimale të pasurisë së tij. Ai është i detyruar që t'i nënshtrohet plotësisht rrethit të trashëgimtarëve që, natyrisht ose ligjërisht janë të tillë, duke qenë i detyruar të mos përfshijë në disponimin testamentar persona të tretë, që ai si testator, qenie njerëzore afektive dhe emocionale, ka zgjedhur t'i konsiderojë të tillë. Testatori është i detyruar të respektojë kufijtë ligjorë, dhe të përshtasë vullnetin e tij sipas atij të ligjëvënësit, pa i garantuar këtij subjekti sigurinë juridike që të disponojë pasurinë e tij mbi baza autonome afeksioni, mirënjohjeje, situatash faktike ndaj personave të tretë që shkojnë përtej këtij rrethi.

---

<sup>266</sup> Shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005, nr.14, datë 22.05.2006, nr.36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

Në opinion kemi trajtuar gjithashtu, cënimin e së drejtës së pronës si pasojë e cënimit të parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë së shtetasve, referuar parashikimeve ndaluese e kufizuese të bëra nga neni 377 i Kodit Civil. Sipas opinionit të paraqitur nga Avokati i Popullit, e drejta për të disponuar lirisht me testament, konsiderohet si parim thelbësor në të drejtën testamentare që duhet të reflektohet në përkushtimin e legjislacionit ndaj respektimit të autonomisë individuale të testatorit. Kështu, liria testamentare manifestohet nëpërmjet lirisë së formës së testamentit, përmbajtjes së lirë apo revokimit të testamentit. Ky parim, presupozohet të manifestohet edhe në atë që përbën thelbin e testamentit, libertas testandi të testatorit që të vendosë lirisht mënyrën se si dhe ndaj kujt pasuria e tij do të disponohet.

Referuar qëndrimit të paraqitur, sipas nenit 377 të Kodit Civil në fuqi, rezulton se testatori mund të disponojë pasurinë e tij në favor të çdo personi fizik apo juridik vetëm nëse nuk le të paslindur, të paralindur, vëllezër apo motra. Kjo dispozitë që në pamje të parë duket se sanksionon lirinë e testatorit, në të vërtetë përbën kufizimin më të madh të vullnetit të tij. Avokati i Popullit çmon se neni 377 i Kodit Civil shkon në kundërshtim me të drejtën themelore të pronësisë, në kushtet kur ndalon testatorin, titullar legjitim të drejtash civile e kushtetuese, që pavarësisht respektimit të nenit 379 “*rezerva ligjore*” të këtij Kodi, të disponojë lirisht pasurinë e tij në favor të të tretëve, të cilët janë gjithashtu titullarë legjitimë të drejtash civile e kushtetuese. Si pasojë, neni 377 krijon një regjim diferencues dhe kontradiktor në disa aspekte:

- diferencon testatorin/pronar titullar legjitim të drejtash civile e kushtetuese nga individi/pronar titullar legjitim të drejtash civile e kushtetuese nga individi/pronar. Ky i fundit ndryshe nga testatori dhe pavarësisht se cilësitë mund t’i përkasin të njëjtit person, mund të disponojë lirisht pasurinë e tij nëpërmjet formave të tjera të pranuar për transferimin e pronësisë, kontratë dhurimi, shitjeje, etj;
- diferencon veprimet juridike për kalimin e pronësisë të cilat pavarësisht se janë të njëanshme, të dyanshme, mortis apo vitae causa bazohen të gjitha mbi autonominë e vullnetit të palëve;
- diferencon trashëgimtarin testametar/përfituesin e pasurisë titullar legjitim të drejtash civile e kushtetuese nga individi/ përfituesi i pasurisë titullar legjitim të drejtash civile e kushtetuese. Ky i fundit ndryshe nga trashëgimtari testamentar dhe pavarësisht se cilësitë mund t’i përkasin të njëjtit person, mund të përfitojë lirisht pasuri nëpërmjet njëres nga mënyrat për fitimin e pronësisë, kontratë dhurimi, shitjeje, etj;
- neni 377 shpreh tërësisht ekuilibrat ndërmjet, a. të drejtës të personave për të disponuar lirisht pasurinë me testament njësoj si me çdo akt tjetër të ligjshëm e të vlefshëm juridik brenda kufijve të nenit 379 dhe të drejtës së personave të tretë për t’a fituar këtë pasuri në një nga mënyrat e njohura nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi dhe b. të drejtës së subjekteve që përbëjnë rrethin familjar për të përfituar në përputhje me nenin 379, një kuotë të caktuar të detyrueshme nga masa trashëgimore testamentare/pasuria e trashëgimlënësit. Të drejtat e subjekteve sipas grupit a paraqiten ligjërisht pak ose aspak të mundshme, kundrejt të drejtave absolute totalitare të grupit b, që rrjedhin në mënyrë të njëkohshme nga instituti i trashëgimisë ligjore dhe neni 377 dhe 379 i Kodit Civil.

Në fokus të opinionit të Avokatit të Popullit në kuadër të papajteshmërisë së nenit 377 të Kodit Civil me Kushtetutën e ligje të tjera, ishte edhe cënimi i së drejtës për respektimin e jetës familjare si pasojë e cënimit të parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë së shtetasve. Pas një analize të hollësishme të këtij

parimi, jemi fokusuar te praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rastet konkrete që afektojnë dispozitën ligjore të Kodit Civil<sup>267</sup>.

Sipas opinionit të paraqitur nga Avokati i Popullit, rezulton se neni 377 i Kodit, i cili nulizon të drejtën e testatorit për të disponuar dhe nuk i garanton personave të tretë të drejtën për të përfituar as përjashtimisht me testament mbi baza “afeksioni” dhe jo “gjaku”, pavarësisht se mbeten të pacënuara përcaktimet e trashëgimisë ligjore dhe rezervës ligjore, përbën trajtim të ndryshëm ndaj titullarëve të të njëjtave të drejta civile dhe kushtetuese. Ky trajtim i diferencuar, evidentohet maksimalisht në pamundësinë ligjore për të përfituar me testament, edhe të bashkëjetuesit faktik të testatorit, i cili njësoj si bashkëshorti i ligjshëm ka patur me de cuius një jetesë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie në përmbushje të detyrimeve, në kuadër të ndjenjës së dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit të “familjes”.

Avokati i Popullit ka çmuar se çdo lloj kufizimi ligjor duhet të jetë proporcional, duke gjetur një balancë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore të individit, sepse vetë parimet e proporcionalitetit suplementohen nga nocionet e sigurisë juridike apo transparencës. Për më tepër, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm dhe kjo domosdoshmëri ka të bëjë gjithashtu me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë kushtetuese/ligjore e nuk mund të konsiderohet i nxjerrë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe barazisë së shtetasve, një kufizim ligjor si ai i sanksionuar nga neni 377 i Kodit Civil, në kushtet kur partnerët faktikë si dhe çdo i tretë që përjashtohet nga të drejtat sipas trashëgimisë ligjore, përjashtohen gjithashtu nga i vetmi mjet tjetër ligjor suksesues, trashëgimia testamentare. Në këto kushte, neni 377 i Kodit Civil (lexuar së bashku me nenin 406), në kushtet kur ndalon testatorin, që pavarësisht respektimit të nenit 379 “Rezerva Ligjore”, të disponojë lirisht pasurinë e tij në favor të familjes faktike dhe këta të fundit në ndryshim nga kategoria e familjarëve trashëgimtarëve ligjorë, privohen nga e drejta për të fituar pronësinë nëpërmjet testamentit, është joproporcional dhe krejtësisht i papajtueshëm me të drejtat kushtetuese/konventore të respektimit të jetës familjare, mosdiskriminimit dhe barazisë së shtetasve.

Duke qenë se opinionin ynë synonte të jepte edhe standarde ndërkombëtare, nga ana jonë u bënë përpjekje për të evidentuar modele të tilla të ngjashme në vende të tjera, duke analizuar në mënyrë specifike jo vetëm ligjin shqiptar që nga viti 1929 e deri në dispozitat konkrete ligjore në fuqi, por edhe legjislacionin e disa vendeve evropiane<sup>268</sup>.

Në krahasim të parashikimeve ligjore të nenit 377 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se neni objekt gjykimi kushtetues (si dhe të gjithë nenet që afektohen prej tij, në masën korresponduese), nuk është i pajtueshëm me kërkesën për siguri juridike, për faktin se norma është e paqartë, dhe nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon të arrijë.

---

<sup>267</sup> Beyeler k. Italisë, nr. 33202/96, parag.100, Fabric k. Francës parag.49 etj, Marckx k. Belgjikës parag. 52-55; Fabris k. Francës”, Moretti dhe Benedetti k. Italisë, Niemietz k. Gjermanisë, Abdulaziz k. Britanisë së Madhe, Keegan k.Irlandës, Marckx k. Begjikës), Brauer k. Gjermanisë, (Lafe k. Spanjës), (X,Y dhe Z k. Mbretëria e Bashkuar).

<sup>268</sup> Kodin Civil Italian, Kodin Civil Gjerman, sistemin juridik francez.

Në konkluzion të opinionit, Avokati i Popullit ka vlerësuar se neni 377 i Kodit Civil (lexuar në sinkron me nenin 406 të këtij Kodi), është i papajtueshëm me të drejtat kushtetuese/konventore të sigurisë juridike, të drejtës së pronës dhe të drejtës për jetë familjare, si pasojë e cënimit të parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë së shtetasve si dhe mungesës së proporcionalitetit.

Gjithashtu, referuar çështjes objekt gjykimi kushtetues, Avokati i Popullit çmon se nevojitet interpretimi mbi baza kushtetuese, i disa dispozitave të paplota dhe/ose të paqarta të Kodit Civil që lidhen me trashëgiminë testamentare në kuadër të nenit 377, të tilla si: (i) neni 374 i Kodit Civil (nëse pazotësia për të fituar me testament i referohet vetëm kushteve sipas neneve 320, 322, 375 apo i referohet edhe përfshirjes në radhët e trashëgimisë ligjore 361-364 të K.Civil), (ii) neni 384 i K.Civil “Legu dhe barra” (disponim testamentar minor që ndjek logjikën e nenit 377), si dhe orientimi i ligjvënësit, për dispozita të paqarta që afektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga neni 377 i Kodit Civil, si pasojë e konkluzioneve që do të nxirren nga Gjykata Kushtetuese lidhur me shpalljen ose jo antikushtetuese të kësaj dispozite.

Vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese me vendimin e datës 27.12.2023, mbështeti qëndrimin e paraqitur nga Avokati i Popullit lidhur me çështjen e sipërcituar, duke pranuar kërkesën dhe duke konstatuar si të papajtueshëm me Kushtetutën nenin 377 të Kodit Civil e duke detyruar Kuvendin e Shqipërisë që brenda një viti nga hyrja në fuqi e vendimit të sipërcituar, të plotësojë boshllëkun ligjor të rrjedhur si rezultat i këtij vendimi.

#### *4.1.6. Monitorimi i aksesueshmërisë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuara në Qendrat e Votimit*

Në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2023, me qëllim evidentimin e problematikave potenciale ekzistuese dhe marrjen e masave të nevojshme përkatëse për garantimin e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokatit të Popullit (Seksioni i Përgjithshëm dhe përfaqësuesit e Zyrave Rajonale në qytetet Shkodër, Kukës, Pogradec, Dropull i Poshtëm, Sarandë, Berat, Vlorë, ka monitoruar aksesueshmërinë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit në disa qytete të Shqipërisë, sipas Planit të Punës të miratuar nga Avokatja e Popullit, znj.Erinda Ballanca.

#### *Gjetjet nga monitorimi në Qendrat e Votimit*

Nga Seksioni i Përgjithshëm janë monitoruar 510 Qendra Votimi të vendosura në 252 institucione shtetërore në bashkitë: Tiranë, Lezhë, Lushnje, Divjakë, Fushë-Krujë, Durrës, Kavajë, Elbasan, Gramsh, Cërrik, Fier, Pukë, Fushë-Arrëz, Rrogozhinë, Vau i Dejës, Kamëz, Kashar, Vorë, Tiranë/ Njësia Administrative Dajt dhe Kashar.

Nga përfaqësuesit e Zyrave Rajonale 430 Qendra Votimi të vendosura në 169 institucione shtetërore në bashkitë: Kukës, Sarandë, Shkodër, Malësi e Madhe, Berat, Kuçovë, Poliçan, Dimal, Pogradec, Maliq, Librazhd, Vlorë, Dropull/Njësia Administrative Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm, Pogon.



Qyteti	Nr. QV	Nr.institucionesh	Me rampë	Pa rampë	Sinjalistikë për të verbrit
Lezhë	22	9	7	2	
Lushnje	35	13	7	6	
Divjakë	13	4	4	-	
Laç	17	8	5	3	
Fushë-Krujë	15	13	7	6	
Durrës	89	61	55	6	
Kavajë	17	9	7	2	
Elbasan	33	16	11	5	
Gramsh	12	9	5	4	
Cërrik	14	9	7	2	
Fier	53	19	15	4	
Pukë	5	5	3	2	
Fushë-Arrëz	4	4	2	2	
Rrogozhinë	7	7	5	2	
Vau i Dejës	4	4	3	1	
Kamëz	50	11	11	-	
Dajt	22	7	5	2	
Kashar	23	3	3	-	
Vorë	12	5	4	1	
Tiranë	63	36	36	-	
Vlorë	72	25	15	10	
Pogradec	75	26	3	23	
Maliq	9	4	1	3	
Prrenjas	4	1	1	-	
Librazhd	6	4	1	3	
Berat	88	30	16	14	
Kukës	22	17	5	12	
Dropull	21	18	3	15	
Sarandë	34	12	-	12	
Shkodër	99	32	18	14	
Gjithsej	940	421	265	156	

Pra, nga monitorimet e kryera në 421 institucione, ku ishin të vendosura 940 QV, 265 institucione ishin të aksesueshme në katet e para të godinave për personat me aftësi të kufizuara (pajisur me rampë në hyrje të godinave) në lëvizje, ndërsa për 156 institucione mungonte vendosja e rampës për në hyrje të godinave.

E shprehur në përqindje, rezulton se 59% e institucioneve, kryesisht arsimore nuk kanë akses për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje.

Në qendrat e votimit të vendosura në katin e dytë të godinave nuk kishte akses për personat me aftësi të kufizuara, pasi nuk janë të pajisura me ashensor apo rampë të brendshme, përveçse dy apo tre shkollave.

Në rastet kur Qendrat e Votimit ishin caktuar në katin e dytë, nuk ishin parashikuar masa specifike për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në lëvizje dhe shikim, megjithë përgjigjet pozitive të ardhura nga disa drejtues të qeverisjes vendore për marrjen në konsideratë dhe zbatimin e rekomandimeve të dërguara për garantimin e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim.

Ndërsa mbetet evidente, si një problematikë ende e pazgjidhur në të gjitha institucionet shtetërore, ku ishin të vendosura qendrat e votimit, mospasja e infrastrukturës ndërtimore për personat me aftësi të kufizuar në shikim.

Avokati i Popullit vë theksin se mungesa e lehtësive të përshtatshme për votimin e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, mund të konsiderohet edhe si një kufizim, apo pengesë, ndaj të drejtës së tyre të votës.

#### *4.1.7. Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj*

Edhe gjatë vitit 2023, institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka vijuar monitorimin e kufijve nëpërmjet zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore,”<sup>269</sup> për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastrë, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll, Bilisht).

#### ***Panorama kombëtare e prurjeve migratore***

Shqipëria është pjesë e Rrugës së Ballkanit Perëndimor ku migrantët e parregullt hyjnë nga kufiri jugor dhe juglindor shqiptar me Greqinë. Nga informacioni i punonjësve të policisë kufitare rezulton se grupet migratore që mbërrijnë në Shqipëri nuk e konsiderojnë vendin tonë si destinacion për qëndrim të përhershëm, ndaj dhe një numër shumë i vogël i tyre kërkojnë azil.

Pjesa tjetër, përmes pikave kufitare tokësore në veri të vendit, vazhdojnë rrugëtimin drejt Kosovës apo Malit të Zi, me synimin për të depërtuar në vendet e BE-së. Prurjet e migrantëve të parregullt nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrika Veriore që kaluan kufirin greko-shqiptar erdhën në ulje gjatë vitit 2023 krahasuar me tre vitet e mëparshme (2020 – 2022).

Sipas të dhënave të policisë kufitare në rajonin e Korçës u identifikuan nga janari deri në dhjetor të vitit 2023 rreth 2340 migrantë të huaj të parregullt. Ndërkohë, gjatë periudhës janar -dhjetor të vitit 2023 në rajonin e Gjirokastrës u identifikuan 903 migrantë të huaj të parregullt ndërsa në territorin e Sarandës u identifikuan 1344 migrantë të huaj të parregullt.

---

<sup>269</sup> Në datë 29 dhjetor 2023, u nënshkrua dhe Marrëveshja e re e Bashkëpunimit me UNHCR-në për vitin 2024.

## Prurjet e migrantëve të parregullt për vitin 2023

<b>Viti</b>	<b>2023</b>
<b>Territori i Gjirokastrës</b>	<b>903</b>
<b>Territori i Sarandës</b>	<b>1344</b>
<b>Territori i Korçës</b>	<b>2340</b>

### *Panorama vendore e prurjeve migratore, Korçë*

Për periudhën janar-dhjetor 2023, në Qendrën pritëse në Kapshticë janë shoqëruar dhe akomoduar 2340 persona, nga të cilët 1463 persona kanë hyrë për herë të parë në territorin e Shqipërisë dhe 877 persona janë përsëritës.

Grupet e migrantëve që konsiderohen me risk janë gratë dhe fëmijët nën moshën 18 vjeç. Statistikat tregojnë se, gjatë kësaj periudhe kanë hyrë në mënyrë të parregullt 105 fëmijë nën moshën 18 vjeç, 96 gra mbi moshën 18 vjeç dhe 30 femra nën moshën 18 vjeç<sup>270</sup>. Krahasuar me vitet e fundit, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2023, ka vijuar rënia e prurjeve që nisi vitin e shkuar<sup>271</sup>. Për shkak të fluksit të migrantëve të parregullt gjatë dy viteve të fundit, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM) kreu një investim të ri brenda territorit të Qendrës Tranzitore në Kapshticë, duke shtuar edhe dy kapanone (kontenjerë), me qëllim rritjen e kapaciteteve akomoduese të Qendrës me 50 shtretër. Në këtë mënyrë, kapaciteti i Qendrës nga 60 shtretër që ishte deri në vitin 2022, aktualisht është për pritjen dhe akomodimin e 110 personave. Stafi i punonjësve të policisë në këtë qendër, i cili përgjigjej për intervistimin, përzgjedhjen dhe trajtimin e migrantëve, nuk kishte mungesa në organikë.

### *Rekomandime:*

- nevojitet përmirësimi i sistemit dhe trajnime për oficerët e migracionit që kryejnë intervistat e përzgjedhjes për të evidentuar kategoritë e migrantëve që kërkojnë dhe meritojnë mbrojtje;
- në 300 raste intervistimi nuk ka qenë i saktë nga ana e policisë kufitare dhe nuk bëhet pyetja nëse duan azil në Shqipëri ose jo;
- problematike mbeten qendrat sociale dhe qendra e pranimit në Babrru, që vazhdojnë të mos pranojnë azilkërkues. Pranojnë vetëm disa raste sporadike që advokohen. Nevojitet shqyrtimi dhe adresimi i kësaj problematike dhe zgjidhja e kapaciteteve të Qendrës;
- mungesa e një përkthyesi për gjuhët Dari, Fars etj, ku trendi i hyrjeve në territor kanë qenë nga Afganistani, dhe përkthimi është bërë nga përkthyes të FRONTEX;
- ambientet e GOS Kapshticë nuk furnizohen me ujë të rrjedhshëm dhe nuk funksionojnë tualetet dhe dushet.

<sup>270</sup> Referuar shtetësisë, migrantët në shumicën e tyre kanë qenë nga Siria, Iraku, Afganistani, Palestina, Maroku, Algjeria etj.

<sup>271</sup> Konkretisht, për vitin 2020 kanë hyrë nëpërmjet kufirit të Kapshticës gjithsej 15 534 migrantë të parregullt, për vitin 2021 kanë hyrë 13 228 migrantë dhe për vitin 2022 kanë hyrë 2328 migrantë të parregullt.

### ***Panorama vendore e prurjeve migratore, Gjirokastrë***

Sipas informacionit të Drejtorisë Rajonale të Kufirit Gjirokastrë numri i migrantëve të parregullt, të kapur në afërsi të kufirit të gjelbër dhe në territor është 903<sup>272</sup>. Referuar statistikave për vitin 2023, në PKK Kakavijë dhe Tre Urat konstatohet një ulje e numrit të migrantëve të parregullt të identifikuar në kufirin e gjelbër dhe në territor nga viti i kaluar. Nga informacioni në DVKM Gjirokastrë u evidentua se, migrantët kanë devijuar drejtimin e lëvizjes së tyre, duke hyrë në territorin e RSH-së nga *Pika e Kalimit të Kufirit në Qafë Botë* (në varësi të DVKM Vlorë).

Nga analiza e këtij fenomeni, tendenca në rritje e numrit të migrantëve të parregullt, është si rezultat i një sërë faktorësh që kanë të bëjnë mes të tjerave, me rritjen e numrit të migrantëve që mbërrijnë në Greqi nga vendet e lartpërmendura, si dhe ngritja e kampeve nga autoritetet greke, në afërsi të kufirit me Shqipërinë, konkretisht në rajonin e Janinës dhe Selanikut. Qëllimi i migrantëve të huaj është që pasi kalojnë kufirin (në rrugë apo shtigje që nuk kontrollohen nga forcat kufitare dhe FRONTEx), të hyjnë në territorin e Shqipërisë duke vazhduar lëvizjen në drejtim të pikave të tjera kufitare në veri të vendit tonë në drejtim të Kosovës apo Malit të Zi, me synimin që të mbërrijnë në vendet e BE-së, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend transit.

#### ***Rekomandime.***<sup>273</sup>

- procedurat e kthimit vullnetarisht në Greqi duhet të kryhen përmes një protokolli me palën greke;
- kryerja e evidentimit të migrantëve të parregullt nga shërbimet kufitare dhe procedurave të përzgjedhjes konform rregullave si dhe dekurajimin e çdo kthimi gjatë orëve të natës të migranëve drejt territorit grek;
- trajnimi i forcave policore kufitare në respektimin e të drejtave të migranëve dhe aspekteve të sigurisë së jetës së tyre sidomos gjatë operacioneve për ndjekjen e kontrabandistëve të cilët sipas monitorimeve në të shumtën e herës nuk u ndalojnë patrullave policore dhe kjo shpesh shoqërohet me aksidente rrugore;
- lidhur me qendrën pritëse që është vënë në funksion në Qafë Botë duhet të kihet kujdes që projekti të përfshijë medoemos edhe qasjen e burimeve njerëzore që do të përgjigjen për mirëmbajtjen dhe mbarëvajtjen e kësaj qendre.

### ***Panorama vendore e prurjeve migratore, Sarandë***

Janë konstatuar gjithsej 1344 shtetas të huaj të paligjshëm<sup>274</sup>, në territor kufitar si dhe në thellësi të territorit, nga të cilët 187 femra gjithsej, 1157 meshkuj dhe 172 të mitur të shoqëruar nga familjarët e tyre. Të gjithë këta shtetas janë për herë të parë dhe kanë kërkuar azil gjithsej 132 persona<sup>275</sup>.

<sup>272</sup> 744 (shtatëqind e dyzet e katër) shtetas për herë të parë; 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) përsëritës, të cilët ndodheshin në kushtet e largimit vullnetar; meshkuj 840 (tetëqind e dyzetë), femra 29 (njëzetë nëntë) dhe të mitur 30 (tridhjetë) nga këta 29 (njëzetë e nëntë) të mitur të pa shoqëruar dhe 1 (një) i shoqëruar nga familjarët e tij; procesi përzgjedhjes është kryer konform procedurës standarde të punës nga Sektori për Migracionin gjithsej për 903 (nëntëqind e tre) shtetas; lëshuar Urdhër Largimi me ekzekutim vullnetar për 852 (tetëqind e pesëdhjetë e dy) shtetas; kërkuar Azil në Republikën e Shqipërisë 4 (katër) shtetas; ndaluar në Q.M.Karreq-Tiranë me Urdhër Dëbimi 10 persona.

<sup>273</sup> Këto rekomandime janë edhe për zonën e Sarandës.

<sup>274</sup> Shtetasit e huaj të parregullt të kapur në territor kufitar si dhe në thellësi, sipas shtetësive janë kryesisht siriane 95, algjeriane 2, afgane 657, marokene 9, irakiane 6, iraniane 233, nepalezë 60, palestinezë 8, somalezë 2, rusë 1, pakistanezë 123, indianë 11, sudanezë 13, bangladeshas 112, Egjiptianë 2, Kinezë 6 etj.

<sup>275</sup> Shumica e tyre me shtetësi Afgane (126), Iranianë (5) dhe 1 me shtetësi Ruse. Janë lëshuar gjithsej 16 Urdhra Dëbimi dhe 1196 Urdhra Largimi Vullnetar.

Janë referuar për te Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) të Bashkisë Konispol gjithsej 8 raste për të huaj të parregullt, fëmijë të mitur të pashoqëruar. Për këta sipas rastit, katër prej tyre u sistemuan në ambientet e Qendrës Sociale të Bashkisë Gjirokastrë dhe katër të tjerë u sistemua te “Qendra Arsis” Tiranë.

Drejtimi kryesor i hyrjes në territor mbetet sektori Qafë Botë - Katajeto. Vihet re një rritje e vogël e numrit të shtetasve të huaj të parregullt të cilët kanë zgjedhur si rrugë kalimi territorin që mbulon Komisariati Sarandë. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ku numri i shtetasve të huaj të parregullt ishte gjithsej 1161, vërehet afërsisht një rritje e vogël me 183 shtetas të huaj të parregullt më shumë. Në çdo rast, është dhënë ndihmë mjekësore kur ishte e nevojshme dhe në bashkëpunim me organizatën “Caritasi Shqiptar” me qendër në Gjirokastrë, për këta shtetas është ofruar ushqim, veshmbathje dhe akomodim. Me hapjen e “Qendrës Tranzitore Pritëse” në PKK. Qafë Botë, është siguruar akomodim më i përshtatshëm për këto kategori.

Për të tre zonat gjeografike të përmenduar më sipër, në lidhje me trajtimin e të miturve të pashoqëruar dhe/apo viktimave të mundshme të trafikimit, ekzistojnë problematikat e mëposhtme:

- mungon Mekanizmi Kombëtar Referues, për rastet e personave me nevoja specifike si: fëmijët e ndarë apo të pashoqëruar, viktimat e mundshme të trafikimit;
- mungon një qendër kombëtare e trajtimit të fëmijëve të pashoqëruar të migrantëve të parregullt;
- mungon udhëzimi i Ministrit të Brendshëm për akomodimin afatgjatë të të miturve të pashoqëruar;
- qendrat nuk kanë kushtet për strehim afatgjatë për të miturit e pashoqëruar;
- sistemi i referimit në Azil ka nevojë të përmirësohet;
- mungon lista e përkthyesve dhe psikologëve të licencuar;
- mungon mbështetja me psikologë në qendrat e përkohshme;
- mungon personeli femër (punonjës policie, përkthyes, psikologë);
- lëvizja e personelit në disa nga Njësitë e Mbrojtës së Fëmijëve pranë Bashkive nga njëri sektor në tjetrin është e shpeshtë. Në rastet e ndihmës ndaj të miturve të pashoqëruar kjo krijon probleme me kualifikimin e stafeve që duhet të kenë trajnime në vijueshmëri;
- mungon stafi mjekësor në identifikimin e rasteve të cilat mund të jenë mbartës e përçues të sëmundjeve infektive.

Indikatorët	Rajoni	Target	Progresi
<i>Monitorimi i procedurave të përzgjedhjes dhe intervistimit të migrantëve</i>	Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë	1300 persona në vit	1330
<i>Vizita monitoruese në kufi dhe vendet e pritjes</i>	Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë	390 vizita	420

<b>Rekomandime Dep. të Kufirit dhe Migracionit</b>	<b>MKPT/Ekspertët</b>	<b>4</b>	<b>3</b>
<b>Raporte analitike për prurjet migratore</b>	<b>Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
<b>Intervistime të thelluara të migrantëve</b>	<b>Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë</b>	<b>600</b>	<b>530</b>
<b>Raportime vjetore të përbashkëta në UNHCR</b>	<b>Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë</b>	<b>12</b>	<b>12</b>

#### 4.1.8. Konferenca vjetore

Më datë 15 dhjetor 2023, u zhvillua Konferenca Vjetore e Avokatit të Popullit me temë “75 vjetori i Deklaratës Universale dhe 25 vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë: Evolucion i të drejtave të njeriut në Shqipëri”. Kjo konferencë synoi të reflektojë mbi përparimin e bërë gjatë 75 viteve të fundit, të njohë sfidat dhe të vizionojë të ardhmen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Të ftuar në cilësinë e panelistëve në Konferencë ishin Zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Ermonela Felaj, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Holta Zaçaj, Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Fiona McCluney, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Gulia Re, përfaqësues të tjerë të Kuvendit, institucioneve shtetërore e atyre të pavarura, përfaqësues të trupit diplomatik, organizatave të huaja në vendin tonë, shoqërisë civile e medias.

Konferenca u hap nga Avokatja e Popullit, Erinda Ballanca, e cila theksoi në mesazhin e saj se “Identifikimi dhe ravijëzimi i të drejtave të reja, apo formësimi i shumë të drejtave social-ekonomike kanë sjellë nevojën për të hedhur përsëri sytë tek parashikimet kushtetuese dhe për të parë nëse ato kalojnë testin e përputhshmërisë me realitetin bashkëkohor të të drejtave të njeriut. Sfidat dhe kompleksitetet e shekullit të 21-të kërkojnë një rivlerësim të kuadrit tonë kushtetues për të siguruar që ai të jetë i përshtatshëm, i përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës”.

Gjithashtu, u nënvizua fakti se “Përfshirja e objektivave sociale në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në një tjetër kapitull, në atë të të drejtave efektive është sot që flasim një nevojë e domosdoshme. Të drejtat efektive mjedisore, problematikat e të drejtave të njeriut, përparimi teknologjik, të gjitha këto janë të drejta që duhet të vihen në Kushtetutë në kapitullin e duhur në mënyrë që të kenë më tej edhe garancinë e duhur. Katalogu i ri i të drejtave të njeriut duhet të mbrojë grupet vulnerabël, që askush të mos mbetet prapa në rrugën drejt përparimit”.

Konferenca u zhvillua e ndarë në dy sesione diskutimesh ku në sesionin e parë panelistët trajtuan temën e “25-Vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë – Nevoja për interpretim Kushtetues dhe hapat për përmirësime

legjislative”, ndërsa në sesionin e dytë, temën: “Roli i Agjencive të Kombeve të Bashkuara – nga premtimi i të Drejtave të Njeriut 75 vite më parë, në arritjet dhe sfidat aktuale”

Këto panele u fokusuan në vlerësimin e rrugëtimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri që nga miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në 1948, duke njohur arritjet dhe momentet kyçe, identifikimi dhe diskutimi i sfidave dhe çështjeve të të drejtave të njeriut që hasen nga individët në Shqipëri, duke theksuar rolin e Avokatit të Popullit në adresimin e këtyre shqetësimeve si dhe nevojën e angazhimit në një dialog konstruktiv mbi strategjitë dhe nismat për të avancuar më tej të drejtat e njeriut në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore, vendim-marrësve dhe komunitetit ndërkombëtar.

Konferenca Vjetore e Avokatit të Popullit shërbeu si një platformë për diskutime, ndarje të njohurive dhe bashkëpunim për të siguruar një të ardhme më të drejtë të barabartë dhe që respekton të drejtat për të gjithë qytetarët si dhe për të nxitur një angazhim të përbashkët për të avancuar të drejtat e njeriut dhe për të ndërtuar një shoqëri që vlerëson dinjitetin dhe mirëqenien e çdo individit.

## KREU V

### BASHKËPUNIMI

---

#### *5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit*

---

Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet kryesore të Avokatit të Popullit është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë. Ky nocion përmban administrim të mirë të pronës publike, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të tregojë standardin e funksionimit për Administratën Publike, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është që të jetë në shërbim të qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre. Në punën tonë kemi konstatuar se krijimi i një kulture të të drejtave të njeriut në Shqipëri, kërkon bashkëpunim të ngushtë me organet e administratës publike, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike e median, si dhe rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të tij.

Funksioni dhe misioni i Avokatit të Popullit është të shqyrtojë çështjet që lindin si pasojë e keqadministrimit në administratën publike. Instrumenti i përditshëm, përmes të cilit Avokati i Popullit synon të arrijë rezultatin e tij, është rekomandimi. Pas shqyrtimit dhe hetimit të çështjeve të ndryshme, Avokati i Popullit realizon ndërmjetësimin dhe, nëpërmjet rekomandimeve të tij, synon t'i zgjidhë problemet mbi baza ligjore. Zgjidhjet e arritura nga ai synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe cilësinë e shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Opinionet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit synojnë të pasqyrojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Eksperienca ka treguar se zgjidhja e një rasti individual në fakt, shpesh evidenton një problem sistematik në fushën e respektimit të drejtave të njeriut, duke nxitur përgjegjësinë e organeve të administratës publike.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Përtej hapave dhe iniciativave pozitive të konstatuara ndër vite, mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim, jo vetëm nga organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor (sidomos sa i përket zbatimit të rekomandimeve) por edhe nga Kuvendi i Shqipërisë si organi legjislativ ku paraqiten dhe diskutohen raportet e hartuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. Është kjo arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore.

Zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga institucionet e administratës publike është treguesi më i mirë i zbatimit të ligjit organik dhe kuadrit rregullator përkatës, si dhe i përmbushjes se



misionit institucional, duke garantuar autoritetin dhe pavarësinë e këtyre institucioneve. Në këtë kuptim, roli i Kuvendit, i cili vëzhgon si institucionet ekzekutive ashtu edhe ato të pavarura, për të siguruar që i pari zbaton rekomandimet e këtij të fundit, konsiderohet shumë i rëndësishëm.

#### 5.1.1. Niveli i zbatimit të rekomandimeve

Gjatë vitit 2023 institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 266 rekomandime drejtuar organeve të administratës publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve, niveli i zbatimit të tyre deri në muajin *Shkurt të vitit 2024* rezulton si më poshtë:

▪ Rekomandime të pranuar dhe të zbatuara plotësisht	31 rekomandime ose 12%
▪ Rekomandime të pranuar dhe të zbatuara pjesërisht	116 rekomandime ose 44%
▪ Rekomandime të pranuar por të pa zbatuara	26 rekomandime ose 10%
▪ Rekomandime të refuzuara	23 rekomandime ose 9%
▪ Rekomandime pa përgjigje	56 rekomandime ose 21%
▪ Rekomandime në proces zbatimi	14 rekomandime ose 5%

Në totalin prej 31 ose 12% të rekomandimeve të pranuar dhe zbatuara plotësisht, janë përfshirë ato për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar plotësisht të gjitha pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe njëkohësisht duke i zbatuar këto në tërësinë e tyre.

Në totalin prej 116 ose 44% të rekomandimeve të pranuar dhe zbatuara pjesërisht, janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, plotësisht ose vetëm një pjesë të tyre dhe njëkohësisht duke i zbatuar ato vetëm për një pjesë të rekomandimit.

Në totalin prej 26 ose 10% të rekomandimeve të pranuar por të pazbatuara janë përfshirë ato për të cilat ndonëse ka pasur një përgjigje nga institucionet duke pranuar parimisht pikat e rekomandimeve, ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose të pjesshëm.

Në totalin prej 23 ose 9% të rekomandimeve të refuzuara janë përfshirë ato rekomandime për të cilat është kthyer përgjigje nga institucionet e administratës publike se refuzohet zbatimi i tyre.

Në totalin prej 56 ose 21% të rekomandimeve pa përgjigje janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ndonëse kanë kaluar afatet administrative procedurale, nuk ka pasur një përgjigje nga institucionet.

Në totalin prej 14 ose 5 % të rekomandimeve në proces janë përfshirë ato rekomandime të cilat janë raportuar në proces zbatimi nga institucionet.

Rekomandimet e adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, në pjesën më të madhe të rasteve adresojnë zgjidhjen e më tepër se një problematike të caktuar. Për këtë qëllim, brenda një rekomandimi të vetëm, që i adresohet organeve të administratës publike, mund të ketë disa rekomandime të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, ose thënë ndryshe disa nën-rekomandime. Në 266 rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2023, janë adresuar gjithsej 1275 nën-rekomandime.

### 5.1.2. Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt rekomandimeve të pranuar nga institucionet

Për efekt të raportimit të këtij indikator përllogaritja do të bazohet në numrin total të rekomandimeve të pranuar dhe atyre të zbatuara plotësisht. Nga 266 rekomandime të adresuara në total, numri i rekomandimeve të pranuar është 173 teksa numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është 31.

Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt të atyre të pranuar nga institucionet, është si më poshtë vijon:

$$R_{ACC} = \frac{31 \text{ rekomandime te zbatuara plotësisht}}{173 \text{ rekomandime te pranuar}} * 100 = 18 \%$$

### 5.1.3. Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integrimit Evropian

Bashkimi Evropian bazohet dhe zhvillohet mbi një angazhim real për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Garantimi i të drejtave themelore është një nga parimet bazë të këtij organizmi. Zhvillimi të drejtave të njeriut është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga interpretimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë e deri në dokumentet më të rëndësishme që trajtojnë këto çështje.

Në përputhje me mandatin e tij kushtetues, institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët kyç në sistemin kombëtar të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore që janë të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, përmes ofrimit të kontributeve domethënëse që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, si premisa për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të kontribuojë në gjithë këtë proces përmes pjesëmarrjes direkte në Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP) të ngritura në përputhje me kapitujt e acquis, për të përmendur veçanërisht angazhimin dhe kontributin e ofruar në kuadër të Kapitulli 23, i cili mbulon disa fusha të cilat janë nën ombrellën e përgjithshme të Gjyqësorit dhe të të Drejtave Themelore. Është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku vendosen kushtëzime strikte dhe etapa të caktuara së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu, pjesëmarrje dhe kontribute konkrete janë ofruar edhe për kapitullin 19.<sup>276</sup>

Ashtu siç është informuar edhe në raportin vjetor për vitin 2022, në datat 25 – 28 tetor 2022, u zhvillua misioni i vlerësimit të ekspertëve të kontraktuar nga Komisioni Evropian në kuadër të monitorimit të institucioneve të pavarura dhe vlerësimit të funksionimit efektiv të tyre, ku një nga institucionet e monitoruara ishte dhe Avokati i Popullit.

Në fund të muajit tetor 2023, u paraqit dhe draft-raporti i përgatitur nga ekspertët përkatës mbi të cilin Institucioni i Avokatit të Popullit shprehu vlerësime dhe konsiderata pozitive lidhur me atë çfarë ishte theksuar dhe evidentuar, duke rezervuar në të njëjtën kohë të drejtën e bërjes të komenteve dhe sqarimeve për disa elementë specifikë, jo vetëm për të shmangur keqkuptimet që mund të lindin, por edhe për të

<sup>276</sup> Politikat Sociale dhe Punësimi.

dhënë një pasqyrë të saktë dhe të përditësuar të të dhënave dhe situatave specifike të trajtuara në këtë raport.

Avokati i Popullit e konsideron këtë raport si një mjet shumë të vlefshëm jo vetëm për identifikimin dhe portretizimin e saktë të mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin funksionon institucioni i Avokatit të Popullit, por edhe për dhënien e një sërë rekomandimesh konkrete për adresimin e duhur të çështjeve. Këto rekomandime krijojnë një hapësirë më domethënëse për veprim dhe ushtrim të mandatit në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë dhe kontribuar edhe në kuadër të takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri, ku mund të veçojmë kontributin e dhënë në kuadër të takimit të 14-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian- Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, të zhvilluar më datë 14-15 Qershor 2023, nëpërmjet platformës Webex, për çështje që lidheshin kryesisht me:

- e drejta e jetës, parandalimi i torturës dhe i keqtrajtimit dhe sistemi i burgjeve<sup>277</sup>;
- mbrojtja e minoriteteve;
- të drejtat e fëmijëve;
- të drejtat e personave të komunitetit LGBTI;
- përfshirja e komunitetit Rom/Egjiptian;

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë kontributin e tij në kuadër të procesit të hartimit të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024 - 2030, Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, si dhe në hartimin e Kontributit të Qeverisë Shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023.

Avokati i Popullit ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive edhe në kuadër të mbledhjeve dhe raportimeve të zhvilluara nga Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin Evropian që funksionon pranë Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit.

---

## 5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar<sup>278</sup>

---

Qasja ndërkombëtare e Institucionit të Avokatit të Popullit në bashkëpunim me faktorët brenda dhe jashtë vendit, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të angazhimit institucional në përmbushje të misionit kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit

---

<sup>277</sup> Duke u fokusuar në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues.

<sup>278</sup> Në mënyrë të detajuar, aktivitetet ndërkombëtare të institucionit të Avokatit të Popullit gjenden në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Pjes%C3%ABmarrje%20n%C3%AB%20aktivitetet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20vitin%202023.pdf>

vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë krijimit dhe forcimit të marrëdhënieve me institucionet homologe, organizatat dhe rrjetet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë kuptim, në kalendarin e aktiviteteve ndërkombëtare të vitit 2023, shënohet një rritje e prezencës së Avokates të Popullit dhe përfaqësuesve të saj në veprimtari të ndryshme si: trajnime, webinare, takime pune apo konferenca, të organizuara nga zyrat homologe dhe nga organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Pjesëmarrja aktive në nivele të larta përfaqësimi ka mundësuar, ndër të tjera, shkëmbimin e eksperiencave të mira në forcimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) si institucione të forta, efektive e të pavarura, thelbësore për garantimin e promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave. Më konkretisht, disa nga veprimtaritë kryesore në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë si më poshtë:

Në datat 13-14 mars 2023, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca së bashku me Komisioneren e Seksionit të Përgjithshëm, znj. Vilma Shurdha morën pjesë në takimin e bordit dhe Asamblenë e Përgjithshme të ENNHRI-it, e cila u zhvillua në Gjenevë. Në këtë takim pati përfaqësues nga 40 Institucione Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të Evropës, ku u diskutua raporti mbi aktivitetet e fundit të ENNHRI-it për të arritur qëllimin e tij në fuqizimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjithë Evropën. Gjithashtu, anëtarët diskutuan studimin e ENNHRI-it mbi zbatimin e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut. Takimi në Gjenevë vijoi më tej me Asamblenë e Përgjithshme dhe Konferencën Vjetore të Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI), të cilat u zhvilluan në datat 14-16 mars. Ndër të tjera, takimi shërbeu si një mundësi për të shënuar 30 vjetorin e Parimeve të Parisit dhe rrjetit global të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, si dhe 75 vjetorin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, duke kujtuar rëndësinë primare e të drejtave të njeriut dhe duke theksuar veprimet e ndërmarra nga IKDNJ-të sot për të adresuar çështjet urgjente të të drejtave të njeriut me të cilat përballen komunitetet anembanë globit. Konferenca vjetore ofroi mundësinë për të reflektuar mbi gjendjen aktuale të të drejtave të njeriut si dhe identifikimin e sfidave, prioriteteve dhe mundësive. Gjithashtu, qëllimi i këtij aktiviteti lidhej me krijimin e kushteve për reflektime të reja mbi rëndësinë e Deklaratës Universale dhe Parimeve të Parisit në kontekstin e sotëm.

Në vijim të aktiviteteve të vazhdueshme të Agjencisë së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (FRA) si dhe në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë si anëtare vëzhguese në këtë Agjenci, u zhvillua një takim online më datë 29 mars 2023 me ekspertë kombëtarë të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Në këtë takim, morën pjesë Avokatja e Popullit dhe përfaqësues të institucionit. Gjatë zhvillimit të takimit u prezantuan të dhënat e reja të FRA-së dhe gjetjet për sa i përket zbatimit të kartës në nivel kombëtar.

Avokatja e Popullit mori pjesë në takimin e bordit të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, takim i cili u zhvillua në datat 15-16 maj 2023 në Berlin. Takimi u bashkëorganizua me Institutin Gjerman të të Drejtave të Njeriut dhe anëtarët e ENNHRI-it diskutuan çështjet që lidhen me rishikimin e progresit dhe statutin e ENNHRI-it, objektivat afatgjatë si dhe akreditimin e anëtarëve të rrjetit.

Në datat 24-25 maj 2023, u zhvillua në Prishtinë, Konferenca e 12-të dhe Asambleja e Përgjithshme të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), në të cilën morën pjesë Avokatja e Popullit dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Tema e Konferencës ishte "Integriteti dhe pavarësia e institucioneve

të Ombudsmanit-qëndrueshmëri përmes sfidave", dhe shërbeu si një mundësi për të diskutuar mbi tipologjinë e kërcënimeve me të cilat përballet pavarësia e Institucioneve të Ombudsmanit, praktikat e mira dhe përgjigjet efektive ndaj tyre. Avokatja e Popullit, znj.Ballanca, mori pjesë edhe në cilësinë e drejtuesit të panelit të parë të diskutimeve me temë "Pavarësia si një element thelbësor për një institucion Ombudsmani efektiv". Në përfundim të punimeve, anëtarët e AOM-së miratuan "Deklaratën e Prishtinës" duke ndalur në disa qëndrime të përbashkëta që synojnë të forcojnë bashkëpunimin dhe aktivitetet në të ardhmen.

Institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua nga Komisionerja e Seksionit për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, znj.Olta Aliaj, në seminarin e organizuar nga Rrjeti Evropian i Ombudsmanit për të Drejtat e Fëmijëve,<sup>279</sup> të zhvilluar në datat 29-30 maj 2023, në Stokholm, Suedi. Në seminarin e zhvilluar nën drejtimin e zyrës së Ombudsmanit për Fëmijët të Suedisë, u diskutua mbi rolin e Institucioneve të Pavarura të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut/Fëmijëve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe forcimin e kapaciteteve mbi adresimin e reagimit/përgjigjes së këtyre institucioneve në kohë krizash ekonomike, shëndetësore, klimatike, lufte, etj.

Në simpoziumin e nivelit të lartë mbi të drejtat e njeriut që u organizua online, në datat 5-6 qershor 2023, nga Ministria Federale Austriake për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare, në bashkëpunim me Komisionerin e Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, mori pjesë Avokatja e Popullit. Në panelet e njëpasnjëshme, ku morën pjesë mbrojtës të të drejtave të njeriut nga e gjithë bota, u diskutua mbi temat e "universalitetit të të drejtave të njeriut", "teknologjitë e reja në lidhje me të drejtat e njeriut" dhe "të drejtat e njeriut si zgjidhje për sfidat aktuale"<sup>280</sup>.

Avokatja e Popullit, znj. Ballanca mori pjesë në mbledhjen e rradhës së Bordit të Rrjetit Evropian të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), që u zhvillua në datat 29-30 gusht 2023, në Oslo, Norvegji. Programi i diskutimeve në këtë mbledhje parashikonte vendimmarrje lidhur me amendimet e statutit të ENNHRI-it, planin strategjik për vitin 2024, përfshirjen e institucioneve anëtare, përcaktimin e tematikave prioritare, si dhe përgatitjet përfundimtare për punimet e Asamblesë së Përgjithshme me rastin e 10 vjetorit të krijimit të organizatës.

Në datat 13-14 shtator 2023, në Romë, Itali, u zhvillua Konferenca me temë: "Mbrojtja e të drejtave themelore në operacionet e kthimit të detyruar: perspektiva evropiane", në të cilën morën pjesë Avokatja e Popullit dhe Komisioneri i Seksionit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Ahmet Prençi. Objektivi kryesor i konferencës, e organizuar nga Garantuesi Italian i të Drejtave të Personave të Privuar nga Liria, ishte diskutimi rreth mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut gjatë operacioneve të kthimit të detyruar në Evropë, në kuadër të një projekti mbi implementimin e sistemit të monitorimit të kthimit të detyruar, financuar nga AMIF<sup>281</sup>. Gjatë konferencës, Avokatja e Popullit mbajti fjalën e saj duke ndarë eksperiencën dhe rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbrojtjen e të drejtave themelore në operacionet e kthimit të detyruar.

Komisionerja për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Znj. Olta Aliaj, mori pjesë në Konferencën e 27-të vjetore të Rrjetit Evropian të Ombudsmanit për të Drejtat e Fëmijëve (ENOC) dhe

---

<sup>279</sup> ENOC.

<sup>280</sup> Globalizimi, digjitalizimi, migrimi dhe ndryshimet klimatike.

<sup>281</sup> Ayslum, Migration and Integration Fund 2014-2020.

Asamblenë e Përgjithshme të organizatës. Takimi u zhvillua në datat 19-21 shtator 2023, në Bruksel, Belgjikë, ku tema kryesore e konferencës lidhej me forcimin e institucioneve të pavarura që kanë fokusin në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh pikënisjen e tyre dhe zhvillimet e mundshme nga perspektiva të ndryshme.

Në datat 27-28 shtator 2023, në Helsinki, Finlandë, u zhvillua takimi i 13-të i Platformës së Bashkëpunimit të Këshillit të Evropës (COE), Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) dhe Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET) mbi të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, dhe Grupit të Punës të ENNHRI-t për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore. Në këto takime mori pjesë Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm, znj. Vilma Shurdha, dhe përfaqësues nga ky seksion.

Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca dhe përfaqësues të tjerë të institucionit morën pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Konferencën e nivelit të lartë të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), me temë “Avancimi në të Drejtat e Njeriut, Demokracisë dhe Shtetit të së Drejtës në kohë kritike në Evropë; Roli i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) dhe ENNHRI-t”, që u zhvilluan në datat 9-10 tetor 2023, në Bruksel, Belgjikë.

Znj. Ballanca mbajti fjalën e hapjes në takimin e nivelit të lartë që u fokusua në sfidat kryesore të IKDNJ-ve në Evropë, në mbështetje të mbrojtësve së mjedisit, lirisë së shprehjes, tubimit paqësor dhe grupimit. Ky panel diskutimi u zhvillua jo vetëm në kontekstin e punës së Rrjetit për mbrojtjen e IKDNJ-ve, por edhe në kuadër të veprimtarive të shtuara mbi ndryshimet klimatike, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Aktivitetet e zhvilluara përkuan me 10 vjetorin e krijimit të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Në datën 18 tetor 2023, në Gjenevë, Zvicër, u zhvillua Sesioni i 86-të të Komitetit për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në të cilën morën pjesë Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, dhe Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm, znj. Vilma Shurdha. Pjesë e agjendës së këtij aktiviteti të rëndësishëm ishte, ndër të tjera, dhe shqyrtimi i Raportit të Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”. Institucioni i Avokatit të Popullit përgatiti një Raport Alternativ për Zbatimin e Konventës “Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave në Shqipëri”, i cili shpалos gjetjet e Institucionit për zbatimin e Konventës CEDAW nga shteti shqiptar gjatë viteve 2016-2020.

Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca dhe përfaqësues të tjerë të institucionit morën pjesë në konferencën e nivelit të lartë me temë “E drejta për mirëadministrim: mit, aspiratë apo realitet?”, e bashkëorganizuar nga Ombudsmani i Maltës dhe Shoqata e Ombudsmanit të Mesdheut (AOM), e cila u zhvillua në datat 31 tetor-1 nëntor 2023, në Maltë. Konferenca kishte në fokus mirëadministrimin dhe ishte konceptuar në formatin e disa sesioneve plenare, i pari prej të cilëve u drejtua nga znj. Ballanca e cila trajtoi rolin e Avokatit të Popullit si një institucion që duhet të sigurojë që administratat publike të mbeten të drejta dhe të përgjegjshme. Në fund të takimit, u miratua Deklarata e Maltës për Mirëadministrimin.

Komisioneri Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Ukrainë (UPCHR), Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut (DIHR), Aleanca Globale e Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) dhe Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), bashkëorganizuan një konferencë

ndërkombëtare me temë “Tortura dhe keqtrajtime të tjera: Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut”, e cila u zhvillua në datat 6-8 nëntor 2023, në Kopenhagen, Danimarkë. Në këtë konferencë, morën pjesë Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca si dhe Komisioneri i Seksionit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Ahmet Prençi. Avokatja e Popullit, drejtoi një ndër panelet ku u trajtua tema e rolit të IKDNJ-ve në mbrojtjen grupeve të margjinalizuara nga tortura dhe keqtrajtimet, si dhe u adresuan aspekte të ndryshme të parandalimit të torturës, rehabilitimit të viktimave dhe kornizave ligjore.

Avokatja e Popullit, znj. Ballanca, mori pjesë në konferencën e Rrjetit Evropian të Ombudsmanit (ENO), organizuar nga Ombudsmani Evropian, znj. Emily O’Reilly, me temë “Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut-qasja në migracion dhe inteligjencë artificiale”, e cila u zhvillua në datën 9 nëntor 2023, në Bruksel, Belgjikë. Konferenca u fokusua në çështjen se si Bashkimi Evropian trajton migracionin, implikimet e inteligjencës artificiale (IA) në vendimmarrje si dhe në mënyrën se si administrata publike ndërvepron me qytetarët.

Në datë 15 nëntor 2023, u zhvillua online një webinar i organizuar nga Institucioni i Mediatorit të Mbretërisë së Marokut dhe Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit, me temë “Fuqia rekomanduese e Mediatorëve dhe Avokatit të Popullit për të mbështetur reformën administrative dhe ligjore”, ku mori pjesë edhe Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, e cila në fjalën e saj nënvizoi angazhimin e institucionit që ajo drejton për përpjekjet aktive në funksion të dhënies së rekomandimeve, të cilat kanë patur një ndikim real në konsolidimin e kornizës ligjore dhe administrative në Shqipëri. Gjithashtu, në vëmendjen e të pranishmëve u theksua roli i Avokatit të Popullit si një institucion proaktiv dhe konkretisht duke e vendosur në kontekstin e Mesdheut, u evidentua lidhshipi i Shqipërisë në inkurajimin e nxitjes së bashkëpunimit rajonal.

Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) organizoi një takim mbi forcimin e kapaciteteve për Inteligjencën Artificiale<sup>282</sup>, në datat 30 nëntor-1 dhjetor 2023, në Ljubjanë, Slloveni. Takimi shërbeu si hapësirë për shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes anëtarëve të ENNHRI-t dhe si një mundësi e mirë për të analizuar Inteligjencën Artificiale, forcimin e kapaciteteve të punës së IKDNJ-ve rreth saj dhe të drejtave të njeriut përmes shkëmbimit të ideve dhe përvojës/punës së përbashkët, zhvillimin e njohurive rreth sfidave potenciale dhe mundësive. Në këtë takim mori pjesë dhe Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca.

### ***Bashkëpunimi rajonal***

Një delegacion nga Shqipëria, kryesuar nga Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, Komisioneri i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Ahmet Prençi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, z. Admir Abrija zhvilluan një vizitë pune në datë 23 qershor 2023, në Prishtinë, Kosovë. Ky takim u realizua në vijim të bashkëpunimit institucional me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në fushën e trajtimit të personave të privuar nga liria.

Komisioneri i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Ahmet Prençi mori pjesë në konferencën rajonale me temë “Siguria për njerëzit dhe kufijtë, lufta kundër kontrabandës së migrantëve dhe mbrojtja e tyre në rrugën e Ballkanit Perëndimor”, të zhvilluar në datat 26-27 tetor 2023, në Beograd,

---

<sup>282</sup> I quajtur ndryshe "The ENNHRI Co-Lab".

Serbi. Konferenca e mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian, kishte në fokus shkëmbimin e përvojës dhe mundësive për përmirësimin e reagimit rajonal sa i përket luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, mbrojtjes së migrantëve dhe krijimit të mekanizmave kombëtarë të pavarur për monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në kufijtë shtetërorë.

Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm, znj. Vilma Shurdha morën pjesë në Konferencën rajonale një ditore për “Krimin e Urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes: sfidat dhe zgjidhjet në reagimet”. Konferenca u organizua nga OSBE në Tiranë, më datë 21 nëntor 2023, duke ofruar një mundësi për praktikuesit në rajon që të diskutojnë ndërlidhjen midis krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, duke u përqendruar në sfidat dhe zgjidhjet në reagim.

Një përfaqësi e lartë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kryesuar nga znj. Ballanca mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ombudsmeni i Malit të Zi me rastin e 20-vjetorit të krijimit të institucionit të Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Malit të Zi, më datë 11 dhjetor 2023, në Podgoricë, Mali i Zi, në vijim të përpjekjeve për të forcuar bashkëpunimin me institucionet homologe të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në rajon dhe më gjerë.

Dita e të Drejtave të Njeriut shënoi një tjetër aktivitet të rëndësishëm në Shqipëri, sikurse ishte organizimi i Tryezës Vjetore të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Në këtë aktivitet, zhvilluar më datë 12 dhjetor 2023, u mbledhën së bashku Institucione Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Organizata të Shoqërisë Civile, për të përcjellë mesazhet e tyre dhe për të evindetuar sfidat në këtë 75-vjetor të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, mori pjesë në këtë aktivitet duke theksuar angazhimin e vazhdueshëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në Shqipëri.

Në datë 12 tetor 2023, në Tiranë, Avokatja e Popullit priti Sekretarin e Përgjithshëm të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, ku u diskutua në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në nivel vendor dhe rajonal, çështja e zbatueshmërisë së vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) nga ana e shtetit shqiptar, si dhe roli i organeve të vetëqeverisjes vendore në promovimin, respektimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar bashkëpunimin me Zyrën e Këshillit të Evropës, Delegacionin e BE-së në Tiranë, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së dhe agjencitë përkatëse të tilla si UNHCR, UNICEF, UN Women dhe UNFPA. Falë këtyre bashkëpunimeve, edhe në formën e kontributeve, aktiviteteve e projekteve të përbashkëta, Avokati i Popullit ka mundur të rrisë kapacitetet institucionale, të shtojë praninë e vet në terren dhe të kryejë një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse.



---

### 5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

---

#### ***Marrëveshja me UNHCR***

Avokati i Popullit, edhe përgjatë vitit 2023 ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNHCR për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve, forcimin si dhe respektimin e të drejtave të tyre. Dy ekspertët e Institucionit të Avokatit të Popullit, në pikat e kalimit kufitar, Gjirokastrë dhe Kapshticë, dhe një ekspert me kohë të pjesshme në qytetin e Tiranës kanë vijuar kryerjen e monitorimit sistematik të kufijve, monitorimin e procedurave të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt, raportimin periodik të gjetjeve si dhe trajtimin e zgjidhjes së problematikave të hasura. Në dhjetor 2023, u nënshkrua Marrëveshja e re e Bashkëpunimit për vitin 2024, e cila do të mbulojë më shumë aktivitete duke qenë se fondet e vendosura në dispozicion nga donatori janë më të mëdha krahasuar me një vit më parë.

#### ***Projekti “Sereny”***

Avokati i Popullit edhe përgjatë vitit 2023 vijoi zbatimin e projektit të financuar nga Programi i Drejtësisë së Bashkimit Evropian me titull “Përforcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në burgje dhe në Shërbimin e Provës”, i shtatë vendeve anëtare të BE-së (Itali, Spanjë, Austri, Slloveni, Gjermani, Francë dhe Belgjikë) dhe Shqipërisë. Qëllimi i këtij projekti konsistonte në forcimin e qasjes për parandalimin e radikalizimit të të rinjve (18-29 vjeç) në burgje dhe shërbimin provës në nivel evropian, sipas standardeve ndërkombëtare dhe rezolutës së Parlamentit Evropian të 5 tetorit 2017 mbi sistemet dhe kushtet e burgjeve (2015/2062(INI)).

Kushtet degraduese të burgjeve, mbipopullimi dhe keqtrajtimi janë faktorë që mund të kontribuojnë në rritjen e radikalizimit në sistemin e burgjeve. Në këtë kontekst, të burgosurit e rinj të moshës 18-29 vjeç konsiderohen të pambrojtur dhe të rrezikuar nga radikalizimi pasi janë ende në procesin e zhvillimit të identitetit të tyre. Ky projekt u fokusua në stafet e institucioneve të privimit të lirisë dhe shërbimit të provës si dhe aktorë të tjerë të përfshirë (politikëbërësit dhe Ombudsmanët) të cilët siguruan që problemi i radikalizimit tek të rinjtë në paraburgim t’u adresohet në mënyrë efektive profesionistëve dhe vendimmarrësve.

Aktivitetet e planifikuara kërkimore të kombinuara me aktivitetet e parashikuara për ndërgjegjësim si dhe për ndarjen e praktikave më të mira, u ofruan grupeve të synuara njohuri mbi nivelin makro dhe mezo (legjislacioni kombëtar dhe praktikave të administratave të burgjeve dhe të shërbimit të provës) dhe mbi nivelin mikro, d.m.th. dimensionin individual i përfshirë në proceset e radikalizimit. Çdo program specifik që synon një grup të caktuar të dënuarish, si ata që konsiderohen si të 'radikalizuar', duhet të respektojë të njëjtat kritere të të drejtave të njeriut dhe detyrimet ndërkombëtare që zbatohen për çdo të burgosur tjetër.

Gjatë vitit 2023 u zhvillua faza e tretë e projektit “Analizë mbi dimensionin individual të radikalizimit të të rinjve” e cila përbante intervistimin e të rinjve në burgje, intervistimin e punonjësve në kontakt të drejtëpërdrejtë me të dënuarit në burgje, si dhe përgatitjen e një udhëzuesi dhe raporti përfundimtar të vlerësimit. Projekti përfundoi në tetor të vitit 2023.

### ***Projekti në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para Anëtarësimit në BE (IPA)***

Gjatë vitit 2023 vijoi zbatimi i projektit “Mbështetja për zyrën e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri”. Projekti i binjakëzimit filloi të zbatohet që nga muaji qershor 2022 dhe përfundoi në qershor të vitit 2023<sup>283</sup>.

Siç dhe kemi raportuar projekti synonte të mbështesë institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar dhe konkretisht ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, me legjislacionin e BE-së në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke promovuar parimet e shtetit të së drejtës, të të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes nëpërmjet rritjes së efikasitetit të kontrollit të ligjshmërisë në punën e organeve të administratës publike. Pritshmëritë dhe rezultatet e zbatimit të këtij projekti ishin harmonizimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së<sup>284</sup>, detyrimet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së, rritja e kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit si një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në zbatimin e mandatit të tij promovues si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve të Avokatit të Popullit sipas modeleve dhe praktikave të suksesshme të shteteve anëtare të BE-së.

### ***Projekti për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve (Sistemi Doculive)***

Siç kemi informuar edhe më parë, që nga muaji shtator 2022 e në vazhdim, në bashkëpunim me UNFPA<sup>285</sup> në Shqipëri, është duke u zbatuar projekti për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve (Sistemi Doculive) të Avokatit të Popullit. Ky sistem ka të bëjë me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve dhe ankesave që paraqiten pranë institucionit të Avokatit të Popullit, përmes përpunimit të të dhënave dhe prodhimit të statistikave të ndryshme që lidhen me të drejtat e shkelura të qytetarëve si dhe institucionet përgjegjëse për mosrespektimin e këtyre të drejtave. Projekti është duke u zbatuar nga kompania indiane “Wishtree” dhe pritet të përfundojë në muajt në vazhdim. Gjithsesi, vlen të përmendet se sfidat teknologjike nuk janë të vogla dhe ka nevojë për investime thelbësore në digjitalizim.

### ***Projekti "SERVRIGHT"***

Në muajin qershor 2023, Avokati i Popullit, përmes një një marrëveshje të nënshkruar me Rrjetin Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), përfitoi një grant të vogël për zbatimin e projektit “Mbrotjtja e të Drejtave të Njeriut në Digjitalizimin e Shërbimeve Publike në Shqipëri – SERVRIGHT”.

Qëllimi i këtij projekti lidhet me faktin se procesi i digjitalizimit të shërbimeve publike si pjesë e strategjisë kombëtare të qeverisjes elektronike, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, rritjen e efikasitetit, zvogëlimin e burokracisë dhe rritjen e transparencës shoqërohet padyshim me pasoja të konsiderueshme në fushën e të drejtave të njeriut. Ndërsa digjitalizimi mund të përmirësojë qasjen në shërbimet publike dhe të zvogëlojë korrupsionin, gjithashtu mund të krijojë forma të reja të përjashtimit dhe diskriminimit, veçanërisht për grupet e prekura të cilave u mungon aksesimi në teknologji, ose aftësitë dixhitale. E thënë kjo, Avokati i Popullit ka një rol të rëndësishëm në sigurimin që digjitalizimi i

---

<sup>283</sup> Kujtojmë se projekti u zhvillua në bashkëpunim me Bordin e Avokatit të Popullit në Austri, Institutin për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut Ludwig Boltzmann, Austri dhe Avokati i Popullit të Shqipërisë

<sup>284</sup> Janë përgatitur draft-amendamentet për ligjin e Avokatit të Popullit.

<sup>285</sup> United Nation Population Fund.

shërbimeve publike në Shqipëri të zhvillohet në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë hulumtimin, ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve, monitorimin dhe raportimin, si dhe angazhimin me palët e interesuara për të mbrojtur standardet e të drejtave të njeriut në këtë kontekst. Në këtë kuadër është e rëndësishme që shteti shqiptar të sigurojë që digjitalizimi i shërbimeve publike të zhvillohet në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë privatësinë, mosdiskriminimin, transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Nëpërmjet këtij projekti dhe aktiviteteve të tija kryesore, institucioni i Avokatit të Popullit ka synuar të realizojë një analizë të thelluar të impaktit që ka digjitalizimi i shërbimeve publike në Shqipëri, për të konkluduar me hartimin e një raporti të veçantë i cili do të ndahet me Kuvendin, institucionet e pushtetit qendror dhe gjithë palët e tjera të interesuara. Në funksion të këtij qëllimi, më datë 29 shkurt 2024, u zhvillua në Tiranë një takim me të gjithë aktorët e interesuar, përfaqësues nga institucionet publike, shoqëria civile, përfaqësues të grupeve vulnerabile etj, në të cilën u diskutua në lidhje me raportin e përgatitur si dhe u dhanë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

---

#### *5.4 Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues*

---

##### *5.4.1. Rëndësia e komunikimit publik të Avokatit të Popullit*

Rritja e pranisë publike të Avokatit të Popullit shënon një sukses të rëndësishëm në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Përmes nismave të ndryshme si takimet publike, faqet zyrtare në media sociale dhe organizimin e ligjërimeve të hapura, Avokati i Popullit ka arritur të shtrijë kufijtë e transparencës dhe të sigurojë një platformë të hapur për qytetarët për të raportuar dhe adresuar çështjet e tyre.

Prania publike e Avokatit të Popullit nxit përgjegjësinë dhe llogaridhënien në administratën publike dhe promovon sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, duke e bërë atë një partner të rëndësishëm në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Në çdo prezantim publik, Avokati i Popullit ka sjellë në vëmendje rolin e tij proaktiv në mbështetje të qytetarëve, përmes ndërhyrjeve të tij dhe rekomandimeve. Gjithashtu, ky institucion në të gjitha paraqitjet publike është fokusuar në edukimin e publikut në lidhje me të drejtat e tij dhe për të ofruar udhëzime për mënyrat sesi publiku mund të përfitojë nga shërbimet dhe ndihma e ofruara nga Avokati i Popullit.

Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në forume ku janë adresuar çështje të rëndësishme sociale, gjithashtu kanë qenë të një rëndësie të veçantë. Në të tilla aktivitete ky institucion përmes prezencës së tij, ka nxitur diskutime për të garantuar drejtësi dhe barazi për të gjithë qytetarët.

##### *5.4.2. Media Sociale*

Prania e Avokatit të Popullit në rrjetet sociale, veçanërisht në Facebook, përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në përdorimin e teknologjisë, për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëveprimin me qytetarët. Nëpërmjet faqes zyrtare në Facebook, Avokati i Popullit ofron informacione të rëndësishme

për misionin, funksionet dhe aktivitetet e tij, duke siguruar që qytetarët të jenë të informuar për të drejtat e tyre, por edhe shënjon ditët e rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të tjera ngjarje që janë të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

Për vitin 2023, faqja zyrtare e Avokatit të Popullit në platformën Facebook vijon të ketë një rritje të qëndrueshme të vizitorëve por edhe të numrit të ndjekësve, duke shkuar nga 9,286 në 9,500 persona, një tregues i interesit dhe mbështetjes së publikut për punën dhe mesazhet e institucionit.


#### Facebook visits ⓘ

66.5K ↑ 56.3%




Në vitin 2023, faqja zyrtare e Avokatit të Popullit në rrjetin social Facebook ka shënuar një qasje të ndryshme sa i takon përqindjes gjinore të ndjekësve. Me një përfaqësim prej 39.9% femra dhe 60.1% meshkuj, audiencat e faqes tregojnë një ndryshim në preferencat gjinore në ndjekjen e përmbajtjes dhe mesazheve të Avokatit të Popullit në këtë rrjet social. Kjo përmbledhje e shifrave duhet të na ndihmojë në përshtatjen e një strategjie komunikimi si një mundësi potenciale për të zhvilluar edhe më tej lidhjen me këtë segment të publikut dhe për të përmirësuar ndërgjegjësimin dhe angazhimin e burrave dhe djemve në temat që trajtohen nga Avokati i Popullit.

#### Age & gender ⓘ



E rëndësishme është të theksohet se grupmosha 25 - 44 vjeç vijoi të dominojë audiencën, duke zënë një përqindje të lartë të ndjekësve. Kjo përshtatet me një tendencë të njohur në rrjetet sociale, ku kjo grupmoshë shfaq interes të madh për çështjet sociale dhe politike.

#### Top cities



Ndërkohë është e rëndësishme të përmendet se shumica e ndjekësve janë nga kryeqyteti, një faktor që mund të interpretohet si një indikator i ndikimit të fortë të Avokatit të Popullit në zonën kryesore urbane të vendit. Gjithashtu faqja zyrtare në Facebook e Avokatit të Popullit për vitin 2023 ishte një kanal i rëndësishëm komunikimi ku në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë reale, u bë transparencë mbi vendimmarrjet dhe rolin mjaft të rëndësishëm që ky institucion luajti në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë dhe shoqërisë civile.

“**Faktet përmes shifrave**” është një rubrikë e veçantë në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit në Facebook, ku publikohen të dhëna dhe statistika të ndryshme lidhur me veprimtarinë e institucionit. Kjo rubrikë ofron një perspektivë të qartë dhe të detajuar për numrin e ankesave të pranuar, kërkesave të procesuara, si dhe për ndërhyrjet dhe rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në adresimin e çështjeve administrative dhe të drejtave të qytetarëve. Përmes kësaj rubrike, qytetarët kanë mundësinë të marrin informacion të përditësuar dhe të verifikueshëm lidhur me performancën dhe ndikimin e institucionit në shoqëri.

#### 5.4.3. Prezenca dhe reagimet publike mbi ngjarjet e aktualitetit në median tradicionale

Në një analizë të prezencës së Avokatit të Popullit në mediat tradicionale, është vërejtur se gjatë 2023, Avokati i Popullit ka dhënë mbi 10 intervista të gjërësishme tematike. Këto intervista janë zhvilluar në platforma të rëndësishme të mediave kombëtare dhe të tjera televizive që kanë një audiencë gjithëpërfshirëse. Përmbajtja e këtyre intervistave është përqendruar në çështje aktuale, duke siguruar një platformë për të diskutuar dhe për të ngritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe interesat e qytetarëve.

Njoftimet përmes titrave televizive në televizionet informative më të rëndësishme të vendit, siguruan që mesazhi i Avokatit të Popullit të arrijë një audiencë të gjerë. Titujt e lajmeve të transmetuara në edicionet

informative kanë ofruar një qartësi mbi çështjet që Avokati i Popullit ka trajtuar, duke nxitur diskutime dhe reflektim në opinionin publik<sup>286</sup>.

Angazhimi publik ka ndihmuar në përmirësimin e transparencës së punës së Avokatit të Popullit dhe ka rritur ndërgjegjësimin publik për rolin e tij thelbësor në mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Vijimësia e prezencës mediatike ka synuar përmirësimin e ndikimit dhe besueshmërinë e institucionit në sytë e publikut. Të menjëhershme kanë qenë reagimet e Avokatit të Popullit mbi ngjarje të rënda që kërkojnë një qasje proaktive përmes reagimeve mbi tema, analiza dhe ngjarje të caktuara, në emisione investigative, duke ofruar pikëpamjet e tij për çështje të ndryshme që janë në fokus të interesit publik.

Politika e hapur e Avokatit të Popullit me median përfshin një qasje të drejtpërdrejtë dhe transparente për çështje të rëndësishme të aktualitetit. Duke komunikuar hapur dhe në mënyrë të qartë, Avokati i Popullit shërben si një zë i qytetarëve dhe përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në veprimtarinë e tij. Përmes intervistave, komenteve dhe analizave, Avokati i Popullit ka ofruar pikëpamjet e tij për çështje të ndryshme ligjore dhe sociale, duke ndihmuar në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe zbardhjen e çështjeve të rëndësishme për shoqërinë.

#### 5.4.4. Aktivitetet publike zyrtare

Konferenca vjetore e Institucionit të Avokatit të Popullit<sup>287</sup>, në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së në Shqipëri, “75-Vjetori i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe 25-Vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë: Evolucionin e të drejtave të njeriut në Shqipëri” ishte një aktivitet i rëndësishëm dhe mediat e trajtuan atë në mënyrë të thelluar. Ky aktivitet u transmetua në kohë reale, ndërsa portalet e lajmeve online siguruan një mbulim të gjerë të audiencës mbi diskutimet e zhvilluara në konferencë. Mesazhi i Avokatit të Popullit për rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut u përhap gjerësisht dhe u bë pjesë e dialogut publik.

Në nivel ndërkombëtar, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në konferenca, forume dhe takime të nivelit të lartë, për të promovuar vlerat e drejtësisë dhe transparencës në nivel global dhe për të ndërtuar lidhje të reja me organizata të tjera ndërkombëtare.

Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit janë një instrument i rëndësishëm në promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shoqërinë tonë. Ata ndihmojnë në forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet e shtetit dhe shërbejnë si një dëshmi e përkushtimit të Avokatit të Popullit për të mbrojtur dhe përfaqësuar interesat e tyre.

---

<sup>286</sup> Për më shumë referojuni faqes zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

<sup>287</sup> Për më shumë referojuni faqes zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

## KREU VI

### SHËRBIMET MBËSHTETËSE

#### 6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe administrative përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të funksionimit, performancës, dhe ecurisë së një institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut. Për të garantuar që institucionet publike të veprojnë në përputhje me standardet dhe aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut *është e domosdoshme mbështetja e vazhdueshme me burime njerëzore dhe financiare të këtyre institucioneve.*

Parimet e Parisit kërkojnë që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të kenë një numër adekuat të burimeve njerëzore. Ngjashëm me burimet financiare, kjo kërkesë përfshihet edhe në Parimet e Venecias dhe njihet dhe nga rekomandimi i Komisionit Evropian për organet e barazisë. Mungesa e stafit të mjaftueshëm dobëson aftësinë e IKDNJ-ve për të kryer aktivitetet e tyre në mënyrë efektive dhe për të përmbushur mandatet e tyre. Në këtë drejtim, edhe Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023, ndër të tjera, theksoi përsëri nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore dhe administrative të institucionit të Avokatit të Popullit<sup>288</sup>. Forcimi i vazhdueshëm i këtyre kapaciteteve ka qenë dhe mbetet një nga sfidat e institucionit të Avokatit të Popullit, duke vlerësuar gjithashtu edhe mbështetjen që është dhënë deri më tani në këtë drejtim.

Siç është theksuar dhe më parë, mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar<sup>289</sup>. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit, çka krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t’u përshtatur dhe përgjigjur në formën dhe mënyrën e duhur funksioneve e detyrave të institucionit. Gjatë viteve të fundit, struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e shërbimit civil. Këto ndryshime kanë synuar dhe reflektuar pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore si dhe plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës.

<sup>288</sup> Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit është theksuar dhe në rekomandimet e lëna nga Misioni i Vlerësimit të Komisionit Evropian (Peer review) që u realizua në datat 25 – 28 tetor 2022, në Tiranë, mbi monitorimin e institucioneve të pavarura dhe funksionimin efektiv të tyre. Për më shumë në lidhje me rekomandimet e lëna referojuni [linkut: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/FINAL%20Report%20on%20PA%20Advance%20Peer%20review%20mission.pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/FINAL%20Report%20on%20PA%20Advance%20Peer%20review%20mission.pdf)

<sup>289</sup> Në nenin 35, paragrafi 3.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave buxhetore shtesë për vitin 2024, gjatë seancës dëgjimore<sup>290</sup> të zhvilluar me Komisionin e Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, u kërkua:

- miratimi i një pozicioni “Ndhmëskomisioner” në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës (MKPT); si dhe,
- përfshirja e punonjësve me kontrata të përkohshme (përfaqësuesit e zyrave rajonale) në strukturën dhe organikën e institucionit.

Me miratimin e ligjit nr. 66/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, u konstatua se numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2024 është 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) nga 59 (pesëdhjetë e nëntë) që ishte. Këto shtesa kanë të bëjnë pikërisht me miratimin e kërkesës së argumentuar për përfshirjen e zyrave rajonale si pjesë tashmë e organikës së institucionit. Ky miratim shkon në linjë me nevojën e ndryshimit të mënyrës së funksionimit të këtyre zyrave, e theksuar si nga Nënkomiteti i Akreditimit në GANHRI-it<sup>291</sup> gjatë finalizimit të dhënies së statusit “A” për institucionin e Avokatit të Popullit (dhjetor 2020), ashtu dhe nga Misioni i Vlerësimit<sup>292</sup> nga Komisioni Evropian mbi Monitorimin e Institucioneve të Pavarura dhe Funksionimin efektiv të tyre, ku është rekomanduar që punonjësit e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së institucionit. Avokati i Popullit e ka mirëpritur këtë përmirësim.

Këto ndryshime u reflektuan tashmë edhe tek struktura e re e institucionit, miratuar me Urdhërin e Avokates së Popullit, nr.2, datë 03.01.2024 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, duke respektuar të njëjtat parime dhe standarde që ndiqen gjatë hartimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës shtetërore, në përputhje të plotë me vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendës ministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bazuar në lidhjen nr. 12 të së cilës, përfaqësuesit e zyrave rajonale përfshihen në emërtesën e pozicionit “Specialist”, kategoria IV-II.

Në administratën publike, nëpunësit civilë konsiderohen si pjesë e një trupe të mirëpërgatitur, profesionale dhe elitë, të cilët janë rekrutuar për t’i shërbyer interesit publik dhe për të qenë të përgjegjshëm për veprimet e ndërmarra në interes të qytetarëve. Rekrutimi është aktiviteti kryesor dhe më i rëndësishëm në të cilin gjen zbatim konkret qëllimi dhe ambicia e ligjit për “krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike”.

Në këtë aspekt, duhet të theksojmë, se gjatë vitit 2023, në përputhje me dispozitat e rekrutimit të legjisllacionit në fushën e shërbimit civil, nga Institucioni janë shpallur disa pozicione të lira<sup>293</sup>, duke

---

<sup>290</sup>Nëntor 2023.

<sup>291</sup> Aleanca Globale e të Drejtave të Njeriut.

<sup>292</sup> Tetor 2023.

<sup>293</sup> 6 pozicione.




pasur parasysh dorëheqjet, largimet në detyra të tjera brenda administratës publike apo pezullimin e statusit për arsye të ndryshme.

Gjithashtu, gjatë muajit maj 2023, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil<sup>294</sup>, nisi procesin e mbikëqyrjes në institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes ishte:

- monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij;
- paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion u përgatit dhe raporti i mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Avokati i Popullit, në të cilën vlerësohej zbatimi i ligjshmërisë në procedurat e ndjekura gjatë aplikimit të instituteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, si dhe u dhanë disa rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të administrimit të shërbimit civil. Për vitin 2023, struktura e institucionit, miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 10, datë 27.01.2023 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar, paraqitet si më poshtë:



<sup>294</sup> Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

**Lidhja nr. 2**

<b>Emërtimi i funksionit</b>	<b>Numri i Punonjësve (59)</b>	<b>Kategoria/Klasa</b>
<b>Avokati i Popullit</b>	<b>1</b>	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
<b>Kabineti</b> - Drejtor Kabineti - Këshilltar - Sekretar	<b>6</b> 1 4 1	I-2 I-3 Lidhja nr. 5
<b>Sekretar i Përgjithshëm</b>	<b>1</b>	I-1
<b>Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre</b> - Komisioner - Ndhmëskomisioner - Ndhmëskomisioner	<b>7</b> 1 3 3	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4 II-1
<b>Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor</b> - Komisioner - Ndhmëskomisioner - Ndhmëskomisioner	<b>5</b> 1 2 2	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4 II-1
<b>Seksioni i Përgjithshëm</b> - Komisioner - Ndhmëskomisioner - Ndhmëskomisioner	<b>7</b> 1 4 2	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4 II-1
<b>Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve</b> - Komisioner - Ndhmëskomisioner - Ndhmëskomisioner	<b>4</b> 1 2 1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4 II-1

<p><b>Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioner</li> <li>- Ndhmëskomisioner</li> <li>- Ndhmëskomisioner</li> </ul>	<p><b>6</b></p> <p>1</p> <p>2</p> <p>3</p>	<p>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar</p> <p>I-4</p> <p>II-1</p>
<p><b>Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtor</li> </ul> <p><b>Sektori i Burimeve Njerëzore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Specialist për Burimet Njerëzore</li> <li>- Specialist Protokolli</li> <li>- Specialist Arkivist/Bibliotekar</li> </ul> <p><b>Sektori i Shërbimeve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Shofer i titullarit</li> <li>- Shofer</li> <li>- Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme</li> <li>- Punëtor pastrimi</li> </ul> <p><b>Sektori i Financës dhe Prokurimeve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Specialist i Financës</li> <li>- Specialist i Prokurimeve</li> </ul> <p><b>Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës sektori</li> <li>- Specialist IT</li> <li>- Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit</li> </ul>	<p><b>19</b></p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p>	<p>II-2</p> <p>III-1</p> <p>IV-1</p> <p>IV-1</p> <p>IV-1</p> <p>III-1</p> <p>Klasa VI</p> <p>Klasa IV</p> <p>Klasa VI</p> <p>Klasa I</p> <p>III-1</p> <p>IV-1</p> <p>IV-1</p> <p>III-1</p> <p>IV-1</p> <p>IV-1</p>
<p><b>Sektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Specialist</li> </ul>	<p><b>3</b></p> <p>1</p> <p>2</p>	<p>III-1</p> <p>IV-1</p>

## 6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2023", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"- i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2023 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023" - i ndryshuar, performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2023, paraqitetsi më poshtë:

### *Programi - "Shërbimi Avokatisë"*

Buxheti i akorduar për këtë program<sup>295</sup> kanë bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2023- 2025 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2023-2025).

### ***Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2023***

Me ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2023", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

**Tabela për planifikimin dhe realizimin e fondeve buxhetore për vitin 2023**

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar 2023	Shtesa dhe Pakësime	Plani i ndryshuar 2023	Fakti 2023
600	Paga	93,600,000	31,930,000	125,530,000	122,401,718
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	14,400,000	2,100,000	16,500,000	15,990,136
602	Mallra dhe shërbime të tjera	23,600,000	- 2,000,000	21,600,000	17,926,111
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	12,000	1,712,000	1,706,288
606	Transf për buxhetet familjare	700,000	238,000	938,000	355,612
231	Investimet	4,000,000		4,000,000	3,737,036
	<b>TOTALI</b>	<b>138,000,000</b>	<b>32,280,000</b>	<b>169,650,000</b>	<b>162,116,901</b>

<sup>295</sup> I vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit.

**Tabela mbi realizimet e shpenzimeve për vitin 2023**

Nr.	Emërtimi	Plani i rishikuar 2023	Fakti 2023	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	125,530,000	122,401,718	3,128,282	97.51
2	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	16,500,000	15,990,136	509,864	96.91
3	Mallra dhe shërbime të tjera	21,600,000	17,926,111	3,673,889	82.99
4	Transferta Korente të Huaja	1,712,000	1,706,288	5,712	99.67
5	Transferta për buxhetet familjare	938,000	355,612	582,388	97.51
6	Investimet	4,000,000	3,737,036	262,964	93.43
	<b>Totali</b>	<b>170,280,000</b>	<b>162,116,901</b>	<b>8,163,099</b>	<b>95.21</b>

**Tabela për planifikimin dhe realizimin e fondeve për vitin 2023**




Tabela per strukturen e fondeve per vitin 2023<sup>296</sup>




Tabela e fondeve të miratuara ndër vite

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga dhe sigurime	Shpenzime Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	2015	75,500	16,000	4,000	21	51	95,500
2	2016	84,500	17,000	4,000	21	55	105,500
3	2017	84,500	18,000	4,000	21	56	106,500
4	2018	94,500	17,500	4,000	21	56	116,000
5	2019	104,500	18,600	2,000	21	56	125,100
6	2020	98,500	17,000	1,000	21	56	116,500
7	2021	98,500	17,500	3,000	21	56	119,000
8	2022	102,500	22,700	4,000	22	57	129,200
9	2023	108,000	26,000	4,000	24	59	138,000

### 1. Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Fondi i akorduar për vitin 2023, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 93,600,000 lekë, i ndryshuar me Aktet-Normative nr. 3, datë 12.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për buxhetin e vitit 2023””, në 125,530,000 lekë, ndërsa realizimi është 122,401,718 lekë ose 97.51%, i buxhetit të ndryshuar, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 14,400,000 lekë, i ndryshuar me Aktet-Normative nr. 3, datë 12.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për buxhetin e vitit 2023””, në 16,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 15,990,136 lekë ose në masën 96.91

<sup>296</sup> Konstatohet se 79% e buxhetit përbëhet nga paga dhe sigurime shoqërore duke rezultuar në fonde të limituara për të ushtruar rolin promovues.

% i buxhetit. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2023 janë realizuar në masën 97.44 % i buxhetit të ndryshuar dhe përbëjnë 85.36% të buxhetit faktik të institucionit.

Gjatë vitit 2023, numri mesatar i punonjësve ka qenë 55 punonjës nga 59 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësisimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakante të krijuara në fund të vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023<sup>297</sup>. Duhet theksuar se gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit të stafit për Sektorin e Teknologjisë së Informacionit (IT), është konstatuar vështirësi apo mungesë shprehje interesi për shkaqe që lidhen me trajtimin financiar të këtyre pozicioneve të punes, trajtim i cili jo vetëm që ka një diferencë të dukshme me sektorin privat por është i ndryshëm edhe vetë brenda administratës publike ku në disa institucione të caktuara pozicione të tilla trajtohen shumë më mirë në aspektin financiar.

Kjo ka sjellë vështirësi reale jo vetëm në aspektin e realizimit të procedurave të rekrutimit (ku kemi qenë të detyruar të rishpallim disa herë thirrjen për shprehje interesi) por dhe në pamundësinë e përthithjes së ekspertizës së duhur për këto pozicione.

## **2. Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera**

Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (zëri 602) për periudhën janar – dhjetor 2023 ishte 21,600,000 lekë ndërsa realizimi është 17,926,111 lekë ose 99.67 % i buxhetit. Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, elektrike, materiale promovuese, furnizim me materiale të tjera zyre, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjetesh, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, shpenzime për organizimin e konferencës vjetore 2023, si dhe shpenzime për taksa të paguara.

Fondi për transferta korente të huaja (zëri 605) për vitin 2023, ishte 1,700,000 lekë, i ndryshuar me “Transferim fonde për vitin 2023” në 1,712,000 lekë ndërsa realizimi është 1,706,288 lekë ose 99.67 % i buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2023, këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësisimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare, sipas tabelës më poshtë:

---

<sup>297</sup> Pozicione që rekrutohen sipas dispozitave të ligjit në fushën e shërbimit civil, dispozitave të Kodit të Punës si dhe vakanca që plotësohen nga Kuvendi i Shqipërisë (psh. Komisionerët).

Nr.	Emërtimi i Organizatës	Monedha	Kuotacionet në vite							
			Vlera në vite							
			2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
2	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	750	900	900	900	900	900	900
3	Rrjeti European i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3,000	3,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
4	Rrjeti European të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
5	Instituti European i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350	350	350
6	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
7	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750	750	750

Fondi për transferata buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Dhjetor 2023, ishte 700,000 lekë, i ndryshuar me “Transferim fonde për vitin 2023” në 938,000 lekë, ndërsa realizimi është 355,612 lekë ose 37,91 % i buxhetit të ndryshuar.

### 3. Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 4,000,000 lekë, ndërsa realizimi 3,737,036 mijë lekë ose 93.43%.

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
Blerje kondicioneresh	M660011	500,000	498,576	99.72
Blerje Pajisje kompjuterike+server	M660009	2,900,000	2,825,960	97.45
Blerje orendi zyre	M660001	600,000	412,500	68.75
		4,000,000	3,737,036	93.43



## KREU VII

### AVOKATI I POPULLIT NË SHIFRA 2023




Gjatë ushtrimit të mandatit gjatë vitit 2023, në institucionin e Avokatit të Popullit, janë depozituar ankesat/kërkesat e qytetarëve mbi pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore nëpërmjet:

- Paraqitjes fizike në zyrën qendrore me seli në qytetin e Tiranës;
- Paraqitjes fizike në 7 zyrat rajonale të cilat gjenden në qytetet: Berat, Dropull, Fier, Kukës, Pogradec, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë;
- Shërbimit postar;
- Postës elektronike (e-mail);
- Rrjeteve sociale;
- Aplikacionit mobile;
- Faqes zyrtare të institucionit;
- Telefonit.


Kështu në vitin 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjithsej 7056 raste /kërkesa, 792 raste më shumë se vitin e kaluar. Konkretisht:

- 1259 raste kanë rezultuar si raste “brenda juridiksionit dhe kompetencës” së institucionit;
  - 1021 raste janë kërkesa/ankesa;
  - 238 raste janë trajtuar me iniciativën e institucionit
- 75 raste kanë rezultuar jashtë juridiksionit;
- 5722 raste janë trajtuar në formën e këshillimeve dhe orientimeve mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të rasteve të tyre.

**RASTE TË DEPOZITUARA NË AP DHE ZYRAT RAJONALE NË VITET 2021-2023**




Paraqitja grafike e rasteve të depozituara nga qytetarët në zyrën qendrore dhe 7 zyrat rajonale të AP.




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të depozituara pranë AP në vitin 2023.

### RASTET NDËR VITE




Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara ndër vite nga institucioni i Avokatit të Popullit.

### TË DHËNAT E ZYRAVE RAJONALE NË VITET 2019 - 2023




Paraqitja grafike e të dhënave të zyrave rajonale në vitet 2019-2023.

## SHPËRNDARJA E RASTEVE SIPAS ZYRAVE RAJONALE PËR VITIN 2023



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas zyrave rajonale për vitin 2023.




Paraqitja grafike e rasteve të depozitura pranë zyrave rajonale të institucionit AP e shprehur në përqindje.


Më poshtë jepet një vështrim krahasimor i ankesave të ardhura nga Zyrat Rajonale për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Total ankesa + K/O	Viti	Z.R. Sarandë	Z.R. Dropull	Z.R. Berat	Z.R. Vlorë	Z.R. Kukës	Z.R. Pogradec	Z.R. Shkodër	TOTALI
	2021	588	122	315	180	110	231	64	1,610
2022	669	104	540	261	163	1,086	88	2,911	
2023	685	144	492	643	229	966	234	3,393	
<b>Ndryshimi</b>		<b>2%</b>	<b>38%</b>	<b>-9%</b>	<b>146%</b>	<b>40%</b>	<b>-11%</b>	<b>166%</b>	<b>17%</b>


Paraqitja grafike e të dhënave në tabelën e mësipërme është si në vijim:



### ANKESAT DHE K/O VITET 2021-2023




Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja e 1259 rasteve të shqyrtuara nga institucioni AP sipas qarqeve dhe qyteteve për vitin 2023.




	1
Tiranë	362
Vlorë	85
Shkodër	84
Sarandë	74
Durrës	73
Berat	68
Pogradec	65
Fier	48
Korçë	44
Elbasan	44
Lezhë	40
Të papërcaktuara	28
Gjirokastrë	28
Lushnjë	18
Kurbin	18
Dibër	18
Malsi e Madhe	17
Kuçovë	17
Krujë	17
Kukës	15
Mat	14
Tepelenë	11
Peqin	8
Tropojë	7
Pukë	7
Përmet	7
Gramsh	7
Bulqizë	7
Kavajë	5
Rrogozhinë	4
Librazhd	4
Has	4
Delvinë	4
Mirditë	3
Devoll	2
Skrapar	1
Kolonjë	1
Jashtë Shqipërisë	0
Mallakastër	0

### SHPËRNDARJA E ANKESAVE SIPAS QARQEVE 2020-2023




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i AP-së në vitet 2020-2023 sipas qarqeve.

### INSPEKTIVE/MONITORIME 2023



Paraqitja grafike e shpërndarjes së inspektimeve/monitorimeve nga Seksionet e AP-së në vitin 2023.




Paraqitja grafike e shpërndarjes së inspektimeve/monitorimeve nga Seksionet e AP-së në vitet 2021-2023.



Gjatë ushtrimit të veprimtarisë në vitin 2023, institucioni i Avokatit të Popullit, ka përfunduar hetimin administrativ për 1591 raste të pretendimeve për shkelje të të drejtave themelore të individëve. Nga këto, 563 raste ose 35% janë raste të depozituara në vitin 2023 dhe 1028 raste apo 65%, i përkasin rasteve të depozituara vitet e mëparshme.

**RASTE PËR TË CILAT KA PËRFUNDUAR HETIMI ADMINISTRATIV NË VITIN 2023**






Paraqitja grafike e rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ në vitin 2023.


Për këto 1591 raste për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ, rezulton se:

- Për 572 raste apo 36% të tyre, shkeljet apo problematikat e konstatuara gjatë hetimit, janë adresuar pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim;
- Për 318 raste apo 20% të tyre, ka rezultuar që rastet kanë qënë të pabazuara;
- Për 266 raste apo 17% të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ pasi shkeljet janë adresuar nëpërmjet rekomandimeve;
- Për 65 raste ose 4 % të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ si shkak i heqjes dorë nga ankuesi;
- Për 75 raste ose 5% të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ pasi kanë rezultuar si raste jashtë juridiksionit;
- Për 136 raste ose 9% të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ pasi kanë rezultuar si raste jashtë kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit.
- Për 159 raste ose 10% të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ për arsye të tjera (për shembull është bashkuar ankesa me një ankesë tjetër, është mbyllur dosja pas përgjigjeve për rekomandimet, etj.).


#### RASTET E MBYLLURA GJATË VITIT 2023 SIPAS SEKSIONEVE TË AP



### MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË HETIMIT TË RASTEVE, VITI 2023




Paraqitja grafike e mënyrave të përfundimit të hetimit të rasteve gjatë vitit 2023




Paraqitja grafike e mënyrave të përfundimit të hetimit të rasteve e shprehur në %.

### NUMRI I RASTEVE PËR TË CILAT KA PËRFUNDUAR HETIMI ADMINISTRATIV NË VITET 2020-2023, ZGJIDHUR PA REKOMANDIM




Paraqitja grafike e numrit të rasteve të zgjidhura në favor pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim në vitet 2020 - 2023.

### RASTET E ZGJIDHURA PA REKOMANDIM NË VITIN 2023 SIPAS SEKSIONEVE TË AP



Nga totali i 572 rasteve të zgjidhura në favor të qytetarit, pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim, rezulton se 242 raste, se rreth 42% e tyre i përkasin rasteve të nisura ndaj organeve të pushtetit vendor.

### RASTE PËR TË CILAT KA PËRFUNDUAR HETIMI ADMINISTRATIV NË VITIN 2023 SIPAS INSTITUCIONEVE



Paraqitja grafike e rasteve të zgjidhura në favor pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim, në sipas tipologjisë së institucioneve.




Paraqitja grafike e numrit të rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ në vitet 2020-2023.




Gjatë vitit 2023, institucioni i Avokatit të Popullit, ka trajtuar me iniciativën e tij nga indicie të tilla si mediat, emisionet investigative, rrjetet sociale, etj. 238 raste të shkeljeve të të drejtave themelore të individit.

### KURBA E NDRYSHIMIT TË RASTEVE ME INICIATIVË



Paraqitja grafike e kurbës së ndryshimit të rasteve me iniciativë të trajtuara në vitet 2018–2023.

### RASTE TE MBYLLURA SIPAS VITEVE




■ 2014 
 ■ 2015 
 ■ 2016 
 ■ 2018 
 ■ 2019 
 ■ 2020 
 ■ 2021 
 ■ 2022 
 ■ 2023

VITI	2014	2015	2016	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI
Raste të mbyllura sipas viteve	1	3	2	11	3	197	220	591	563	1591

## RASTE TE MBYLLURA SIPAS SEKSIONEVE 2014-2023

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni i Përgjithshëm			1				6	4	118	132	261
Seksioni i Veçantë		1			2		46	25	108	197	379
Seksioni i Administratës	1	2	1		2	1	24	76	163	148	418
Seksioni i MKPT					7	2	107	94	115	32	357
Seksioni i Fëmijëve							14	21	87	54	176
Totali	1	3	2	0	11	3	197	220	591	563	1591


### SEKSIONI I PËRGJITHSHËM



■ Viti 2016 ■ Viti 2020 ■ Viti 2021 ■ Viti 2022 ■ Viti 2023

Viti	2016	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni I Përgjithshëm	1	6	4	118	132	261


## SEKSIONI I VEÇANTË



■ Viti 2015  
 ■ Viti 2018  
 ■ Viti 2020  
 ■ Viti 2021  
 ■ Viti 2022  
 ■ Viti 2023

Viti	2015	2018	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni I Veçantë	1	2	46	25	108	197	379


## Seksioni I Administratës



■ Viti 2014  
 ■ Viti 2015  
 ■ Viti 2016  
 ■ Viti 2018  
 ■ Viti 2019  
 ■ Viti 2020  
 ■ Viti 2021  
 ■ Viti 2022  
 ■ Viti 2023

Viti	2014	2015	2016	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni I Administratës	1	2	1	2	1	24	76	163	148	418


### SEKSIONI I MKPT



■ Viti 2018 ■ Viti 2019 ■ Viti 2020 ■ Viti 2021 ■ Viti 2022 ■ Viti 2023

VITI	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni i MKPT	7	2	107	94	115	32	357


### SEKSIONI I FËMIJËVE



■ Viti 2020 ■ Viti 2021 ■ Viti 2022 ■ Viti 2023

Viti	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni I Fëmijëve	14	21	87	54	176






Paraqitja e rasteve të trajtuara me iniciativë sipas seksioneve të institucionit të AP-së për vitin 2023, shprehur në numër dhe %.




Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, në vitin 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 266 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike, përfshire ato qendrore dhe vendore ku 198 rekomandime i përkasin rasteve të vitit 2023 dhe 68 rekomandime i përkasin rasteve të mbartura ndër vite.




Paraqitja grafike e kurbës së ndryshimit të numrit të rekomandimeve të adresuar nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite.

**REKOMANDIMET E ADRESUARA NË VITIN 2023 SIPAS SEKSIONEVE**




## REKOMANDIME SIPAS SEKSIONEVE



Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuar ndër vite nga seksionet përkatëse.

Nga 266 rekomandime institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar gjithsej 1275 zëra, apo nënrekomandime.


## ZËRAT E REKOMANDUARA SIPAS SEKSIONEVE VITET 2020-2023



Paraqitja grafike e numrit të zërave të rekomanduara sipas seksioneve krahasuar për vitet 2020 – 2023


Siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, nga 1275 zëra të rekomanduara nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të mandatit të tij në vitin 2023, 34 % e tyre janë zbatuar nga institucionet e rekomanduara, 18% janë zbatuar pjesërisht, 33% nuk janë zbatuar, 9 % nuk kanë marre ende një përgjigje dhe 5% janë refuzuar.

## REKOMANDIME




VITI	VITI 2015	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023	TOTALI
Nr. I Rekomandimeve	1	2	7	59	197	266

## Rekomandime sipas seksioneve 2015-2023




Viti	2015	2020	2021	2022	2023	Totali
Seksioni i Përgjithshëm				14	41	55
Seksioni i Veçantë	1			8	25	34
Seksioni i Administratës		1	7	27	19	54
Seksioni i MKPT				2	92	94
Seksioni i Fëmijëve		1		7	21	29
<b>Totali</b>						266

## ZBATIMI I NËNREKOMANDIMEVE SIPAS SEKSIONEVE




Paraqitja grafike e zbatimit të nënrekomandimeve për vitin 2023

## INSTITUCIONET E ADRESUAR ME REKOMANDIM NË VITIN 2023



Paraqitja grafike e numrit të institucioneve të adresuara dhe të vëna në dijeni sipas seksioneve.

### GJINIA E ANKUESVE PËR TË CILËT INSTITUCIONI KA ADRESUAR REKOMANDIM




Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuar në vitet 2020-2023 sipas gjinisë së ankuesit.



Shpërndarja e rekomandimeve të realizuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015<sup>298</sup> paraqitet si më poshtë:

### REKOMANDIME TË ADRESUARA NË VITIN 2023 SIPAS SDG




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rekomandimeve sipas Objektivave të SDG.

<sup>298</sup> Për një informacion më shumë lidhur mbi SDG -> [Lexo SDG](#)




Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara në vitin 2023, sipas fushave kryesore të të drejtave

### SHPERNDARJA E RASTEVE TE REGJISTRUARA NË VITIN 2023 SIPAS INSTITUCIONEVE





Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara në vitin 2023, sipas sistemit të institucioneve

### INSTITUCIONET NDAJ TË CILAVE ADRESOHET PJESA MË E MADHE E ANKESAVE, 2023





## SHPËRNDARJA E RASTEVE SIPAS FUSHËS SË TË DREJTËS



Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara për hetim nga institucioni i AP-së sipas shkëlqes së të drejtës së pretenduar, viti 2023.

## PRETENDIME PËR SHKELJE SIPAS SË DREJTËS 2021-2023

